


PANAJOT BARKA

**KRYENGRITJE
E
TRADHTUAR**

- KRONIKE -



PANAJOT BARKA

KRONIKE E

NJE KRYNGRITJEJE TE TRADHETUAR

GJIROKASTER 1998

Vendimin për të shkruar këtë libër
e mora natën e dy marsit 1997, kur kishin
qëlluar me kalashnikov mbi muret e apartamentit
tim. Ishte ora dy e natës. Nuk ndodhesha aty dhe
djali im trevjeçar ishte mbledhur sa një grusht
mbi një karrige dhe priste mua «për t'i vrarë» ata
që qëlluan. Unë kuptohet nuk do të vrisja njëri,
por shkrova këtë libër që të kontribuojë për
të vertetën e madhe të shkatërrimit të stetit dhe

të tradhëtisë së aspiratës së popullit

NE VEND TE HYRJES

Që kur Sudja mbylli qepenët për hërë të fundit, në fund të nëntorit të vitit 1996, dhe deri tek deklarimi i falimentimit të Gjallices në fillim të Shkurtit, dhe veçanarisht gjatë marsit, situata në vend zhvillohet me një shpejtësi ndryshimesh politike të pakonceptueshme për mënyrën se si erdhi në pushtet dhe si e administronte atë Sali Berisha. Njëkohësisht këto zhvillime dhe fundi i turpshëm i Berishës vertetuan se shpërftyrimi i shtetit, i parimeve demokratike dhe i vlerave njërezore kishin arritur në një shkallë të tillë sa që mund të mendohet pa frikë se do të duhen shumë vite, mund dhe përkushtim kolektiv për t'i rigjenëruar.

Para se të ndodhte shkatërrimi i Beratit, Vlorës, I ushtrisë, policisë dhe I gjithë vendit, në Shqipëri ishin rrenuar së brendshmi institucionet e shtetit. Një shkatërim që prej kohësh kishte si shfaqje të jashtme godinat ku ishte vendosur, kryeministria, ministritë. Rrugicat, shkallarët, mobiljet e tyre muret, ishin ngrënë dhe rrjepur sikur atje jetonin njërez të dalë nga shpellat. Fasadat e tyre mbëten të palyera gjersa dolën parullat e vjetra Italiane dhe të diktaturës komuniste. Kanatët e dritarëve u bënë gati të binin mbi kokat e kalimtarëve. Edhe Presidenca, që ndryshonte paksa nga godinat e tjera të shtetit të porozuar, priste momentin e largimit të Berishës për t'u rrjepur me rite barbarësh. Pikërisht ky shpërftyrim total I shtetit ishte njëkohësisht një tregues I qartë I shkallës së lartë të grabitjës nga shtetarët I vlerave morale dhe materiale të shtetasve të vet deri në atë kufi sa tek këta shtetas nuk ishte vrarë ende shpresa për të ribërë edhe një hërë shtetin nga fillimi. Përvoja i kishte mësuar se shtëpia e vjetër, sado meremetim që t'i besh, prap e vjetër mbetet, ndaj dhe iu bindën me vërbëri urrejtjës ndaj shtetit mashtrues.

Po t'u kthehemi këtyre zhvillimeve, do të vëmë re se kishin dy komponentë me një dimesion kundërshtie për jetë a vdekje që rritej me progresion gjeometrik. Nga njëra anë qëndronte Berisha me shtetin e tij të korrumpuar, që shkërmoqej dita-ditës, (gjersa perfundoi në një klan njërezish pa vlerë, por që mbeti deri në fund i pandryshuar në dëshirën për të mbajtur me çdo mjet dhe pasojë pushtetin), dhe nga ana tjetër shfaqëshin njëra pas tjetrës palë që kompensoheshin reciprokisht dhe që shfaqnin vetëm një dimesion. Ishin kundër Berishës.

Kështu, në fillim të janarit shtypi i pavarur dhe opozitar, që deri atëherë mbajti peshën kryesore në rolin e opozites politike, tregon një lodhje në lidhje me zbardhjen e enigmës fajde dhe me përpjekjet për të denoncuar makinën e stërkonsumuar të pushtetit të Berishes.

Pas këtij momenti shfaqën partitë politike opozitare të cilat deri në javën e parë të Shkurtit arrijnë të bëhën strumbullari i luftës politike kundër Berishës. Mjetët që përdorin duket se e tmerrojnë njëriun e gjithëpushtetshëm në shtetin shqiptar, aq sa, ai lë të kuptohet për një dorëheqje të qeverisë dhe zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme në vend me një qeveri po të PD-së. (26.01.97). Mëgjithatë kjo ishte një manovër e tij për të risiguruar dhe legjitimuar me mjete të njohura (me një qeveri të PD-se) një rizgjedhje të PD-së.

Pavarësisht nga kjo Sali Berisha mbetet besnik i mbajtjes me forcë të pushtetit në një kohë që opozita nuk arrin të bëhët deri në fund një udhëheqje organike e simpatizantëve të vet, pa lë më e popullit. Arsyet që partitë nuk arrijnë nivele të tilla politike, janë kryesisht dy. Heshtja e gjatë e

opozitës për çeshjen e fajdeve dhe se dyti bindja e popullit se me mjetet që zgjodhi opozita ishte tepër e vështirë për të përmbysur Berishën. Këtë boshllëk të opozitës, e rimbush përkohësisht shtypi. Në kohën e furtunës së parë popullore 15 -28 janar, roli i shtypit të pavarur ridimensionohet. Kështu p.sh "Koha Jonë" dyfishon tirazhin e shitjes.

Fundi i janarit dhe fillimi i shkurtit përbëjnë një fazë heshtjeje. Është një pauzë e domosdoshme në dukje për të dyja llogoret, por që evidenton faktorin popull në luftën kundër Berishës. Ky faktor si levë që vë në lëvizje zemërimin e tij, ka paratë e fajdeve. Por pas fajdeve populli zbulon në gjithë thellësinë dhe gjerësinë e poshtersisë, regjimin e Berishës brenda të cilit shtrëmbërimi i demokracisë ishte më tepër së zhgënjim. Kështu pas pesë shkurtit, kur vërtëtohet se sportelet e shtetit për kthimin e parave të fondacioneve të Popullit dhe të Xhaferit edhe në masën 52 dhe 60 % , (në të njëjtin kohë që rrënja e vlerës së lekut është vertikale) nuk përbëjnë zgjidhjen e prituri, kur Gjalica shpall falimenton, dhe skemat e tjerë priamidale ndjehen të tronditura, populli kërkon kokën e fajtorit që politikisht do të thotë rrëzimin nga pushteti të qëverisë së PD-së. Këtë ndryshim destinacioni të vullnetit popullor Berisha nuk e vlerësoi dhe u mbeshtet tek mjetët e dhunës të cilave kish kohë që u besonte se tepërmi. Ky konceptim i pushtetit të tij e bën Berishën të mos pranojë një zgjidhje politike për krizën e krijuar. Rrjedhim logjik i vetëdijës popullore ishte që Berisha duhet të provojë vendosmërinë e shtetasit të tij të thjeshtë për t'u përmbysur. Epiqendra bëhet Vlora dhe me një rol të pashlyeshëm studentët e këtij qyteti dhe të Gjirokastrës.

Në këtë kohë, revolta popullore merr trajtat e një Lëvizjeje Popullore, ose më sakt të një kryengritjeje popullore. Niveli i kësaj Lëvizjeje përsa i përket qëllimit dhe mjetit për realizimin e tij kaloi në një plan të pa arritshëm nga partitë politike. (populli kërkonte rrezimin e Berishës si sistem dhe ngritjen e një shtetit të vertet demokratik dhe po e realizonin atë me mjete force dhe dhune të imponuar nga vet shteti i PD-së. Partitë politike kërkonin rrezimin e regjimit të Berishës thjesht për të marrë ato për vete pushtetin. Nga ana tjetër këto parti nuk kishin zgjedhur mjetët për të realizuar këto ndryshime aq më tepër që ato rriteshin aq sa i linte hija e Sali Berishës) Tërheqja e tyre përballë Berishës në këto momente, deri më 09.03, që e tillë sa që këto parti rrezikonin të mbëteshin jasht lojës politike në vend.

Por populli bëri një kompromis të gabuar me vetvetën. Delegoi në mënyrë të pamërituar misionin e vet partive politike opozitare dhe pranoi që roli i tij të përfundonte me zbritjen nga fronti të Berishës, duke u dhënë dorë të lirë partive që të manipulonin pas zgjedhjeve serish me vullnetin e tij. Tregoi paaftësi në zgjedhjen e një klase udheheqëse për ta çuar deri në fund strategjinë e vet, - Kjo strategji nuk përfshinte President Berishën në strukturën kalimtare të drejtimit të shtetit. Rolin e presidentit e zevëndësonte me një Këshillë Presidencial. Ndërsa në tavolinën e vendimeve për të ardhmën e vendit Lëvizja politike e popullit kërkonte pjesëmarrjen e vet si palë me të drejtën e faktorit që përcaktoi zhvillimet e deriatëhershme në Shqipëri.

Këtë situatë e vulosi përfundimisht kompromisi i nëntë marsit. Ky kompromisi, është e vërtetë se i rifut partitë në lojën politike të vendit por bëhet sipas kushtëve të vëna nga Berisha, i cili ende s'i kish venë në vendin e vet gjërat nga valixhet për braktisjen e vendit. Kompromisi në fakt riinstaloi për një kohë të gjatë rrethin vicioz të krizës në Shqipëri, ku shkatërrimi i vendit si shprehje e shkatërrimit të një shteti institucional të ndërtuar keq, në vend që të qartësonte horizontin politik, po bënte më të rëndë krizën.

Marrëveshja e arritur midis nëntë partive dhe Sali Berishës tregoi gjithashtu se deri ku arrinte dora e zgjatur e Perendimit në lidhje me situatën në vend. Edhe pse ishte marrë pothuaj në mënyrë përfundimtare vendimi për të hequr nga pushteti Berishën, Perendimi nuk kishte përcaktuar në mënyrë të saktë pasardhësit.

Me dashje apo pa dashje Berisha ishte futur midis berylave të të fuqishmëve të Perendimit në lidhje me faktin e kush do të ruante influencat në pjeën jugore te gadishullit strategjik për ekulibret shekullor Lindje - Perendim. Ky veprim bëhet më I ndjeshëm pas përcaktimit të rolëve me marrëvehjën e Dejtonit, në veriun e Ballkanit, në Bosnjë Hercegovinë. Berisha konsiderohej gjithashtu si njëri që kontrollonte , ose të paktën ushtronte një ndikim të padiskutueshëm mbi çelësin tjetër të zhvillimëve në Ballkan , në Kosove. Këtu nuk përjashtohen edhe interesat ekonomike të disa zyrtarëve perendimorë të lidhura me Berishën në pushtet si dhe këmbëngulja për të ruajtur të djathtën berishiane në pushtet në Shqipëri nga një alergji shpesh e pakuptimtë për të majtën në vend, apo dhe pjesën tjetër të opozitës. Po ashtu nuk duhet harruar se Perendimi bëri investime të mëdha në përkrahje të Berishës efektiviteti I ecurisë së të cilave konsiderohej shumë pozitiv. Madje Shqipëria përmendej si model I aplikimit të formulave të Perendimit për të nxjerrë nga periudha e tranzicionit një vend ish komunist Këto janë disa faktorë që Perendimi nuk mund të kërkonte heqjen qafe të Presidentit Berisha.

Nga ana e vet opozita e kishte mësuar keq mësimin se Perendimi të vë ose të heq nga pushteti ndaj tregonte një servilizëm deri në bezdi ndaj valixheve diplomatike, pa e kuptuar se manifestonte kështu paaftësi për të drejtuar politikisht dhe për të marrë situatën në duart e veta. Kësaj opozite I mungonte gjithashtu faktori Njesh. Nëntë marsi u arrit kështu edhe për t'i prerë rrugën faktorit popull në oreksin për pushtet, I cili popull kishte marrë përsipër rolin vendimtar për zhvillimet në vend. Perendimi kishte konstatuar se ky faktor në Levizjen e tij kryengritëse ishte pak veshtirë të kontrollohej dhe të ndikohej ,aq më tepër po të arrinte të kishte edhe një kokë udhëheqëse. Partitë e opozitës, megjithë përtpjekjet që bënë disa parti të vogla, nuk e shfrytëzuan këtë faktor për të fituar një autoritet pavarësie, si nga e kaluara e aferme apo e largët, ashtu dhe nga Perendimi, por mbetën sklave të formulave të perendimit. Të trembura ende nga faktori Berishë dhe të ndodhura në grackën e kompromisit të gatuar prej tij, dhe njëkohësisht duke studiuar qëndrimin e të huajve ndaj Levizjës Popullore për Demokraci, partitë e opozitës u shfaqen të dyzuara përballë saj

Nga njëra anë e donin Levizjen Popullore si një çekiç mbi kokën e Berishës, nga ana tjetër donin ta mbanin në distancë se bertiste Berisha. Kjo ndodhte edhe sepse partitë politike kishin frikë nga një zyrtarizim i tyre si palë, se mund të elimononte rolin e tyre politik në të ardhmën e afërt. Pra kur bëhej fjalë për marrjen e pushtetit. Mirëpo pamundesia e partive politike për të realizuar lëvizje me synime të qarta politike , që përkundrazi shfaqeshin hapur dhe më vendosmeri nga populli i armatosur dhe pamundesia e këtij populli për t'i çuar deri në fund aspiratat e veta politike dhe njëkohësisht vetpërmbajtja e tij, (i imponuar nga një logjikë e drejtë dhe e pjekur politike), për të mos iu kundërvënë hapur partive politike dhe Qeverisë së Pajtitimit Kombëtar, çoi në kënëtitizimin e Lëvizjës Popullore për Demokraci. Kjo situatë, se bashku me faktorë të tjerë, si, vazhdimimi i veprimtarisë së grupeve të Berishës, reagimi shpesh I opozitës me mjete të njehta, interesat ekonomike të grupeve të caktuara, mungesa e veprimit të ligjit, mungësa e strukturave të qarta dhe të zbatuara në praktikë për rolin K.SH.P në funksionimin dhe drejtimin e pushtetit lokal, rritja e varferisë, etj e degjënëruan këtë Levizje dhe situatën në përgjithësi , në krim dhe përbaltje. Kjo kryengritje, e vetme në llojin e vet, u braktis e tradhetuar

Berisha nga ana e vet do të përdorë disa taktika për të mbijetuar, por që janë vazhdimisht të paefektshme. Në fazën e parë, ndërsa nuk harron traditën e akuzave komuniste për opozitën, kërkon të fut si pyk në zhvillimet e brendshme politike problemin e Kosovës . Ai lëviz gjithçka mundet që edhe në Kosovë të mbahet një qëndrim radikal ndaj Milloshevicit, si opozita e Drashkovivit në Beograd . Kjo çoi në acarimin e marrëdhënjeve midis Tiranës dhe Prishtinës sepse Prishtina, pavarësisht nga njerëzit që gjeti Berisha për të mbeshtetur idenë e tij, nuk zgjodhi këtë rrugë. Sidoqoftë, zjarri që i ndezur dhe përflakja edhe gjografikisht, ishte tepër e rrezikshme, por

Berisha që i vendosur për të luajtur, edhe pse ishte bindur se një qëndrim i tillë e bënte me më shumë kundërshtarë se aleatë

Në një fazë të mëvonshme Berisha futi si një pyetje të dytë në ato grupime që mund të përbënin lëvizje kërcënuese kundër tij, (sindikatat dhe studentët), Azem Haidarin . Por edhe ai deshtoi, ose më sakt u jashqit.

Berisha pas kësaj u drejtohet mjetëve të dhunës. Mënjaron vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme 26.01, por vendosi daljen e ushtrisë nga gazerat «për të ndimuar policinë në vendosjen e rendit». Aktivizoi SHIK-un deri dhe në veprime policore, arrëton , torturon , bën gati gjyqet masive. Kjo situatë nërvash, ekulibresh, tensionësh, shkoi deri në fund të shkurtit, dhe arriti kulmin më 02.03 kur parlamenti i Berishës vendosi gjendjen e jashtëzakonshme nën drejtimin e forcave të SHIK-ut . Pas kësaj përgatiti operacione luftarake kundër Jugut dhe pasi brenda një jave dështoi , detyrohet të kërkojë dialogun.

Në këtë luftë qëndrimesh, para dhe pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme , dhe përgatitjes së operacionit kundër Jugut, Berisha nuk ndalet as para aktëve që çonin jo në luftë civile por në një luftë Veri -Jug, si shprehje e dallimit që vet ai e kishte kultivuar në vend gjatë pushtetit të tij. Në këtë periudhë Berisha kërkon ta infiltrojë Levizjen kundër tij si vepër, herë të mafies ndërkombëtare, herë «të ekstremistëve të kuq brenda vendit» dhe herë të agjentuarave të huaja “ që kërkonin copëtimin e Shqipërisë». Berisha dërgoi në parlament gjeneralin e diskretiteuar të gjendjes së jashtëzakonshme Bashkim Gazidede që me copa letre «të vertetojë këtë tezë».Por ajo që i intereson është propaganda nëpërmjet organit ligjvënës për të çorientuar vëmendjen dhe për të fanatizuar Veriun kundër Jugut. E gjithë kjo lojë megjithatë bie poshtë jo vetëm nga qëndrimi zyrtar i shtetëve që Berisha kërkon të implikojë, por edhe nga qëndrimi i përhershëm, vetëm kundër Berishës, i Komiteteve të Shpëtimit Publik. Dhe jo vetëm kaq.Fakt është që kush i pengoi këto agjencitë të realizonin “copëtimin e Shqipërisë”, ushtria, policia dhe strukturat inegzistente të shtetit të Berishës? Në bazë të kësaj logjike ose këto plane egzistojnë në mendjen e Berishës, ose meritojnë për mos realizimin e tyre e ka populli i armatosur që udhëhiqej nga Komitete e Shpëtimit Publik. Atëherë pse Berisha i sulmonte kaq ëger këto komitete dhe partitë opozitare për bashkëpunim me to?

PJESA E PARE

Kapitulli I

ZGJIMI I VONUAR ANTIFAJDE I PARTISE SOCIALISTE

Viti i ri, kaloi i zbehtë. Njërezit nuk mendonin kaq shumë për festën se sa për faktin se kur do të kalonin ditet e festës që të kondaktonin me pronaret e firmave rentjere , por edhe me qeverinë. Cështja e fajdeve mbisundon tani të gjitha nivelet e jetës shqiptare, vertikalisht e horizontalisht

Janari fillon me pozicionimin e Partisë Socialiste më e madhja në opozitë. Partia Socialiste e akuzon qeverinë se përdori fenomenin fajde për arsye elektorale dhe kërkoi marrjen e masave për garantimin, të paktën të kapitaleve fillestare të rreth një milioni deozituesve shqiptarë.

Pozicionimi i PS ka rëndësi për momentin se që kur lindi fenomeni fajde dhe deri kur FMN-ja, në fillim të nëntorit 1996 kishte "imponuar" ministrin e atëhershëm të Financave Ridvan Bodën të deklaronte në TV-në zyrtare se "interesat që japin firmat e fajdeve janë aq të larta sa që krijohen dyshime për mundësinë e tyre për të kthyer borxhet", PS-ja heshti. Rezervat e PS-së për të mos "sulmuar" fenomenin fajde para zgjedhjeve të pushtetit Lokal , me 20 tetor, mund të justifikohen me frikën e kostos politike parazgjedhore, pasi masiviteti i firmave fajde dhe interesat e larta deri më 25-30 përqind dhe administrimi i fenomenit nga PD-ja, nuk linte vertet shumë hapësira për sulme kur për pak kohë ke për të përballuar në të gjitha drejtimet zgjedhje të pabarabarta. Por është i pakuptimtë qëndrimi i heshtur i PS-së pas zgjedhjeve në një kohë që edhe ekonomisti me i zakonshëm e dinte fundin e skemave piramidale, aq me tepër kur ato administroheshin për qellime politike dhe ekonomike nga PD-ja. Nënshtrimi i perspektives politike ndaj kostos politike të castit nga ana e PS-së dhe e partive të tjera opozitare, përbënte një miopi politike. Në të kundërt kjo heshtje imponohej nga fakti se edhe përfaqësues të opozitës ishin të lidhur me fije të ndryshme e të shumta me fenomenin fajde.Dhe jo vetëm aq. Pasojat do të ishin të rënda, jo vetëm se nuk do të kishte transparencë mbi fajdet dhe denim fajtorësh për krizën në vend por edhe mbetej e kërcenuar e ardhmja e pushtetit dhe e shtetit në Shqipëri Ky është edhe një argument më shumë në favor të logjikës pse opozita nuk do të mund të ingranohet natyrshëm me protestat popullore .

Po ashtu nuk duhet harruar se në këto momente Partia Socialiste nuk kishte kapërxyer problemet e brendshme dhe shfaqej e papërgatitur për të marrë pushtetin. Lidhjet e shumëfishta me përfaqësitë Diplomatike në Tiranë përveç shanseve pozitive, bënte më evident paragjykimin e diplomacisë së huaj për PS-në si trashëgimtare e pandryshueshme e komunistëve . Ndikonte negativisht në këtë aspekt sistemi shumë nënkryetarësh në drejtimin e PS-së dhe pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre kontraktotore si në lidhje me Nanon, ashtu dhe për probleme të tjera të politikës së brendshme dhe të jashtme të Partisë Socialiste. Këto ishin ndoshta edhe arsyet që ky faktor i jashtëm të nguronte, t'i jipte PS-së një rol të tillë pararojë në planin antifajde, në një kohë që vihej re nxitja e opozitës branda PD-së për një rol përmbysës të Berishës. Në Janar, kuptohet që ishte kristalizuar mendimi se në Shqipëri nuk mund të ndryshonte spektri politik shqiptar, pra nuk mund të dilte një forcë e tillë e madhe sa PS-ja, e aftë për të marrë Pushtetin, apo dhe sa PD-ja, edhe pse pritej në të ardhmën një shkërmoqje tjetër e PD-së.

Pozicionimi antifajde e PS-së ka rëndësi edhe për faktin tjetër se pikërisht në këto momente shtypi i pavarur dhe ai partiak bën shumë lëshime në qëndrimet e veta antifajde. Problemi që e "shqeteson" më shumë në këto momente shtypin është p.sh gjendja e emigrantëve në Greqi.Kuptohet që vonesa e politikanëve për t'u pozicionuar po e zhgënjente shtypin . Por lë të mos harrojmë se në fillim të janarit firmat piramidale e ndjenin deri në palce fundin e tyre dhe donin sa

më pak kundërshtarë për të shtuar jetën e tyre. Shtypi ishte sigurisht armiku kryesor i tyre. Boset e fajdeve më sa duket e aplikuan logjikën «e dorës, e cila kur nuk mund të kafshohet puthet». Nuk ka dyshim se firmat piramidale edhe pse në krizë kishin aq para sa për tua bërë jetën e ngruhtë disa botuesve me peshë në Shqipëri, të cilët kuptohet se mund ta justifikonin heshtjen e tyre, ashtu siç thamë, si zhgënjim nga qëndrimet e mëfshta të politikanëve. Por kjo situatë nuk do të vazhdojë gjatë.

PIRAMIDAT E LUKSIT, - NGREHINE QE TREMBIN QEVERINE

Më 05.01, VEFA, Gjallica dhe Kamberi, tre nga firmat më të mëdha unifikojnë interesat mujore nga 12 në 5%. Mirëpo kjo nuk shpëtoi Gjallicën e cila po më pesë janar detyrohet të mbyllë sportelet, deri më 15.01, siç deklaroi, pas skandalit të vjedhjes misterioze të mbi 40 milion dollarëve disa ditë më parë. Firmat e tjera nuk pranojnë ta ndihmojnë. Edhe gjendja e tyre duket shumë e rënduar ku vëmendja kryesore është përqëndruar tek VEFA. Ndërkohë Gjallica deklaroi se kishte siguruar ndihmën e partnerit të vet turk, por atij “do t’i ndodh” një aksident që i mori jetën.

Sidoqoftë, situata e krijuar tek firmat rentjere dhe reagimi i parë i ashpër i opozitës vetëm në aparençë duket se nuk trondit qëverinë. Por kjo nuk do të thotë se bëhët e gatshme për të ndryshuar qëndrimin. “Paratë fitohen apo humbasin atyre që se bashku iu futen kësaj loje” do të rideklarojë Kryeministri Mexi. Qëveria pra e quan problemin thjesht personal. Mëgjithatë ajo nuk mund ta fsheh gjatë tronditjen. Më shtatë janar shpall se më datë 10.01 do të fillojë nga puna komisioni jashtëparlamentar për “transparencën e skemave piramidale», pa dhenë asnjë kuadër real për efektivitetin e tij në lidhje me garantimin e depozitave të dhjetra-mijra shqiptareve. Në të njëjtë kohë, ndjek tani hap pas hapi një rëzit kryesor të skemave piramidale nga frika se mos ata largohen jashtë vendit.

Unë vet jam bërë deshmitarë i një ndjekjeje të tillë që përfundoi në tragjedi. Isha në Tiranë me një të afërm për çështje pune. Një miku im tregetar nga Tirana, kërkoi të vinte me ne në Gjirokastrë, ku kryente një pjesë të veprimtarisë së tij. Ai kishte lidhje me Rapush Xhaferrin, më të cilin disa herë kumunikuan me celularë për të ndihmuar disa persona me para. Ndërkohë na komunikoi, për çdo të papritur, se makina jonë ndiqej nga një makinë e vogël ëolksëagën në të cilën ishin katër të rinj. Ishte natë janari. Nga ora njëmbëdhjetë arritëm në Gjirokastrë. Tek ADI PETROLI hengrëm darkë. Makina ndjekëse ishte atje. Miku jonë nga Tirana fjeti po aty. Djelmoshat nuk e vunë re se ishin shumë të lodhur dhe i kishte zenë gjumi në makinë. Kur ne u nisëm për të ikur ata u zgjuan dhe na erdhën nga prapa por në distancë. Makina me çoi mua në shtëpi në qytet dhe u nis për në Dropull nga ku ishte dhe poseduesi i saj. Ata e ndoqën makinën por jo por një kohë të gjatë. Në të dalë të Gjirokastrës ishin përplasur ballas me një plep ku ishin coptuar që të katërt. Por askush nuk tha gjë për ta.

Më 14.01, mbyllin sportelet e tyre dhe Populli e Xhaferi, dy nga fondacionet me një aktivitet të paimagjinueshëm në gjysmën e dytë të vitit 1996, kryesisht në Jug të vendit. Njëkohësisht, nga kjo ditë bankat e kategorisë së dytë nuk japin më shumë se 30 milion lekë në ditë tek firmat rentjere nga frika e shpërthimit të inflacionit. Edhe në këto momente qëveria hesht duke aktivizuar faktorë të tjerë, (bankat), që të përballen me kreditorët, ose me problemet në përgjithësi.

Të njëjtën gjë la të kuptohet dhe Sudja, emri zyrtar, Maksude Kadena, i së cilës akoma nuk ishte i njohur. Më datë 15 janar Sudja gënjente për herë të tretë, brenda pak ditëve të 100 mijë, sipas Sudes, kreditorët e vet, për t’u kthyer paratë. Edhe më parë ajo kishte folur «për mustaqe» në qëveri që përbënin zemërekun e saj. Dëshmitarë okularë kishin venë re se çdo kontakt i saj me kreditorët ishte e diktuar nga një dorë e padukshme. Kjo u vu re edhe kur ajo deklaroi me një fjalë të

përseritur “ishte piramidë, ishte piramidë”, për firmën e vet. Pas këtyre fjalëve një dorë e tërhoqi nga dritarja nga ku fliste me megafon . Gjithashtu është fakt se Sudja, edhe pse qeveria deklaronte se çeshtja e fajdëve , është çeshtje personale, ajo, ruhej nga forcat shtetërore

Edhe kur ajo një ditë më vonë ,më 15.01 97, do të arrëstohet , u duk qartë se arrëstimi i saj u bë që të mënjanohet nga çdo kontakt me kreditorët e saj . Njëkohësisht, arrëstimi që i vlefshëm që Sudës t’i mbyllet goja, ose “ të humbiste kujtesen”, ashtu siç ndodhi sipas shtypit

Pra në këto momente duket se egziston një mosbesim midis qeverisë dhe firmave piramidale. Baza e këtij mosbesimi, pas periudhave të gjata mjalti qëndron tek fundi i papritur i skemave piramidale ,që solli si rezultat kohë të pamjaftueshme për të mbyllur llogaritë me to dhe ajo që ka më shumë rëndësi është se, po fuste në rrezik pushtetin e qeveritarëve që majmeshin me to .

Njëkohësisht duhet thenë se kjo periudhë mosbesimi është fare e vogël . Pak më vonë, si qeveria ashtu dhe drejtuesit e piramidave bëhen të ndërgjegjshëm se mbajtja e njërit nga tjetri mund të përbente një mundësi shpëtimi për të dy.. Është kjo arsyeja dhe historitë me thasë me para (është ndoshta rast unikal në botë që në kronika shtypi të ndiqje lajme të tilla si shtatë thasë të mbushur me para ranë në lumë) që do të detyrojë qeverinë apo segmente të shtetit t’ i percjellin vetë dhe me garanci për jasht shtetit, po të njëjtat përsona, të cilët dikur i ruanin apo u kishin prerë edhe fletë aresti, siç ndodhi me Shemsie Kadrien, presidentën e Gjallicës. Ndërkohë thashethëmet se bankat, kryesisht arabe që furnezonin me para të pista skemat piramidale në Shqipëri u bllokuan dhe si pasojë sollën edhe fundin e tyre , arrijnë dalëngadalë në të verteta shtypi. Madje mund të flitet për të verteta më të plota.

Nga ana tjetër , ndërsa qeveria ndërmerr këtë hap, pra për «transparencën» e firmave piramidale 10.01,(komisioni faktikisht nuk funksionoi asnjë herë), dhe bllokun logaritë e dy fondacionëve,15.01, Kryeministri Mexi përpiket serish t’i mbush mendjen opinionit publik se të gjitha këto firma në Shqipëri janë thjeshtë sisteme piramidale. (16.01.) Askush nuk e kupton nëvojën e këtyre shpjegimeve kur asgjë nuk është provuar, gjë që rrjedhimisht logjika të çon në përfundimin se qeveria kërkon të fsheh diçka tjetër. Të fsheh këmbët e veta dhe atë që këto firma shërbënin për pastrim parash të pista, burimi i të cilave duhet të jetë i ndryshëm. Ajo që vihet re lehtë dhe përforcon idenë e shpëlarjës së parave të pista është sasia shumë e madhe e këtyre parave dhe mënyra anadollake e adminisrimit të tyre. Deklarata e zëvendës ministrit të jashtëm Italian Fasino, se Shqipëria është e kthyer në vend i grumbullimit të parave të paligjshme, nuk lë shumë vend për diskutim. Rrjedha e ngjarjeve nënvizon qartë sikletin dhe nervozimin e qeverisë

Një situatë e tillë kish filluar të përvijohet shumë kohë më parë. Në dhjetëditorin e fundit të nëntorit të 1996 ministri i atëhershëm i Financave Ridvan Bode , kishte folur për interesa të përhershme të larta të këtyre firmave dhe dyshimin që ato ngjallin për mundësinë e kthimit të këtyre interesave . Ishte pikërisht kjo deklaratë dhe deshtimi i rinovimit të një marrëveshjeje të re të qeverisë së PD-së me FMN-në, (pas 15 ditëve qëndrimi në Shqipëri të një delegacioni të këtij institucioni, po në nëntor të 1996) ku shkaku kryesor qenë fajdet dhe qëndrimi i qeverisë lidhur me to , që detyruan Berishën të dalë në konferencë shtypi, në fund të nëntorit, dhe të deklarojë se “ paratë e shqiptarëve janë paratë më të pastra në botë, dhe se nga ajo masë e madhe parash të pista nëpër botë stërkalet e tyre mund të vijnë edhe në Shqipëri.” Kuptohet , kush e dëgjoi kuptoi të kundërtën.

Ndërkohë aksidenti misterioz i partnerit turk të Gjallicës e përforcon akoma më shumë idenë se këto piramida ishin makineri gjigante që pastronin paratë e huaja. Aksidentimi i partnerit turk të Gjallicës, me shumë se një rastësi të kujton përplasjen e grupëve mafioze shumë të fuqishme ekonomike me gjymtyrë deri tek interesa dhe marrëdhënie ndërshtetërore Ky proces ishte përdorur nga hallka të keqëtyre interesave si laku më i sigurt i kontrollit të qeverisjës së Berishës dhe se tani

kishte ardhur momenti që kjo qëverisje nuk duhej t'i gëzohej më përkedheljës së butë të xhelantinës aromëdehese të litarit fajde

PARA ME THASE -QEVERIA ME XHEPA TE SHPUAR

Tre - katër ditët e mevonshëm do të përçohen nga një qetësi e shurdhët. Qëveria duket se kërkon një rrugëdalje, por duket se gjendet para një të papriture të madhe . Ajo konstaton se xhepat e saj janë bosh.Firmat piramidale me marrërinë e tyre e shfaqur në para të transportuar me thasë e me makina shtetërore, kishin për pronarë individë, të cilët kishin më sa duket mundësi të urdhëronin makinat shtetërore , ose makinën e shtetit.

Po këtë ditë, më 10.01, duhej të fillonte nga puna komisioni parlamentar për transparencën e fajdeve. Ky komision, ishte krijuar që më 20 nëntor kur PD-ja e imponuar nga delegacioni I FMN-se në Shqipëri, futi në parlament, nëpërmjet «një grupi deputetësh» ligjin për ngritjen e këtij komisioni, që edhe u votua. Ngritja e komisionit I shërbënte pikërisht këtij qëllimi , të bindej FMN-ja se qëveria e PD-se po hynte në rrugën që ky institucion propozonte dhe si pasojë të nënshkuante me qëverinë shqiptare një marrëveshje të re. Por ky komision nuk funksionoi kurrë, pasi FMN-ja nuk nënshkroi marreveshjen e re me qeverinë shqiptare.

Me 14.01. radio Zeri I Amerikes transmeton lajmin se më datë 09.01, njëqind e tridhjetë milion dollare amerikanë u ngarkuan në një gomone në Vlorë për drejtim të paditur. Policia deklaroi se nuk disponon njoftime të sakta, megjithatë arrëston tre veta për qarkullim jashtë shtetit të valutës. Sipas Zerit të Amerikës kjo “ përbën rastin e parë të trafikut të parave të pista “ ose lidhet me mundësinë e largimit nga vendi të ndonjë bosit të fajdëve.

Qëveria hesht për lajmin e ditës , por as nuk reagon ndaj vërejtjeve të FMN-së për të shmangur piramidat e fajdeve.

Leku shenon çvlerësim vertikal në lidhje me valutat e huaja, gjë që lidhet, sipas specialisteve, me nxjerrjen jashtë të valutës. Shtypi bënte fjalë se në Tiranë një rrez të çuditshëm mbledhnin në sasi të mëdha valutash të huaja, sidomos dollarin dhe frangun zvicerian. (14.01.) Me 30.01 një dollar amerikan u këmbye me 125 lekë, ndërkohë që në nëntor vlera maksimale e dollarit ishte 96 leke.Kjo ishte amplituda më e madhe e viteve të fundit të vlerës së dollarit në krahasim me lekun. Mallrat ushqipore pësuan një rritje të ndjeshëm çmimesh. Buka, p.sh si produkt bazë ushqimi shënoi një rritje prej 17 përqind.Bankat nuk mund të ndërhyjnë më për ndaljen e rreniës së lekut. Xhepat e shtetit që kishin një mbushje fiktive tani shfaqën realitetin e varfër të tyre.Ndërsa nga ana tjetër makinës shtetërore I duheshin tani shumë e më shumë para për të mbajtur vetën në këmbë. Procesi I nevojës për të mbrojtur pushtetin më cdo kusht kishte filluar.

Kjo situatë krize solli edhe një fenomen të ri. Nëpër klinika neurologjike dhe psikiatrike mjekët kishin shumë punë. Atje përfundonin shumë një rrez që nga shokimi I pësuar nuk gjenin dot rrugëdalje . Ndërkohë, vetvrasjet po ktheheshin në një diçka të zakonshëm.

Kapitulli 2

CFARE KISHTE NDODHUR

Për më shumë se tre vjet, por sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit 1996, firmat piramidale ishin kthyer në promotor të jetës në Shqipëri, në një proces paradoksesh të kthyer në tabu vetëvrasëse. Celësi i të gjithave ishte etja për t'u pasuar sa më shpejt. Interesat nga 8 % deri në 100 % në muaj, e bëri këtë lojë gjithëpërfshirëse për Shqiptarët. Në këtë valë hynë rreth një milion njerëz. Në firmat e fajdeve depozitojnë të ardhurat e tyre, ata që kishin fituar miliona nga trafiku i drogës, nga kontrabanda e karburantëve, e cigarëve, e kafes dhe çdo lloj tjetër fitimi të paligjishëm. Shumë tregëtarë e shikonin veprimtarinë e fajdeve si një veprimtari të dytë më fitimprurëse. Refugjatë në Greqi, Itali e në vende të tjera tërhiqnin depozitat e tyre dhe i fusnin në firmat e mashtrimit të madhë duke kontribuar kështu në rritjen e përmasave të tragjedisë së ardhshme. Vetë firmat po ndërtonin në këto vende rrjetet e tyre për grumbullimin e parave të emigrantëve. Më i spikatur ishte ky fenomen në Greqi ku Ministria e Financave greke arriti të shfaq frikë, se mos grumbullimi i parave të shqiptarëve mund të përbënte një kërcënim për vet fatin e vlerës së dhrahmisë në ndonjë moment krize.

Në këtë kurth ranë madje dhe qytetarë të huaj me biznes të drejtpërdrejtë, apo dhe ndërmjetës në Shqipëri, pavarësisht nga thirrjet e diplomatëve të huaj që të tregoheshin të përmbytur në veprimet e tyre financiare në Shqipëri. Në këtë grackë pra, ranë njerëz të thjeshtë që për hir të fitimit të shpejt pranuan të shisnin akoma dhe shtëpitë e tyre. Ranë intelektualë të të gjitha rangjeve: - ekonomistë të thjeshtë dhe ata që mësonin të tjerë se lojrat piramidë kanë një fund tragjik të pashmangshëm për të gjithë ata që përbëjnë bazën e kësaj piramide. Në to depozitonin paratë e tyre politikanë të pozitës dhe të opozitës.

Qeveria e përdori këtë fluks parash, që arrin në miliarda dollarë, për të treguar efektivitetin e vet qeverisës. Rrjedhimisht kjo lojë, krijoi një lidhje të dyfishtë midis qeverisë dhe firmave piramidale. Firmat e donin përkrahjen e qeverisë se krijonin garanci për të grumbulluar sa më shumë para, ndërsa qeveria krijonte përmes tyre përshtypjen e afrimit të parajsës në publik por edhe një mundësi praktike për përfitime kolosale të individëve të qeverisë ose afër saj. Lë të mos harrojmë se Vehbi Alimucaj hynte në veprimtari zyrtare menjëherë pas Sali Berishës dhe pas tij hynte kryeministri Meksi, apo ndonjë zyrtar tjetër i lartë. Ashtu si nuk duhet të harrojmë se Berisha mirrte pjesë në çdo "inagurim" të VEFES. Lë të mos harrojmë gjithashtu financimet e Partisë Demokratike, të pranuar madje nga një drejtues të vet PD-s, nga ana e firmave rentjere, apo dhe financimet e fushatave elektorale të partisë në pushtet në përgjithësi dhe të individëve në veçanti.

Opozita tepër vonë kujtohet dhe akuzon qeverinë dhe PD-në se fshihen pas firmave rentjere, se PD-ja u financua nga ato në të dy fushata elektorale të vitit 1996, dhe se janë "shkaktarë të gjendjes së krijuar në vend".

Firmat rentjere gjetën një terren psikologjik shumë të përshtatshëm për lulëzim në Shqipëri. Varfëria tej kufirit të logjikës që kishte trashëguar populli shqiptar gjatë regjimit komunist kishte zhvilluar njëkohësisht një koncept urrejtjeje për punën por edhe për shtetin që grumbullonte në mënyrë gllabëruese dhe të paprincipitë të gjitha vlerat materiale, morale e intelektuale që krijonte shoqëria. Ky realitet u ballafaqua me një kapitalizëm «dorëlëshuar» në hapat e tij të para në Shqipëri, që zgjoi tek shqiptarët konceptin feudal në adaptimin e këtij kapitalizmi. Parazitizmin dhe mënyrën magjike për t'u pasuar menjëherë. Rrugët e këtij pasurimi qënë tre: - Kontrabanda, ndihmat e perendimit dhe piramidat. Ato u instaluan para se shtetit të vihej në lëvizje sipas parimeve të reja të funksionimit të shoqërisë dhe shumë shpejt fituan fuqi më të madhe se shteti, gjersa dhe vet ky shtet, filloi të funksionojë më këtë mentalitet.

Piramidat nga ana e tyre përbënin shtratin më ideal për mentalitetin e pasurimit tek shqiptarët, aq më tepër që deri në mesin e vitit 1996 ato lulëzuan aq shumë sa krijuan imazhin se shqiptarët gjetën mënyrën më përfekte për t'u pasuar. Kjo ndodhi se fenomeni i lashtë i fajdeve i

strukturuar në formën e skemave piramidale , në Shqipëri po jetonin më gjatë se në cdo vend tjetër. Jetëgjatësia e tyre nuk kishte aq shumë lidhje me rentabilitetin ekonomik të efektivitetit investues të këtyre firmave. Këto investime, në sistemin e tregëtisë apo dhe të prodhimit, ishin shumë të vogla për të realizuar një përqindje kaq të lartë fitimi. Firma Cenaj p.sh duhej të furnizonte me vezë, më të njëjtin numër pulash, gjithë Ballkanin dhe gjysmën e Evropës dhe prap nuk do të arrinte një normë kaq të lartë fitimi . Sigurisht që këto investime përbënin vitrinën e cila me përkrahjen e qeverisë joshte qytetarët për të depozituar para, ndërsa nga ana tjetër përbënin një ombrellë të mirë për sigurimin e efektivitetit të shpëlarjës së parave .

Në planin praktik logjika si e qeveritarëve ashtu dhe individëve të thjeshtë është e pranueshme. Ata nuk interesoheshin për origjinën e parave, por për mundësinë e fitimit të tyre. Mirëpo ata nuk arritën të kuptonin se në këtë lojë të rrezikshëm të dy ishin vetëm figurantë ose viktima.. Pasuria e patundur e firmave rentjere përbën megjithë mend stërkalat e parave që kaluan në Shqipëri. Roli i qeverisë lidhet më faktin se i toleruan dhe i lëgalizuan këto ndërmarrje fantazmë se vetëm vula zyrtare legalizonte pastaj pastërtinë e parave në duart e pronarëve të vertetë.

Përmendim një rast. Një tregëtar Gjirokastritë lidhi një kontratë me firmën aq shumë të reklamuar të VEFES për prodhimin e ambalazheve plastikë në Permet. Pas kontratës ai merr me qira një kamjon dhe shkon për ta ngarkuar në Permet . Mirëpo kur arrinaty dyert e fabrikës nuk i hapen Ato ruheshin nga një numër i madhë bodygardesh, sikur të që objekt i një rendësie të vecantë. Kur u hapën dyert, trefgëtari vuri re me keqardhje se brenda nuk kishte as shishe plastike, as makineri për prodhimin e tyre. Atje ishin ca makineri për prodhimin e makaronave të cilat pak më vonë u transferuan në Shkodër për të hapur atje një fabrikë makaronash. Vehbi Alimucaj deklaronte se kishte 130 vepra prodhuese dhe mbi 6 000 punonjës. Realisht ato nuk kanë egzistuar me përjashtime të përralla si supermarketi në Tiranë , të cilat lidheshin me reklamën se sa me realitetin ekonomik

. Pjesë e reklamës është edhe marrëzia e veprimeve të «pronarëve» të këtyre firmave, si reklamimi i një pasurie përallore , rrethimi nga një numër i madhë bodygardesh, etj. Vehbi Alimucaj udhëton në Shqipëri me helikopter. Reklamon firmën e vet në pistat e Formala uno-s. Xhaferi blen trajnerë dhe lojtarë futbollit nga më të dëgjuar në botë dhe paguan tofozet për të shoqëruar ekipin e Lushnjës në cdo ndeshje. Brazili Mario Kembes gjen në këtë periudhë një ofertë nga ana e Xhaferit konkurrese dhe për ekipe të përralla në Evropë. Po ashtu, Xhaferi nga ana e vet bën deklarata për pronësi hotelësh në SHBA (pavarësisht se vet i deklaroi dhe po vet i përgenjeshtron dhe me të ardhurat nga këto pasuri të patundshme pretendon se ngrë fondacione bamirësie. Por ai nuk sqaroi dot kurrë pse duhet t'i mbledhte atij , popullit, para e pastaj t'i shpërndante të tjera më përqindje atij...

Pra midis fajdeve pastrimit të parave dhe endrës së keqe të shqiptarëve i cili për të fituar sa më shumë para, shiti dhe gjënë më të shtrenjtë , për të cilën rropatët një jetë të terë,- shtëpinë,- egziston një lidhje zbardhjen e së cilës ose nuk do të dëshirojë kush për ta bërë ose nuk do ta lenë.

Lë të shikojmë një aspekt tjetër, për të kuptuar edhe më mirë pyetjen e shtruar. Cuditërisht ,në krye pothuaj të të gjitha këtyre firmave dhe fondacionëve ishin njëri-tjetër të padëgjuar dhe me pak shkollë. Kjo i përshtatët logjikës për të qënë më lehtë të shfrytëzueshëm dhe raja të mirë. Sudja ishte një punëtore i zakonshme në një fabrikë të Tirnaës së cilës nuk i dihej as emri juridik. Vehbi Alimucaj «thmeluesi i Holdingut të parë Shqiptar» ishte një kapter në ushtrinë e pafund të kaptëreve shqiptarë. I së njëjtë kategori është edhe Xhaferi.

Në strukturat e këtyre firmave egziston edhe një sekret tjetër. Krerët e këtyre firmave kanë një lidhje politike. Kështu pjesa më e madhe e krerëve të firmave , të Vefës, Gjallicës, Kamberit, Cenaj, Silvës, etj kishin lidhje më PD-në. Fondacionët Popullit dhe Xhaferri tregonin se kishin lidhje

me opozitën. Në strukturat e mëposhtme pjesa më e madhe e nëpunësve janë të kambëve kundërshtarë, në lidhje me kreun. Alternimi i forcave politike në pushtet bën kështu të pamundur arritjen e transparencës mbi këto frima. Të dyjat palët nuk janë të interesuara për transparencën se i kanë ngjeshur duart në mjaltë

STUDENTET INICOJNË KERKESA POLITIKE . FANEPSET A.HAJDARI PARTITE POLITIKE NDJEKIN HAPIN E KREDITOREVE

Më 06.01, njëzet e pesë mijë studentë në vend nuk shkuan në mësim në shenjë proteste për përmirësimin e kushtëve të jetësës. Studentët e Tiranës dhe të Vlorës kërkojnë edhe dorëheqjen e drejtuesve të RTSH-së dhe lejimin e radios dhe gazetës për studentët. Në Korçë, në Gjirokastrë dhe në Shkodër, shkruan shtypi i ditës, ndërhyjnë makina shtetërore për të penguar këtë lëvizje .Vecanarisht shqëtësuese qe prania e SHIK-ut

Në Gjirokastrë , ishte pikërisht ndikimi i SHIK-ut dhe i PD-së mbi unionin studentor të Universitetit E Cabej, që çoi në dështimin e grevës. Gjendja e studentëve, veçanarisht e vajzave konviktore që më shumë se tronditëse. Egzistojnë xhama të thyera, lageshti e papërbalueshme. Nuk ka ujë, ndërsa zbulohen dhe një seri skandalesh në vjedhjen e ushqimit të studentëve, apo ndërim destinacioni të fondeve. Megjithatë nën këtë presion unioni i studentëve Gjirokastritë jo vetëm që nuk mbeshtet kërkesat jo ekonomike të studentëve të Tiranës , madje nuk zhvilluan as grevë të regullt me kërkesa ekonomike.

Lëvizjen e nisur studentore , kërkon ta manipulojë , Azem Hajdari, kryetari enigme për momentin i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë.Më vonë do të provohet se ishte pjesë e një taktike të Berishës për të tërhequr vemendjen e opinionit publik dhe për të përcareë struktura të tilla, - studentë,sindikata,- që mund të kundërshtonin regjimin e Berishës . Hajdari pra, i vet shpallur kryetar i Sindikatave të Pavarura nga fundi i dhjetorit, deklaroi më datë 07.01, se më datë 10.01 do të fillonte një grevë pa afat e studentëve. Më datë 10.01. pothuaj gjysma e fakulteteve te Universitetit te Tiranës, janë në grevë pa afat. Qëveria bën përpjekeje që më premtime t' i kthejë studentët në auditorë, por nuk ia arrin.Megjithatë ata, -studentët,- nuk pranuan as Hajdarin për t'i drejtuar.

Haidari do të rishfaqet përsëri në publik në ditët e para të dhjetëditorit të dytë të janarit, në përkrahje të revoltave të kreditorëve. Pak ditë më parë ai ishte “përrjashtuar “ nga grupi parlamentar i PD-së. Kuptohet që edhe kjo përpjekje e dështuar e Azem Haidarit bëhej me një qëllim të caktuar . Berisha donte të kishte ndikimin e vet në lëvizjen e protestës që imagjinata e kohës nuk mund të arrinte në përmasat e disa javëve më vonë. Më këtë menyrë Berisha do të mund të hiqte qafe ato koka brenda në PD që do të mund të bënin më të lehtë mbijetësen e tij. Një kokë e tillë p.sh ishte ajo e Meksit të cilën e kërkonin protestuesit dhe opozita por që nuk i duhej më as Berishes. Sic do të shihet më vonë, ndërsa opozita kërkon dorëheqjen e qëverisë së Meksit dhe krijimin e një qëverie teknike, Berisha , më qëllim që të qetësojë dhe përplasjet e brendshme në PD do të kërkojë të heq Meksin dhe të krijojë një qëveri po të PD-se

KERKESAT POLITIKE DALIN NE RRUGE, ZGJIDHJET POLITIKE BLOKOHEN

15 janari shënon daljen në rrugë të kërkasave politike. Eshtë dita që kreditorët e Sudës zhgënjimin e tyre të përseritur nuk do ta shprehnin më me shpërndarje të heshtur për të riardhur

përseri të nësermen për të thelluar zhgënjimin. Disa mijra kreditorë e kthejnë tubimin e tyre në protesteë masive duke thirrur parulla kundër Presidentit Sali Berisha dhe kryeministrit Aleksander Meksi. Ata nuk do të shpërndahen aq thjeshtë as nga perdorimi i dhunës nga ana e forcave të ndërhyrjes së shpejtë. Protestat kreditorëve do të vazhdojnë deri vonë.

Ndërkohë forcat e shumta policore mbajtën Tiranën të rrethuar nga frika e përseritjes së protestave. Kjo lëvizje sjell si pasojë arrëstimin e Sudës dhe të 18 drejtuesve të tjerë të firmës së saj. Mëgjithatë as kjo nuk i qetëson mijrat e kreditorëve. Arrëstimin e Sudës përbën ndërhyrjen e parë të shtetit në firmat e fajdeve, ndërkohe që një ditë më parë ishte thirrur për një orë në prokurorinë e Tiranës pronari i Fondacionit XHAFERI, Rapush Xhaferi ose Gjenerali

15 janari do të jetë një ditë tëpër e gjatë ose e ngjeshur me veprime politike. Po këtë ditë, tri parti politike, Socialistja, Socialdemokratja dhe Aleanca Demokratike, vendosin t'i japin përfundimisht fund heshtjes ndaj problemit të fajdeve. Ato i shkruajnë një letër Këshillit të Evropës ku kërkojnë të ndikojë në vend për aprovimin e Kushtetutës, pasi fillimisht të jetë përcaktuar data e zgjedhjeve të parakohshme. Theksojnë gjithashtu se në popull ka humbur besimi tek vota e lirë, se në Shqipëri ka shkelje sistematike e të drejtave të njëriut dhe kufizim të veprimtarisë së opozitës. Këto tri parti kërkojnë bashkëpunimin me parti të tjera edhe të së djathtës në një grupim që fillimisht do të quhej Opozita Progresiste (pak më vonë Forumi për Demokracinë) dhe zgjedhjen e një Komiteti që do të rregullonte levizjen e kësaj opozite.

.Ndryshe nga një ditë më parë, 16 janari do të jetë një ditë e nxëhtë. Në Vlorë ku një ditë më parë Gjallica kishte njoftuar për mbylljen e sporteve deri më 02.02, mijrat e depozituesve u mblodhen para zyrave të saj për të kërkuar shpjegime për këtë shtyrje dy javore. Gjallica pas Sudës kishte marrë tatëpjetën që në fund të dhjetorit dhe më sa duket zhvillimet në vend e bënë të pamundur shpalljen e falimentos.Kushdo e dinte, aq më tëpër qëveritarët se ku do të shkarokohej zëmërimi popullor Rrjedhim logjik që që grumbullimi i mijra kreditorëve të Gjallicës atë ditë të kthehej në një revoltë antiqeveritare. Ndërhyjnë forcat e policisë por dhunës së tyre protestuesit i përgjigjen me dhunë. Mjetët zyrtare të informacionit bëjnë të ditur së midis protestuesve pati edhe të plagosur dhe se gjendja në qytet është shpërthyesë

Incidente pati edhe në Shkodër, ndërsa në Tiranë u mblodhën serish kreditorët e Sudës e deklaruar e falimentuar. Forcat e shumta policore vazhdojnë të ruajnë sheshin Skënderbej. Ky shesh është kthyer tanimë në simbol i sundimit të PD-së. PD-ja ishte kujdesur më të gjitha mjetet, madje më një kosto politike ndërkombëtare shumë të madhe, të mbante larg këtij sheshi opozitën dhe cdolloj kundërshtar tjetër.

Pikërisht një ditë më vonë tri partitë, PS-ja, PSD-ja dhe AD-ja, që kërkojnë të marrin inisiativen politike në vend, ftojnë të dielën, më, 19.01, popullin e Tiranës në protesta masive në sheshin Skënderbej, «në mbrojtje të interesave ekonomike».

Ndërkohë qëveria, pas trazirave në Vlorë, Shkodër dhe Tiranë, vendosi të bllokojë depozitat e Fondacionit Populli dhe Xhaferi që arrijnë shumën e 250 milion dollarëve. Veprimi konsiderohet si më i rrepti i ndërmarrë nga qëveria në jetën e firmave piramidale. Qellimi, siç preteëndon është "mbrojtja e interesave të kreditorëve në firmat rentjere". Por edhe kjo masë e qëverisë ka një prapamendim. Ajo i kish akuzuar të dy këto fundacione se drejtoheshin nga njëherë shumë pranë opozitës. Kështu që edhe veprimi i ndërmarrë prej saj kërkonte të godiste indirekt partitë opozitare, sidomos atë Socialiste, për të justifikuar akuzat e herëpashershme të saj se prapa fajdeve "fshihet opozita e cila ndaj edhe hesht". Nga ana e vet, Kryeministri Meksi, sic e theksuam edhe pak më lart, përpiqet edhe një herë t'i mbush mendjen opinionit publik se të gjitha këto firma ishin thjeshtë piramidale, gjë që e ndërlikon edhe më situatën.

FAKTORI NDERKOMBETAR VIHET NE LEVIZJE. BERISHA E KA ATE KUNDER.

Pikërisht në këto zhvillime të vrullshme në vend vjen një deklaratë e re nga zëvendës sekretari i Ministrisë së Jashtme Amerikane Timothy Ēirth, 17.01., ku ndër të tjera deklaron se “ Qëveria nuk i kontrolloi firmat piramidale” duke fajësuar kështu drejtpërdrejt qëverinë shqiptare për to. Ēirth shkon më tej duke shtuar se «Shqipëria po reshqet nga rruga e demokracisë». Zyrtari i lartë amerikan u kërkon autoriteve Shqiptarë të aprovojnë kushtetutën, të funksionojë tavolina e rrumbulakët e të gjitha partive, pavaresinë e medjave, zbutjen e marrëdhënjëve me opozitën dhe angazhimin e tyre për zhvillimin e zgjedhjeve të reja në Shqipëri.

Kërkesën për aprovimin e kushtetutës dhe zhvillimin e zgjedhjeve të reja më një kushtetutë të re, Ministria e Jashtme Amerikane e kishte bërë menjëherë pas zgjedhjeve lokale të 20 tetorit dhe Timothy Ēirth e kishte përsëritur atë më 24 nëntor 1996. Madje ai përcaktoi atëherë dhe partnerin për “zbatimin” e politikës amerikane në Shqipëri. Ky partner ishte Italia, e cila gjatë muajve të krizës së madhe, madje dhe pas zgjedhjeve të 29 qershorit, do të vazhdojë të luaj një rol primar në zhvillimet në vend, pavarësisht se në një moment ambasadori i saj në Tiranë P. Foresti kërkoi të luante një rol tjetër, në dukje personal, por pro Berisëes dhe PD-së.

Zhvillimet e vrullshme në Shqipëri shqetësojnë tani edhe vende të tjera Evropiane. Katër ditë më vonë, 21.01, ambasadori grek në Tiranë do të deklaron se, «Greqia shqetësohet seriozisht për shembjen e skemave piramidale që mund të çojnë në destabilizimin politik të vendit dhe që mund të shoqërohet me shpërthim të një vale emigrandësh klandestinë drejt Greqisë”

Po ashtu nga Roma, zëvendës ministri i Jashtëm italian Fassino, i cili një javë më parë ishte në Tiranë, akuzoi Shqipërinë se «është kthyer në kancer i parave të pista.» «Qeveria e Tiranës, shton Fassino, duhet të bëjë kujdes se Shqipëria është kthyer vendi më importim më të madhë të parave të paligjshme”

SHBA-ja shpresonte gjithashtu se edhe Evropa kishte renë dakort me formulën e saj, por zhvillimet e korrente do të tregojnë se s’kishte të drejtë. Megjithatë ajo që duhet parë në këto zhvillime është se opozita shqiptare në luftën e saj politike kishte adaptuar formulën amerikane dhe në qëndrimet e përditshme konsumonte deklaratat amerikane të thena ndryshe.

BERISHES I MBIJNE HAPUR KUNDERSHTARE TE BRENDSEHEM POR I KERCET DHEMBET OPOZITES. - OPOZITA I PERGJIGJET ME TE NJEJTEN MONEDHE

Më 18 Janar Berisha për të kontrolluar situatën e krijuar në vend, bën një hap prapa. Për herë të parë pranon, nga tribuna e Kuvendit Kombëtar të PD-së, i mpledhur po këtë ditë, “ se Shqipëria nga kjo lojë pësoi një «goditje të rëndë” Berisha propozon ngritjen e një Komisioni Qëveritar për të verifikuar shkallën e pasojave nga fajdet. Përshtet nuk nguron të zotohet se rreth një milion Shqiptarë të mpleksur në firmat rentiere do t’i “marrin paratë e tyre dhe interesat deri në qindarkën e fundit” Pak ditë më vonë, më 29.01 Berisha në një konferencë shtypi do të deklarojë se “ Nuk do të përfitojnë (nga kthimi i parave të të dy fondacioneve të mbyllura shen. yni) ata që morën të paktën edhe një herë interesa” (pra as që bëhet fjalë për kthimin e parave të firmave të tjera rentjere) Berisha foli gjithashtu në aktivin kompëtar të PD-se se do të krijonte lehtësira për investime me paratë e depozituara në skemat piramidale. Njoftoi se do të bllokoheshin depozitat dhe veprimet e tjera që lidheshin me transferimin e pasurive të firmave piramidale. (Shtypi bënte fjalë një ditë më vonë se sasia e parave në skemat piramidale arrin në 7 miliardë dollarë, ndërkohë që qëveria konfiskoi vetëm 250 milion dollarë nga dy fondacione)

Njëkohësisht, në të njëjtën ditë që Meksi nga po e njëjta mpledhje l kthen përgjigje opozitës që kërkonte dorëheqjen e tij , se «objektivi nuk ishte Ai por PD-ja»,(duke lenë kështu të kuptohet se ai është thjesht një vegël në duart të partisë, ose të kërkojë përkrahjen e Partisë në këto situata të vështira), Tomor Maliasi akuzon qeverinë për politikë të brendshme dhe te jashtme te dështuar. Eshtë deputeti dhe kuadri l vetëm l këtij rangu në PD që në vitet pas verës së 1992, kur u shkëputen nga PD-ja mocionistet, që akuzon ashpër qeverinë e partisë se Berishës, në momente tepër të vështira për të.

Po atë ditë opozita do të marri përgjigje negative për zhvillimin e protestave të nësermen në sheshin Skëndërbej

Fakt është që policia të nësermën nuk lejoi rreth tre mijë simpatizantë të opozitës të arrinin tek sheshi Skëndërbej. Përpjekjet e demonstruesve për të çarë kordonet e policisë e cila kishte rrethuar që një ditë më parë sheshin dhe bllokuar rrugët që të çonin në kryeqytet , dështuan. Rreth orës 11 policia përdori dhunën për shpërndarjen e tyre .Mbi pesëdhjetë veta ndalohen dhe dërgohen në rajone të ndryshme policie. Demonstruesit u mblodhën afër selisë së PS -së duke thirrur parulla antiqeveritare ,madje duke akuzuar hapur qeverinë si shkaktare për humbjen e parave të tyre.

Në një njoftimin e vet Ministria e Rendit e konsideroi të paligjshëm përpjekjen për organizimin e demonstrates, dhe kërcenoi se do të zbatonte ligjin për organizatorët.

Inisiativa e organizimit të kësaj proteste l takon tre partive të opozitës, PS-së ,PSD-së dhe AD-së . Ndërkohë protesta ishin zhvilluar dhe në qytete të tjera në vend dhe policia kishte bërë arrëstime të shumta. Ajo që duhet shënuar këtu është fakti se në këto lëvizje popullore vihej re një ngurim dhe një stepje para makinës së shtetit të Berishës. Mënyra se si ishte sjellë Ai me opozitën , me gazetarët dhe kundërshtarët e tjerë të tij e bënte këtë makinë tepër hijerendë. Eshtë kjo arsyeja që shtypi kërkonte të inkurajonte vendosmëri në radhet e protestuesve duke botuar fotografi nga protestat e opozitës ne Beograd e Sofje.

Më ironike e bëri situaten specialja e ditës në televizionin shtetëror, ku jipeshin skena nga rradhët e gjata të njërzve për të blerë bileta lojrash të ndryshme fati. E vërteta ishte se këto rradhë egzistonin dhe shtoheshin cdo ditë duke zëvendësuar kështu rradhët para sportelëve të firmave piramidale .Televizioni thjesht stimulonte mënyrën e re e të sjellurit të shqiptarëve për t' u bërë të pasur pa punuar, nëpërmjet lojrave të fatit.

Ndërkohë, Berisha duke parë se situata në vend precipiton dhe natyra ekonomike e kërkesave merr trajta të plota politike, (duke kërkuar hapur dorëheqjen e qeverisë), akuzon opozitën se e politizon fenomenin fajde. Nga ana e vet opozita, kryesisht ajo Socialiste , deklaroi po atë ditë , më 20.01. se protestat do të vazhdojnë deri në dorëheqjen e qeverisë. Ajo kërkoi lirin e të gjithë të ndaluarve një ditë më parë, në Tiranë e gjetkë, “ ndryshe ,-kërcenon ,- do të jetë qeveria përgjegjëse për ashpërsimin e situatës në vend”

Më i ashpër ishte në deklaratat e veta po atë ditë kryetari l PSD-së, Skënder Gjinushi.Gjinushi kërkoi dorëheqjen e menjëhershme të qeverisë së Meksit dhe krijimin e një qeverie teknike deri në zhvillimin e zgjedhjeve të reja. Ai akuzoi qeverinë e PD-së se:” kërkoi të ndërtonte kapitalizmin shqiptar nëpërmjet fajdeve, drogës kondrabadës së armëve, prostitucionit dhe femijëve, si dhe nëpërmjet lidhjeve më mafien ndërkombëtare.”

REAGIME TE PAVLEFSHME TE QEVERISE

OPOZITA NUK ARRIN T'I IMPONOJE BERISHES MOS RADIKALIZIMIN E SITUATES

Situata e re krijuar më pas me përhapjen e lojës së protestave dhe deklaratimet e diplomave dhe e politikanëve perendimorë për gjendjen e krijuar në vend , e vë qeverinë në lëvizje për të

gjetur mjete kundërveprimi më qëllim parandalimin e protestave dhe karakterin e tyre politik. Kështu më 22.01, policia arrëston në orët e para të mëngjesit me një aksion blic në të gjithë vendin 50 punonjës të dy fondacionëve, konkretisht të Popullit dhe të Xhaferit. Mëgjithatë nuk bëhen publike arsyet e këtyre ndalimeve masive. Një ditë më vonë njoftohet arrëstim i pronarit të firmës Gjallica, Fitim Gerxhalliu, (I cili çudëtërisht, pranoi pronësinë mbi Gjallicën, pasi ajo kishte falimentuar). Në të njëjtën kohë kërkohet të vihet në veprim komisioni qeveritar, i propozuar nga Berisha për të parë gjendjen në firmat piramidale, si dhe kuadrin ligjor që do të ndalonte në të ardhmën funksionimin e skemave piramidale.

Një ditë më vonë, më 23.01, policia është në gadishmeri në të gjithë vendin. Gjykata e Tiranës denon me gjobë 40 pjesëmarrës në mitingun e Tiranës të së dielës, ndërsa 13 të tjerë me denime të ndryshme burgimi. Policia e Tiranës dënnonci në prokurori udhëheqësit e opozitës për organizimin e mitingjëve të paligjshme.

Po atë ditë Parlamenti voton në mënyrë të nxituar ligjin për mbylljen e firmave rentjere, veprim që opozita e konsideron "pas të vjelave". Opozita kërkon dorëheqjen e qeverisë Meksi si mënyrën më efikase për zgjidhjen e krizës. Berisha si rallë ndonjëherë, një ditë më vonë merr në dorë drejtimin e qeverisë, "për përbalimin e situatës"

Por, përpjekjet e qeverisë dhe të vet Berishës janë të paefektshme dhe të pashpresa. Në medjen e kohës vazhdojnë të qarkullojnë lajme për thase më para që qarkullojnë me mjete të policisë apo dhe të vet firmave, për shuma parash të humbura apo të depozituara nëpër banka të huaja, apo dhe për vila dhe pasuri përallore të pronareve të firmave, kur mijra familje shqiptare kishin mbetur pa shtëpi dhe pa asnjë qindarkë.. Dy komisionet, si ai parlamentar dhe ai qeveritar për transparencën e firmave piramidale nuk japin asnjë rezultat. Sasia e parave prej 250 milion dollarësh të dy fondacioneve të bllokuara në bankat me vendim qeverie, përbëjnë rreth 55 % të sasise se parave që qarkullojnë në kanalet jasht bankare të ekonomisë, ndërkohë që nuk është e ditur përqindja që zë pjesa nëndheshme, d.m.th. e parave të "humbura" të firmave piramidale në sasinë e parave që qarkullojnë në ekonominë Shqiptare, që për kohën arrinin shifrën e 1.5 miliard dollareve. Në bazë të një logjike ekonomike çdo përpjekje për të kthyer kreditorëve paratë mund të çonte drejtpërdrejt në shpërthimin e inflacionit, gjë që do të ishte me pasoja të rënda si për treguesit real të ekonomisë, ashtu dhe për ata makroekonomik. Të njëjtin rezultat do të kishte edhe tentativa për të shpërndarë monedhë të çlirësuar, pavarësisht se më këtë rrugë mund të kontrollohej rritja e inflacionit. Kjo ritje mëgjithatë do të ishte galopante. Nga ana tjetër procesi i transparencës vlerësohej se do të kërkonte një periudhë kohore mbi nëntë muaj, gjë që e bënte të pavlefshme ndërhyrjen e qeverisë.

Mëgjithatë në veprimet e qeverisë dukej qartë se ajo bënte ç'ishte e mundur për të mbajtur në këmbë disa nga këto firma. Por edhe kjo ishte e pamundur se nga njëra anë mungonin mjetet financiare të shtetit për të mbajtur në këmbë përkohësisht qoftë edhe njërin prej tyre, dhe nga ana tjetër ishte veshtirë të zgjidhej se cila do të përkrahej. Interesat e individëve të qeverisë që lidheshin me këto firma prekëshin drejtpërdrejt gjë që çonte në rritjen e tensioneve brenda vet PD-së.

Që nga momenti që qeveria vendosi të ndërhyjë në firmat piramidale ajo u gjend midis dy zjarrëve dhe çdo veprim për të mbyllur një plagë në një drejtim hapte plagë të reja në drejtime të tjera. Me veprimet që ndërmyrte ajo legalizoi, si të thuash akuzat që i bëheshin se prapa këtyre firmave fshihej vet ajo. Kështu u gjend përballë mijra viktimave të firmave rentjere. Nga ana tjetër ajo duhej të përballonte rrenimin fatal të ekonomisë. Një gjendje e tillë mund të quhet më të drejtë si denim i botës ekonomike për qeverinë e Tiranës, e cila përdori "lulezimin" e sistemeve piramidale për qëllime politike dhe populiste. Kështu qeveria dhe të gjitha strukturat e shtetit të organizuara nga

Berisha dhe PD-ja, hyn në një rreth vicioz, ku cdo përpjekje për ta goditur këtë rreth çeliku në një pikë të caktuar shkaktonte automatikisht rrethë viciozë të rinj.

Mëgjithatë , ajo që ravijëzohej qartë ishte përpjekja e Berishës për t'u mbajtur në këmbë me çdo kusht gjë që çonte në radikalizimin e situatës. Partitë politike të opozitës pavarësisht nga deklaratimet, jo vetëm që nuk arrinin ta detyronin Berishën t'i hynte rrugës së mjeteve politike për të zgjidhur krizën, por nuk arrinin as të parandalonin radikalizimin e situatës. Në gjendjen e re që po krijohet u duk qart se në thelb nuk ishin ato që drejtonin protestat popullore. Populli po zgjidhte rrugën e vet në zhvillimet në vend. Ai e kuptonte se paratë në firmat e fajdëve nuk kishte si t'i gjente. Nga pronarët mund të përfitonin shpirtin e tyre , gjë që për ta s' kishte vlerë. Ndaj dhe ata do të kërkonin ballafaqimin me qeverinë dhe shtetin e po kësaj qeverie si bashkëfajtorë në vjedhjen e tyre makabre.

Por shteti nuk shfaqej gjekundi. Vetëm sa provokonte për të matur pulsën.

Kapitull 3

OPOZITA NUK KUPTON LOGJIKEN E PROTESTAVE POPULLORE

Tritan Shehun nuk e mbron imuniteti e katër funksionëve të për të larta. Ai është hallka që provon kalbëzimin e shtetit të Partisë Demokratike

Pavarësia e lëvizjes popullore nga opozita duket edhe më qartë me fillimin e veprimeve të dhunshme të protestuesve si hakmarrje ndaj shtetit tinzar. Opozita e akuzuar nga PD-ja si organizatë e veprimeve të dhunës, distancohet prej tyre. Ajo nuk mund t'i imponohet logjikës se re të protestave, (kujtojmë fjalimet e udhëheqësve socialist të kryeqytetit në mitingun e 26.01 në aneksin e stadiumit Dinamo)

Njëkohësisht Opozita harxhon shumë kohë në akuzat e ndërsjellta për shkaktarët e vertetë të veprimeve të dhunshme. Kështu që ajo edhe një herë vetëizolohet në rolin udhëheqës të protestave antifajde, antiqeveritare dhe në përgjithësi kundra regjimit të Berishës. Udhëheqja e opozitës nuk arrin dot të përckatojë rregullat e lojës dhe t'i imponohet Berishës, aq më tepër që një pjesë e mirë e saj detyrohet të braktis vendin për shkak të represionit berishian, ndërsa një pjesë tjetër ka frikë se është mpleksur me piramidat. Njëkohësisht opozita nuk frymëzon dot zgjidhjen në perspektivë të situatës. Pranon si zgjidhje konfortable përpara Berishës, distancimin nga dhuna duke hapur kështu dritën jeshile, shkatërrimit fizik të shtetit, të cilit faktikisht i kishte mbetur vetëm një dimension, - dhuna të revoltuarit, që kërkonin tanimë si shpërblim për humbjet në piramida, rrezimin e Berishës, e përceptonin atë si shkatërrim të çdo gjëje që lidhej me funksionin e tij. Kjo i interesonte dhe klanit të Berishës pasi humbiste gjurmët e grabitjes sistematike që i kishin bërë shtetit . U interesonte gjithashtu dhe asaj pjese të opozitës që zotëronte pushtet.

Kjo u duk qart me fillimin e revoltave të dhunshme në Lushnjë. Me 24.01, mijra kreditorë dhe banorë të tjerë të qytetit, duke kërkuar paratë e tyre, lirin e Xhaferit, (i cili pretendonte se i lirë do të kthente paratë), dhe rrezimin e qeverisë, iu sulen bashkisë së qytetit duke e shkatërruar atë. Policia ndërhyr për të mos e djegur krejtësisht. Të njëjtin fat pati dhe kinoteatri i qytetit, ndërsa digjen 7 makina policie dhe bllokohet në disa vende rruga nacionale drejt Tiranës. Ndërhyrjet e policisë u kthyen në përlëshje të fuqishme.

Ngjarje të dhunshme, por jo të përmasave të tilla, ka dhe në Kavajë. Një ditë më parë në Shkodër. Elbasan e Durrës. Në të gjitha rastet u desh ndërhyrja e policisë për shpërndarjen e demonstruesve. Karakteristikë është fakti që në këto protesta nuk shquhen udheheqës.

Po këtë ditë, më, 24.01, VEFA bllokoi kapitalet e kreditorëve dhe jep përqindje intëresi të ulura jo në valutë por në lekë. Në vend bien sirenat e alarmit. Deklarimi i falimentimit të VEFES, që mbahet me gjilpera, mund të sjell pëshjtjellimin dhe kaosin e përgjithshëm. Kjo për faktin se kërkesa e 500 mijë kreditorëve të saj për tërheqjen e kapitalëve, vë në rrezik jo vetëm VEFEN por dhe arkat e zbrazura të shtetit.

Veprimet e dhunshme në qytetin e Lushnjës përseriten edhe paraditën e ditës 25.01.97 për të arritur kulmin pasditën e kësaj dite ku mbahet peng për më shumë se tetë orë, zëvendëskryeminstri, ministri i jashtëm dhe kryetari i PD-së, Tritan Shehu. Ai kishte vajtur në Lushnjë për të qetësuar zgjedhësit e tij, por sa zbriti nga helikopteri në stadiumin e qytetit rrethohet, zhvishet, i futet presh në gojë dhe në vende të tjera dhe mbahet rrob gjërsa erret dhe demonstruesit humbasin vigjilencën. (preshi do të bëhet më vonë në demonstratat e Vlorës simboli i fitorës mbi Berishën. Edhe ky është një fakt domëthenës). Shehu është i plagosur në kokë dhe në trup. Grupi prej tetë vetash që erdhi më një helikopter të dytë për ta shpëtuar, shpartallohet dhe anëtarët e tij përcillen me plagë në spital, në gjendje që konsiderohet e rëndë.

Ngjarja e trondit thellë makinën e frikshme të shtetit të Berishës. Më sakt duhet thenë se demonstruesit panë se shteti i Berishës ishte i gërryer, i dobët dhe i paaftë. Ai priste vetëm një shkëmb që të shembëj përdhe.

Po atë ditë, në Belsh një deputet tjetër i PD-së mbahet peng në këmbim të të ndaluarve nga policia dy ditë më parë në mitingun e Elbasanit.

SITUATA MAHISËT.- SHFAQET SILUETA E GJENDJES SE JASHTEAKONSHME

Situata në vend po dilte jashtë kontrollit, por Berisha deklaroi se ajo është plotësisht nën kontroll. Mjetet shtetëror të informimit flasin për një gadishmeri të lartë të policisë në të gjithë vendin. Berisha shfaqet në televizion dhe pa mundur të fsheh frikën e tij, pasi mbron në mënyrë banale Tritan Shehun në Lushnjë duke thenë se ishte vizitë tek disa miqtë e tij, i bën thirrje popullit që të qetësohet duke premtuar edhe një herë se do t'u kthejë paratë. Për të konkretizuar këtë premtim, menjëherë pas tij shfaqet në ekran kryeministri Meksi i cili deklaroi se më 05.02 do të fillojë shpërndarjen e parave të kreditorëve. Kuptohet se bëhet fjalë për paratë e kreditorëve të fondacioneve Populli dhe Xhaferi. Paratë e bllokuara megjithatë janë vetëm 250 milion dollarë në një kohë që paratë e kreditorëve arrijnë në disa herë më shumë gjë që do të thotë se paratë nuk egzistojnë, aq me shumë në duart e qeverisë.

Lajmi, megjithë shpresën që sjell për shumë njëzëz, nuk arrin të shuaj përshtypjen e krijuar se shteti ndërhyr pa ligj tek depozitat bankare të një subjekti, me qëllim që një pjesë e tyre t'i kalojnë buxhetit të zbratur të shtetit. Ky fakt do të përforcohet më shumë disa ditë më vonë kur qeveria do të shpallë se do të shpërndajë reciprokisht 50 dhe 60 përqind të parave të këtyre dy fondacioneve, një pjesë e tyre me librezë, në një kohë që dy boset e burgosur të këtyre fondacioneve deklarojnë se i kishin të gjitha paratë e kreditorëve.

Po atë ditë Berisha fton partitë politike parlamentare për të gjetur një rrugëzgjidhje. Lëvizja e Berishës nuk është vetëm produkt i panikut që zuri kambin e tij. Kjo lëvizje nuk lidhet gjithashtu me

përpjekjen e Berishës për të shpëtuar vendin . Me këtë levizje Berisha kërkon të shpëtojë vetën duke ndarë fajin me opozitën.

Partia Socialiste bojkoton tavolinën e Berishes . Logjika e bojkotimit është me se e thjeshtë. Partia Socialiste nuk njih tavolinën e partive parlamentare përderisa nuk njih parlamentin dhe kërkon tavolinë të rumbullakët të të gjitha partive politike në vend.

Në krah të Berishës u ulën partitë që konsideroheshin në fakt aleatë të tij. Berisha lë pikërisht këta aleatë të akuzojnë Partinë Socialiste se është ajo që «nxit protestuesit në veprime të dhunshme dhe në shkatërrime.»

.Kjo përplasje midis pozitës dhe opozitës për faktin se kush është nxitësi veprimeve të dhunshme nuk ndikon aspak në rrugën që kishin marrë këto protesta Kështu më 25.01, në protesta përfshihen disa qytete të vendit me kërkesa ekonomike por edhe për dorëheqjen e qeverisë Meksi. Në Vlorë, Fier, Korçë, Kocovë shkatërrohen dhe digjen një sërë objektësh shtetërore dhe të pushtetit lokal.Në Vlorë digjet në mënyrë të cuditshme Bashkia dhe jo e gjitha. Pas dy shpërthimeve marrin flakë tri zyra, njëra e kontrollit të shtetit, e dyta zyra e ktimit të pronave dhe një tjetër pa rendësi. Në Korçë digjet cudetërisht dhe shtëpia ku ka qëndruar nobelisti grek Seferis. Ndërkohë, edhe një ditë më vonë, më 26.01 vazhdojnë veprimet e dhunshme në Lushnjë. Protëstuesit shkatërrojnë godinën e arkës së kursimit por nuk prekin arkën.

BERISHA NDALON GJENDJEN E JASHTËZAKONSHME DUKE FORCUAR POZITAT E VETA

Ngjarjet e dhunshme përhapën në Berat ku digjet Bashkia, Keshilli I Rrethit, Prefektura, zyrat e Komisarariatit dhe të SHIK-ut.Plagoset rendë shefi I komisarariatit dhe një deputet.

Në Memaliaj, një ditë më parë bllokohet rruga tek ura jasht qytetit deri natën vonë.

Ngjarje me episode te dhunshme ka dhe në Kavajë, në Peqin, Elbasan , dhe në qytete të tjera , kryesisht të Shqipërisë së Mesme. Në përleshjet midis demonstruesve dhe policisë mbetën te plagosur 83 policë dy prej të cilëve në gjendje shumë të rendë. Nuk dihej numri I të plagosurve nga ana e demonstruesve. Policia nuk arriti t'i parandalonte e t'i shpërndante protestat, por shkon natën shtëpi më shtëpi dhe arrëston ata që I konsideron organizatorë. Numri I të ndaluarve sipas opozitës dhe shtypit arrin ne 800 veta në të gjithë vendin. Ministria përkatëse deklaroi më pak se 400. Torturat që u bëhën të ndaluarve nuk përshkruhen dot, do të deklarojnë vet të ndaluarit në polici.

Por e fuqishme qe, në të njëjtën ditë dhe protesta në Tiranë. Demonstruesit nën thirrjen e udhëheqësve te opozitës e braktisin shumë shpejt vendin që u kishte caktuar policia, aneksin e stadiumit DINAMO, dhe I drejtohen sheshit Skënderbej, e ndaluar nga strukturat e Berishës kategorikisht për opozitën. Policia ndërhyri edhe këtu, për të mënjanuar sipas variantit zyrtar, aktet e dhunshme. Por gjakos rendë disa nga drejtuesit e opozitës dhe shumë prej tyre I con nëpër komisariate

Pas gjithë këtij represioni Kryeminsitri Meksi rishfaqet në ekranin e televizionit shtetëror duke përmendur përseri datën pesë shkurt për kthimin e parave.

Në të njëjtën ditë mbledhet edhe parlamenti për të diskutuar për situatën. Në vend është krijuar bindja se nuk ka asnjë vlerë ,çdo vendim I parlamentit çelësat e të cilit I mban Berisha. Rrugëdaljet janë vetëm dy, ose të japi dorëheqjen qeveria ose të vendoset gjendja e jashtëzakonshme në vend.

Në punimet e parlamentit ndërhyu Berisha. Ai kundërshton propozimin e deputetëve te partisë së tij të cilët kërkojnë të vendosin gjendjen e jashtëzakonshme në vend. Berisha e shfrytëzon

këtë veprim për të rritur sadopak kredibilitetin e vet demokratik. Nga ana tjetër nuk ishte as i predispozuar të kërkonte dorëheqjen e qeverisë. Perkundrazi Ai tha se qeveria punoi mirë dhe se “shkaqet e krizës duhen kërkuar tek të zgjedhurit e partisë” Me këtë Berisha la të kuptohet hapur mundësinë e zhvillimit të zgjedhjeve të reja, por me qeverinë e PD-së. Një levizje e tillë përbënte nga ana tjetër një mjet presioni shumë të fuqishëm për të eliminuar çdo lloj kundërshtimi, apo revolte të brendshme ndaj vetës, në një kohë kur dihej se opozita nuk do të pranonte kurrë zgjedhje të reja me një qeveri po të PD-së.

Parlamenti i PD-së nuk vendosi atë ditë as një të asnjë tjetër. Natën vonë duke u gdhirë 26.01. autorizon Presidentin e Republikës dhe Komandantin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura « Për të përdorur Forcat e Armatosura në ndihmë të rendit publik. Po atë ditë Berisha nxorri urdhërin përkatës.. Kjo, kuptohet, donte të thoshte se vetëm de jure nuk është vendosur gjendja e jashtëzakonshme në vend, aq më tepër kur në urdherin e Berishës, nuk përcaktohet numri i ushtrisë dhe i repartëve që do të kalonin në këtë mision e as detyrat përkatëse. Këto shkelje nga ana e presidentit do të pasohen me vonë nga urdhërat e drejtuesve të lartë të ushtrisë. Më 28.01, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm SHEME KOSOVA dhe pas tij ministri i Mbrojtjes SAFET ZHULIALI urdherojnë lëvizjen e brigadës komando të ZALL HERIT në drejtim të FIERIT për përforcime të brigadës së këtij rajoni. Urdhërat do të pasojnë njëra tjetër deri dy ditë para vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme kur po prap SHENE KOSOVA jep urdher për lëvizjen e brigadës së tankeve të ZALL HERIT për në FIER në drejtim Vlorën .

Kuptohet është momenti kur populli proteston krejt jashtë çdo logjike të përdorimit të armëve. Por lëvizja e forcave dhe e armëve ushtarake në drejtim të qëndrave të protestave në JUG zgjon vetëdijen popullore se duhet mbrojtur. Që nga ky moment dhe shkallëzimi i masave ushtarake kundër qyteteve të protestave provokon armatosjen për mbrojtje të popullit. Mobilizimi i forcave ushtarake të instaluar në VERI për t’ju kundërvënë JUGUT, ashtu siç pohohet edhe në raportin e Komisionit Parlamentar të hetimit të ngjarjeve të trazirave të 1997, tregon qartë se skenari i JUGUT kundër VERIUT, ose më sakt e kundërta, ishte një skenar që nuk lindi thjeshtë në fillim të marsit , me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme

Megjithatë, prova e parë e përdorimit të ushtrisë kundër protestuesve deshtoi një ditë më parë, kudo ku u përdorë. Fakti që asnjë forcë dhune nuk është efektive në shtypjen e revoltave nuk lidhet aq me forcën e papërbalueshme të protestave se sa me faktin e vullnetit të paktë të këtyre trupave për të vëpruar. Logjika dhe realiteti pra i kishte bërë dhe forcat më besnike të njëshit të shtetit të ishin të paefektshme.

SHPERTHIMI I BURGUT TË KAVAJES , -SHENJE E KEQE PER ECURINE E NGJARJEVE. RADIKALIZIMI I SITUATES LOGJIKE E PASHMANGSHME

Ndërkohë , ndërsa në një situatë të tillë Berisha, sipas shtypit mendon edhe për braktisjen e vendit, në zhvillimet e atyre ditëve shfaqet dhe një fenomen i ri. Duke u gdhirë 27.01, shpërthen burgu i Kavajës. Të burgosurit djegin ç’ mund të djegin dhe pasi marrin dy gardianë pengë, e braktisin burgun. Pati dy të vrarë nga ana e të burgosurve dhe disa të plagosur nga të dyja anët. Po krijohet një precedent i rrezikshëm . Dikujt i interesonte që të burgosurit të ishin të lirë. Problemi ishte se si do të përdorëshin këta një të njëz në situatat e trazuar në vend . Shpërthimi i burgut të Kavajës do të pasohet disa javë më vonë më shpërthimin e burgut të Sarandës , më 01.03 dhe më 13.03.97, me shpërthimin e të gjithë burgjeve në vend nga lirohen afër 1500 të burgosur. Këto akte dhe falja misterioze e një të njëzve me denime të rënda nga ana e Berishës pak kohë më vonë, 16.03 (52

të burgosur midis të cilëve dhe F.Nano si i dënuar politik, por edhe Gaxhai I Vlorës, I denuar për vrasjen e një të mituri) është domosdoshmerisht e lidhur me përpjekjen e pushtetit tëpër të dobësuar të Berishës për të siguruar përkrahës . Lidhet gjithashtu edhe me krijimin e një situatë tepër refraktare edhe të tokës së djegur për pasardhësit e tij në pushtet.Vezhguesit të huaj politikë atëherë I përcaktonin zhvillimet e mëtejshëm në vend me qëndrimin e të liruarve nga burgu. Të gjithë donin të shikonin anën e kujt do të mbanin ata. Por ndodhi edhe me ata një çudi shqiptare. Ata I hynë rrugës së grabitjeve dhe të kaosit. Kuptohet kishte edhe nga ata që u rreshtuan me Berishën, shumica, emra prej tyre u panë më vonë në strukturat shumë afer afër pushtetit, por edhe me opozitën. Mëgjithatë, edhe ata që ndoqën rrugën e bastisjeve dhe terrorit, ndihmonin Berishën. Një situatë e tillë kaosi jo vetëm që e dekompononin përfundimisht shtetin dhe strukturat shoqërore, por edhe nuk linin asnjë korridor për të menduar për të ardhmën, që tanimë I atribuohet vetëm popullit dhe opozitës.

Dita e 27.01, në fakt shpалos edhe një herë tensionet në dukje të fashitura disa orë më parë në parlamentin shqiptar. Në mbledhjen e qeverisë kryeministri Mexsi kërkon që “ forcat e ruajtjes së rendit, (d.m.th edhe ushtria) do të duhet të zbatojnë ligjin në mbrojtje të interesave të kombit dhe të shtetit ligjor” dhe përsëriti se do të respektohet 05.02, për shpërndarjen e parave.

Po këtë ditë Tritan Shehu zëvendësi I Mexsit në qeveri, kryetari I tij në Partinë Demokratike dhe Ministër I Jashtëm I Shqipërisë, akuzon opozitën për valën e demonstratave dhe të shkatërrimeve në vend. Në zbatim të deklaramëve të Berishës në grupin parlamentar ai bën përgjegjës struktura të zgjedhura të PD-së , deputetë dhe të zgjedhur të pushtetit lokal, “ të cilët nuk reagojnë në kohë për parandalimin e gjendjes”.

Mirëpo kjo deklaratë duket se nuk frenon revanshin dhe tendencën për zgjidhje ekstreme nga ana e të zgjedhurëve në Partinë Demokratike të Kryeqytetit . Ata kërkojnë që të dalin jashtë ligjit P.S-ja, PS D -ja dhe AD-ja. Ndërkohë po në mbledhjen e PD-së së Kryeqytetit dëgjohen thirrje: “ Vdekje socialisteve” Televizioni shtetëror në emision special flet “për terror të kuq”, duke fajësuar hapur opozitën për gjendjen e krijuar në vend.

Rezultat I kësaj situatë të radikalizuar në kulm është dhe masakrimi I njërit prej eksponentëve të shquar për guxim e qëndresë të PS-së, Ndrë Lëgisit. Plagosja për vdekje në kokë me sende të forta e Ndrë Legisit ishte kulmimi I një taktike të njohur tanimë nga ana e PD-së, për asgjësimin e shpirtit luftarak të spektrit të gjërë të kundërshtarëve të vet. Në këtë listë përfshihen emrat Cekinit, të Kekos , të Zefit, të Ramës, të Islamit, Rucit, Imamit, Cekës, Brokajt, Cupit, etj. Kërcënime të herëpashërshme I bëhen dhe gazetës “KOHA JONE” dhe gazetarëve e korespondentëve të tjerë në qëndër dhe në rrethe. Por vazhdimi I një taktike të tillë ishte tanimë e pavlefshme. Shpirti I revoltave kishin tjetër venddodhje që nuk mund të asgjësohej. Berisha kishte tanimë kundërshtarë të betuar popullin e vet.

Momentet tregojnë se urat që lidhnin pushtetin e PD-së me Opozitën dhe popullin ishin shembur përfundimisht. E ndërsa PD-ja mund të nëpërkembte akoma opozitën, tanimë e kishte tepër të veshtirë të përballej me popullin.

Edhe opozita nga ana e vet mëgjithatë nuk e pranon sfiden e PD-së. PS, PSD dhe AD ri distancohen edhe një herë nga dhuna dhe shkatërrimet dhe akuzojnë segmente të shtetit në veprimet kundër opozitës në mitingun e Kryeqytetit dhe vet qeverinë se gjendet pas sistemit të fajdeve , pas çdo lloji kondrabannde dhe pastrim parash. Përsëriten gjithashtu kërkesën për dorëheqjen e qeverisë së PD-së, krijimin e një qeverie teknike për gjetjen e zgjidhjes së krizës dhe në vijim zhvillimin e zgjedhjeve të reja.

OPOZITA KRIJON FRONTIN ANTIBERISHE - FORUMIN PER DEMOKRACI

Pas kësaj përplasjeje pozitë - opozitë, Berisha ribën një piruetë tjetër. Më 28.01. ai provon të organizojë para bashkisë së Tiranës një "antimiting paqësor" për të rikuperuar gjasëm demtimet e ndodhura në kryeqytet nga ithtarët e opozitës dy ditë më parë. Përpjekja deshton dhe njëkohësisht tregon se Berisha jo vetëm që ka humbur popullaritetin por rrethi i përkrahësve është ngushtuar shumë dhe se ai detyrohet të dalë në terren i stërmbrojtur. I shoqëruar nga Tritan Shehu, që tanimë në Shqipëri i thërrasin Tritan Preshi, Berisha gjen rastin të deklarojë se kredotitret do t' i marrin parët e tyre pa përmendur datë të caktuar si kryeministri Meksi.

Po në të njëjtën ditë, më 28.01, një nga aleatët e Berishës në qeveri, kryetari i Partisë Republikane Sabri Godo, ndryshe nga Berisha që ftoi para disa ditësh partitë parlamentare në tavolinë të rumbullakët, fton 13 parti që kanë përfaqësues në pushtetin lokal. Por pikënisja e Godos për të gjetur një zgjidhje duke u mbështetur në qeverinë dhe udheheqjen aktuale politike në vend has në kundërshtimin e opozitës gjë që bën edhe këtë tavolinë të deshtojë.

Cudetërisht këto veprime të pozitës u zhvilluan në një ditë të qetë pa protesta dhe veprime të tjera dhune në vend, ndërkohë që ushtria ishte e pranishme në qendra dhe institucione shtetërore si dhe nëpër rrugë. Kjo prani shoqërohet paralelisht me një valë arrestimesh në të gjithë vendin si shpresa e vetme e Berishës për të thyer shpirtin e revoltave popullore që i jipnin zemër si opozitës ashtu dhe kundërshtarëve të vet brenda partisë. Llogaritet që numri i të arrësuarve të këtë tejkalar numrin e 500 vetave, kryesisht njërez të opozitës. Berisha shfaqet vet tani publikisht për të akuzuar opozitën socialiste se është përgjegjëse për valën shkatërrimtare. Nga ana e vet Tritan Shehu i akuzon socialistet se janë ata frymëzuesit e ngritjes së skemave piramidale.

Kundërpërgjigjen socialistet. Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Rexhep Meidani e akuzon Berishën se pas marrjes së vendimit për të nxjerrë ushtrinë nga kazernat kundër protestuesve, pas arrestimeve të shumta dhe terrorit të ushtruar, ai de facto ka vendosur në vend gjendjen e jashtzakonshme me synim zhdukjen e opozitës. Ndërsa për shkatërrimin e një serë objektesh ku mbaheshin dokumentat e privatizimit të pasurisë shtetërore, theksoi Meidani, "janë të interesuar drejtpërdrejt strukturat e korruptuara të partisë në pushtet. Opozita, ndërsa pretendon pushtetin nuk është e interesuar për të marrë në dorëzim tokë të djegur". tha Meidani.

Në fakt një deklaratë e tillë përmban gjithë filozofinë e çarmatosjës politike të strukturave shtetërore të PD-së, e cila, nga njera anë, si shtet duhet t' i mbrojë këto institucione, pra tregon paaftësi qëverisëse, dhe nga ana tjetër, vet ky qëndrim e bën atë fajtorë si të vetmën forcë të interesuar për këto shkatërrime me qëllim fshehjen e gjurmëve të korupsionit. Problemi është në të vertetë shumë më i thellë.. Revoltat popullore, që më kalimin e kohës do të marrin natyrën e plotë të një kryengritjeje, kundërshtojnë shtetin destinacioni i të cilit kishte kohë që ishte i ndryshuar. Ai funksiononte nën një mentalitet vjedhjeje të pasurive materiale dhe asgjësimit të vlerave të tjera morale dhe shoqërore të krijuara nga shoqëria, në emer të këtij shteti dhe përjetësimi të pushtetit të PD-së. Në këtë gjykim nuk mund të konsiderohet pa përgjegjësi opozita e cila kontrollonte gjatë kësaj periudhe shkallën e parë dhe të dytë të pushtetit,-pushtetin lokal. Askush nuk mund ta vë në dyshim se dhe ky pushtet i kontrolluar nga opozita funksiononte më të njëjtin mentalitet, si pushteti i PD-së, por në atë masë që e lejonte pushteti i kontrolluar nga Berisha. Pra në përpjestime që kontrollon pushtet që të dyja palët janë përgjegjëse për shkatërrimin e shtetit. Fakti që Berisha pranoi për krymenistër të qëverisë se Pajtimet Kombëtar, disa javë më vonë, një përfaqësues të këtij pushteti nga radhët e opozitës, dhe po ashtu fakti që opozita erdhi në pushtet pas disa muajsh dhe kurrsesi nuk mori përsipër për të gjetur fajtorët e katastrofës, tregon pikërisht një bashkëfajësi të të dy palëve.

Berisha , që më 26 maj të 1996 , ishte venë përballë një grupimi partish të një spëktri më të gjerë, që, megjithatë , Ai qëllimisht i quante opozitë të majtë .Më këtë logjikë revoltat popullore, sipas tij ishin të organizuara nga bandat e kuqe. Më 29 janar këto subjekte nga e majta në të djathtë bashkohen , me inisiativën e shoqates së ish të përndjekurve politikë, dhe krijojnë “ Forumin për demokraci” Forumi doli me një platformë politike më të organizuar por jo të plotë. Forumi për Demokraci kërkonte dorëheqjen e qeverisë, krijimin e një qeverie teknike, krijimin e një komisioni për kontrollin e pasurisë së personave qeveritarë, të kontrollit të menyrës së privatizimit dhe kontrollit të firmave piramidale. Krijimin e një komisioni tjetër për përmirësimin e ligjit elektoral dhe përgatitjen e zgjedhjeve të parakohshme, si dhe të përcaktimit të procedurës së Kushtetutës”

Siç shihet dhe siç u provua në praktik, krijimi i këtij Forumi pati rendësi shumë të madhe. Krijoi një front unik të deklaruar nga e majta në të djathtë kundër Sali Berishës. Themi të deklaruar se në praktik ai pak funksionoi si tillë. Kjo jo për arsye se i pengonte uniteti ideologjik porse struktura e tij ishte më e dobët se struktura organizative i partive të veçanta. Autoriteti i udhëheqjes së tij ishte gjithashtu më i dobët se ai i udhëheqjes së partive në veçanti. Nga ana tjetër, e theksojmë edhe një herë se Forumi u krijua që të rritet forca politike e vet partive.

Nga ana e tyre, protestat popullore , edhe pse kishin nevojë për një rol udhëheqës dhe koordinues që mund të shmangte ashpërsinë e dhunës, nuk e pranuan rolin udhëheqës të partive politike për arsye se pasiviteti dhe mjetët e zgjedhura prej tyre si për kthimin e parave ashtu dhe për rrëzimin e Berishës ishin larg nga rruga që kishte zgjedhur populli dhe që i shkonte për shtat Berishës. Nga ana e vet Forumi nuk përcaktoi një strategji të caktuar dhe unike në veprimet e veta si për të imponuar zgjedhje të reja , ashtu dhe për bashkupunimin midis pjesëmarrësve në të , para dhe pas zgjedhjeve të mundshme . Po ashtu në platformën e tyre partitë e Forumit, janë sa të përgjithshëm dhe evazive sidomos përsa i përket mënyrës së realizimit e kësaj platforme. Atje fillet, p.sh, për krijimin e komisionëve të ndryshme, por për to nuk flitet si do të fitojnë fuqi vepruese ligjore Në praktikë Forumi dhe partitë vepronin paralelisht

KRONIKE NGJARJESH, SITUATE TENSIONI NE RRRITJE

Duke ardhur tek kronika e ngjarjeve duhet thenë se ditët e fundit të janarit shquhen nga përpjekjet e vazhdueshme të qeverisë së PD-së për të krijuar bindjen se shkurti duhet pritur si muaji i shpresës. Mirëpo nga ana tjetër vihet re një shkërmoqje e mëtejshme e skëmave piramidale, ndërkohë që midis mijërave të shqiptarëve riciklohet një atmosferë të përdur e elektrizuar. Njëkohësisht në shumë qytete vazhdojnë demonstratat popullore. Ato , pavarësisht nga deklaratat e opozitës se do të jetë në krye të tyre kanë një logjikë të tyre të brendshme e mbeshtetur në dy akse bazë. Në kthimin e parave të humbura dhe në dorëheqjen e qeverisë së Partisë Demokratike.

Në Shkodër, nën vëzhgimin e rreptë të forcave të rendit mijra protestues demonstrojnë ulur dhe në heshtje në sheshin kryesor të qytetit.. Në Pëshkopi protestat kishin karakter të përdur të dhunshëm. Kordoni i policisë u gjakos nga sendet e forta të përdorura nga ana e demonstruesve , të cilët në vijim dogjen dhe shkatërruan zyrat e prefekturës. Në Permet, policia me përkrahjen dhe të forcave të ushtrisë shpërndan protestën e qindra qytetarëve të qytetit dhe të fshatrave përreth

Kuadrin e protestave në të gjithë vendin e plotëson edhe Gjirokastra ku akoma nuk kishte asnjë shenjë revolte. Pushteti lokal kërkon nga Konsullata e Përgjithshme Greke në Gjirokastër që të pezullojë funksionimin nga frika se mos grumbullimi i njerëzve për vizë mund të shërbente edhe si shkëndijë për organizimin e protestave popullore. Një masë tjetër që ndërmori pushteti lokal në këtë qytet ishte bllokimi i kanalave televizive të huaja në kohën e lajmeve. Kjo ndodhte veçanërisht me

kanalet greke Megjithatë në Gjirokastrë shenohet akti i parë i protestave popullore nën drejtimin e opozitës. Kjo protestë që e vakët

Po më datën 29.01. Berisha kërkon të qetësojë shqiptarët duke komunikuar masat e kthimit të parave. Këto masa përbëjnë thelbin e ligjit të qeverisë që do të aprovohet një ditë më vonë nga parlamenti. Sipas këtij ligji sasia e parave që do të shpërndahen do të kënë si bazë koeficientin e dalë nga raporti i parave të depozituara me paratë gjendje. Këtu do të llogariteshin dhe pasuritë e patundshme të dy firmave rentjere Populli e Xhaferi. Këto lloj garnacish të Berishës do të karakterizohen nga shtypi i ditës “si një dozë e re morfine në situatën e dekombozuar për vet Berishën» Kjo lidhet dhe me faktin se Berisha nuk dha asnjë garanci dhe shpresë për mijrat e kreditorëve të firmave të tjerë që ose falimentuan, ose drejtuesit e tyre u larguan jashtë vendit. Bëhët fjalë për Kreditorët e Sudës, të Gjallicës, të Kamberit (firmë e cila që prej tre ditësh i kishte, pa asnjë shpjegim, të blokuara sportelet) të Grunasit që u zhduk bashke më 16 milion dollarë të kreditorëve, të Cenajt që në fakt falimentoi, etj. Po ashtu VEFA pas uljës së interesit mujor në 5% , që një ditë më parë nuk kthen interesa në valut por në lekë shqiptare. Kjo shoqërohet me një humbje të fshehtë të parave të kreditorëve. Nga ana tjetër përpjekjet e qeverisë për t’ë “kthyer“ paratë me librezë me qëllim që të frenojë sadopak ritjen e inflacionit, janë të pavlerë. Leku shënon vetëm rrenje duke arritur më 30.01 të kembehët një dollarë me 120 lekë nga 96 që ishte në Nëntor. Ndërsa një ditë më vonë një dollar do të këmbhet me 125 lekë. Një situatë e tillë tregon se as inflacioni s’mund të ndalet e as populli ka më besim tek leku gjë që sjellë dhe çvlerësimin të metejshëm të monedhes shqiptare.

Po ashtu të gjitha gjasat janë që Gjallica të mos mund t’i hapi sportelet e vet as me pesë ose gjashtë shkurt, gjë që i bën këto data të konsiderohen si minë me sahat në tokën barut i thatë të Shqiperisë

Fundin e muajit janar e shenon edhe një ngjarje tjetër. Gjykata e Tiranës dha denimet e para për 80 të arrësuar “për kryerjen e veprimeve të dhunshme dhe shkatërrime në shumë qytete të vendit.

Kapitull 4

BALLE PER BALLE

BERISHA NUK PERCAKTON DOT ME RREGULLAT E LOJES

«Në rast se nuk do të na kthehen paratë do t’i vemë flakën detit» kërcenonin Vlonjatët më 5 shkurt, ditën e komunikimit të falimentimit të Gjallicës. Të nësermën më datë 06.02 ishte njoftuar për rihapjen e sporteleve saj. Kjo datë shenon fillimin e protestës dhe rezistencës mbi 100 ditëshë të Vlorës që rrezoi Sali Berishën. Kjo rezistencë i kushtoi Vlorës gjashtëqind jetë njerëzish. Ishte një lëvizje që të kujtonte kryengritjet e Parisit të kohës së Hygoit. Një mpleksje e shumëfishtë interesash që kërkonin ta tërhiqnin këtë lëvizje drejt llumit. Por ky qytet arriti që mbi llum të lartësojë pa njolla simbolin e qendresës që mund të këqën dhe i hap rrugën perspektivës. Humbja e Vlorës përballë Berishës shënonte humbjen e shqiptarëve përballë së keqës.

Filloi dita e parë e demonstratave masive në Vlorë. Vlonjatët mblidhen në shesh para Gjallicës dhe kërkojnë paratë e tyre por bërtasin dhe parulla politike kundër Berishës dhe qeverisë së PD-së. Pas kësaj demonstruesit, në fillim rreth pesë mijë veta, i drejtohen Sheshit të Flamurit dhe duan të demonstrojnë paqësisht vullnetin e tyre. Por ndërhyjnë forcat e rendit dhe të ushtrisë. Ato

përdorin gazin lotsjellës dhe pombat e zjarrefikësve. Protestuesit përleshën me forcat qeveritare. Nata në Vlorë është e frikshme. Policia bën arrëstime të shumta. Televizioni shtetëror I transmeton pamjet e shemtuaara për të treguar se qeveria dhe shteti nuk do të tolerojnë askend, të bëjë si të dojë. Madje transmeton se pati dhe të plagosur me armë zjarri,- tre nga ana e domenstruesve dhe dy nga rendi.

Të nësemën pritej që në Vlorë të arrinin edhe kreditorë të tjerë nga Fieri e krahina të tjera, « për të marrë paratë». Ndaj edhe kërsaçi I dhenë, sipas logjikës së shtetit, duhej të ishte shëmbullor. (Siç dihej Gjallica ishte më e madhja firmë pas VEFES në vend). Në Fier ishin dislokuar forca të shumta si për ta mbajtur të izoluar Vlorën, ashtu edhe për të penguar derdhjen aty të kreditorëve të tjerë. Në Vlorë po atë natë arrijnë forca të tjera dhe pothuaj gjithë drejtuesit e Rendit posht ministrit. Në krye të tyre ishte Agim Shehu. Forcat e Briskut dhe të RENEAS që sollën me vete do të përplasen me demonstruesit po atë mbasdite tek vendi I quajtur Kali I Trojës. Këto forca do të thyhen menjëherë para masivit të demonstruesve Vlonjatë.

Situata në Vlorë precipiton shumë shpejt. Më datë 06.02 Konfrontimi I popullit të revoltuar me policinë përseritet. Populli kërkon ta diferencojë policinë, ashtu si dhe policia vendase tregon gjakftohtesi dhe afinet. Por në Vlorë tanimë janë dislokuar shumë forca dhe shumë oficerë. Arrëstohen shumë njërez dhe çohen në Tiranë. Demonstratat antifajde marrin menjëherë karakter politik. Demonstruesit kërkojnë dorëheqjen e qeverisë dhe të presidentit Berisha dhe zhvillimin e zgjedhjeve të reja. Në të njëjtën kohë banorët e Vlorës e prishin tabunë e paprekshmerisë së njërezve të rendit dhe të ushtrisë të dislokuar në Vlorë. Xhahid Xhaferri, komandanti I Gardës, kërkon që populli të goditet. Agim Shehu bindet se Vlora nuk shtrohej më ato forca që kishte dhe më datë 07.02 ikën nga Vlora për në Tiranë për t'u rikthyer dy ditë më vonë me makina të shumta IVECO të ngarkuar me forca, të policisë dhe të ushtrisë..

Po më 08.02 situata në Vlorë kishte marrë përmasa të paparashikueshme. Ishin degjuar armë dhe ishin sulmuar disa nga objektet kryesore të qytetit Përgatitej përplasia e madhe midis forcave të shumta policore e ushtarake dhe demonstruesve. Atje ishin dislokuar forca të shumta nga Elbasani, Tirana, Durrësi, Lushnja Sranda, Mallakstra, etj. Midis tyre kishte edhe forca nga Veriu. Ato I drejtonte Agim Shehu. Pas cdo përplasjeje provokimet ndaj qytetarëve Vlonjatë veçanarisht në çeshtje nderi dukej se fshihnin një strategji. Më këtë Berisha, ose tentonte të fuste në lojë kartën e përplasjes Jug-Veri ose e kishte kuptuar se vetëm veriorët, të gënjer me sloganin «Jugu sulmon Veriun, dhe ata që kishin përfituar nga Ai më shumë se sa në ëndërr mund ta mbronin. Madje ishte venë re dhe përhapur në shtyp se shumë nga ushtarët e atjeshëm nuk flisnin fare, ose nuk flisnin shqip. Që këtë lindi ideja se ushtarët Islamikë, nga vendet Arabe të luftës së Bosnjës, pjesë e tyre, kur u tërhoqën ishin vendosur në Shqipëri dhe se tani mund të përdorëshin nga Berisha si pikëmbështetje e fundit. Burime të tjera nga Ministria e Mbrojtjes do të pohojnë se në dokumentet që prisnin prokurorinë kishte nga ato që vërtetonin se Berisha përdori kundër Jugut dhe Vlorës ushtarë nga bazat stërvitore të Labintit ku stërviteshin pjesëtarë të asaj pjese të UCK të kontrolluar nga Sali Berisha. (deklaratë që në fakt mbeti e pakonfirmuar plotësisht.)

Nuk kish dyshim se Berisha donte ta shtypte Vlorën me cdo kusht, jo thjesht për demonstratat me karakter ekonomik, por për kërkesat politike të shtruarra dhe për faktin se Vlora me qëndresën e vet kishte nxjerrë në shesh kalbësirat e regjimit të vet. Pikërisht ky fakt përbën dhe argumentin e parë dhe themelorë të karakterit kryengritës të demonstratave të Vlorës. Arritja kryesore për momentin në këtë drejtim ishte arritur në Memaliaj. Strukturat shtetërore këtu ishin tërhequr dhe çdo gjë ishte në dorë të të "rebeluarve" të cilët ndryshe nga Vlora që nuk dukej asnjë udhëheqës, kishin udhëheqës ose një grup udhëheqësish.

Më datë 09.02 turmat e iritura, mëqënë nuk mirrte asnjë përgjigje nga qeveria, për çeshtjën e parave, kërkoi të marshojë drejt Fierit. Në Fshatin Panaja , demonstruesit qëllohen nga prapa më bresheri automatiku. Ishin nja dhetë veta , thotë një përsôn pjesëmarrës në grupin shoqëruës I policisë, për Komisionin Hetimor Parlamentar. Më ta qe edhe Xhahid Xhaferri, Ata që qëllonin ish-in një-rëz të SHIK-ut. Kjo e iritoi më shumë turmën që u kthye mbrapsht duke I detyrar një-rëzit e Xhaferrit të strehoheshin në një fshat aty afër . Turma u kthye nga rruga dhe iu drejtuan komisarariatit për arsye se forcat e SHIK-ut të cilat nuk kishin asnjë detyrë nga policia , kishin marrë me vete një protestues.

Kur turma u qëtesua, afër komisarariatit erdhen makina të shumta ushtarake me forca nga Tirana. Turma u sulet atyre dhe fillon një përlëshje e frikshme me gurë. Gforcat e ardhura nga Tirana mëzi futën në Komisarariat dhe qëllojnë më armë zjarri. Demonstruesit iu përgjigjën me shishe me lendë djegëse dhe mjete të tjera rrethanore

Forcat policore paralajmërojnë për të nësermen se nuk do të lejojnë zhvillimin e demonstratave paqësore të cilat kishin hyrë në ditën e tyre të pestë.

VLORA LAJMI I PARE NE TE GJITHA KANALET E BOTES

Të burgosurit e shumë të , provokimet, shndërrimi i protestave ekonomike në demonstrime të fuqishme politike deri në përplasje, bënë që atë ditë, e henë më 10.02.97, Vlora dhe Shqipëria të përbënin lajmin e parë në të gjithë botën e medjave. Situata precipitoi deri në një luftë të vertetë ku demonstruesit vlonjatë arritën të zbrapsin turpshëm trupat policore, ushtarake dhe ato të shërbimeve sekrete, t'i carmoatosin, t'i shtrengojnë të struken nëpër qoshe të ndryshme dhe t' i qëllojnë me sende nga më të ndryshme. Ishin skena të papara turpi për forcat shtetërore dhe ku u duk qartë se shtetit të Berishës gjithcka i kish vajtur në fund të këmbëve. Po atë ditë vritet Artur Rustemi, me një variant vertet të rrezikshëm. U tha se ai u vra nga xhamia e qytetit, gjë që s'u vërtetua . Një goditje serioze mori atë ditë 10.02, SHIK-u në Vlorë i cili megjithatë do të vazhdojë të luajë një rol të rrezikshëm në këtë qytet por dhe në të gjithë Jugun . Pas përlëshjës me demonstruesit forcat qëveritare detyrohen të tërhiqën drejt kodrave të qytetit në një kohë që demonstruesit e shumë vlonjatë sulmojnë komisarariatin ku mbaheshin të arrestuar me dhjetra dëmonstrues. Komisarariat mbrohej nga mbi 1 000 forca . Barrkada dhe vende sulmi për demnstruesit bëhën tarracat e pallatëve nga ku qëllojnë me s e të mundnin mbi mbi forcat qëveritare. Tridhjet veta nga demonstruesit u dërguan në spital me goditje me sende të forta, njëri në gjendje shumë të rëndë. Në mesantë Agim Shehu më të burgosurit dhe forcat e tij largohen nga Vlora

Të nësermen më 11.02 masiviteti i protestave në Vlorë ishte i paparashikuar. Një det me njërez pecjell A. Rustemin në banesën e tij të fundit dhe të dy viktimave të tjerë. Turmat djegin selinë e PD-së në Vlorë. Në Vlorë mbërijnë serish më këmbë mbi 15 mijë veta nga Fieri për të përkrahur protestat e vlonjatëve dhe rrinë aty dy ditë.

Pas kësaj, ndërsa Vlora kërkon përkrahjen e qytetëve të tjera, qeveria jep urdhër se nuk do të lejohen më zhvillimi i demonstratave, pasi, sipas saj, " ne gjirin e demonstruesve egzistojnë grupe të ekstremit të majtë që manipulojnë demonstruesit për veprime të dhunshme". Kryeministri Meksi do të deklarojë në televizionin shqiptar se "Kemi informacione të plota se egziston një skenar për

përdorimin e armëve në Vlorë” Nga ana tjetër Prokuroria urdhërohet të hetojë me procedura të përsheptuara gjithë të ndaluarit e arrëstuar.

Situata në Vlorë duket se keqësohet. Në ditën e 11-të të demonstratave, provokimeve, luftës , të burgosurve dhe 7 të vdekurve, shfaqet edhe uria. Organizimi i parë që shfaqet në Vlorë është ai i grave Vlonjate .Më datë 15.02, dy mijë gra vlonjate i shkruajnë zonjës së parë të Planetit, Hillary Klinton “ Rrezikohemi nga uria e vertetë , ju lutemi na ndihmoni”

Fakt është që deri atëherë demonstruesit nuk kishin asnjë grup udhëheqës, situatë e cila do të vazhdojë për një kohë të gjatë. Madje deri në zgjedhjet e 29 qershorit, asnjë forcë nuk kontrollonte plotësisht situatën . Është ndoshta fenomen i rrallë historik që të kemi lëvizje kaq të fuqishme politike pa një udhëheqje të qartë. Faktoret janë të shumtë. Ato do t’i analizojmë pak më vonë, por tani lë të themi se këto lëvizje kishin brenda vetës një romantizëm politik dhe një unitet e solidaritet të kodicionuar nga një pakënaqësi totale e gjithëplanëshe, të imponuar sidomos nga ana ekonomike, gjë që nuk e bënte kaq të domosdoshme një udhëheqje permanente e cila do të përpunonte parullat, idet, lëvizjet qëllimet. Ato ishin mëse të qarta dhe përmbledheshin në idenë e vetme të shembjës së pushtetit të Sali Berishës. Berisha nga ana e vet kishte një strategji pragmatiste. Në rast se do të arritne të mboshte popullin, ai do të siguronte vahdimësinë në krye të pushtetit. Në të kundërt atij i nterësonte që të shembej gjithcka, si për t’i lenë kundërshtarit tokë të djegur , ashtu edhe për të humbur gjurmët e veta.

Nga ana tjetër, është e vertetë se forcat politike, nën presionin e Berishës që akuzonte për ekstremistë të majtë opozitën, nuk donin që të mirrinin përsipër një rol të tillë udhëheqës,(madje ajo, opozita kurrë nuk pranoi të mbështeste zyrtarisht, levizjën popullore , në trajtën e një kryengritjeje).Opozita nuk e kuptoi se raportet e pushtetit te Berishës me popullin , populli i kishte përmbysur në favor të tij. Opozita nuk arriti kurrë ta shikojë Berishën ndryshe , veçse të veshur me pushtet absolut. Në këtë konteks Opozita vetëm sa përfitoi nga situata e krijuar nga lëvizja popullore për të hyrë në jetën politike Shqiptare , por nën presionin e Berishës dhe nga paqartësia e saj , nuk arriti kurrë, jo vetëm të pranojë si palë përfaqësuesit e Lëvizjes Popullore, por as të adaptojë zgjidhjet politike të ofruara prej tyre.

TUTJE KUFIJVE TE VLORES

Kryeministri Meksi,më datë 05.02 do të dalë në medjën shtetërore dhe do t’u rijap garanci kreditorëve për kthimin e parave. Atë ditë u hapën sportelet për 8 100 kreditorë te Popullit dhe të Xhaferrit në masën 52 dhe 60 %.Por numri i përgjithshëm i tyre ishte rreth 35 herë më i madhë. Meksi përgenjështon fjalët e përhapura se paratë në këto dy fondacione ishin më shumë dhe se i kishtë përvetësuar qëveria. Ai fton kreditorët e Gjalicës të gjejnë vet një zgjidhje tani që Gjallica kishte falimentuar, duke lenë hapur të kuptohet se VEFE-n dhe të ngjashmët më të do t’i përkrahë qëveria.(Ndoshta këtu duhet kërkuar vendimi i Gërxhalliut për t’u bërë pronar i një firme të falimentuar)Nga ana e saj qëveria më 05.02, konfiskon pasurinë e patundshme të Gjalicës. Në Gjirokastër konfskohet MOTELI i Adi Petrolit, por me një vlerë rreth dhjetë herë më shumë.

Po atë ditë sportelët u hapën vertet, por më gjithë propagandën e bërë, atje njërëzit kërkonin para të thata dhe jo libreza dhe mënjëherë në shumë qytete filluan t’i mohojnë edhe ato në emër të sasisë së plotë. Gjashtë veta vetvriten se nuk i bënë dot ballë tragjedisë së ndodhur më paratë e tyre

Në Tiranë situata nuk qe fare e qetë. Berisha kërkon për herë të parë partitë politike të opozitës për dialog.,por ato nuk pranojnë.

Situata në vend pritet të keqësohet së tepërmi. Radio Vatikani transmeton më datën 07.02 se stafetën do ta marri Shkodra banorët e së cilës do të zbresin në Tiranë dhe do të rrethojnë Parlamentin. Radio Vatikani dha e para lajmin se Tirana mbrohej nga mbi tre mijë forca dhe mjete të blinduara të vena në gadishmeri.

Po më datë 07.02 Prokuroria e përgjithshme nxjerr urdhërin për arrëstimin e Shemsie Kadrisë, në një kohë që atë sipas shtypit, dhe e vertetuar më vonë, e përcollen prej ditësh në aerodromin e Rinasit makina shtetërore dhe u strehua në Turqi. Gjithashtu përhapën fjalë të vërteta se shumë nga pjesëtarët e familjeve të zyrtarëve të lartë largohen për jashtë shtetit.

Ndërkohë në Gjirokastrë dhe në shumë qytete të tjera njëzëz të besuar të Berishës zbatojnë edhe një herë formulat e shtetit komunist, dmth të gjasëm inisiativave nga posht për të marrë vendime nga lartë. Kjo inisiativë presupozonte që vulnetarisht kreditorët e Gjallicës të ktheheshin në aksionerë. Në Gjirokastrë, në një formë bajate, më të keq se edhe komunistët këtë "inisiativë" e materializoi Fatos Bejo. Këtu ndodhi incidenti i parë me gazetarët e medjës zyrtare. Bejo bën vetë lajmin e suksesit të tij që transmetohet menjëherë nga TV-ja. Por u prit me reagime nga publiku dhe gazetarët e medjës zyrtare në Gjirokastrë, të cilët e tërhoqen autoresinë fallco të këtyre lajmëve.

STRUKTURAT E REZISTENCES NE MEMALIAJ JANE DHE STRUKTURA MBROJTESE PER VLOREN

Pikërisht në këtë moment vihet re dhe akti i parë i solidaritetit të banorëve të Memaliajt që kishin bllokuar urën më banorët e Vlorës në demonstrata të përhershme mëngjës e pasdite, me dhe pa praninë e forcave të rendit dhe të ushtrisë. Më datë 07.02, pasdite tentojnë të çbllokojnë urën rreth 60 forca të armatosura në krye të të cilëve ishte vet komandanti i divizionit Laberia të Gjirokastrës, Dilaver Laci, me katër oficerë të tjerë. Forcat e zbrituara nga makina ushtarake, të armatosuara me pushkë, u rreshtuan nga të dy anët e urës ndërsa zoti Laci u dha urdhër oficerëve të armatoseshin me automatikë dhe të çanin urën. Shumë nga ata që ishin në urë në ato momente u kërkuan ushtarëve që të mos ndërhyjnë, gjë që ata e bënë. Gjeneral Laci nuk mundi të çante gjokset e djemve nga Memaliaj, të cilët duke ngritur duart lart bënë mbi urë një mburojë gjoksesh dhe e hodhën atë në kanal. I pranishëm në operacion ishte dhe kryetari i SHIK-ut të Gjirokastrës me njerëzit e tij. Qëllimi i operacionit, siç u mësua më vonë, ishte të çbllokohej ura dhe të kalonin trupat ushtarake nga Gjirokastra për në Vlorë. Forca të tjera nga Tirana për në Vlorë atë ditë nuk mund të zbrisnin. Të nësermen kishte njoftuar për demonstrata në Tiranë, Forumi për Demokraci, por edhe sepse Tirana duhej mbajtur nën fre me çdo kusht.

Po atë ditë forcat e policisë së Memaliajt, më bllokojnë mua makinën më të cilën udhëtonim unë, gazetari i Dites Informacion, Engjëllush Seriani dhe deputeti Thoma Micio. Bllokimi u bë me preteksin se ishim tek ura dhe mirrnim intervista nga demonstruesit. Urdhëri për konfiskimin e mjetit ishte «nga lart», pasi të gjitha përpjekjet e autoritëve lokalë për ta liruar atë, pavarësisht se ishin të PD-së, dështuan. Ndërsa pas disa ditësh, përfaqësues të lartë të PD-së, si Leonard Demi, në një takim më demonstruesit, sipas njerit prej tyre, i pranishëm në takim, u thanë atyre se pranoni të manipuloheni nga grekër të tillë si Panajot Barka.

Forcave të ushtrisë atë pasdite iu desh shumë punë për ta venë nën kontroll urën e Memaliajt. Megjithatë do ta mbajë vetëm për disa orë, se, pasi policia arrëstoi rreth 25 veta nga Memaliaj, qyteti u zgjua e tëri dhe e ripushtoi urën dhe demonstruesit u bënë kështu një autoritet në qytet. Një ditë më vonë rreth dy mijë veta do të marshonin më këmbë nga Memaliaj drejt Tepelenës.

për tu bashkuar më demonstruesit e atjeshëm dhe se bashku kërkuan lirimin e të ndaluarve të një dite më parë.

TUTJE KUFIJVE TE VLORES (vijim)

Berisha kërkon t'i heq iniciativën opozitës dhe ta mbajë larg frymës se Vlorës

Më datë 08.02, dhjetë forcat politike të Forumit për Demokraci tentuan të dalin tek sheshi Skënderbej, simbol i pushtetit të Berishës, por provuan dhunën e egër policore. Shumë nga udhëheqësit e opozitës morën plagë dhe u goditen. Demonstrata dështon ndërsa udhëheqësit e Forumit për Demokraci çohen nëpër komisariate ku mbahen për disa orë. Mënjëherë pasi u lanë të lirë ata deklaruan se do t'i vazhdonin protestat. Por goditja e asaj dite dhe rrethi i hekurt rreth Tiranës nga forcat policore-ushtarake u hoqi terrënin veprues forcave të Forumit për Demokraci. Forcat e Forumit për Demokraci e shikonin krizën ballas por vazhdonin të propozonin mjete politike për kapërximin e saj. Këto mjete ishin dialogu, dorëheqja e qaverisa dhe krijimi i një qeverie që i vinin emrin teknike, si dhe zgjedhje të reja deri në nëntor të vitit 1997. Kjo kërkesë vinte edhe nga brenda vet PD-se, por sidomos nga forca që përbënin koalicionin si Partia Republikane, apo dhe Balli Kombëtar.

(Kërkesa nga brenda PD-së shkonin deri në dorëheqjen e Meksit, ose më së shumtin deri dorëheqjen e qeverisë dhe krijimin e një qeverie po të PD-së.)

Po atë ditë, 08.02 një përplasje e fuqishme midis demonstruesve dhe forcave të rendit ndodh dhe Fier ku si rezultat u plagosen, sipas burimeve të PS-së së rrethit, 40 demonstrues. Ndërkohë iu konfiskuan mjetet e punës dhe u rrahën nga policia 12 gazetarë të kanalëve dhe agjensive me më zë të botës. Në Fier shteti po përqëndronte forca dhe kërkonte ta kthente në një post-blok kundër Vlorës, por edhe për ta mbajtur Fierin jashtë ndikimit të Vlorës, gjë që ia arriti deri në një farë masë.

Klima dhe situata e protestës në Vlorë ishin në një nivel të paarrtshëm nga qytetet e tjera. Kjo bënte që si qytetarë nga Fieri por edhe nga Shkodra të vinin për të manifestuar në Vlorë.

Të nësërmën, më 09.02, një ditë pas demonstratës në Tiranë prononcohet për situatën dhe Fatos Nano nga burgu i Bencës, (i cili çuditërisht do të hesht pastaj deri sa doli nga burgu dhe Sali Berisha amnistoi lirimin e tij, 16.03 1997). Nanua pra kërkoi dialog nga të gjitha forcat politike, ndërsa nga Berisha «të çtensiononte situatën».

Por fatkeqësisht situata nuk ruajti as ekuilibret egzistues. Ajo u rendua më një shpëjtësi të jashtëzakonshme.

Në Tiranë, më 09.02, nga njëri të Berishës, goditet Neritan Ceka, në kafenenë kryesore të gazetarëve, Fideli. Goditja e Cekës dhe politikanëve të tjerë vjen pas goditjes për vdekje të Ndre Legisit, Edi Ramës dhe eksponentëve të tjerë të luftës kundër pushtetit të Sali Berishës. Në zyrat e Forumit për Demokraci, njëri të veshur me lloj-lloj etiketash nxjerrin me dhunë nga zyra, kryetarin e Forumit Kurt Kolën, duke zvetënuar kështu në maksimum lëvizjen politike në kryeqytet. Cuditërisht televizioni shtetëror ishte me kamerë atje (!) Kjo bëri që shumë figura politike të dalluara për guxim dhe këmbëngulje të largohen nga vendi. Forcat politike, ose njëri të veçantë të tyre të shkojnë vetëm në Vlorë ose në rrethe të tjera.

RISHFAQET GJENDJA E JASHTËAKONSHME

(Opozita e brendshme në PD kërkoi rol politik në situatë)

Situata në Vlorë detyron parlamentin të mbledhet , 10.02, në mënyre urgjente për të diskutuar situatën në Vlorë. Grupi parlamentar i PD-së diskutoi për orë të tëra propozimin e kryeministrit A. Meksi dhe ministrit të rendit Shamata për vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Vlorë dhe rreth saj. Propozimi hasi në kundërshtimin e shumë deputetëve të PD-së , vecanarisht atyre që ishin nga Vlora. Situatën në favor të mos vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme e zgjidhi vet Berisha i cili sfrytëzoi rastin për t'u shfaqur edhe një herë në favor të "demokracisë" dhe të kredibilitetit të vet ndërkombëtar. Ai ndërmerr këtë veprim edhe për t' u distancuar nga Meksi, kokën e të cilit Berisha e kërkonte në këmbin të unitetit të lekundur të udheheqjes së partisë. Mënjanimi i Meksit jo vetëm që do të sillte afër Berishës grupin e mënjanuar të Koplikut,(i cili kërkonte heqjen e Meksit për ta zëvendësuar), por do t'u kujtonte gjithë të tjerëve, sidomos grupit të Dashamir Shehit me prejardhje direktë nga Vlora, se kokat e tyre nuk i kishte për gjë t' i spastronte . Berisha është e vertetë se nuk pranon de jure vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme, por de fakto e ka atë të vendosur.

Kundërshtimin e vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme në Vlorë shpreh dhe Partia Republikane dhe e Ballit Kombëtar që kërcenojnë me largimin nga koalicioni qeveritar dhe nga parlamenti. Të njëjtin qëndrim mban edhe Partia e të Drejtave të njëriut . Partia e Ballit Kombëtar, kërkon njëkohësisht dhe dorëheqjen e qeverisë.

PD-ja vazhdon mbledhjet maratonë ku përpjekja për të ravijëzuar një opozitë të brendshme duket se dështojnë.Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të datës 13.02,propozimet e grupit të ri mocionist brenda PD-së, për dorëheqjen e kryeministrit , ose për krijimin e një qeverie të re të PD-së mbesin propozime në minorancë. Kundërshtim më të madh pati ideja për një bashkëpunim në qeverisje me opozitën. PD-ja pranon në këtë mbledhje dialogun , por kursesi bashkëpunimin me opozitën e "ekstremistëve të majtë», të cilën e fajëson për gjithcka ndodh në vend. Kuvendi Kombëtar I PD-së dhe Berisha marrin një vendim tjetër të karakterit komunist. Kërkojnë të verifikohet mbështetja e partisë në popull dhe pastaj të mirren vendime n.q.s «duhen pranuar kërkesat e opozitës», ashtu sic la të kuptohet kryetari i PD-se T.Shehu. Berisha do të nis serish një turne nëpër Shqipëri. Po atë ditë mjetet zyrtaret të informimit bëjnë fjalë për mbleksjen e mafies Italiane në trazirat e Vlorës ashu dhe në piramidat.

Në Tiranë, ditën e varrosjes së Artur Rustemit në Vlorë Opozita socialiste mbledh , në mënyrë urgjente Komitetin e Përgjithshëm Drejtues. Mënjeherë pas mbledhjes në një konferencë shtypi ku drejtuesit socialist dalin me shiritat të zinj në nderim të viktimave të dhunës shtetërore, udhëheqësit e PS-së, kundërshtojnë energjikisht vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Vlorë, dhe kërkojnë dorëheqjen e qeverisë dhe krijimin e një qeverie teknike që «do ta çojë vendin në zgjedhje të reja». Socialistet kërkojnë lirin e të gjithë të ndaluarve të cilët i konsideron opozitarë dhe njëkohësisht ndërrimin e të gjithë stafit drejtues të Radiotelevizionit.

Një ditë më vonë,më 12,02, forcat e policisë në Tiranë shpërndajnë me dhunë mijra gra dhe femijë që tentuan të ndiznin qirin në sheshin Skënderbej në nderim të viktimave të Vlorës

Situata nuk është fare premtuese për Berishën icili kërkon të mobilizojë forca besnike për të përballuar gjëndjen në shpërthim anëkalend vendit. Radio «Dojce Ëelle» njofton më datën 15.02 se rekrutimi bëhet nga rradhët e studentëve të Veriut në këmbim ose të dhenjës pa mund të provimeve ose më shpërblime të majme parash, deri në katërqind mijë lekë në muaj. D- Ë bën fjalë për rekrutimin e 40 vetave studentë vetëm nga rrethi i Kurbinit.

ZGJOHET GJIROKASTRA.

Ndërkohë më 10.02.ndërsa në Tepelenë demonstruesit lëshojnë një ultimatum për lirimin e 25 të burgosurve, fillon protesta e pare në Gjirokastrë me rreth dy mijë veta. Parullat kryesore ishin “ Duam paratë tona “ , “Vlora-Vlora” «Poshtë Sali Berisha» etj. U duk qart se partitë e Forumit për Demokraci që e organizuan protestën kërkonin ndërhyrjen e policisë për t’ i dhenë protestës forcë. Por kjo nuk ndodhi. Nga ana tjetër, frika se mos policia ndërhynte, i mbajti larg protestës shumë njerez. Policia në Gjirokastrë faktikisht qëndroi tëpër korekte dhe jo vetëm atë ditë por gjatë gjithë protestave në qytet. Cdo ditë me vonë numri i protëstuesve rritet në mënyrë të qëndrueshme duke aplikuar madje forma te reja, si proteste e heshtur me qëndrim ulur në sheshin e 18 -Shtatorit, apo dhe organizimin e nates se qirinjve në përkujtim të viktimave të dhunës shtetërore. Shetitorja e lagjës 18-Shtatori është gjithashtu dëshmitare e protëstave të përditshme, shpesh edhe me pjesëmarrjen e kolektivave punonjese, sic ishte ai i Lekurë-Këpucës. Gjithcka ndodh vecse nën vëzhgimin e rreptë të policisë dhe të forcave të SHIKU-t

Situata duket se është tepër e elektrizuar në qytet. Ajo bëhet edhe më inkandeshente kur më datë 18.02. në aktivin e PD-së së Gjirokastrës, 6 nga 7 diskutantët kërkojnë dorëheqjen e qëverisë Meksi . Një situatë e tillë duket se përgatit terrënin për zhvillime më intensive dhe politikisht më të efektshme në ambientet e universitetit, ku mbikqyrja nga ana e SHIKU-t ishte po ashtu e rreptë

Protestat në Gjirokastrë, ndonëse nuk vazhdojnë me të njëjtin ritëm si në Vlorë dhe në Tepelenë, as dhe për një kohë të gjatë, kanë rëndësinë e tyre . E para se zhvillohen në Gjirokastrë, qytet që dihet se “ nxëhet” rrallë. E dyta se ato janë paqësore dhe e treta plotëson në mënyrë iniciuse gjithë kuadrin gjeografik të Jugut.

Më 12.02 në të gjithë Jugun, Vlorë , Tepelenë, Permet, Gjirokastrë, Sarandë, me mijra qytetarë kishin dalë në rrugë dhe protestonin. Një ditë më parë në rrugë kishte ridalë edhe Shkodra. Dy ditë më vonë do ta dalin në rrugë edhe Durrësi,Elbasani dhe Kukësi.

SHTYPI I HUAJ DHE STUDENTET E VLORES I IMPULSE TE REJA LEVIZJES ANTIBERISHE

Aty nga datat 13-15.02 Shtypit Shqiptar i vjen në ndihmë më shkrime akuzë kundër Berishës shtypi i shkruar Evropian dhe sidomos ai Anglez. Gazeta të tilla me peshë si “ The Independent”, me protagonist gazetarin Andre Gumbel, akuzon qëverinë e Berishës për mpleksje në skandale ekonomike dhe politike, në trafikun e armëve, në thyerjen e embargos në ish Jugosllavi, etj. Gazeta e quan qëverinë e Berishës qëveri të Gangstereve. Berisha nërvozohet së tëpërmi dhe deklaroi se do ta hedh në gjyq gazetarin. Dicka të tillë deklaroi se e ka bërë ministri i Mprojtjës Zhuliali. Ndërsa ministria e jashtme akuzon Euro Neës për lajme të pasakta nga Shqipëria. Të njëjtat akuza bënë Ministria e Jashtme Shqiptare edhe për B.B.C-në dhe Dojce Ëelle-n, ndërkohë që brenda vendit kërcënohet hapur gazeta Koha Jonë.

Eshte koha kur në të gjithë vendin ka filluar një tendosje e jashtëzakonshme nërvash me epiqendër Sali Berishën i cili edhe pse duhet të përballonte dhe përplasjet e brendshme partiake kishte ndërmarrë një turne në të gjithë vendin si një hidalgo që duhet të çajë një rrethim real dhe mbytës për të . Një ditë me vonë, pra më 16.02. Berisha do të deklarojë në një takim “me intelektualë” nga e gjithë Shqipëria, se zgjedhjet do të bëhën në vitin 2 000.Ai edhe një herë do të këmbëngulë se për humbjet në firmat piramidale faji u takon mijrat e qytetarëve shqiptarë, se qëveria e Partisë Demokratike kurrë nuk I ka përkrahur ato dhe se, as opozita ka folur. Berisha më këtë rast kërcënoi opozitën të braktiste rrugën e protestave. Mëgjithatë dukej qartë se Berisha ishte venë përballë revoltës popullore, më shumë me hijen e se kaluarës së vet, se sa me shtatin e vertet,. Revolta popullore me epiqender ne Vlorë dukej hapur se kërkonte një nivel të ri zhvillimi dukej se

Berisha ishte ambjentuar dhe kishte fituar imunitet me konstandën e demonstrave të përditshme pa përfitur aspak terren politik. Në të njejtën kohë konstatohej fare lehtë se Berisha kërkonte ta asgjësonte lëvizjen në Vlorë, nga njëra anë duke shtrenguar rrethimin kundër saj, si nëpërmjet copëzimit dhe fragmentarizimit gjeografik të kësaj lëvizjeje, (kujtojmë se në Vlorë nuk dihej se ç' bëhej në rrethe të tjera Jugore. I vetmi mjet informacioni ishin kryesisht gazetat, të cilat kuptohet nuk kanë atë ndikim direkt kolektiv sa mjetet elektronike. (Demonstratat në Vlorë fillonin me mbritjen e gazetave, ku pasi lexoheshin shpërthenin në parulla kundra regjimit të Berishës dhe mijrat e protestuesve nisnin ritualin në drejtim të rrugës së Skelës). Po ashtu përveç thirrjes drejtuar qytetëve të tjera për të përkrahur Vlorën, Vlora nuk kish arritur të vendoste lidhje me simotrat e veta, aq më tepër ku vet demonstratat në të, sic thamë, nuk kishin një kokë përfekte udhëheqëse. Në Vlorë p.sh egziston në këtë periudhë Komiteti i Intelektualëve, dhe njëkohësisht tavolina e rrumbullakët e partive politike dhe forumeve të tjerë në qytet. Këtë rol nuk arritën ta bënin as udhëheqësit e Forumit për Demokracinë. Forumi nga ana e vet, ashtu sic e theksuam edhe më lart, nuk kishte një qëndrim përfekt, të përcaktuar dhe një angazhim total të të gjitha forumëve pjesëmarrëse në të. Partitë dhe udhëheqës të vecantë të tyre vepronin në mënyrë individuale. Ata edhe pse përbënin një rrezik për Berishën; (kujtojmë arrëstimin e S. Brokajt po ato ditë); faktikisht përbënin shpesh një dekor për lëvizjen, dhe më shumë përfitonin për vete se sa jepnin për Lëvizjen. Partitë Politike duket se nuk mund të mbanin më, atë ritëm me të cilën kishte filluar të kundërshtonin Sali Berishën populli, (gjatë janarit dhe në fillim të shkurtit), ashtu si nuk mund t'u bënin ballë veprimeve provokuese të SHIK-ut dhe të forcave të policisë, Kështu që lëvizja kundër Berishës u fut në një proces stërlodhjeje të përditshme. Kjo situatë përbën njëkohësisht një pjesë të arsenalit të taktikave të Berishës kundër popullit dhe kundërshtarëve të tjerë të tij.

Kapitull 5

VIJNE STUDENTET

Pikërisht në një moment të tillë hyjnë në ditarin e protestave dhe të Lëvizjes popullore si një dimesion i ri, studentët. Që më 18.02. studentët kërcenojnë me grevë urie nqs deri më datën 20.02, nuk realizohen kërkesat e tryezes së rrumbullakët të të gjitha partive politike në Vlorë, të përfaqësuesve të komunitetëve fetare etj, (Tavolina e këtyre forumëve pas 6 orë diskutimesh dolën me një deklaratë nëpërmjet së cilës kërkohet dorëheqja e qeverisë së Partisë Demokratike, krijimi i një qeverie me përkrahjen e të gjitha partive politike, depolitizimin e radiotelevizionit dhe transparencë në skemat piramidale që nuk falimentuan, dënimi i fajtorëve të vrasjeve të 10 shkurtit. Dorëheqjen e qeverisë Meksi e kishte kërkuar, tre ditë më parë, 15.02. edhe Këshilli Bashkiak I Vlorës shumicën e të cilit e përbënin anëtarë të Partisë Demokratike). Po atë ditë Sali Berisha tentoi të hynte në Lushnjë, qytet ku, sic përkrahja, më 25.02 u mbajt peng për më shumë se 8 orë, pasi i futën preshin në gojë, e goditën me sende të forta dhe i hoqën pantallonat, kryetari i PD-së, Ministër i Jashtëm dhe Zëvendëskryeministër, Tritan Shehu.

Të nësërmen më 19.02 studentët e Vlorës kërkojnë të takohen në Tiranë me Berishën, por largohen andej pa marrë asnjë premtim për kërkesat e tyre. Ata kthehen në Vlorë dhe futën, më 20.02, në grevë urie në një nga sallat e Universitetit Ismail Qemali. Janë 58 studentë shumica vajza, që ngujohen në grevë urie. Mijërat e protestuesve mbrojnë universitetin nga çdo sulm i mundshëm. Po ashtu sheshi para universitetit bëhet stacioni i protestuesve në interarin e tyre të përditshëm, Sheshi i Flamurit - Skelë. Pas disa ditësh, më 23.02, Berisha nga Shkodra do t'u jap "porosi" studentëve grevistë të urisë që «të mos bien viktimitë e partive politike».

NJE OAZ SHPRESE PER ZOTIN BERISHA OPOZITA KAFSHON KAROTEN E DIALOGUT. POPULLI VAZHDON RRUGEN E NISUR

Brenda në PD në këto ditë pati edhe një zhvillim të ri. Grupi I kundërshtarëve të vijës së Berishës del më një promemorje me të cilën kërkon krijimin e një qeverie të Shpëtimit Kombëtar dhe distancimin e Berishës nga punët e PD-së dhe të qeverisë si dhe kufizimin e tij në detyrat presidenciale. Promemorja hidhet serish posht. “Krijimi I një qeverie të Shpëtimit Kombëtar, do të thotë shkatërrim kombëtar”, do të thotë nga Bureli kreu I PD-së Tritan Shehu.

Në Tiranë po më 20.02 PD-ja përkujton në sheshin Skëndërbej, ditën e rrëzimit të monumentit të diktatorit Enver Hoxha, ndërsa opozita në fushën Ali Demi denon diktaturën e re të PD-së së instaluar në vend.

Një ditë më vonë, Partitë e Forumit për Demokraci kërkojnë të manifestojnë në sheshin Skëndërbej, por copëzohen në të gjitha drejtimet dhe gjakosen keq nga forcat e policisë. Përleshje të ashpra janë zhvilluar sidomos te ura e Lanës nga ana e rrugës së ambasadave.

Në këtë kohë, kur të gjithë prisnin që qëndrimi i Perëndimit të ishte më i ashpër ndaj Sali Berishes, atij i vijën në dorë dy shanse që i kujtojnë se është tëpër i fuqishëm pikërisht kur akoma nuk do t'i mbëten as 20 ditë jete në fronin politik. Sic dihet , më 23.02, Këshilli i Ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian, mbledhet enkas për Shqipërinë dhe vendos në favor të mbijetesës së Berishës me kusht që të instalohet në vend dialogu, dicka që opozita shqiptare bie dakort duke deklaruar vetëm se “ Jemi dakort per dialog gjithëpartiak por jo me një dialog që të diktojë vullnetin e vet Partia Demokratike.”

Në të njëjtën kohë në Tiranë mbrin nëpërmjet ambasadorit Grek në Tirane ftesa e presidentit grek Stefanopulos për një vizitë në Athinë të Sali Berishës. Madje ishte caktuar dhe data 09.maj 1997. Opozita e priti këtë ftesë me indinjatë të thellë duke e konsideruar si një mbështetje të hapur të qeverisë greke ndaj regjimit të Sali Berishës. Neritan Ceka i kujton Athinës sakrificat e opozites shqiptare «në mbrojtje të fqinjësisë se mirë me Greqinë , kur Sali Berisha më 1994 i kishte shpallur kësaj fqinjësie praktikën e luftës së ftohtë»

Berisha kërkon ta shfrytëzojë këtë situatë për të fituar terren . Në të njëjtën ditë 23.02 ai do të flas nga Shkodra,”për organizime grupesh fontamelistësh të kuq që dështuan plotësisht në përpjekje për të risjell në pushtet komunizmin”.Duket qartë se Berisha nuk do t' i përmbahet frymës se deklaratës së BE-s. Presidenti I vendit zgjodhi këtu taktikën e sulmit kundër opozitës.Dhe e bën këtë pikërisht në Shkodër që të mund të zgjerojë aleancën e vet , mirëpo ky qëndrim përballet me kundërshtimin e Bashkimit të Djalhtë Shkodran. Mëgjithatë Mexi e Berisha do të vazhdojnë të bejnë deklara për përkrahjen nga Perëndimi. Albert Brojka nga pozita e Sekretarit për Marrëdhnje me jasht I PD-së deklaroi se qëndrimi I BE-së “ Shpreh realitetin politik të Shqipërisë”

* * *

Duke vazhduar udhëtimin e tij nëpër Shqipëri për të qëtësuar popullin , por tani edhe me mandatin e kandidatit të vetëm nga partia e tij për postin e Presidentit të vendit për një mandat të dytë, (e fitoi atë më 27.02) Berisha mbrin në qytetin e Beratit ku e ul shumë barazhin e akuzave kundra opozitës dhe shfaqet në frymën e deklaratës së Ministrave të jashtëm të Bashkimit Evropian, pro dialogut,” Një dialog nga I cili do të përfitojnë të gjithë”,-sic tha vet ai. Mjetët e veta të propagadës bëjnë të ditur se të nësermën do të vizitonte Gjyrokastërën, vizitë që u komentua gjerë e gjatë si shprehja nga afer e falinderimëve për përkrahjen që I dha qeveria Greke në këto momente të veshtira për të.

Në këtë atmosferë Berisha për të zbutur edhe më klimën kundër tij, pranon nëpërmjet gojës së Blerim Celës, Kryetar i Kontrollit të Shtetit se PD-ja kishte marrë para nga firma e falimentuar Gjallica dhe se ajo do t'i kthente të pësedhjetë mijë dollarët e deklaruar si të marra nga Gjallica

STUDENTET E GJOROKASTRES OKSIGJEN I RI PER VLOREN

Ndërkohë paralelisht Berisha shton rrethin e hekurt ndaj Vlorës me qellim që protesta të mos përhapet dhe në rrethe të tjera. Ai aktivizon në një masë të paparë SHIKU-n, ku vecanarisht vepron mes studenteve të Tiranës duke i pënguar ata të grumbollohen dhe të organizohen aq më shumë në një grevë urie. Studentet e Tiranës arrijnë të bojkotojnë mësimin deri në katër fakultete, por nuk lejohen të kalojnë në organizime të tjera. Një pjesë e tyre arrijnë të shkojnë në Vlorë dhe shkruajnë parulla kundër regjimit dhe në përkrahje të grevës së urisë. Në Vlorë arrijnë dhe qytetarë të organizuar nga Shkodra, nga Durrësi, nga Fieri e nga qytete të tjera të vendit, të cilat nuk mundën të organizoheshin vetë.

Po ashtu është e vertetë se në Tiranë ka pasur dy qendrimë të unionëve studentorë. Një pro Berishës, dhe që nuk dihet sa studentë kishte nga prapa, dhe një kundër Berishës, që pëngohej me të gjitha mënyrat për t'u organizuar.

Ndërkohë në Vlorë në ditën e pestë të grevës së urisë së 58 studenteve, kater katër prej tyre cohen me urgjencë në spital. Komiteti i Drejtimit të Protestave ,(një organizim I ri ky) ,bën thirrje për "Sakrificë te Vlorës që të shpëtojë Shqipëria"

Pikërisht në këtë atmosferë mbytese për revoltat masive kunder Berishes, rrethi i tij i hekurt cahet nga studentët e Gjirokastrës. Ishte koha kur edhe këtu partitë politike e kishin ulur pothuajse fare ritmin e protestës, ndërsa SHIK-u dhe Partia Demokratike kishin marrë në mbikqyrje të plotë Universitetin. Rektorati edhe pse pa rektorin, Unioni studentor dhe një pjesë e pedagogëve ishin në marrëdhënie të vazhdueshme me SHIK-un dhe PD-në si dhe me përfaqësuesit e pushtetit lokal, vecanarisht prefekturën. Studentë që disa javë më parë deshtuan plotësisht në organizimin e një greve me karakter të theksuar ekonomik, kësaj here ishin nje lum i fjetur që mbushej e mbushej dhe zgjohej duke i sfiduar mbikqyresit e vet.

Duan apo nuk duan të tjerët studentët e Universitetit "Eqrem Cabej" në fillim dhe pak ditë më vonë, populli i Gjirokastrës, kanë meritën e madhe , që në përplasjen për jetë a vdekje midis popullit dhe makinës së ndryshkur e të kalbur të pushtetit të Berishës, u futën në rolin e balladerit që e anuan balancën në favor të popullit kundër Berishës. Studentët e Gjirokastrës deri më 24.02, paraqitëshin si një masë e qetë. Një pjesë të drjtuesve të Unionit Studentor ishin nën kontroll të plotë të strukturave të PD-së. Në Universitet prania e makinave të SHIK-ut dhe e njerëzve të armatosuë me leje ishte jasht cdo realiteti të mundshëm . Pikërisht në një atmosferë të tillë, studenti i vitit të katërt në degën e greqishtës , por nga Tirana, Kastriot Kola organizon një peticion masiv , me mbi 800 firma studentesh që solidarizoheshin me studentët e Vlorës dhe kërkonin bojkotimin e mësimëve. Hapi imetëjsëm i Kolës nderpritet. Ai kercenohet fizikisht nga shumë drejtime , ndërsa televizioni shtetëror, duke iu referuar Unioinit Studentor të Gjirokastrës, e akuzon atë si manipulorë më emprin e xhaxhait të tij Kurt Kola, kryetar i Forumit për Demokraci. Mëgjithatë ky zhvillim përcaktoi gjithë rjedhen e metejshëm të ngjarjeve midis studenteve gjirokastritë. Dy nga drejtuesit e Unioinit studentorë theritën në kryesinë e PD-së , ku prej ditësh ishte ancoruar dhe vet Fatos Beja. Në këtë takim njëri nga udheheqësit e studentëve bën një deklaratë tronditese, e cila një ditë me vonë 26 .02 në takimin e studenteve, disa orë para se të vizitonte Gjirokastrën Sali Berisha, do të sherbejë si katalizatorë për të përmbysur gjithcka që PD-ja dhe SHIK-u kishin ngritur me aq mund. Ai

kërkoi tanket për të shtypur studentët e urisë në qytetin e Vlorës. Njërezit e PD-së në Gjirokastrë, duke parë se ishte I pashmangshëm reagimi I studenteve, kërkuan që unioni t'u propozonte studenteve dy variante lidhur me vendimin pothuajse të marrë prej tyre për bojkotimin e mesimit. Studentët të bojkotojnë mesimin çdo ditë nga dy orë mësimi, në përkrahje të studenteve të Vlorës . Propozimi I dytë kërkonte që vendimi të mirrej cdo ditë në një mbledhje të përgjithshme dhe në rast se studentet nuk do të paraqiteshin, pra mund të kishin ikur në shtëpi, bojkotimi të ndërpritej.

Në mëngjesin e datës 26 Senati I Univirsitetit nuk lejoi studentët që të mbledheshin në auditorin e madhë. Studentë që nuk lejoheshin as të ngjiteshin në katin e parë në një moment e humbën durimin dhe u ngjiten deri para derës së rektorit duke bertitur në kor, -"Duam sallën, duam sallën, salla është e jona»,ejt.

Pas pak zëvendës rektori doli dhe e hapi derën duke kërkuar që asnjë pedagog tjetër të mos hynte as dhe gazetarë. Hyri vetëm ai. Kjo ishte arsyeja që na detyroi të hynim edhe ne në sallë. Përpjekja e drejtuesve të unionit për ta mbajtur tubimin brenda traversave të parashikuara ,dështoi shumë shpejt . Propozimet e tyre stononin hapur me situatën e precipituar në Vlorë dhe në gjithë Shqipërinë. Vecanërisht iritues që propozimi për të pritur "me lule " Sali Berishën. Studentët e detyruan udheheqjen e tyre të bentë prapa, ndërkohë që me kontributin edhe të disa studenteve të tjerë disa nga udhëheqësit e instruktuar të unionit po e kthenin tubimin në kaos. Në një moment të tillë kërkova fjalën .Fola pikërisht për rolin e studenteve, dhe të brezit të ri në të gjitha epokat për progres e për sakrificat që kërkon ky progres dhe se e konsideroja të papranueshme një qëndrim kaq të tërhequr nga nga ana e unionit. Situatat, thashë nuk pranojnë rol të tillë nga udheheqja e studenteve por as quhet i pranueshëm dhe e logjikshëm konfuzioni dhe kaosi I tubimit . Iniciova që unioni të rinovohet në udheheqje, ose në zgjedhjen e nje komisoni për drejtimin e protestave të studenteve.

Ndërhyrja pastaj e një studenti nga Vlora I cili protestoi ashpër për deklaratën e kryetarit të Unionit , se do të mirrte tanket për të shtypur studentët e Vlorës, e përmbysi krejt situatën . Studenti Vlonjat Shkelqim Mecorapaj, që të nësermen do të shpallej kryetari I grevës së urisë , shtoi akoma se nënat vlonjatë nuk e hanë peshkun se është I ushqyer me gjakun e djemve të tyre.

Diskutimet e disa vajzave studente, madje në udhëheqjen e unionit, kundër Sali Berishës, (të cilin e quajtën "filan person që vjen sot kapardisur në orën 12") dhe qëndrimet kompromentuese të disa kolegëve të tyre, coi në shkrirjen e kryesisë së unionit dhe propozimin e një udheheqjeje të re për drejtimin e protestës.

Studentët vendosen që në përkrahje të të gjitha kërkesave të grevistëve të urisë së Vlorës të bojkotojnë mesimet dhe në rast se "nuk shikohet një impenjim total I qeverisë , atëherë, -thoshin në vendimin e tyre,- lëvizja jonë do të shkallezohet deri në grevë urie"

NJE KOVE ME UJE TE FTOHTE PER BERISHEN

Në tubim nuk u vendos se çdo të bëhej me Berishën. Një palë thoshte ta ftojme në Univirsitet një palë tjetër të shkojmë atje. Vendim nuk u morë se faktikisht po afrohej ora e ardhjes së Berishës për takimin në pallatin e sportit. Tek po niseshim më afrohet një grup studentesh dhe më thonë.- Profesor të vemi ta ftojme Berishën në Universitet. Iu përgjigja shpejt. N.q.s do të jeni si, ishit deri tani ftojeni, përndryshe në asnjë mënyrë. Ata ikën duke më thenë se do të jenë më të mirë. Në atë moment një koleq m'u afrua dhe më tha se bëra gabim që I nxita të ftojnë presidentin. I thashë shkurt se ata më pyetën mua.

E verteta është se në pallatin e sportit kishin vajtur mbi 1500 veta për të parë Berishën, bashkë me ata që ai sillte me vete. Ishin nxënës shkollash dhe punonjës administrate dhe

simpatizantët e tij. Po ashtu u vu re që ndërsa Berisha ishte tëpër entusiast, qindrat e policëve të tij ishin të trembur dhe shumë të përmbajtur. Mbaj mend se në një moment kur erdhi dhe më shtyu një nga rojet e tij, u tremb shumë kur I thashë se po ta marrë vesh shefi yt këtë veprim do të të pushojë nga puna.

Ndërkohë studentët kishin kërkuar nga deputeti Bejo që të përcillte kërkesën e tyre presidentit. Ai u tha ta cojnë vet tek sekretaria e pyetjeve. Fatos Bejo ishte I informuar pak a shumë për zhvillimet në universitet dhe këto zhvillime ishin të kundërta nga ato që ai kishte projektuar dhe informuar në Tirinë, dhe tani donte t'i linte Berishës vendimin. Eshtë pikërisht kjo arsyeja që Berisha më të lexuar kërkesën e studentëve në morinë e pyetjeve që iu bënë u tregua tëpër I gatshëm. Bile Berisha shkuroi dhe kohën e përgjigjeve për të vajtur tek studentët. Në logjikën e tij, ishte një rast shumë I mirë për të bërë propagandë

Pritja që I rezervuan studentët ishte pak të thuash një kovë me ujë të ftohtë. Studentët ia bënë uuuuuu... dhe u binin tavolinave. Berisha u trajtua si një njëri I rendomtë Sulmi u bë fillimisht kundër SHIK-ut, dhunës së përdorur nga policia dhe frikës. Pastaj u kërkuar paratë, pastaj realizimi I kërkesave të studenteve Vlonjatë dhe u këmbëngulë tek dorëheqja e qeverisë dhe zhvillimi I zgjedhjeve të reja. "Kaq të pazvendësueshëm jeni, vetëm ju mund të qevverisni, s' ka të tjerë"- I tha një vajzë nga Lushnja Berishës "Këtu po vdesin një rëz, bashkëmoshatarë tanë,- I tha një djalë nga Lazarati duke përmendur numrin e studenteve vlonjat të çuar në spital, «dhe ju po na flisni për banda të kuqe dhe terrorist të kuq» "Ne, i tha Berisha,- nuk do t'i lemë studentet e Vlorës të vdesin" Kjo u prit nga studentët si një premtim që Berisha do t'i plotësojë kërkesat e tyre dhe të mbarë popullit. Djali nga Lazarati këmbënguli duke I thenë. "pse ore ç'pret ti të bëhët Shqipëria Somali, që t' I shkelim kufomat me këmbë rrugëve?"

Në këto momente kritike ngrihet një koleg dhe pasi eci në trasen e nënkuptuar nga Berisha për ndryshime politike, tha hapur se studentet edhe të tjerë, po manipulohen nga ish oficerët e sigurimit.

Nuk m' u durua dhe kërkova fjalën. Pasi sigurova prej Berishës afinitet që të mos më ndërhyjnë lakejt e tij (I kujtova se më 1991 për të shpëtuar atë nga një e goditur me send të fortë u futa në mes dhe goditjen e henga unë. Pastaj I kujtova se si unë edhe ai nuk kishim shami dhe gjakun tim e fshiu me shaminë e vet, ambasadori amerikan Rayersoni. Berisha tha ,po), atëherë I thasë pak a shumë. Unë mendoj se studentët manipulohen dhe janë nën presion nga SHIK-u. Cfarë do, -I thashë, SHIK-u në mjediset e Universitetit akoma edhe tani. Aq më keq akoma nëq strukturat e ish Sigurimit janë kaq të forta edhe pas pesë vjetësh. Pastaj I thashë, pse flisni për Partinë Komuniste. Më duket, - I thashë,- se doni të bëni propagandë. Zbatoni ligjin dhe nxirreni jasht ligjit Partinë Socialiste n.q.s është, parti komuniste dhe mos bëni propagandë.

Në vazhdim I thashë se deri tani nga tridhjet e ca parti që ka vendi mbi 25 kërkojnë dorëheqjen e qeverisë dhe zgjedhje të reja. Atëherë përse nuk e dëgjoni zërin e tyre. Lë të mos harrojmë, vazhdova, se Italia, Greqia, Franca, e një serë vendesh të tjera I kanë ndruar qeveritë, për një kohë të gjatë, për çdo gjasht muaj. Si ta kuptojmë atë që ju thatë se n.q.s ju jipni dorëheqjen vendi mbetet pa qeveri.

Berisha e kishte të kot që vazhdonte dyluftimin me logjikën e ftohtë të studenteve. Përçartja e tij arriti në një moment sa që në vend të thoshte "qëveria jonë", këmbëngulte duke thenë studenteve, "qëveria juaj, qëveria juaj" si gjilperë gramofoni e mbetur në vend. Për çaste të tëra shikonte në një pikë dhe nuk e tërhiqte veshtrimin. E shoqja e tij u shqëtësua shumë dhe pa nga Kolec Topali që rrinin në rreshtin e parë. I pashë që vendosen për ta mbyllur takimn. Topalli ngrii dorën lart, por Berisha edhe pse shikonte në atë drejtim nuk e vuri re dorën e ngritur të njëriut të

tij. Kur e pa Berisha shikoi nga gruaja e cila i bëri me shenjë për të ndaluar. E ndërpreu fjalinë në mes. Lëshoi një buzeqeshje , u çua dhe iku.

Por edhe largimi nga Gjirokastra nuk qe e thjeshtë. Berisha e shoqja, Kolec Topoalli dhe një gazetare ikën me helikopter, pjesa tjetër e ekskortës së tij të stërmadhe, detyrohet të iki nga Permeti se rruga në Tepelenë ishte e bllokuar

VENDIMI PER GREVEN E URISE ISHTE I MARRE

Mirëpo mbremja qe vendimtare për zhvillimet e metejshme në Universitetin e Gjirokastrës. Televizioni si zakonisht bëri montazh në paraqitjen e takimit. Duartrokitjet për qëndrimet e studenteve televizioni ia veshi fjalëve të Berishës. më këtë mënyrë televizioni e transformoi në të gjitha përmasat takimin

Po atë natë në Vlorë ndodh një incident tëpër i rendë. Bëhen përpjekje të organizuara nga shërbimet sekrete dhe njëri të Berishës për të nzyrrë nga greva e urisë pesëdhjetë studentë të mbetur. Ky ishte thelbi, sipas studentëve të Gjirokastrës, i premtimit të dhenë nga Berisha ,se nuk do t'i linin ata të vdisnin.

Të dyja këto ngjarje i detyruan studentët e Gjirokastrës të rishikonin vendimin e tyre të një dite më parë. Senati mëgjithatë u desh të mblidhej në mënyrë të jashtëzakonshme për të vendosur nëse do t' u lejohej auditori i madhë studenteve. Në vendimin që mori , i lejonte ata të mblidheshin në “ një orë të caktuar për problemet e tyre, brenda ligjeve e normave në fuqi, jasht politizimeve dhe kërkesave politike, dhe të mos lejohej pjesëmarrja e të huajve në tubimin e tyre”

E çuditshme qe, se studentët hynin në auditorin e madhë të universitetit me vendimin e marrë për grevë urie. Eshtë pak për të thenë se e dëgjuam nga më shumë se dhjetë veta këtë deklaratë në korridorin e ngushtë që të çon për në auditorin e madhë të Universitetit. Kështu edhe u vendos. Në fillim 35 veta e më pas 46 nga të cilët 24 vajza vendosën të hynin në grevë urie pa afat. Dy momente delikate, e para gadishmeria për një sakrificë sublime dhe kujdesi që në grevë të mos hynin manipulatorë dhe grevëthyes u kapërxyen shumë shpejt. U munduam tua bëjmë të qartë se greva që këtej e tutje nuk u përkiste atyre por kishte një rendësi shumë të madhe për të gjitha zhvillimet në vend. Serioziteti i gjithçkaje u duk qart tek momenti i ndarjës së grevisteve në orën tre mbasdite nga gjiri i shokëve.

Në rregullorën e tyre përcaktuan qartë se greva është absolute, Ndalohet reptesisht hyrja e personave të huaj në ambientet e Universitetit. (Në kushtet e një përkrahjeje masive një vendim i tillë, i hiqte çdo të drejtë policise për të ndërhyrë dhe rektoratit për të kërkuar ndërhyrjen e policisë) Po ashtu u ndalohej komunikimi i studeneve me grevistët e urisë. Kryetari i grevë së urisë u caktua Shkeliqim Mecorapaj nga Vlora. Ndërsa gjithë bara në organizimet e tjera u mbeti dy vajzave heroike të Gjuhë-Lëtërsisë, Aleksandra Koshit dhe Elona Shehut. Që me komunikatën e parë për shtyp studentët kërkuan gjithashtu përkrahjen e popullit të Gjirokastrës dhe njëkohesisht bojkotimin e mësimit të nësermën nga të gjitha shkollat e rajonit të Jugut

Komisioni drejtues i grevës së urisë u mblodh për të përcaktuar jo vetëm orën dhe rregullorën, por edhe modalitetet e tjera . U vendos ora tre kur të gjithë studentët do të ishin prap në auditor nga ku do të bëhej edhe përcjellja e grevistëve. U caktua salla e greves , një klasë mësimi në katin e parë jo me shume se 35 metra katrorë . U njoftua rektorati, komisariati dhe spitali. Njoftimi bëhej nga komisioni i autorizuar i grevës komisariatit “ Për marrjen e masave mbrojtëse të mjedisit të grevës”, spitalit që të siguronte një ekip mjekësor «për mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e shendetit të studenteve në një grevë urie absolute dhe pa afat” dhe rektoratit “për marrjen e masave për mbarëvajtjen e grevës dhe mbrojtjen e jetës së grevistëve “

Përgjigjet erdhen që të tria negative .

SHTETI XHINDOSET

Studentët grevistë protestuan aty për aty që rektorati nuk i linte të zhvillonin grevën e urisë në mjediset e universitetit. Për situatën u alarmua menjëherë Tirana që u kërkoi organëve të rendit të nderhynin për të mos lejuar një qendër të re graviteti të kundërveprimit ndaj shtetit.

Në fillim, vet Agim Shehu, ish z/ministër i Brendshëm, sipas autoritetëve të atëhershëm të komisarariatit të policisë së Gjirokastrës, kërkoi që të parandalohesh me përdorimin e dhunës greva e studentëve. Më pas ai kërkoi që studentët të dilnin më forcë. Urdhrat gojore vinin për gati çdo njëzet minuta a gjysëm ore, por që hasën në një kundërshtim të hapur të dy drejtuesve të komisarariatit të Gjirokastrës, Ilir Kokaliari nga Gjirokastra dhe Agron Pipa, nga Fieri. Urdhrat u shndëruan madje në kërcënime të hapura . Ishte pikërisht kjo përplasje që u dha mundësi studenteve të fitonin kohë dhe në orën tre e tridhjetë minuta , ata të futeshin në grevë urie. Ata megjithëse kishin njoftuar orën 15 për t'u mbledhur serish, nuk ishin larguar pothuaj fare nga Universiteti dhe ishin gati të zinin auditorin me forcë në rast të çdo kundërshtimi.

Ndërkohë në komisarariat shkon edhe z/rektori i universitetit për të kërkuar ndihmën e rendit për të nxjerrë nga greva studentet. Komisar Kokaliari dhe ndihmësit e tij ia kërkuan kërkesën me shkrim për arsye se mjediset e universiteteve me ligj janë të paprekshme nga policia. Z/rektori nuk pranoi ta bënte një kërkesë me shkrim .

Njëkohësisht u shfaq edhe një përplasje tjetër. Ajo midis rendit dhe SHIK-ut. Rendi njoftonte Tiranën se greva e urisë së studenteve ishte pjesë e revoltës popullore dhe mund të kishte kundërveprime masive n.q.s veprohej kundër studenteve, SHIK-u relatonte se greva nuk kishte mbështetës dhe se policia nuk do të veprojë.

NATA E GJATE MIDIS RREZIKUT DHE QENDRESES

Ardhja e natës që shumë e shpejtë dhe kërcënimi i pritshëm . Studentët grevistë përpak mbetën vetëm. Greva e tyre ndryshonte nga ajo e studentëve Vlonjatë që kishin jashtë 15-20 mijë njëzëz që i ruanin. Pikërisht në momente të tilla arriti informacioni i parë se në mesnatë ose aty nga ora katër e mëngjesit do të sulmoheshin. Atëherë u vendos që gjithë studentët, të mos largoheshin . U bllokuan të gjitha dyert dhe u krijuan grupe studentësh që do të mbronin çdo derë apo dritare në rast ndërhyrjeje të mundshme. Nga dera kryesore ishin vetëm disa përfaqësues partish dhe ndonjë simpatizant i tyre apo kundërshtar i Berishës, por edhe ndonjë sherbetor i tij i ngushtë. E verteta është se studentët patën që natën e parë përkrahjen e shumicës së pedagogeve të tyre.

Megjithatë nata e parë ishte e rrezikshme. Informacionet që kishim ishin të vërteta Gjeneral Shehu dha urdher për organizimin e një plani operativë, për nxjerrjen me dhunë të grevistëve nga greva e urisë, për t' u zbatuar në orën 24 oo. Po ashtu është e vertetë se hasi në kundërshtime të hapura të policisë së Gjirokastrës . Urdheri ishte gojor dhe përsëritej për çdo pjesë minuata . Kur u pa se nuk zbatohesh urdheri gjeneral Shehu kaloi në kërcënime të tipit :- Të shitur tradhëtar, do t' ju vrasim etj.

Pikërisht në këtë kohë zoti Kokaliari kërkoi ndihmën tonë, pra , e para që të krijohej opinioni për situatën dhe së dyti të mos arrinte asnjë shkresë me shkrim për ndërhyrjen e policisë. Pas kësaj, në një distancë prej rreth 150 metrash larg universitetit takova prokurorin A. Pasho me dy oficerë, shoqëruesit e tij. Nuk i njihja fort mirë por megjithatë u fola për situatën dhe u kërkova që të konsiderohej Universiteti banesë e të mos sulmohej pa urdher të prokurorisë. "Ne nuk do të lejojmë

që t'u preket asnjë fije floku motrave tona, për b... të Saliut "- më tha Arbeni, as këta, tha dhe tregoi tre katër makina të SHIK-ut të parkuara aty afër.

Informacioni i dytë që erdhi ishte se sulmin do ta organizonte SHIK -u me forca nga Lazarati dhe në orën katër të mëngjesit. Përshtetësisht takova R.B nga Lazarati dhe i thash se këto fjalë janë përhapur. Në rast se do të ndodhë dicka, dini se do të mbeteni me turp për tërë jetën, Brenda keni pesë veta nga fshati. Ata do të godisni? Nga ana tjetër, i thashë, studentët i kanë marrë masat, kushdo që do të guxojë që të vij do ta godasin me thika, me xhama, me gurrë, me kembë karrigësh e ku ta di unë. Askush s'ka për të hyrë i gjallë tek studentet.

Iku dhe erdhi në universitet pas një ore duke më thenë fshehtas. "Mos kini frikë nuk do të ndodhë asgjë"

E verteta është se unë të kundërtën besova. I kërkova Aleksandrës dhe Elonës, bashkë me Ari Zoton që në këto orë të gjithë duhet të jenë në kembë dhe të bëhet sa me shumë zhurmë.

Njoftimi i tretë që na erdhi ishte se universiteti ishte rrethuar me ushtarë. Dola pothuaj vetëm dhe kontrollova rreht e qark. Nuk pashë gjë. Të nësërmën thanë se ushtarët ishin vendosur në pikat dominuese në kodra mbi universitetin.

Rreth orës dhjetë të darkës nga jashtë godinës së universitetit ishin larguar pothuaj gjithë njëzërit që kishin ardhur për të përkrahur grevën e studenteve. Ishin larguar madje edhe të afërmit e studentëve. Kishin mbetur aty disa njëzërit të opozitës, por edhe ndonjë njeri i SHIK-ut. Ishin aty edhe gazetarët të cilët transmetonin moment pas momentit për gjithçka ndodhte në godinën e Universitetit. Studentët tregonin shumë të vendosur për të mbrojtur vëpre e tyre, ndërsa pedagogët që kishim qëndruar aty tregonin se nëse ndodhte që të derdhej pikë gjaku studentit në mjediset e universitetit ata nuk do të shkelnin më në pragun e tij për të dhenë mësim.

Nata e parë që ne kishim frikë, kaloi pa ndonjë incident. Përrashtoj telefonatat kërcënuese. Veçanërisht e rëndë që telefonata për "minën që do të shperthente në orën katër të mëngjesit". Z/rektori bëri gabimin që nuk njoftoi. Por kur u pa që ishte farsë, duhet thenë se bëri mirë që s'njoftoi se në rast të kundërt, çdo gjë do të kishte marrë fund. Kishte rrezik që të gjithë ta braktisnin universitetin, edhe grevistët e urisë.

Po ashtu duhet thenë se greva e urisë në Gjirokastrë ndiqej moment pas momenti nga Vlora dhe anasjelltas. Në Vlorë njoftimet se do të ndërhynin forcat speciale për të nxjerrë me dhunë grevistët e urisë kishte nxjerrë në rrugë mbi 50 mijë veta në ruajtje të tyre. Nga bisedat telefonike që kishim gjithë atë natë të gjatë me Vlorën mësonim se si Vlora ishte zgjuar, dëgjoheshin bresheri armësh të llojeve të ndryshme dhe se dicka e keqe po ndodhte me SHIK-un. Askush nuk po flinte atë natë në Vlorë dhe fjalët tona "na falni se ndoshta ju shqetësojmë por ...", nuk kishin asnjë vlerë.

NJE DITE TJETER E VESHTIRE PER STUDENTET GREVIST

Në ditën e dytë të grevës së tyre të urisë, studentët e Gjirokastrës kishin në përkrahje të tyre më shumë se dy mijë nxënës të shkollave të mesme të qytetit. Nxënësit që zunë shumë shpejt shkallët deklaruan se do t'i bojkotojnë mësimet deri në plotësimin e kërkesave të studenteve grevist. Reagan mënjëherë nga Drejtoria Arsimore që kërkuan nga mësuesit të bindnin nxënësit të ktheheshin në mësim.

Thirrje studentëve, për t'u kthyer në audotorë bëri në ditën e dytë grevës së urisë edhe senati i universitetit duke iu rekomanduar të tjerë rrugë për të protestuar. Më gjithatë senati kërkoi nga forcat e policisë që të mirreshin masa mbrojtëse për studentët grevist dhe mjediset e universitetit. Dhe në fakt kështu ndodhi

Pas nxënësve arritën në universitet punonjësit e fabrikës së Lekurë -këpuceve .” Jemi me kërkesat tuaja, shkruajnë punonjësit e kësaj fabrike në një letër mesazh drejtuar studentëve grevist të urisë,-për përmbysjen pa kushte të qeverisë hajdute “Meksi” dhe për dorëheqjen e mënjëhërshme nga posti I presidentit të Sali Berishës”...

Përkrah studenteve grevist, u radhitën, ndoshta më pak vonesë , dhe sindikata e pavarur e pedagogëve. Pedagogët, edhe pse hartuesit e deklaratës hezituan në një moment të përdornin termin grevë urie , grumbulluan para që t’u vinin në ndihmë studentëve, sidomos për të siguruar ujin me sheqer.Në deklaratën përkatëse prej shtatë pikash ata kërkojnë që të mos ndërhyhet nga forcat e rendit dhe “ të mbrohet institucioni nga çdo forcë e jashtme”. I kërkojnë administratës së Universitetit të “ marrë masa të plota higjeno - sanitare “ për grevistët e urisë”. I kërkojnë gjithashtu administratës që “ grevistët të jenë nën mbikqyrjen e vazhdueshme të një ekipi mjekësor”

Ndërkohë spitali vazhdon të hezitojë dhe nuk dërgon një ekip mjekësh për të mbikqyrur studentët grevist. Edhe pse është vetëm dita e dytë midis tyre u shfaqën dhimbja e kokës, marrja mendsh deri në të vjella, që ishin ndoshta rezultat edhe I ambientit të ngushtë ku zhvillonin grevën 46 veta

Këtë detyrë të spitalit e morri përsipër vullnëtarisht një mjek I ri Gj Kaci, iniciativë që detyroi përfundimisht edhe spitalin të gjiunjëzohej.

Po atë ditë studentët grevist I viziton konsulli grek në Gjirokastër N. Kanello “ si diplomat dhe si njëri” siç u shpreh ai. Studentët e falinderuan për vizitën dhe I kërkuan të përcjellë në qeverinë e vet “ të mos përkrahë herë tjetër qëveri hajdute, si qeveria e Berishës”. Studentët kishin këtu parasysh përkrahjen e Greqisë për qeverinë e Tiranës në Keshillin e Ministrave të Jashtëm të B.E.

Studentët grevist I vizituan dhe I përshendetën edhe dy deputetët e PPDNJ-s, të vetëm politikanë që u lejuan të hynin nga studentët në mjediset e Universitetit.

Po atë ditë drejtuesve të grevës jashtë sallës ku ajo zhvillohej iu desh të përballonin një serë presionesh të njërëzve të dërguar nga Ministria e Arsimit por dhe telefonata nga rrethi I ngushtuar I njërëzve të Berishës. Ata edhe pse tregonin interes për karakterin e grevës, (studentët e fshihnin në fakt karakterin politik të grevës dhe kërkesave të saj , duke e konsideruar atë si përkrahje të kërkesave të studenteve të Vlorës), në fakt ishin të interesuar për shpërndarjen e saj

Nata do të risjell të njëjtën skenë. Mjediset e universitetit janë të pushtuar nga mbi pesëqind studentë të cilët kanë vendosur të mbrojnë deri në fund shokët e tyre grevist.

Kapitulli 6

BERISHA PILOTON DREJT VDEKJES STRUKTURAT E SHTETIT

Më 27.02, në Tiranë , Keshilli Kombëtarë I PD-së I dha votën Sali Berishës si kandidatë e vetme për postin I Presidentit të Republikës për një mandat të dytë, me 90 vota pro dhe 5 abstenime. Le të mos harrojmë se edhe kësaj here Berisha ushtroi presion mbi votuesit. Por ajo që ka më shumë rëndësi është fakti që Berisha tregohet tëpër I vendosur për të vazhduar në rrugën e tij represive për të mbajtur pushtetin. Data e zgjedhjes së Presidentit të ri të republikës është caktuar 03.03.1997.

Opozita socialiste reagon ashpër duke thenë se «përderisa parlamenti është I paligjshëm dhe produkti I tij, pra zgjedhja e Prsidentit do të jetë e paligjshme.» Nga ana e vet kryetari I partisë së të Drejtave të Njeriut Vasil Melio , deklaroi se nuk do të marrë pjesë në zgjedhjen e presidentit.

Kandidatura e Berishës për President ndëzi me keq protestat e popullit të Vlorës që e kundërshtoi atë me forcë. Situata në Vlorë ishte edhe më shpërthyesë edhe për faktin se po atë ditë, sipas vendimit të gjykatës së Tirnaës, pas padisë së vet qeverisë në ngarkim të studenteve greviste të urisë së Vlorës, gjyqi duhej të zhvillohej në Tiranës Studentët grevist të urisë në Vlorë vazhdojnë grevën e urisë për të nëntën ditë duke mos pranuar më të kurroheshin jashtë murëve të universitetit. Ndërkohë lajme nga Vlora tregonin se protestuesit provokoheshin nga grupe te armatosura ku si pasojë një protestues u plagos në kokë. Njëkohësisht flitej se këta provokatorë për të mos marrë parasysh rrezikun që mund të përballonin, përdornin lëndë narkotikë. Pikërsiht njëzëz të tillë të hipur në një fugon të bardhë tentuan natën e 28 Shkurtit, aty rreth orës 22, të hynin në godinën e Universitetit, por hasën në kundërshtimin e menjëhershëm dhe të fuqishëm të rreth 15 mijë protestuesve Vlonjatë që ruanin universitetin. Ndërsa qyteti u mbush nga krismat, disa dhjetra protestues ndoqën fugonin e bardhë i cili mori rrugën për nga SHIK-u. Atje ata u strehuan dhe hapën zjarr kundër protestuesve të zbuluar. Kështu ndodhi që u plagosën disa prej tyre. Pas kësaj protestuesit Vlonjatë morën një makinë reportabel, iu afruan godinës së SHIK-ut dhe duke përdorur atë si mburojë hapën zjarr deri në asgjësimin e plotë të njëzëzve të SHIK-ut të ndodhur atje dhe djegjen e godinës. Ishte një urrejtje e pashembullt. Asnjëherë nuk u tha i plotë numri i viktimave të asaj përlëshjeje të egër. Një numër fliste për 13 të vrarë, tridhjetë të plagosur, gjashtë prej të cilëve në gjendje shumë të rëndë. Një nga njëzëzit e SHIK-t u lincua në sheshin e Universitetit, i cili megjithë torturat të egra, sipas deshmitarëve okularë, nuk pranonte të mohonte Sali Berishën. E verteta është se shumë nga njëzëzit e SHIK-ut janë zhdukur në mënyrë misterioze. Televizioni shtetëror tha për gjashtë të vrarë nga forcat SHIK-ut. I mbështetur në informacionët e ardhura nga SHIK-u, TV-ja fliste se sulmi kundër SHIK-ut u organizua nga "grupe terroriste" të organizuar nga Partia Socialiste të cilat egzekutojnë persona "të listave të zeza anëmbanë Shqipërisë". Ushtria u vu në gadishmeri, ndërkohë që protestuesit Vlonjatë, midis të cilëve edhe Fierakë e Beratash, sulmuan depot ushtarakë morrën armë dhe organizuan mbrojtjen e qytetit nga të gjitha drejtimet.

Po t'i referohemi kryeartikullit të gazetës "ALBANIA" të ditës së nëserme, dhe pohimeve të shkruarit të këtij kryeartikulli, (por një nga të paktët që mund të kondaktonte, sipas tij me Sali Berishën në ato ditë të rënda dhe njëkohësisht gazetar i Zërit të Amerikës), të botuara këto pohime në revistën "BLIC", rezulton se SHIK-u në Vlorë duhet të kishte mbështetjen e Ushtrisë. Ndaj edhe në këtë kryeartikull sulmohej ashpër pothuaj si tradhetar Ministri i Mbrojtjes Safet Zhuliali që nuk i çoi SHIK-ut forcat ushtarake. (Zhuliali i mbështetur në këtë shkrim, sipas tij të sugjeruar nga Berisha, dhe në disa fakte të tjera, pohoi disa ditë me vonë pasi do të këtë braktisur vendin, se Berisha donte kokën e tij si kokë turku për situatën. Njëkohësisht ai vet pohon se e kish humbur autoritetin mbi ushtrinë) Fakte të sjella në dritën e shtypit pothuaj një vit me vonë (Koha Jonë 01.02.1998) nga grupet hetimore në arkivat e Ministrisë së Brendshme tregojnë se ushtria kish filluar të mirrte urdhëra nga kreu i policisë Agim Shehu i cili kishte ideuar dhe udhëhequr sulmin për shtypjen e protestave në Vlorë dhe qytete të tjera në Jug.

Në Tiranë, më 28.02 studentët morën kontakt me përfaqësitë diplomatike të SHBA dhe të Gjermanisë duke kërkuar të përcjellin në qeveritë e vendeve të tyre kërkesat e veta për dorëheqjen e qeverisë Meksi. Edhe gjatë kësaj dite të gjitha përpjekjet e studenteve për t'u organizuar në grevë urie, dështuan. Forcat policore ndërhyjnë me forcë kundër çdo llogi organizimi të tyre.

Forca policore ushtruan dhunë të egër në mënyrë të përseritur ndaj nxënësve të shkollave të mesme të kryeqytetit, të cilët për të tretën ditë radhazi kishin mbojkotuar mësimet në shenjë proteste. Me dhjetra nxënës u shfaqën nëpër redaksi të gazetave të pavarur për të treguar shenjat e dhunës së ushtruar kundër tyre nga policia.

Policia e Tiranës megjithatë lejoi opozitën të organizojë një ditë me vonë një tubim proteste, por jo në sheshin "Skënderbej". Por opozita u bëri thirrje përkrahësve të vet të mbledhen pikërisht atje. Të nësërmën Ministria e Brendshme u kërkoi forcave politike të opozitës të mos e zhvillonin mitingun e paralajmëruar për në orën 14 në fushën Ali Demi. Arsyeja lidhej me situatën e krijuar në vend pas zhvillimeve të një nate më parë në Vlorë. Forumi për Demokraci e zhvilloi, megjithatë mitingun dhe pas mitingut u nisën në drejtim të qytetit të studenteve duke u bërë thirrje atyre që të bashkohen me ta. Tek ambasada Amerikane ndërhyri policia për t'i shpërndarë. Në përlëshjen e zhvilluar u plagosen dhjetra demonstrues dhe shtatë policë.

Po ashtu në Tiranë ishin rrembyer nga "përsona të panjohur"(!) dy liderë kryesorë të opozitës socialiste, Sabit Borkaj dhe Kastriot Islami, të cilët pas lirimit largohen jashtë vendit. Gazeta "Koha Jonë" një ditë më parë kishte lenë hapur të kuptohet se ishte në rrezik jeta e liderit të burgosur socialist, Fatos Nano.

Në Tepelenë rruga vazhdon të jetë e bllokuar në urën e Memaliajt. Në ditën e katërt të bllokimit të urës, arrinin lajme që flisnin për konfrondime midis demonstruesve dhe forcave të policisë dhe të ushtrisë që kërkonin të çbllokohet urën.

Saranda po atë ditë, më 01.03, do të shndërohet në vatër tjetër të shpërthimeve të dhunshme. Hapet burgu dhe mënjëherë u vihet zjarri, bibliotekës, hetuesisë, gjykatës, SHIK-ut, komisariatit të policisë. U bastisen bankat dhe paprtitue të gjitha rrugët janë të mbushur me njerëz protestues. Ajo që të terheq vemendjen në përfshirjen e Sarandës në valën e protestave është fakti që fillon me shpërthimin e burgut dhe djegjen e zyrave të SHIK-ut.

NGA DOREHEQJA E MEKSIT TEK GJENDJA E JASHTEAKONSHME

Rezultat ndoshta dhe I presionit të gjithanshëm Berisha komunikon dorëheqjen e qeverisë Meksi, të shtunën më 01.03 ora 20 në televizion, pa njoftuar konkretisht se çdo të behet pas kësaj dorëheqjeje dhe si do të qeveriset vendi. Do të mirrej parasysht propozimi I opozitës për qëveri teknike. Do të shkohet apo jo në zgjedhje të parakoheshme dhe me çfarë qeverie do të zhvillohen ato. Faktikisht ky vendim shenon një pikë të rrezikshme në zhvillimet në vend. Shteti mbëtet dhe de jure pa qëveri. Fillon pra praktikisht shkermoqja edhe e hallkave kryesore, të fundit ,të shtetit dhe zhvillimet në vend u drejtohen një aventure të paimagjinueshme, jashtë kontrollit të mjetit që rregullon raportet e marrëdhënieve midis qytetereve të thjeshte , midisë kategorive të ndryshme njërësh dhe midis tyre dhe shtetit . 24 orët që pasuan vertetuan sa larg , po në kahun e së keqës kishin shkuar punët.

Lajmin se qeveria Meksi dha dorëheqjen u prit me entuziazëm shumë të madhë . Në momentin e parë ajo u kuptua si thyerje e Berishës. Veçse ky entuziazëm nuk zgjati shumë.se logjika s'u linte kohë dhe vend emocionëve. Dorëheqja e Meksit , u kuptua mënjëherë se ishte një manover politike e Berishës. Ai tatonte pulsën dhe kërkonte pak kohë për hapin e mëtejshëm të tij. Koha I duhej që ky hap të bëhej në terrenin e shpresës për ndryshime.

Të parët ndoshta që reagan negativisht për këtë vendim ishin studentët grevist të urisë në Gjirokastër. Në orën 20 e 30 minuta doli komunikata e Komisionit Qëndror të Grevës së Urisë ku midis të tjerave sqarohej se greva do të vazhdojë, në përputhje me kërkesat e paraqitura presidentit Berisha dhe në aleancë me grevistët e urisë së Vlorës. Cuditerisht në këtë deklaratë tepër të rëndësishëm për fatin e mëtejshëm të grevës, ata gjejnë vend të falinderojnë policinë për qëndrimin korekt të mbajtur ndaj tyre.

Pavarësisht nga fakti që greva e urisë së studentëve dhe përkrahja e tyre nga ana e qindra qytetarëve e kthen atë në qëndër me rendësi në zhvillimet politike në vend, ajo ka një mëvetësi nga rrjedha e përgjithshme e jetës në qytet. Të gjitha dyqanët janë të mbyllura. Në qytet krijohet paniku për bukën. Ishte gdhirë e diela, datë 02.03.

Në ambiente të ngushta qarkullon me shpejtësi lajmi se nga burgu I Bencës është tërhequr me helikopter natën Fatos Nano për në drejtim të paditur. Nuk ishte I qartë kush e kishte bërë këtë veprim dhe për ç' arsye bëhej. Variantët ishin nga më të ndryshme, Ca thoshinin se e tërhoqi Berisha që të mos e lironin tepelenasit. Të tjerë thoshnin se Berishën e detyroi Perendimi që t'i siguronte jetën. Varianti I tretë thoshte që në këtë katrahurë Berisha mund të gjente rastin ta zhdukte. Ne transmetuam se nuk I dihej fatit të jetës së udhëheqësit të opozitës Fatos Nano

Në mesditën e kësaj të diele ,02.03, në orën 14, mbi pesëqind makina të llojëve të ndryshme vershajnë nga Tepelena në qytetin e Gjirokastrës dhe I drejtohen universitetit. Më ta bashkohen edhe qindra Gjirokastritë të tjerë. Atyre u printe Gjolek Malaj , se bashku me Robert Targal. Ishte hera e parë që shikoja se si rezistenca e policisë I ngjante fijos së letrës. Gjoleka iu përgjigj kërkesës tonë që të respektohej paprekshmeria e universitetit dhe ai dha urdher që çuditërsht turma e protestuesve , edhe pse dukej si një lum I fryrë tej masës , u bind si një ari I butë. Por Gjoleka dhe protestuesit e tij nuk qëndruan shumë mbi shkallët e universitetit. Dikush erdhi dhe I tha dicka në vesh Gjolekës I cili u zverdh edhe më në fytyrë nga tendosja e nervave, shau rend dhe I priu turmës drej sheshit të qytetit, para stadiumit. Atje u zhvillua një miting I shkurtër me pjesëmarrjen edhe të forcave politike. Pas kësaj ata hipën përseri në makina dhe ikën për në Tepelenë pa ndodhur as incidenti më I vogel.

Po atë ditë përfshihet në flakë Delvina. Grupe keqbërëesish, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me mijrat e protestuesve, hynë në orën 11 në qytet dhe shkaterruan e dogjën godinën e komisariatit të policisë, të bashkisë dhe të bankës. Me grupet e ardhura nga jasht qytetit u bashkuan edhe disa vendas. Pak a shumë edhe këtu u përserit skema e Sarandës më të vetmin ndryshim që Delvina s' ikishte burg.

Skema e Delvinës ishte gati edhe për Gjirokastrën. Në orën 11 paradite të po kësaj dite, komisariati I Gjirokastrës u hap. Ndërkohë që shefi I Komisarariatit të Gjirokastrës , Ilir Kokalari, e kishte braktisur detyrën dhe ishte zhdukur. Sipas pohimëve të tij ishte kërcenuar drejtpërsdrejti nga Zhuliali e Shehu se do të egzekutohej nga vet ata si tradhëtarë dhe si I shitur tek greku.

Nga hapja e komisariatit u morën armë automatike, pistoleta dhe armë snaipërash, u vodhën kompiutërat e pashaportave etj. Kjo hapje u bë në bashkëpunim me punonjësit e policisë dhe sulmi që do të ndodhte pasdite do të justifikonte këtë bastisje

Pas ikjës së tepelenasve nga Gjirokastra, rishfaqet lajmi se qyteti do të sulmohet nga sarandjotët dhe delvinjotët. Kjo I kishte bërë qytetarët të strehoheshin në shtëpi dhe të mund të vinin në vende të sigurta ç'farë kishin më të shtrenjtë. Mirëpo njëëziti e dërguar për të verifikuar lajmin e përhapur edhe pse arritën deri në Qafë Gjashtë, nuk e vertetuan dot atë. Në kthim, pak kilometra jasht Gjirokastrës vunë re një grup njëëzish me maska dhe nja 8 makina pa targa. Janë po këto makina që rreth orës 17 30 nisen në drejtim të Gjirokasës. Bëjnë një xhiro deri tek sheshi I Cerçizit dhe pastaj zbresin poshtë në drejtim të lagjjes 18-Shtatori. Tek kthesa e ish NPV-së qëllojnë në ajer dhe pas asaj I sulën komisariatit. Në fillim ata thërriten "posht kommunizmi". Por mënjëherë ndruan taktikë, se diçka nuk shkonte mirë dhe filluan të bërtisnin " Vlora Vlora, poshtë Sali Berisha". Policia nuk rezistoi fare dhe komisariati u përfshi nga flakët. Zjarri përfshiu në vazhdim edhe një zyrë të prokurorisë së rrethit, pikërisht atje ku ishin vendosur dosjet më të rrezikshme.

Para komisariatit vritet I riu Bahri Dudumi, flamurbajtësi në mitingjet e PS-së, I cili në mitingun e paraditës se po asaj dite kishte marrë jasht radhës mikrofonin për të mbajtur edhe ai një

fjalim ndoshta të parin dhe të fundit, ku më shumë kishte folur për demokracinë se sa kishte denuar diktaturën e re. Komisariati nuk i dorëzohet vetëm flakëve por edhe njërezve, të cilët duke përfituar nga errësira, hynë në ambjentët e tij, lirojnë gjithë të ndaluarit dhe rrembyen ç' gjetën, kryesisht armë.

Sakaq qyteti mbushet me armë e me krisma. Armë dhe municione s' kishin vetëm të rriturit por dhe femijë të vegjël. Po ndodhte diçka e çuditshme. Shumë shpejt po ambjentoheshim me armë të hedhur sheshit. Dy armë kishin hyrë edhe brenda universitetit, ku vazhdonte greva e urisë. Madje u dëgjuan edhe dy të shtena në një dritare nga ana e pasme.

Nata ishte bërë më e frikshme dhe lëvizjet shumë shpejt u ralluan deri në zero. Armët megjithatë nuk pushonin dhe dalëngadalë filluan të zoterojnë gjithë qytetin. Aty rreth orës 21 30 digjet dhe bastiset dhe Adi Petroli, pronë e Gjallicës që konsiderohej si një perlë e qytetit. Djegja e shoqëruar me bastisje ishte një bashkëpunim i shkëlqyer e shumë palëve. Një familje Gjirokastrite mori aq shumë materiale nga Adi Petroli sa që plotësoi gjithë depozitat e humbura tek Gjallica dhe VEFA

Në Vlorë vazhdonte gjendja kaotike. Protestuesit kërkonin më çdo kusht shpagim për ato që ndodhnin në qytetin e tyre. Furia e urrejtje atë ditë, 02.03, shkarkoi tek vilat qeveritare dhe tek ajo e Presidentit Berisha.

Në mesditë, në fshatin Levan të rrethit të Fierit erdhen nga Vlora dy kamiona dhe një numër i madh makinash të vogla. Pasi morën armatimin e repartit aty u kthyen serish në Vlorë.

Disa orë me vonë sulmohen depot e divizionit të Fierit dhe mbahet për rreth katër orë i rrethuar komandanti i Divizionit të cilit i vijnë në ndihmë policia. Plagosen gjashtë qytetarë dhe vritet një tridhetvjecar.

Në Tepelenë lirohen më forcë njërezit e arrësuar gjatë trazirave dhe merr fund funksionimi qoftë edhe formal të institucionëve shtetërorë. Edhe këtu sulmohet brigada e artilerisë dhe vihet nën kontrollin e protestuesve armatimi i rendë. Në Tepelenë, për të ruajtur krahët, por edhe për të ruajtur krahët e Vlorës, në të gjitha fshatrat ishin ngritur grupe të gatshme, të armatosura të cilat kishin një sistem komunikimi dhe plan bashkëveprimi dhe që inspektoheshin rregullisht nga udheheqja reale e revoltës, në krye të së cilës qëndronte Gjolekë Malaj

Në Tiranë po atë ditë Berisha takohet me ambasadorët e vendeve të B.E, por i refuzojnë takimin partitë e opozitës. Këto parti, nga që më sa duket parashikojnë rrugën e zgjedhur nga Berisha për zgjidhjen e krizës në vend, mbledhen serisht vetëm për të përcaktuar qëndrimet e tyre të metejshme. Ndërkohë, takimi Majko-Shehu kishte përfunduar pa ndryshuar asgjë nga qëndrimet përkatëse për zgjidhjen e krizës. (Majko kërkoi zhblokim politik të situatës, ndërsa Shehu zbatimin e masave teknike, dmth dhunës)

Berisha nuk qe se ndoqi vetëm rrugën makbethiane. Ai ishte tanimë dhe Makbethi i Shqipërisë. Pallati mbretëror ishte gjithë Shqipëria dhe në terrin ku e kishte zhytur atë e tmerronte gjaku që nuk arrinte të ngrinte në duart e tij. Atë e tmerronte edhe proecia se si mund të zbriste nga kali, ndaj dhe në logjikën e rrugës makbethiane ai e damkos vendin e tij me një turp të pashlyeshëm. Në fund të shekullit njëzet e bën Shqipërinë, në zemër të Evropës me gjendje të jashtëzakonshme. Parlamenti i komanduar prej ti, më 02.03, shpall ligjin e gjendjes së jashtëzakonshme

Komandant i gjendjes së jashtëzakonshme u caktua nga Sali Berisha, kryetari i SHIK-ut Bashkim Gazidede, i cili po atë ditë shpallet gjeneral me katër yje. (Siç do të vertetohet më vonë dekreti për gradimin e Gazidedës nuk egziston) Nën komandën e tij vihet ushtria, forcat e rendit dhe të shërbimeve sekrete. Vendosja e Gazidedës në krye të gjendjes së jashtëzakonshme ishte e paligjshme dhe u duk e tmerrshme në sytë e popullit. Mbivendosja e shërbimeve sekrete, me një

emer dhe hije kaq të rendë, mbi strukturat e tjera ushtarake, e bënte të frikshme vet gjendjen e frikshme ta jashtëzakonshme. Po ashtu, përveç rregullave klasike të gjendjës së jashtëzakonshme, parlamenti votoi dhe një seri nënesh të tjera të cilat shprehnin në fakt vet karakterin dhe forcën e atyre që vendosën gjendjen e jashtëzakonshme. Në bazë të ligjit u kërkohej të gjithë atyre që kishin armë t'i dorëzonin, në kuadrin e një armëpushimi 48 orësh. Po ashtu parashikoheshin masa të përpjër të rrepta për ata ushtarakë që braktisnin detyrën. Krijohen në bazë prefekturë, rrethi dhe bashkie, Shtabi I Gjendjës së Jashtëzakonshme, me përbërje reciprokisht të prefektit, kryetarit të këshillit të rrethit, kryetarit të SHIK-ut, shefit të komisarariatit, etj. Në këtë shtab duhet të paraqesin materialet e tyre gazetat,. Ndërsa që nga ajo datë mbylleshin të gjitha kategoritë e shkollave deri në një datë të dytë.

Pikërisht , mungësa e qëverisë, së shpërndarë de jure, një ditë më parë dhe vënja nën urdhërat e Gazidedës të të gjitha strukturave gjysëm të gjalla të shtetit si dhe fakti që masat in ekstremis që po mirreshin për të shpëtuar mbetjen në pushtet të klanit të Berishës, në kushtet e një populli gjysëm të armatosur, e bënin situatën të përpjër të rrezikshme. Njëkohësisht fakti që nuk egzistonte më, hierarki shtetërorë, krijonte precedentin e drejtimit të veprimeve luftarake nga shumë qëndra. Kjo gjë, përveç se përmbante rrezikun e zhvillimëve të pakontrolluara, nga ana tjetër tregonte kalbezimin total të strukturave të shtetit Berishan. Coprat e urdherave të mbetura në arkivat e ministrive lidhur me situatën e krijuar në vend si dhe deklaratimet e njërezve kompetentë të asaj periudhe, sidomos për sa l përket fluturimëve të avionëve drejt Jugut apo dhe pjesëmarrës në ngjarjen e Permetit , treguan pikërisht këtë kaos gjakosës, por edhe fundin e pashmangshëm të strukturave të Berishës

PJESA E DYTE

Kapitulli 7

SHIJA E HIDHUR E GJENDJES SE JASHTZAKONSHME

Lajmi I gjendjës së jashtëakonshme tronditi rendë grevistët e urisë dhe gjithë studentët dhe pedagogët e universitetit të Gjirokastrës, që atë natë ishin më të shumtë .Frika e një sulmi të mundshëm u bë evident. Minutat dhe orët kalonin dhe të gjithë u shmangeshin përgjesive. Prirja që po ravijëzohej ishte shpërndarja, por askush nuk guxonte ta bënte këtë. Më shqetësonte fakti se jo studentë por edhe pedagogë më thoshin se ç’duhej të bënim. Kuptohet ishte një moment delikat dhe I veshtirë dhe nuk doja që këtë përgjegjësi ta mbaja vetëm unë, pasi çeshtja s’më përkiste përsoanlisht mua. Nga ana tjetër bëhej fjalë për jetë njërezish të rinj.

Më thanë se më kërkonin grevistët e urisë. Kontaktova me Sandrën dhe Elonën. Nuk dija ç’t’u thoshja.U fola për ruajtjen e gjakftohtësisë. Aleksandra nuk përtoi dhe tha «Atë e dimë të terë por ç’ duhet të bejmë, të ikim». Aty për aty u shpreha kategorisht kundra dhe truri prodhoi pothuaj pa vetëdije formulën që u përdorë në deklaratën e studenteve por dhe si zgjidhje më e mirë “Ne , thuhet aty, u futëm në grevë urie në kushte paqëje. Në kushtet e gjendjës së jashtakonshme nuk ka vlerë greva e urisë”

Më këtë formulë hymë në sallën e grevës së urisë. U thashë se mund të ishte me shumë pasoja largimi natën, në kushtet e braktisjes së madhe nga qyteti dhe në kushtet e ndalim qarkullimit. Duhet të qëndrojmë, u thashë,- të gjithë se bashku sa të kalojë nata, dhe sa të zbardhi dita të mund të shpërndahemi.

. Ishte mesnatë dhe që nga ai moment grevistët e urisë mund të leviznin , ashtu si edhe benë. Masat mbrojtëse ishin më të repta se netet e tjera. Në qytet deri vonë degjoheshin krisma, dhe një zhurmë e shurdhët. Gruan dhe femijët I ndjeja fare të braktisur në shtëpi.Isha larguar për më shumë se njëzet orë. Aty nga ora dy e mëngjesit vendosa të largohem për në shtëpi fare vetëm. Kaloja pallat pas pallat pa lenë fushë qitjeje mbi vete.

Në shtëpi gjendja ishte e tmershme . Kishin qëlluar me armë në muret e pallatit. Djali I vogel trevjeçar, I porositur nga e ema e vet ishte strehuar në një qoshe dhe I mbledhur sa një grusht I thoshte se “ kur do të vij babi t’i vراسi?”. E shoqja ishte me cianozë rreth buzëve. Sipas një ndihmësmjekeje gjitone, kishte probleme me zemrën dhe se duhet t’i hiqja mënjëhërë nga Gjirokastra.Në rrethana të tilla nuk e mbajta dot premtimin që I kisha dhenë vetës për t’u kthyer serish tek studentët

Të nësermën Gjirokastra u gdhi me dy të vrarë dhe tre të plagosur, por edhe e bastisur. Me dhjetra dyqane ishin boshatisur. Gjithë pazari I vjetër ishte grabitur. Njërezit dukëshin krejt tjetër soj dhe tëpër të largët, sikur s’kishin ç’ t’i thoshin njërit tjetrit.

Ika nga shtëpia aty nga ora shtatë e tridhjetë minuta dhe vajta nga universiteti. Vendi më I afërt , tani më dukej tëpër I largët dhe disi I frikshëm . Aty s’kish më njëri. Mora vesh se studentët ishin larguar sapo gdhiu dhe se perveç disa kërcenimëve verbale , nuk kishte ndodhur asgjë tjetër. Ishte veshtirë të gjenin atë ditë makina dhe ikën si mundën. Kryetari I grevës së urisë Shkelqim Mecorapaj, iku me kembë deri në Vlorë.

Në kondaktin e parë që kisha më e kolegë gazetarë mora vesh se po përgatiteshin për t’u larguar nga vendi, por edhe shumë njerëz të tjerë po e linin qytetin. E verteta është se nuk ishin

vetëm opozitarë por edhe njëri të partisë në pushtet. Shumë nga udhëheqësit lokalë të opozitës ishin larguar ditë më parë. I kja përkohej mbeti dhe për mua rrugëdalja e vetme. Mora makinën dhe me ato placka të pakta që përgatiti e shoqja ikëm pa ditur se ku do të shkonim. Askush nuk na priste. Në çdo ndalesë që bëja në rrugën për në Kakavijë, ndjeja njëri që njihja të thoshnin, "Iku dhe Barka, iku dhe Barka" më një ndjenë të tillë sikur kritikonin vetën për vendimin e tyre për të qëndruar.

Në Kakavi pamë se drejtonin njëri të ardhur nga Tirana dhe dyshova se mos na ndalonin. Për t'i shpëtuar një veprimi të tillë nuk pranova të ndihmoja as edhe një mikun tim gazetar që pikërisht atë ditë donte të hynte në Shqipëri dhe nuk e linin. Nxorra në tokën greke familjen dhe u ktheva serish. Qëndrimi i njëri të ardhur nga Tirana, për çudinë tonë s'ishte fare i rreptë. Madje mbanin një qëndrim kritik ndaj gjendjes së jashtëkonshme.

Ky ishte kontakti i parë dhe i fundit me gjendjen e jashtëkonshme, pasi pas dy ditësh që u ktheva në Gjirokastrë e deri sa ajo u hoq as u respektua dhe as kërkoi kush për ta zbatuar. Kjo kishte vlerë për gjithë Jugun .

Në Tiranë, natën e parë të gjendjes së jashtëkonshme duke u gdhirë 03.03, njëri të "panjohur" i vunë flakën redaksisë së gazetës më të madhe në vend "Koha Jonë". Gjendja megjithatë që e qetë veç se nëpër rrugë kishte shumë policë. Që prej kësaj dite dhe deri nga mesi i prillit, nuk qarkulloi asnjë gazetë.

Gjithë vëmendja gjatë ditës ishte përqëndruar tek parlamenti ku do të zgjidhej presidenti i Republikës , vet Berisha. Parlamenti ishte tmerësisht i rrethuar me mjete dhe njëri. Berisha edhe pse me dorën e këtyre deputeteve kishte marrë viston për kandidaturën e Presidentit, prap kishte frikë se mos reaksioni brenda partisë dhe sidomos vendosja e gjendjes së jashtëkonshme i detyronte ata të votonin kundër. Berisha në keto kushte kërkonte një votim unanim, për të justifikuar dhe vendimin e një dite më parë, ndaj dhe u kishte kaluar mëszahin deputeteve se kushdo që do të votonte kundër , e prisnin xhupëzinjtë tek dera apo dhe jashtë parlamentit. Po ashtu vet deputetet e PD-së shikonin tanimë tek Berisha një mundësi të zbehtë për të mbijetuar. Sali Berisha u zgjodh President në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme në mënyrë unanime, pavarësisht nga thirrjet , presionet e politikës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare dhe nga kërcenimet popullore.

BERISHA TKURE MUSKUJT E FUNDIT (skenari i operacionit ushtarak kundër Jugut)

Kjo shenoi edhe fillimin e reagimit të fundit të Berishës. Ai vendosi të mbrohej duke shfrytëzuar institucionin e shtetit të personalizuar tek vetja . Por makina e shtetit ishte kaq e drobitur sa nuk lëvizti dot dhe u shemb përfundimisht. Kjo bëri që dhe rezistenca popullore të mos tregonte trajtat e një kryengritjeje klasike. Ajo s'kishte kundërshtar për t'u ballafaquar apo dhe për të mundur.

Po atë natë do të mblidhet Këshilli Kombëtar i Mbrojtjes, për të përpunuar strategjinë e shtypjes së «rebelimit të Jugut». Ideja, siç del nga letër e një diplomati të një vendi fqinj në Tiranë, botuar në shtypin e huaj , ishte që Berisha të shtypte revoltën të jo më shumë se dymijë e pësëqind të «rebeluarve», sipas informacionit të SHIK-ut, në Jug. Për këtë , i kërkohet ndihmë edhe qeverisë së këtij vendi që të mbylleshin portat e furnezimit për Jugun që «rebelet » të dorëzoheshin.

Shenime nga kjo mbledhje që përbënin në fakt idenë e një sulmi ushtarak kundër Jugut do të gjenden disa ditë më vonë në çantën e Gjeneral Ali Koçekut ditën e zbardhimit të forcave qeveritare në Gjirokastrë, 08.03, ditë që Koçeku, se bashku me Hysen Arapin dhe Gjergji Vladin do

të detyroheshin të linin kapelën pelerinën , çantën pistoletën, diku jashtë divizionit të Gjirokastrës për të shpëtuar kokën.

Nga shenimet origjinale të mbajtura në mbledhjen e Këshillit të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë e datës 03.03.97 dhe të gjetura në çantën e braktisur të Ali Koçekut, një anëtar i Shtabit të Gjirokastrës, ushtarak i lartë ka nxjerrë përfundimet e mëposhtme mbi masat dhe detyrat e përcaktuara gjatë fazës së parë të operacionit kundër Jugut.

Qellimi: Me pjesëmarrjen e kufizuar të trupave aktive dhe rezerviste të ushtrisë si dhe në bashkëpunim me forca speciale presidenciale të shtypej me anë të zjarrit dhe të dhunës revolte e popullit «për të rivendosur pushtetin dhe qytësinë.»

Idea e operacionit: Njëpërmjet mobilizimit të trupave rezervist nga Shqipëria e Mesme dhe e Veriut dhe në bashkëpunim me trupa komando presidenciale, si dhe me mbeshtetjen gjerësisht të avacionit , LHL-ve,artilërisë tankëve dhe grupeve të zbulimit në zonat e kundërshtarit të realizohej përqendrimi i forcave dhe i repartëve në brigjet veriore të lumit Vjose , si Bazë Nisjeje për të ndërmarrë mesazje duke dhenë goditjen kryesore në drejtim Fier - Vlorë, dhe atë ndihmëse në drejtimin Gjirokastrë - Sarandë.

Për të asgjësuar fizikisht të gjithë personat që do të kundërshtonin dhe personat që ishin hartuar në listat e zëna nga SHIK-u dhe PD-ja , në rast rezistence ose në pamundësi të realizimit të ketyre objektivave të përdorej për “ terror të gjerë ndaj rebelëve , bombardim me aviacion , përdorim të LHL-ve, mjetëve të blinduara dhe tankëve , deri në vendosjen e plotë të pushtetit ushtarak. Kjo ide do të realizohej njëpërmjet këtyre objektivave:

1.Mobilizimi i trupave në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut nga data 04.03, deri më datën 07.03.1997 dhe përqendrimi i tyre në bazën e nisjes Fier Ballsh, Këlcyrë, Permet Gjirokastrë,

2. Hartimi i listave për njërezit që do të asgjësoheshin përpara mbritjes së trupave në qytetet Vlorë, Tepelenë,Gjirokastrë, Permet, Delvinë, Sarandë.

3.Kapja e urave kryesore, si pika të rëndësishme të kalimit të trupave:-Ura e Mifolit,(Vlorë), Ura e Poçemit, (Mallakastër), Ura e Dragotit dhe e Leklit, (Tepelenë Kelcyrë), Qafa e Muzinës, etj, duke përdorur trupa speciale, transportues të blinduar, përdorimin e LHL-ve. Nga data 04-06.03.97.

4.. Dësantimi i trupave speciale në rajonet e Fushë Cajupit aerodromit të Gjirokastrës, Sarandës, krahinës së Kurveleshit deri edhe zbarkimin nga deti, me drejtim kryesor Vlorën. Nga data 04-06.03.1997

5. Përqendrimi i Akademisë së Rendit Publik dhe forcave speciale në rajonin ushtarak të Gerhotit dhe në Arshi Lengo në Gjirokastrë.

6. Vendosja e lidhjeve direkte midis forcave qeveritare dhe repartëve të policisë, SHIK-ut dhe forcave të besushmërisë së lartë të cilët do të armatoseshin nga shtabet e gjendjes së jashtëakonshme me armatim të lehtë dhe që do të sherbenin si baza të besueshme dhe të qëndrueshme për forcat qeveritare.

7. Organizimi i terrorit mbi popullsinë e qytetit të Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës Permetit, Tepelenës, njëpërmjet djegjeve shkatërrimëve të objektëve të ndryshme, që të paralizonin jetën publike.

8.Kufizimi me çdo kusht i përhapjes së Kryengritjes në veri të Lumit Vjosa, duke ndërprerë çdo lloj komunikimi në të dy drejtimet.

9. Mbrojtja me çdo kusht e Tirtanës nga marshimi i forcave rebele të Jugut, duke organizuar kontrollin e lëvizjes dhe bllokimin e urës së Rogozhinës, Qafën e Krabës, me anë të përqendrimit të forcave policore e ushtarake në këto drejtime.

10. Kontrolli I gjendjës morale dhe origjinës gjeografike të trupave për mbrojtjen e Tiranës dhe neutralizimi I ushtarëve të Jugut.

11. Përdorimi I aviacionit luftarak gjuajtës-bombardues nga regjimenti I Gjadrit, kundër përqëndrimit të forcave në Vlorë, Sarandë, Tepelenë, Delvinë.

FORCAT PJESEMARRESE NE OPERACION.

Komanda e operacionit Bashkim Gazidede. Në varësi të tij ishin forcat e ministrisë së Mbrojtjes, të Rendit dhe të SHIK-ut në të gjithë Shqipërinë.

Komanda e operacionit në drejtim kryesor Fier - Vlorë. Bashkim Gazidede, Adem Copani, Agim Shehu.

Komanda e operacionit në drejtimin ndihmës Permet - Gjirokastrë - Delvinë - Sarandë. Safet Zhuliali, Bujar Rama, Hysen Arapi, Gjergj Vladi, Ali Koçeku.

Forcat pjesëmarrëse në drejtimin ndihmës

BrK Kavajë me 2 bk

Br 127K. me 2bk.

BrK/....?

Br ATGerdec me 3 bAT.

.....

Br xhenjere

Br Tankeve Gjirokastrë

Br AT. Fushë Krujë

Br Tankeve në Vorë

Distrikti detar Durrës e Shengjin

Regjimenti I Aviacionit ...?

Të gjitha forcat e komisariatëve e SHIK-ut në rrethet Vlorë, Gjirokastrë, Permet, Tepelenë, Delvinë e Sarandë

Numri total I forcave arrin të 25 mijë vetat, pa llogaritur këtu forcat nga ithtarët e PD-së dhe Këshillave të gjendjës së jashtëakonshme

Faza e parë e operacionit ,nga 01 -10.03. parashikonte. Pergatitjen, mobilizimin dhe përqëndrimi I tyre në bazat e nisjës. Pastrimi I zonave të rebeleve nga personat drejtues të tyre, kryesisht nëpërmjet përpunimit të këtyre drejtimeve me aviacion LHL, Artileri.

Faza e dytë,- 10-30.03.1997. Levizja e forcave në drejtim të qytetëve dhe vendosja e pushtetit ushtarak në këto zona.

Kapitulli 8

PLANI I OPERACIONIT ESHTË I PAMOHUESHËM

Do të ishte tëpër I veshtirë mohimi I egzistencës I një plani të tillë. Nuk janë ngjarjet reale të jetuara dhe dokumentat e mbetura pa u asgjësuar nga braktisja e zyrave nëpër institucionet e larta të shtetit për të shpëtuar kokën, që e vertetojnë atë, por paraelisht dhe vet ata, protagonistët e egzekutimit të këtij plani. Sabit Brokaj nga roli I ministrit të Mbrojtjes demonstroi në parlament disa muaj më vonë harta të sakta dhe dokumenta të plota që faktojnë këtë plan Nga ana tjetër, gjatë

muajit gusht 1997, por edhe para e pas tij medja shqiptare , madje televizioni shtetëror dhe shtypi I pavarur u lë shumë vend këtij lloji protagonistësh të ngjarjeve të marsit të 1997, Këta protagonist e shfrytëzojnë momentin, e para për të fituar të drejtën e qytetarisë dhe së dyti të dalin të larë madje dhe patriotë. Mirëpo në përpjekjen kolosale që bëjnë për të mohuar këtë plan lufte, bëjnë pohime që edhe një herë e vertetojnë egzistencën e planit të dështuar. Shpesh herë gazetarë të devotshëm ose me lidhje të ndryshme me këta protagonist gjejnë mundësinë për t'u sherbyer edhe një herë tjetër. Njëkohësisht në këto publikime vet ata njërëzit e lartë të të ish shtetit ,nxjerrin edhe një herë në pahë shpërberjen dhe kaosin që mbizotëroi në drejtimin e njësisë më të disiplinuar të shtetit,- ushtrisë.

MOBILIZIMI I FORCAVE NGA VERIU

Gazeta “Koha Jonë” e datës 30 maj 1997 në faqën e dytë sjellë deshmi të mënyrës së mobilizimit dhe dërgimit të veriorëve në drejtim të Jugut. Këto fakte të papërgënjeshtuara edhe një herë tregojnë mashtrimin e madh të pushtetarëve të atëhershme ndaj popullsisë së Veriut , së cilës iu bë thirrje «të mobilizohej dhe të armatosej për t'u mbrojtur nga banditët e jugut»

Gazeta I referohet tregimit të një të rekrutuarit nga Laci dhe njëkohësisht boton një thirrje nën armë e tipit KUSHTRIMI LUFTARAK me Nr 178 dt 02.03 1997 që e riprodhojmë

Rruga që ndiqej për mobilizimin e njerëzve, ishte:

a. vullnetarë, b. të mashtruar nga premtimi për punë pas “fitores”, c. me detyrim , me anë të Fletë Thirrjes në formën e “kushtrimit luftarak”, ku të rekruarve u lëxohej një nen I ligjit të gjendjes së jashtakonshme për denim me vdekje në rast mosparaqitjeje.

Organizimi bëhej nga policia . Pastaj me furgon e të veshur civilë dergoheshin në Tiranë, godina e SHIK-ut, tek Shkolla e Bashkuar për të marrë armatimin,- një automatik + 200 fishekë dhe rroba ushtarake. Pas armatosjes niseshin drejt e tek zonat e përcaktuara. Miratimin e për ata që mobilizoheshin e jipte Shefi I Policisë Kriminale të rrethit. Në këtë mënyrë, - shenon gazeta, duke iu referuar burimeve nga njëriëz të SHIK-ut, ishin dislokuar në Fier rreth 20 mijë veta . Pagesa e tyre bëhej pa bordero nga kryetarët analogë të PD-së. Të rekrutuarit ishin të moshave nga 17-18 vjec- 60 vjecarë.

Sipas raportit të parë të paraqitur në Parlamentin Shqiptar nga Komisioni Ngjela, 11.02.98 “ U thirren nën armë , vetëm njëriëz nga Veriu I vendit me qëllim për të krijuar një konflikt midis një pjese të popullsisë kundër pjesës tjetër”. Po në këtë raport paraprak Ngjela thotë se të “ paqarta ishin dhe fenomenet të tilla si dërgimi I forcave të Gardës së Republikës dhe të SHIK-ut për të shtypur revoltën e popullsisë së Jugut “

Fakt është se urdhëra të tilla morrën edhe komandantët e njësisive të rregullta ushtarake të Veriut, ashtu siç është e njohur dhe përgjigja e komandantit të divizionit të Shkodrës I cili duke iu referuar ligjit nuk pranoi të nxirrë forcat nga territori I divizionit “ vetëm në rast se sulmohet vendi nga armiku I jashtëm”.-tha ai

SHIK-u, USHTRIA DHE VERIORET - LEMSHI I PERMETIT

Bujar Rama: « Operacioni deshtoi pa I nisur» .Kush e ka fajin !?

Për egzistencën e “veriorëve” në Jug të vendit flasin në mënyrë të përsëritur në intervista të ndryshme gjeneral Bujar Rama, ish nën kryetar I SHIK-ut, vet ish ministri Zhulali, apo dhe ish Shefi I Shtabit të Pergjithshëm të Ushtrisë ,Adem Copani.

Po citojmë Gjeneral Bujar Ramën I cili vajti I pari në Permet në ditën e tretë të marsit, ku më vonë , deri më datën 8 mars, një ditë para masakrës së Permetit dislokohen aty forca të shumta të

SHIK -ut dhe të ushtrisë dhe drejtuesit e tyre akuzojnë njëri tjetrin për provokimin e situatës në Permet

“.... urdhri,- thotë Rama,- ishte marrë që të neutralizoheshin rebelet e Tepelenës . Duke parë që ishte e vështirë nga drejtimi I Memaliajt, u mendua që forcat të përqëndroheshin në krahun e Permetit_Por në këto caste unë nuk di asgjë mbi planet e operacionit.,thotë B. Rama në intervistën e dhenë Gazetës “JAVA të Gjirokastrës ,gusht 1997. Mirëpo në një intervistë të tij të mëparshme ne gazetën Republika më 17 gusht 1997, gjeneral Rama bën fjalë edhe për shkaqet përse deshtoi operacioni ushtarak kundër Jugut. “Operacioni dështoi në çastin sa nisi,- thotë Rama. Për mendimin tim , -vazhdon,- shkaku I disfatës duhet kërkuar në faktin se në krye të ushtarakëve nuk kishte njëri të aftë profesionalisht”.

Sipas tij, ai shkoi në Permet pas urdhrin të Sali Berishës .Berisha I kishte thenë se «në qytetin e Permetit mund të venë rebelë nga qyteti I Tepelenës, të cilët kanë bërë djegje në qytetin e Gjirokastrës dhe mund të djegin qytetin e Permetit . I thashë, tregon Rama, vetëm “si urdhëron” dhe me dy helikopterë dhe me 10 veta kryesisht veriorë u nisa për në qytetin e Permetit». Dhe vazhdon në Intervistën dhenë tek Java: -” Por shoh që aty vijnë edhe persona të tjerë siç ishte Sokol Mulosmani që kishte marrë detyrën për të shkuar në drejtim të Gjirokastrës_Këto ishin disa forca veriore, afersisht ishin rreth 300 veta, të cilët kishin dalë vullnetarë për të ardhur këtu, sigurisht në përputhje me ligjin që nxorri parlamenti sepse I jepte kompetencë Komandantit të operacionit për ta bërë një gjë të tillë. Dhe sigurisht komandanti I operacionit e kishte parë të arsyeshme që t’i dërgonte këto forca.”

Ndërsa refimi I tij në gazetën Java vijon: “Ajo që ka qënë e çuditshme dhe që e kam ngritur edhe një herë, ka qënë ardhja një ditë para se të ndodhte ngjarja,(bëhet fjalë për masakrën e Përmëtit më 09.03.97) e një kompanie do të thoshja unë që pjesa dërmuese ishin me një biografi që nuk dihej se nga vinin . Ajo më ka shqëtësuar 24 orë para se të mirrja vendimin se duhej një zgjidhje tjetër.....dëgjoj bresheri armësh në repart. Më thanë që është një kompani që ka ardhur prej Tiranës. Thërras dy drejtuesit e tyre . Ata më thanë se nuk e komandojmë dot atë repart Një pjesë e tyre janë jashtë rregullave ushtarakë”

Më vonë gjenerasl Rama , edhe pse po sipas tij kishte në varësi 10 veriorë, na tregon se si e rrethoi këtë kompani dhe e nxorri 15 km jasht Permetit. Në një moment tjetër na tregon se në qytet kishte edhe një brigadë komando”që unë nuk kam pasur asnjë lidhje më të se ishte në linjën e ushtrisë”....(!?)

Në intervistën, dhenë gazetës “Republika” 17.08.97 gjeneral Rama thotë se përvec kësaj kompanie të ardhur nga Tirana që ai e rrethoi me dhjetë veta, u dha bukë dhe I nxorri , e përseris , në këtë intervist, 5 km larg qytetit ”kishte rreth 500 forca veriorë dhe nje ushtri tjetër pa dijeninë time, një komando ishte në repartin ushtarak të Permetit”.

Në intervisten e Javës, gjeneral Rama thotë se të gjitha forcat e tjera ishin nën komandën e tij, pavarësisht se vet pretendon se Berisha e dergoi atje me dhjetë veta për të venë rregullin. Po ashtu në varësi të tij, thote tek gazeta Java, ishin edhe forcat e Mulosmanit që prisnin në Kelcyrë. Në intervistën tek Republika thotë se “Nuk e di ç’bëri Mulosmani pavarësisht se nuk kishte marrë detyrë që të ishte në varesinë time”.

Pra sipas Ramës çdo peshtjellim në Permet e shkaktuan forcat ushtarake të cilat edhe I kishte edhe s’i kishte nën komandën e tij

Nga ana e vet, A Copani, në intervistën dhenë gazetës “Koha Jonë”,datë 14 gusht 1997,Akuzon SHIK-un për veprime të fshehta “...në zonën e Permetit ishin futur fshehurazi edhe forca të SHIK-ut për të cilat Shtabi I Përgjithshëm nuk kishte marrë asnjë njoftim.»-thotë ai.

Ndërkohë, vazhdon ish Shefi I Përgjithshëm I Ushtrisë, «më njofton në radio komandanti I repartit Komando, se tek ata kishte qënë Zhuliali dhe sapo ishte larguar»(08.03) dhe se «forcat e SHIK-ut kishin kryer veprime rrugaçerie në qytet, duke irrituar popullin dhe tensionuar situatën në qytet» Zhuliali kërkoi nga brigada e komandos që të luftonin pasi ishte I tradhëtuar nga oficerët e lartë të Shtabit të Përgjithshëm, por shumë oficerë të brigadës komando kundërshtuan , ndërsa gjeneral Rama që drejtonte forcat e SHIKU-t nuk iu pergjigji fare kërkesës së Zhulialit për takim pasi , sipas Ramës,më dorëheqjën e qëverisë, Shqipëria nuk kishte ministër Mbrojtjeje (Sipas Bujar Ramës, Zhuliali u largua vetëm disa minuata para se të shpërthente konflikti në Permet)

NEN ARME NJEREZIT E PD-së

Lë të shikojmë një aspekt tjetër të planit të luftës kundër Jugut, atë të armatosjës së njërvëzë të PD-së dhe rolit që duhet të kryenin SHIK-u, forcat e rendit dhe ithtarët e flaktë të PD-së .

Spartak Ngjela në emer të Komisionit Parlamentar që ai drejton do të deklarojë në Parlament më 11.02. 1998 ,pa përmendur emra se “ është shpërndarë armatim sipas preferencave politike” . Mirëpo kohë më parë, një nga krerët ambiciozë të PD-së , Bashkim Koplaku, kishte deklaruar në gazetën “Intervista” se “ urdhërin për armatosjen e PD-së e dha Berisha në prani të 100 deputetëve”

Në çantën e Ali Koçekut të zenë peng ditën e deshtimit të operacionit të desantimit të trupave qeveritarë në Gjirokastrë, u gjend gjithashtu një informacioni i shefit të K/zbulimit të repartit 7700 t ,mbi menyrën e shpërndarjes së armëve në garnizonin e Kavajës me datën 02.03.Eshtë dita që fillon armatosja e njërvëzë të PD-së dhe fillimi I përhapjes së semundjës së hapjes dhe bastisjes së depove ushtarake.

Në informacionin që mban datën 03.03 1997 nën siglën sekret të kopjës së dytë thuhet se «Rreth orës 14.00 të datës 02.03.1997 ka ardhur në garnizonin e Kavajës Kryetari I Keshillit të rrethit të Kavajës z. Ibrahim Mullaliu I cili ka takuar komandantin e batalionit, kapiten Dilaver Bishtaja. Z. Mullaliu I ka kërkuar atij, që në repart të vijë qytetarë të Kavajës dhe të pajisen me armatim e municion, për të mbrojtur qytetin e Kavajës nga forcat kriminale që janë nisur të vijë nga Vlora.Për këtë problem kryetari I rrethit ka thenë që «kam biseduar dhe me zotërinjtë Halit Shamata e Safet Zhuliali” Pasi z Bishtaja nuk ka pranuar të zbatojë urdherin , po sipas këtij informacioni, “rreth orës 16. 30 dt. 02.03, kanë ardhur para postblokut të repartit rreth 200 qytetarë të revoltuar që kërkonin të hynin me forcë në repart për të marrë armë dhe municion. Në orën 17.10 kanë ardhur në repart Kryetari I Këshillit të Rrethit, Shefi I Komisarariatit dhe Kryetari I Degës së SHIK-ut Kavajë, të cilët kanë kërkuar lejjimin e qytetarëve për të marrë armë e municion “ Pas kundërshtimit të përseritur të komandantit të batalionit. cdo gjë e zgjidh celulari I Zhulialit. Sipas Informacionit “. Safet Zhuliali ka urdheruar lejjimin e armatimit të qytetarëve të Kavajës me list të rregullt” «Por rregulli u mbajt, po sipas informacionit deri tek numri 28. Pas kesaj çdo gjë është lenë në mëshirë të fatit dhe bastisja e depove të batalionit kavazhduar deri në orën 23.00»

Gazeta Shqiptare e datës 12.04.98 faqe 12 boton faksimile nga urdhera e firmosura nga A. Copani dhe Leonard Demi për armatosjen e strukturave të SHIK-ut nga bazat e ushtrisë dhe që mbajnë datën 02.03.1997. Sipas gazetës armatosja ka zgjatur nga data 02-13.03.97 dhe strukturat e SHIK-ut morën mbi 15 topa 75 mm, rreth 7000 automatikë dhe mbi 12 000 pushkë 7.62mm. Një arsenal I terë armësh si mitroloza të lehtë, granada dore, transportues të blinduar kanë kaluar në duar të ministrisë së Brendshme. E keqja është se , sipas deputetit socialist S. Braho, nuk I dihet adresa këtij armatimi.

Të merkurën më 05.03 Shtabi I Gjendjës së Jashtëakonshme në Gjirokastër organizon lista me anëtarë të PD-së për armatosje. Armatosja u bë nga depot e divizionit në Gerhot. Komandanti I divizionit, Dilaver Laci, I përkiste linës radikale të Sali Berishës. Ai se bashku me drejtues të tjerë në rreth, shefa të komisariatit që ndërroreshin shpesh dhe pothuaj nga Veriu, me prokurorin e rrethit, kryetarin e SHIK-ut dhe prefektin Gjyrezi, para Th Merkurit, që të tërë nga Veriu, kishin bërë një klikë në Gjirokastër me linjë të përbashkët veprimtarinë në doganën e Kakavijës.

Në fillim pra, shenimet për armatosjen e njërezve I jipte vet prefekti Thanas Merkuri pas konsultimeve me krerët e PD-së dhe zbatoheshin po në linjën e PD-së. Ndërsa me vonë vendimin se kush do të armatosej e jipte drejtpersedrejt kryetari I SHIK-ut.

Më 06.03, e njëjta situatë u përserit në Permet. Burime të ndryshme thonë se në atë mbledhje që u fol dhe u vendos për armatosjen e ithtarëve të PD-së ishte I pranishëm edhe ish deputeti I PD-së dhe këshilltar I Sali Berishës, Genc Pollo. Nuk ka diskutim se në mbledhjet e Këshillit të Gjendjës së Jashtëakonshme të Përmetit ishte edhe gjeneral Bujar Rama.

Të njëjtën skenë do të tentojë të perseris në Kolonjë deputeti tjetër I PD-së Uran Butka një ditë me vonë. (rrethimi I tij në godinën e bashkisë, ngjalli panik tek Bujar Rama që nga frika se mos bllokohej dhe rrugëdalja tjetër nga Permeti kërkoi që të tërhiqeshin forcat nga Permeti)

Po më datën 04.03 katër helikopterë, sipas shtypit të kohës, ngarkojnë “nën kujdesin” e z. Blerim Cela, armatime të ndryshme për t’i sjellë nga Tirana në zonën e Lekëdushit për të armatosur atje ithtarët e PD-së. Helikopteri I parë që mbriti atje mori përgjigjë negative nga banorët e atjeshëm dhe u detyrua të kthehet për vete dhe të kthejë dhe të helikopterët e tjerë për në Tirnaë.

PJESEMARRJA E AVIACIONIT NE OPERACION

Përsa I përket pjesëmarrjës së aviacionit në këtë operacion, shenojmë se nga 90 urdhëra të regjistruara në ministrinë e Mbrojtjës në datat 03 -04 mars rezulton se afërsisht një e treta e tyre lidhen me fluturime dhe levizje të aviacionit nga Kuçova, Rinasi, Gjandri, Farka, etj mbi Jugun e Shqipërisë. Mbi 10 janë urdhërat që të hapej zjarr ose drejtpërdrejt mbi “rebelët” ose mbi shpate malesh për t’i trembur ata. Urdhërat në shumicën e rastëve nisin nga Shefi I Shtabit të Përgjithshëm, shpesh me telefon, nga ministri I Mbrojtjës, por edhe nga Ministria e Rendit. Të po kësaj date, 04.03, janë dhe njoftimet për largimin e dy pilotëve mëgjithë aeroplanët luftarakë për në Brindizi

Më datën 02.03, dhe në orën 14.05 ish Ministri I Mbrojtjës Safet Zhuliali jep urdher të bombardohet Ura e Mifolit në Vlorë. Pësë minuta më vonë Shefi I Shtabit të Përgjithshëm SHEME Kosova jep dorëheqjen. Deputeti I PS-së, Spartak Braho, në ditën e refimit të Ngjelës, më 11.02.98, deklaroi se sipas dokumentave plani I bombardimeve për Jugun kishte si objektiv tre pika, Urën e Mifolit, atë të Rogozhinës dhe burgun e Bëncës. Në të njëjtën seance plenare të Parlamentit flitet dhe për urdhëra «për përdorimin në masë të LHL-ve».

E ndërsa kjo është një fakt I pamohueshëm, zëvendësuesi I Kosovës me urdhër të Berishës, A Copani, deklaron në gazetën «Koha Jonë», 15.08.97, katër ditë pas publikimit në shtyp të urdhërit për bombardimin e Urës së Mifolit se “në Shtabin e Përgjithshëm janë hedhur poshtë kategorikisht propozimet për të hedhur në erë objekte si Ura e Mifolit në Vlorë”.

Gazeta Shqiptare boton më datë 04.03.1998, një faximile tjetër të urdhërit nr 4 dt.03.03.1997 për «Për përgatitje për shkatërrime urash», dhe bëhet fjalë për shkatërrimin e urës hekurudhore në Qafën e Sokolit në Rogozhinë dhe të urave të tjerë mbi lumin Shkumbin. Urdhëri firmoset po nga Adem Copani, por nuk dihen arsyet pse nuk u zbatua

Vetë Copani në të njëjtën intervistë , në gazetën «Koha Jonë» edhe pse pranon lëvizjen e aeroplanëve dhe përdorimi i zjarrit nga ata, thekson se “ vetëm Presidenti ka të drejtë, në bazë të ligjit, të urdhërojë, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, për lëvizjen e dislokimit dhe përdorimin e Forcave të Armatosura” Mëgjithatë ne po përcjellim më poshtë disa nga moria e urdhërave të atyre ditëve të pa dhenë nga ish presidenti i vendit.

Datë 03.03.1997

ora 07 20

SH.SH.P urdhëron që një çift avionësh të fluturojnë ulët mbi Fier dhe Vlorë.

ora 11 11

Me telefon SH.SH.P urdhëron Gj.M.A.B që të ngrihet një çift avionësh me armatim dhe të kontrollojë rrugën Bençë - Tepelenë - Permet dhe të hap zjarr nëpër terrenin e rrugëkalimit.

ora 11 40

SH SH P urdhëron që për përdorimin e helikopterëve të Farkës të bashkëveprohet me oficerin e SHIK-ut kol Bujar Rama...

ora 20 30

Kol P.D raporton tek Gj.M.A.B. se avioni u ul në rregull dhe nga të dhenat e pilotit rezulton se në Jug të Levanit, Babicë, Kuzbaba e Kaninë është qëlluar avioni nga toka me bresheri 8-9 fishkë gjurmëlenës, kurse në zonën Dukat, Pashaliman, Babicë është qëlluar nga toka me një municion jo më ngjyrë të kuqe. Në zonën e Himarës, Sarandës ,Gjirokastrës e Tepelenës nuk ka zbuluar gjë.

Datë 04.03.1997

ora 10 55

Në telefonë SH SH P urdhëron Gj.M.A.B që të ngrihet një avion (çift), të fluturojë mbi rajonin e Delvinës dhe të hap zjarr paralajmërues. Në konsult edhe me Gj.Br Y.D dhe kol S.Gj u vendos që të ngrihet çifti roje I BMA Kuçovë në rrugëkalimin Kuçovë-Delvinë dhe në kodrat përreth të hapi zjarr me top

ora 11 26

Kol. S.Gj, I raporton Gj.M.A.B se dy avionë “Mig-19” të BMA Kuçovë kryen detyrën mbi Delvinë, bënë tre qitje me top në shpatin e malit të Delvinës.

ora 13 44

Gj.M.A.B, në konsult me kol P.D dhe kol, S.Gj vendosi që të ngrihet, (pas urdhërit me telefon katër minuta më parë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm) avioni luftarak “ Mig -19” dhe të godasë me zjarr autokolonën në rrugën Tepelenë - Vlorë, në rajonin e Arzës . Të demtohet makina e fillimit dhe e mbarimit. Goditja të bëhet me raketa ajër-tokë. (gjashtë minuta me vonë Shefi I Shtabit të Përgjithshëm urdhëron me telefon për një goditje të dytë me raketa ajër - tokë në fshatin Turhan)

ora 18 00

M M urdhëron një avion që është në Jug të kalojë urën e Memaliajt dhe të bëjë mitralim paralajmërues mbi urë

ora 19 50

Gj.M.A.B në konsult me kol. S.Gj. dhe Gj.Br.Y.D vendosi të ngrihet avioni me pilot kol A.M, të bëjë 2-3 kalime mbi burgun e Bençës dhe të hap zjarr në afërsi të rajonit

Po ashtu ish Shefi I Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Adem Copani, I pyetur ,në gazetën “Koha Jonë” të datës 15 gusht 1997për egzistencën e një plani të Flotës Detare për të sulmuar Vlorën , do të deklarojë: “ Në fakt , ne kemi planifikuar të dërgonim anije në Sarandë për të tërhequr prej andej dy mjete detare që kishin mbetur.Për këtë veprim ramë në kontakt edhe me

organet publike në qytet. Por me keqësimin e gjendjës atje , si dhe me sulmin e armatosur të përseritur të bandave të pidentifikuara kundër bazës detare, plani nuk u realizua”

Sipas Ministrit të Mbrojtjes, S. Brokaj dhe hartës së demonstruar në parlamentit shqiptar po gjatë muajit gusht, vertetohet egzistenca e një plani të studjuar të sulmit nga deti në Sarandë me qëllim mbylljen e rrethit të hekurt në drejtim të Vlorës

ROLI I RI I KOMPONENTEVE TE DHUNES NE KUSHTET EKRIJUARA

Lë ta shikojmë problemin edhe në aspektin e rolit që morën në ditët e para të marsit forcat e SHIK-ut , Rendit dhe Ushtrisë. Një nga drejtuesit e komisariatit te Gjirokastrës G. Shehu, tregon për këtë: “Gjeneral Hysen Arapi pasi u kthye me turp nga Delvina qendroi këtu në Gjirokastër. Gjeneral Arapi qendroi edhe në komisariat edhe në divizion dhe ishte koordinues I veprimeve midis ministrisë së brendshme dhe jepte edhe informacione për situatën në Jugkomunikimi me gjeneral Agim Shehun , ishte pjesa e nënujshëm e ajsbergut. Qëndrimi I tij thuajse në ilegalitet, duke parë edhe gjendjën e ngjarjeve, na shqëtësonte..... Shkrirja e ministrive, -vazhdon zoti Shehu sollën faktin e daljës si kërpudhat pas shiut të punonjësve të SHIK-ut. Marrja e komandës prej tyre(në komisariatin e Gjirokastrës, shen yni P B) të cilat u thelluan shpejt deri në konfrontim të hapur . Në një nga këto ditë, gjeneral Arapi, kërkoi riorganizimin e forcave të policisë e të SHIK-ut duke deklaruar se forcat (e ministrisë për përforcime në Jug për rimarrjen e vetës dhe fillimin e një operacioni në shkallë të gjerë,- deklaratë po e zG. Shehut) janë nisur dhe situata do të rivendoset shumë shpejt”....Kjo deklaratë e gjeneral Arapit u bë pak orë para desantimit të trupave në Gjirokastër që verteton megjithatë logjikën e përshkruar të planit të luftës kundër Jugut

Kapitull 9

BERISHA HUMBET NJE NGA NJE BETEJAT NE JUG

Zgjedhjen e vet si president I vendit Berisha do ta shfrytëzojë si një pikënisje të re për të reaguuar, si një injeksion në trupin e drobitur të shtetit. Dendësia e lëvizjeve politike në ditët e para të Marsit nga ana e Berishës , përbënin një përprjekje të stërmunduar për të sfiduar situatën e krijuar rreth vetës. Duket qartë se Berisha akoma e shikon realitetin jashtë vetës me sytë e forcës së pushtetit të vet qoftë edhe të para disa muajve dhe me sytë e një rëzve të oborrit të vet të cilët shikonin mundësinë e shpëtimit të lekurës së tyre tek qëndresa e Berishës. Kjo, nga ana tjetër flet se Berisha akoma vazhdon të veprojë në bazë të recetave të këshilltarëve të vet që për interesa nga më të ndryshme e kërkonin atë në pushtet. Kuptohet nuk flitet këtu për keshilltarë të brendshëm. Fakt është që Berisha edhe në këto momente, fundore për të, kërkon të marrë iniciativën dhe të imponojë zgjidhjet e veta. Kjo ndodhi për faktin se opozita e shikon gjendjën e jashtëakoshme e shoqëruar, (dhe kjo është e vertetë) me një represion të egër në prapaskenë kundër saj, si një masë që e nxorri atë krejt jashtë loje. Udhëheqësit e opozitës në përgjithësi u shndëruan nga një masë e madhe, në individ anonimë që kërkonin të shpëtonin kokën . Berisha që vazhdimish kishte bërë titur , se ishte opozita që organizonte dhe nxiste revoltën, me qëllim mposhtjen e saj në të gjitha drejtimet, duket se kishte besuar me sa duket idetë e propagandës së vet dhe priste që pas kësaj ta kishte të lehtë të zhdukte dhe rebelet e nxitur, sipas tij, nga opozita. Ai nuk e kish plotësisht të qartë se populli kishte dalë në një rol të vetin politik. Dallimi është që ai, populli, nuk pretendonte pushtetin por shkatërrimin e një pushteti të ndërtuar keq dhe me sens kundër tij.

Në këtë logjikë medja zyrtare flet për veprime “të shtetit” në zbatim të gjendjës së jashtëakonshme. P.sh flet për arrëstimin e disa personave në Lushnjë që transportonin me një makinë armë, për shoqërimin në policinë e Tiranës të 38 personave, që kishin shkelur ndalim qarkullimi , se në një kanal afër komisarariatit në Vlorë u gjendën disa mitralozë te lehtë etj Nga ana tjetër “ shteti” , edhe pse kërkon të nxjerrë në pahë një fytyrë respektimi të armëpushimit, jep urdhëra dhe sposton drejt Jugut ushtri me synime tëpër të përcaktuara, - rëzimin e lirisë në Vlorë.

DELVINA I JEP MESIMIN E PARE

Në bazë të planit të luftës kundër Jugut, rrethi për të mbytur Vlorën do të fillonte të mbyllej nga drejtimi Permet Gjirokastër Delvinë Sarandë Deti Jonë dhe nga ana tjetër Permet Tepelenë Fier. Eshtë kjo arsyeja që pas përpunimit me aviacion të Delvinës me datë 04.03, vihet re kalimi I forcave të Akademisë së Rendit , nën drejtimin e gjeneral Hysen Arapit, nga Permeti në Gjirokastër me drejtim Delvinën. Pësë makina ushtarake me student të akademisë së rendit, ikin nga divizioni I Gjirokastrës në orët e para të mëgjësit të datës 05.03 për në Delvinë.Më të arritur në të hyrë të Delvinës nga ana e Stiarit hapen në pozicion luftimi. Kjo gjë shkakton reagimin e ashpër të popullit të revoltuar të Sarandës e të Delvinës. Forcat e Hysen Arapit detyrohen të dorëzohen dhe kërkojnë kohë që të largohen pa u prekur nga forcat e popullit dhe kështu ndodhi. Studentët e Akademisë së Rendit qanë më lotë kurthin që u kishin përgatitur. Ata nuk pranuan të luftonin.

Sulmi I Akademisë së Rendit mbi Delvinë ishte shoqëruar me goditje aviacioni me bomba napalmi që u hodhen ne shpatin e malit të Delvinës dhe të Muzinës. Po ashtu urdhëri ishte që të goditeshin me avion tanket në rajonin Finiqit dhe të Vllahatit. Këto urdhëra jipeshin në një kohë që kishte filluar dhe kundërreagimi I pilotëve sidomos në rajonin e Kuçovës. Avionët u goditën me armë zjarri nga kryengritësit. Një ditë më parë me 04.03, dy pilotë Arian Elezi dhe Agron Daci me një avion luftarak MIG, nuk zbatojnë urdherin për të qëlluar mbi popull dhe ulën në Brindizi të Italisë bashkë me topin e tij 23 m/m dhe 80 predha .

Po më datë 05.03.97 në bazën e Kuçovës aviatorët nuk duan të ngrihen më në fluturim . Kanë informacione se nga vet ata po vriten një rëz të pafajshëm dhe kërkojnë për sqarim zv/ministrin Alfred Moisiun .Por as vajtja e tij nuk I bind pilotet të ngrihen në ajër . Nga Kuçova I propozohet Sekretarit të Shtetit për Punë të Mbrojtjës L. Demit që të zbatohet ligji. L Demi urdheron që kush kundërshton të çohet në Tiranë.

Hysen Arapi kthehet I turpëruar në Gjirokastër. Delvioniotët hedhin në erë urën e parë mbi kthesën e Jergucatit me qëllim që t'u ndërpritët rruga forcave qeveritare për të riardhur në Delvinë. Në Gjirokastër u jipet urdhër tankëve që të patrullojnë rrugën nacionale. (Një tank rrezohet në kanal) dhe të ngrenë postbllqe, Një postbllok u vendos edhe në Jergucat.

Ndërsa forcat e e Akademisë së rendit largohen nga Gjirokastra, gjeneral Arapi do të qëndrojë në Gjirokastër për të koordinuar, sic e theksuam më lart, veprimet midis ministrisë së Brendshme, asaj të Mbrojtjës, SHIK-ut dhe forcave të ndodhura në Permet.

PERPJEKJE PER ORGANIZIMIN E KAOSIT NGA HEKURAT E LUFTES

Ndërkohë në Sarandë pas pesë ditë protestash nga më masivet për këtë qytet, formohet Shtabi Qytetar. Komandanti u zgjodh Xhevat Kocia, një gjeneral I liruar që punonte në filialin e

VEFES në Sarandë .Ishte ky hapi I parë për organizimin dhe drejtimin e kryengritjës popullore.Kjo lëvizje fiton këtu në Sarandë një bosht drejtimi. E theksojmë këtë pasi nga Vlora deri tani nuk vinte asnjë njoftim për një organizim kualitativ të revoltës popullore të shndëruar përfundimisht në një kryengritje. Në Vlorë egzistonin disa organizime paralele që bashkëvepronin nën trusninë e popullit por që akoma nuk e kishin fituar autoritetin e udhëheqjës së popullit e cila do të vinte disa ditë me vonë.

Në Sarandë pra, përveç udhëheqjës politike të revoltës popullore nga gjeneral Kocia u zgjodh dhe drejtuesi I rivendosjës së rendit. Ky ishte Fuat Karaliu. Edhe ky ishte një oficer I liruar . Zoti Karaliu disa ditë me vonë do të nxierr një qarkore prej 12 pikash . Ndër të tjerash përfshihej : - ndalimi I të shtënave me armë jarri në qytet, ndalimin e qarkullimit të makinave pa lejën e Shtabit Qytetar të Mbrojtjes. Urdhëron , gjithashtu të gjithë oficeret dhe ushtarët që gjenden në qytet të marrin në dorëzim repartet ushtarake të bastisura dhe të shkatërruara dhe të administrojnë armatimin e mbetur .

Qarkorja kuptohet doli atëherë kur gjithë populli ishte I armatosur, kur ishin në duart e njërezve dhe armatimi I rendë dhe tanket. Në duart e njëreëve kishin renë gjithashtu anijet luftarake të bazës së Sarandës dhe mbeteshin të ekspozuara depot e silureve. Shumë anije luftarake ishin mbytur ndërsa të tjerat kishin ikur në drejtim të paditur.Qitjet e vazhdueshme nga qindra grykë armësh natë e ditë përbenin një shqetësim serioz për shtimin e viktimave të pafajshme.

Në Vlorë gjithashtu ishte bastisur baza detare e Pasha Limanit. Këtu përvec rrezikut të shpërthimit të silurëve që mund ta hidhnin në erë Vlorën , krijohet një rrezik I ri. Nga anijet luftarake hidhej në det armatimi luftarak , ndërsa anijet përdorëshin për të përcjellë refugjatë në Itali. Ishte hapur serish loja e refugjatëve. Lodhja e stërgjatur , uria dhe plagët e shumta si dhe frika për të ardhmën I detyronte njërezit të largoheshin nga Vlora.

KRAHEMARRJA E DESHTUAR E TEPELENES

Në të njëjtën kohë që Delvina dhe Saranda smprapsën forcat e gjeneral Arapit, gjeneral Bujar Rama jo vetëm që organizon forcat në Permet por mundohet të manipulojë situatën në Tepelënë. Ai demonstroi forcë tek ura e Leklit , disa metra larg rrugës nacionale që t' u tregojë tepelenasve se ajo pjesë ishte domen I tij. Njëkohesisht ai lidhet me Shtabin Qytetar të Tepelënës. Atë e kryesonte Kryetari I Këshillit të rrethit dhe kryetar I PD-së Sotir Ceka dhe bënte pjesë edhe kryetari I PS-së Dashamir Kamberi, por edhe Gjolek Malaj dhe Robert Targaj, megjithse pa një rol në të. Edhe vet ky I loj Komiteti a Shtabi, kishte si synim të shpëtonte qytetin nga kaosi ku po zhytej. Egzistenca e tij megjithatë është e përkohshme . Përfaqësuesit e të dy partive nuk do t'i rezistojnë dot situatës që do të krijohet në ditët e ardhshme.Ata manifestojnë një ngathësi që nuk I përgjigjej situatave reale. Përveç kësaj deshira e mirë për bashkëpunim pengohet edhe nga interesat partiake. Kjo do të sjellë braktisjen e tyre nga masa e madhe e kryngritësve.

Pikërisht me këtë Komitet kërkonte të vendoste lidhje Rama, për “ riorganizimin nga vet ata të policisë dhe vendosjen e rendit” , - siç thotë në intervistat e dhena tek Republika dhe tek “Java”. qëllimi I këtij organizimi ishte të dorëzoheshin armet, të hapej ura e Memaliajt , të mos cenoheshin repartet e tjera luftarake,etj Për organizimin e punës për rivendosjen e rendit në Tepelënë Bujar Rama pretendon se u dërgoi këtyre komiteteve dy veta të ardhur nga Garda Presidenciale.(!!) Por më datë 06.03. në kohën që dy përfaqësuesit e këtij Komiteti do të shkonin të mirrnin kontakt me vet zotin Rama, siç tregon vet ai, ndodh vrasja e një të riu tepelenas nga një plumb në kokë.Po atë ditë vritet edhe një I ri tjetër nga pakujdesia. Ishin viktimat e para pas kaq kohë trazirash në qytet Ngjarjet I ndezen keq gjakrat në Tepelënë. Ata akuzuan SHIK-un se qëlloi mbi popullin me snajper

dhe I thanë gjeneral Ramës , gjithmonë sipas tij , se I kishte prerë në besë. Nga ana e vet gjeneral Bujar Rama flet për një ngjarje të kurdisur. “Papritur dy përfaqësuesit e tij, (shen yni) që kishin organizuar shtabin e Tepelenës dhe do të vinin në drejtim të Permetit , ndodhen përballë një bande maskash në agjensinë e Tepelenës dhe në çast një rrjet televiz grek ishte në pritje. Cdo gjë ishte llogaritur . Inskeniimi ishte I përlogaritur, thotë gjeneral Rama në intervistën dhenë gazetës “Rpublika” më 17.8.1997. Ndërsa në gazetën Java të po kësaj periudhe do të thotë “ dhe kjo nuk ishte një rastësi, as një diçka e papërseritur”.

Televizioni Shqiptar, duke iu referuar ATSH-së tha se njëri nga të dy tepelenasit e vrarë të asaj dite “ është vrarë aksidentalisht për shkak të nxitjes së një ekipi të huaj televiziv, para të cilit rebelet e armatosur pozonin duke shtirë me armë. Në vendin e ngjarjës , tha televizioni Shqiptar, ndodhej edhe gazetari I Dojce Ëelle-s “ Gazetari Ibrahim Kelmendi, për të cilin bëhet fjalë në TV shtetërore , në librin e tij pohon se ishte atë ditë në Tepelenë, por kur u vra I riu tepelenas me një plumb në kokë ai nuk kishte aritur akoma në qytet dhe kur u vra I dyti ai ndodhej brenda në ndërtesën e Këshillit të Rrethit.

E verteta është se po atë ditë Gjolek Malaj kishte arrestuar në Tepelenë tre oficerë të Gardes Presidenciale. Ata ishin Skëndër Kalemi, radisti ose ndërlihdësi Behar Trimi , dhe Adem Hasa. Snaiperi Flamur Haidini arriti t’i shpëtojë arrëstimit. Nënkolonel Hasa ishte komandanti I njësisë së sigurimit të Sali Berishës, Ky grup I përgatitur posacerisht dhe I pajisur me armatim special dhe radiomarrës kishin marrë urdher nga Agim Shehu për të hyrë në zonën e Tepelenës për veprimtari diversive. Kishte arritur aty nga rruga malore Patos-Berat, Kelcyrë Permet Tepelenë. Po drejt Tepelenës ishte nisur edhe një grup tjetër I drejtuar nga Asqeri Zeneli. Këta njërez mbetën të arrestuar të kryengritësve mbi 15 ditë dhe egzistojnë deponimet e tyre Nuk dihet vetëm si u liruan . Më tutje No Coment, për alibinë e njërezve të derguar të Ramës

KAROTA DHE KERBACI SIPAS KONCEPTIT TE BERISHES

Mëgjithatë ajo që ka rendësi në ngjarjet e këtyre ditëve ishte urdhëri I Berishës I cili sipas gjeneral Ramës thoshte që nga data 06-07 mars, ai, gjeneral Rama, të mos kryente asnjë veprim luftarak .Njëkohesisht po ato ditë mbrin në Permet një kompani tjetër nga Tirana me objektiv Gjirokastrën. “ Ish Presidenti Berisha,- thotë zoti Rama, dha urdher që dy ditë të rri pushim, pra të pezullohet çdo gjë.Por për çudi, vazhdon,- në këto çaste vjen dhe një kompani tjetër e komanduar nga ushtarakët. Erdhën nga Tirana dhe pretendonin se do të vinin në drejtim të Gjirokastrës”. Këto dy ditë sipas marrëveshjes së arritur më 6 mars I përkisnin armëpushimit.

Eshtë momenti që Berisha do të luaj me të dy kartat, dialogun në Tiranë dhe kërbacin në Jug. Janë ditë që shpejtësia maramendëse e levizjeve të Berishës për t’i paraprirë rrjedhës së ngjarjeve çvlerësohet para mënyrës se si lëviz populli.

Në Sarandë ishte shkatërruar si në Vlorë edhe baza ushtarake detare. Atje , pas dështimit të turpshëm të gjeneral Arapit për të futur Akademinë e Rendit në Delvinë, dështon edhe një përpjekje tjetër për të provokuar popullin kryengritës të Sarandës. Një oficer I SHIK-ut digjet I gjallë dhe një tjetër arrestohet dhe gjykohet në një gjyq publik, I diktuar nga parimet e xhunglës dhe të vetgjyqësisë por jo nga parime të shoqërisë civile.Ai iu nënshtrua torturave të çmedndura. Ndërsa një I tretë, shefi I krimeve të Vlorës në kohën e Mulosmanit arrin të humbas nëpër male

Po këtë ditë, kërkoj informacion për situatën në Sarandë pas këtij provokacioni të njërezve të SHIK-ut. Burimi im I informacionit, anëtar shtabi ndodhej në mbledhjen e tij. Ai nuk pranoi të më fliste vet por më tha, «degjo, po flet komandanti me Berishën» Afroi telefonin e vet celular pranë receptorit ku fliste me Berishën zoti Koçia. Berisha e kërcenonte hapur “se do t’i shtypte të gjithë si

mizat". Nga ana tjetër, z. Koçia me zë të përdhër të lartë I kërkonte "të hiqte forcat nga Jug , për të mënjeluar gjakderdhjen.". Ndërkohë Saranda po organizonte mbrojtjen e vet . Në duart e tyre kishin tani jo vetëm armatim të lehtë, por edhe armë të rënda, topa të kalibreve të ndryshme edhe një numër të konsiderueshëm tankesh.

Me përjashtim të Gjirokastrës dhe Permetit një situatë e njejtë mbreteronte dhe në, Delvinë ,Tepelenë e Vlorë. Njëkohësisht, edhe pse të pashprehura në meënyrë të unifikuar në trevat e kryengritësve ishte plazmuar përfundimisht një platformë e plotë politike. Kjo platformë përmbliidhej në tri pika kryesore, Dorëheqja e Berishës, krijimi I një qeverie teknike dhe zhvillimi I zgjedhjeve të reja. Ceshtja e parëve të humbura, edhe pse përbënin promotorin levizës të kryengritjës, kishte dalë në fakt në plan të dytë

PO PERGATITEJ TRADHETIA

Kërcenimi I Berishës tregonte hapur se e kishte seriozisht. Ai nuk hiqte dorë nga plani I Luftës kundër Jugut , dhe njëkohësisht, as nga sulmi eventual kundër Vlorës, kuptohet , pasi të kishte paralizuar Tepelenën dhe Sarandën.Logjika e sundimit të shtetit prej tij nuk e pranonte kurrsesi rrëzimin nga fronti.Megjithatë pafuqia e të gjitha mjetëve ushtarake dhe policore për të mposhtur Jugun dhe më e keqja braktisja që po I bënin strukturat e veta, po e dëtyronin Berishën të fitonte edhe ndonjë veti elastike.Berisha nuk kishte si të mos kuptonte tanimë, se edhe opozita, pavarësisht nga akuzat që I bënte, ishte e shkëputur nga Levizja Popullore.Ai kishte rastin për të shfrytëzuar dëshirën e opozitës për tu riingranuar në jetën politike shqiptare nga ku vet Berisha e kishte përjashtuar. Nga ana tjetër duke adaptuar propozimin e opozitës për dialog në këtë situatë krize, Berisha kthehej në drejtues I këtij dialogu dhe njëkohësisht krijonte rreth vetës mundësinë për të manipuluar Kryengritjen Popullore, ose në rastin më të keq ta armiqësonte atë me opozitën . Berisha ishte I sigurt në këto hapa. Ai e njihte shumë mirë opozitën Shqiptare e cila të gjitha veprimet e veta I bënte nën hijen e tij .

Situata në vend, veçanarisht në Jug nuk jipte asnjë fije shprese për dialog. Mirëpo logjikën e Berishës e favorizonte edhe fakti se në Tiranë egzistonte një klimë krejt tjetër nga ai I vatrës së kryengritjës . Vendosja e gjendjës së jashtakonshme e kishte paralizuar krejt jetën e kryeqytetit. Shumë nga politikanët, sidomoë të opozitës ose ishin strehuar, ose ishin larguar nga vendi ose bëhëshin gati të iknin nëpër ambasada të huaja, si veprin I fundit për të akuzuar regjimin e Berishës.

Intelektualët , skalioni I dytë I veprimit dhe mendimit politik në vend , gjetën kohë të radikalizoheshin në qendrimet e tyre për zgjidhjen e krizës së përgjithshme në vend. Egzistonte grupi që shikonte zgjidhjen e krizës me çmontimin e presidentit Berisha dhe strukturave të tij. Egzistonte grupi tjetër ai afër Berishës që mbrojtjen e tij e lidhnin me vetë sigurinë e tyre dhe të gjithë ç'kishin krijuar në kohën e Berishës. Ky grup me antikomunizmin e demonstruar mbliidhnin rreth vetës dhe disa intelektualë që me gjithë mend ishin antikomunist radikalë. Egzistonte dhe një grup tjetër ai I konformistëve pa principe të qarta . Ky grup intelektualësh duke folur në emer të paqës dhe të civilizimit e shikonin zgjidhjen e krizës dhe " shpëtimin e Shqipërisë" tek kompromisi politik midis klanit të Berishës dhe opozitës.Tek ky grup gjeti mbeshtetjen dhe grupi I njërzëve të Sali Berishës dhe që se bashku futën në kurthin e tij, kreret e opozitës shqiptare. Fakt është që asnjë nga këta grupe intelektualësh të Tiranës nuk kishin lidhje me Kryengritjen në Jug të vendit . E megjithatë, ndërsa kategoria e parë e intelektualëve të kryeqytetit, edhe pse nuk kishin lidhje me kryengritjen e Jugut e pranonin atë dhe e shikonin si një pikë mbeshtetje për të eliminuar Sali Berishën nga skena politike shqiptare si faktor përgjegjës për rrokullisjen e vendit në greminë, të tjerët edhe pse mund ta vlerësonin Kryengritjen Popullore si faktor determinant për zhvillimet e

fundit politike në vend , e përjashtonin këtë faktor nga skena e politikës zyrtare në Tiranë . Madje arrinin deri atje sa ta shikonin Sali Berishën si pikën e fundit ku mbahej në kembë shteti dhe ku do të mbeshet rishikimi i bazave të tij në të ardhmen . Transmetimi prej tyre tek Berisha i këtij mentaliteti, bashkë me faktorë të tjerë, e bëri atë që të mos marrë kurrë vendimin aq të përfolur për braktisjen e fronit dhe të vendit.

Në fakt , me disa korrigjime të vogla , kjo rrugë u ndoq dhe solli si pasojë zgjatjen tej çdo parashikimi të krizës, ose me sakt futi në qarkullim në perspektivën e shtetit konfliktin politik midis pozitës dhe opozitës, dikur me role të kundërta. Ky konflikt për momentin u shpreh me terrorizmin dhe krimin e organizuar e me vonë korupsionin, kontrabandën dhe mungesën e gadishmerisë dhe mundësisë për të rindertuar shtetin.

Mbasditën e datës 05.03, në orën 21 00, Berisha hapi derën e pasme të Presidencës për të hyrë në zyrën e tij “ kush të dojë nga opozita ”, siç iu shpreh ai mediatorit nga grupi i intelektualëve pranë tij,. Aty hyn Ceka, Zogaj, Meidani dhe Dokle, për t’u mbledhur të nësermën më 06.03 dhjetë parti politike. Në këtë akt, duket qart se Neritan Ceka është viktimë e frymës së intelektualëve të përmendur më lart. Ai duke përfutur nga autoriteti që kish fituar gjatë gjithë përpjekjeve të opozitës , sidomos në muajt e fundit, konsiderohej tani dhe si shef i opozitës. Kështu që me qëndrimin e vet mori në qafë dhe pjesën tjetër të opozitës, pasi i “futi në rresht të tijtë” për tek strofulla e Berishës. Në fakt këtë rrugë, të justifikuar më emrin e tolerancës, mirëkuptimit për të të shpëtuar Shqipërinë, opozita e shikonte si një mundësi, siç e thamë dhe më lartë, për të marrë rol real në jetën politike të vendit. Këtu fillon dhe tradhetia ndaj kryengritjes popullore dhe aspiratës së tij.

Opozita doli atë mbasdite të 06 marsit nga zyrat e Berishës e përçarë lidhur më ato që u vendosën. Takimi u quajt historik por një pjesë e pjesëmarrësve në takim doli me përshtypjen se ua kishte hedhur dhe sapo kapërcyen pragun e presidencës kërkonin t’i mbushnin mendjen pjesës tjetër se kishin renë në kurthin e Sali Berishës.

Në këtë takim partitë pjesëmarrëse kishin marrë përsipër t’u bënë thirrje palëve për ndërprerjen për 48 orë të veprimëve luftarake , ranë dakort të angazhoheshin në krahë të qeverisë për vendosjen e rendit dhe t’i hapej rrugë zgjidhjes politike të krizës në një takim të ardhshëm pas dy ditësh.

Fundi i takimit flet qart për një kurth të Berishës ndaj opozitës. Në takim pra, u ra dakort t’u behej thirrje palëve të ndërprisnin veprimet luftarake. Palë në konflikt ishin forcat e Berishës dhe populli.. Berisha ishte përfaqësuesi i palës së tij dhe po të donte i ndërpriste veprimet luftarake. Po opozita kë përfaqësonte. Askënd, veç vetën e saj. Mirëpo më këtë veprim ajo mori përsipër , direkt apo indirekt, rolin e udhëheqësit të palës kundërshtarë të Berishës, gjë që s’ ishte fare e vertetë. Vetë kërkesat e Kryengritjes Popullore ishin krejt të ndryshme më ato që opozita arriti me Berishën. Nga ana tjetër cila ishte qëveria që duhet të përkrahnin ata?

Po ashtu Berisha, edhe pse ra dakort që të ndërpriteshin veprimet luftarake , ai mobilizonte njerëz dhe i niste për në Jug. Pak më sipër ne cituam vetë gjeneral Bujar Ramën , si komandant i forcave që Berisha grumbollonte në Permet që thoshte se edhe pse Berisha i kishte dhenë urdhër të ndërpriste çdo veprim Luftarak, në Permet arriti dhe një kompani tjetër , e ardhur nga Tirana në drejtim të Gjirokastrës.. Po ashtu nga ana e vet gjeneral Arapi , i cili mbeti në Gjirokastrë në rolin e koordinuesit, po në këtë kohë kërkoi riorganizimin e forcave të policisë dhe të SHIK-ut duke deklaruar se forcat janë nisur nga Tirana dhe situata do të rivendoset shumë shpejt. Dhe fakt është që pas dy ditësh ato do të niseshin nga Permeti me helikopterë në drejtim të Gjirokastrës

KRYENGIRTESIT REAGOJNE POR NUK KUPTOJNE PSE NUK DEGJOHEN

Ndërkohë, takimi divergjoi shumë nga kërkesat politike të popullit kryengritës. Në këtë takim nuk u fol as për dorëheqjen e Berishës, as edhe për krijimin e një qeverie teknike, aq më keq për zgjedhje të parakohshme. Pra forcat politike po l hynin një rrugë që l binte erë tradhëtie, por pozitiv është fakti që partitë politike të opozitës nuk shprehnin atje popullin. Kjo bëri që në Hotel Rogner në Tiranë, vend ku zhvillohej një pjesë e konsiderueshme e politikës shqiptare, udhëheqësit e opozitës të përplasën më ata intelektualë që besonin se çdo kompromis me Berishën ishte tradhëti. Një reagim l tillë dhe pa qenë nën ndikimin e drejtpërsdrejtë të Berishës l bëri përfaqësuesit e opozitës te sapo dalë nga zyrat e Berishës ta konsideronin pa vlerë takimin. Kjo ndodhi madje pas disa orësh..

E verteta është se reagimi l Komitetëve të Shpëtimit Publik dhe shtabëve në Vlorë Tepelenë dhe Sarandë, ishte l ashpër ndaj rezultatëve të takimit të sipërpërmendur. Në komunikatën e Komitetit të Shpëtimit Publik të Sarandës, të lexuar dhe aprovuar nga mijrat e kryengritësve thuhej: “Nuk do të dorezohen armët deri në krijimin e një qeverie teknike, deri në nxjerrjen e një dekreti presidencial me të cilin do të caktohet data e zgjedhjeve të parakohshme, deri në dorëheqjen e vet Sali Berishës, dhe deri në dhenjen e amnistisë për të gjithë oficerët dhe ushtarët që braktisën ushtrinë”.

Edhe qëndrimi l Perendimit ishte l paqartë ndaj kësaj marrëveshjeje. Aty sa u përshendet filloi të shprehej pasiguri lidhur më të . l dukshëm në këtë drejtim që qëndrimi l amerikanëve,qëndrimi l prerë l të cilëve kundër Berishës para jo më shumë se dy javë ishte hedhur posht nga Këshilli l Ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian. Van Der Merlo Ministër l Jashtëm Hollandes, që përfaqësonte Bashkimin Evropian dhe Van der Linden që përfaqësonte Këshillin e Evropës të cilët arritën të nesërmën , më 07.03 , në Tiranë , biseduan më të gjitha palët për këtë problem por dukej qart se shpresat për respektimin e marrëveshje se një dite më parë , ishte thjesht një iluzion .Ata kuptohet nuk mundën të bisedonin me palën kryesore, popullin e armatosur.

Mëgjithatë kriza shqiptare ishte marrë tanimë seriozisht nga Komuniteti Ndërkombëtar gjë që do të thoshte se atë nuk mund ta zgjidhnin më shqiptarët midis tyre. Ish presidenti austriak Franz Vranicki, ishte caktuar si ndërmjetës ndërkombëtar (l OSBE-së) për zgjidhjen e krizës Shqiptare dhe një ditë më vonë ai pritej të vinte në Tiranë, në udhëtimin e tij të parë nga 9 që do të bënte gjithsej deri në hapjen e zyrave to OSBE-së në Shkodër dhe Gjirokastrë nga fundi l vitit 1997.

Dështimi l marrëveshjes l interesonte direkt opozitës , e cila, ishte e sigurt, se në rast se do të përpiquej për ta respektuar atë, do ta përkeqësonte më shumë situatën në lidhje me popullin. Hendeku midis tyre do të hapej në përmasa të pariparueshme. Nga ana e vet Berisha filloi të lekundej midis vendimit të pahequr nga tavolina për të shtypur Jugun, presionit ndërkombëtar për një zgjidhje politike shumë të dhimbshme për të dhe braktisjes së vendit.

Mëgjithatë Berisha nuk del nga karakteri l tij. Do t'i provojë deri në fund letrat që ka në dorë, sidomos planin për të shtypur me mjete ushtarake Jugun. Sidoqoftë as mundësia për t'u arratisur (pak ditë më vonë , më 12 mars gjithë familja e tij duke filluar me vjehrin e vjehren pajisen në mënyrë urgjente me pashaporta diplomatike) nuk përjashtohej.Lajme që vinin nga Tirana tregonin se një nga helikopterët e udhëheqjes ishte në gadishmeri të plotë në dispozicion të Berishës. l pyetur nga një gazetar spanjoll se a ka ndërmend të arratiset Berisha, komandanti l gardës Xhahid Xhaferi do të përgjigjet se jemi gati për çdo veprim. Cdo gjë varet nga zhvillimi l orëve që do të vijjë, Varianti l arratisjes deri dhe në detaje të tilla si dalja në një televizion të huaj për ta parë të ikur , me qëllim që të qetësohej populli, u serviren ato netë të veshtira në hollet e hotel Rognerit në Kryeqytet .Ky skenar, si edhe mundësia për të dhenë dorëheqjen janë vendime që Berisha tenton t'i marrë pasi deshton operacioni l dislokimit të trupave në Gjirokastrë , më 08.03

BERISHA HUMBET LUFTEN - KRYNGRITJA NUK FITON

Franz Vranicki I kërkon Berishës që të shtyj armëpushimin edhe 48 orë të tjera, (pasi kishte skaduar afati I marreveshjës së prishur të datës06.03) por Berisha hedh hapin e fundit drejt dështimit të plotë të operacionit ushtarak të gjendjës së jashteakonshme.

Në mëngjësën e datës 08.03, kërkohet nga pushteti lokal I Gjirokastrës që të përgatitet terreni për zbarkimin e forcave qëveritare. Qëllimi kryesor ishte që të dukej se këto forca vinin këtu më kërkësën e vet popullit të Gjirokastrës. E verteta është se pothuaj asnjë instancë e pushtetit lokal nuk pranoi të dërgonte një shkresë të tillë që kishte si iniciatorë këshilltarin e Berishës Fatos Bejën. Partitë politike në Gjirokastër reaguesh për një tentativë të tillë.Por ardhja e këtyre forcave ishte një vendim I marrë që kur Hyesen Arapi kishte kërkuar riorganizimin e komisarariatit të Gjirokastrës më rol primar SHIK-un. «Forcat janë nisur nga Tirana dhe situata do të rivendoset shumë shpejt» , -kishte thenë Arapi. Ndërkohë në Gjirokastër kishin ardhur në mëngjësën e po asaj dite gjenerali Gjergj Vladi nga Dibra, komandant I Divizionit të Tiranës dhe gjeneral Ali Koçeku nga Tropoja , komandant I Akademisë Ushtarake. Plani I veprimëve luftarake për Gjirokastrën ishte përpunuar, sipas një oficeri të liruar nga Gjirokastra, nga Agim Lala zëvendës drejtor I drejtorisë operative në Ministrinë e Brendshme, dhe nuk egziston më se u dogj.

Sipas këtij plani për forcat që do të zbarkonin në Gjirokastër do të kishte dy vendqëndrime , një në Arshilengo dhe një në Gërhót. Veprimet do t'i drejtonte komandanti I divizionit të pestë të këmbësisë në Gjirokastrës gjeneral Dilaver Laci Detyra e tyre ishte të hapnin rrugën në dy drejtime. Drejtimi I parë ishte ai nga Gjirokastra në Tepelenë-Memaliaj dhe të zinin Qafën e Poçemit , nga ku nisesh rruga e vjetër për në Vlorë. Drejtimi I dytë ishte nga Arshilengo për në Delvinë Sarandë. Kështu, duke qenë se në Fier kishte një dislokim tjetër të madh në trupa dhe mjete, do të krijohesh rrethimi I hekurt kundër Vlorës kundër së cilës ishte parashikuar përdorimi I të gjitha llojëve të armëve deri dhe në LHL.

Kapitulli 10

GJIROKASTRA KRIPA E KRYENGRITJES

Në Gjirokastër mbizotëronte atë ditë, 08.03, një shurdhëri vrastare, Të gjithë kishin drejtuar veshët nga Permeti nga ku arrinin lajme të frikshme dhe që kishin lidhje më forcat e shumta të dislokuara atje.

Ishte ora 13 45 ku nga gryka e Selckës, përballë Gjirokastrës u shfaqën dy helikopterët e parë, pas tyre edhe katër të tjerë.Në grupin e gazetarëve që ndodhesha filluan pyetjët e shumta se çmund të ishin. Ndërkohë pashë shumë njërez që zbrisnin për nga komisarati dhe për tek Ura e Lumit. U kuptua që ishin forca ushtarake. Situata tregonte se alergjia që kishin dhe në Gjirokastër për forcat e shtetit të Sali Berishës që e madhe. Helikopterët lanë ngarkesën e tyre, rreth 36 veta dhe u larguan. Në atë kohë në grupin tonë u afrua edhe një njëri tjetër që tha se ishin forca qëveritare që erdhën për të mbrojtur qytetin dhe minoritetin grek. Kërceva mënjëherë nga vendi. Një motivim I tillë kompromentonte keq minoritetin grek, aq më tepër që e dija se qëveria greke kishte bërë të pamundurën për ta mbajtur larg minoritetin nga «trazirat».Një veprim I tillë mund ta ndërlikonte shumë situatën në dem të minoritetit, I cili, akoma dhe në luftën e dytë botërore, zgjodhi

pikërisht rrugën e bashkëpunimit me popullin shqiptar kundër nazifashistëve. Nuk e kuptoja se kush ishte ai tani që donte t'i vinte minoritarët kundër shqiptarëve. Kush ishte ai që donte të konsiderohej minoriteti i përzgjedhur i S. Berishës.

I ka me vrap drejt turmës së njëzëve duke tërhequr pas vetës dhe njëzëz të tjetër për të kundërshtuar "forcat e Saliut", siç dëgjohej nga çdo anë. Unë tani kisha një arsye më shumë. Nëse s'idoqë të vinte puna nuk do të mund të akuzonte njëri minoritetin se kërkoi mbrojtjen e forcave të Saliut.

Para komisarariatit pash një kordon policesh të armatosur me automatik dhe gjerdan më karikatorë që kishin zenë gjithë hyrjen e komisarariatit. Dikush kishte dhenë urdhër që forcat të strehoheshin në komisarariat meqëse kalimi për në divizion ishte i pamundur. Ishte kjo arsyeja që i detyroi policët të dilnin aty dhe të bashkoheshin përfundimisht me popullin. Tek ura e lumit rreth 200 metra më posht, qëllohej me armë. Askush nuk e di se nga dolën ato armë, kuptohet të pakta në krahasim me grumbullin e njëzëve. Po ashtu ishte e pamundur të mendoje se do të dilnin kaq shumë gjirokastrë për të përballuar "forcat e Saliut". Nuk ishte thjeshtë çështje moshe. Ishin aty të gjithë Gjirokastritët e thjeshtë, pavarësisht se me ç'punë mirreshin dhe çfarë parti votonin. Nga e njëjta familje ishin disa vellezër se bashku pavarësisht se atje shkohej për luftë. E përseris aty ishin njëzëzit e thjeshtë të Gjirokastrës që nuk pranonin të përdhosej emri i qytetit të tyre. Ata ndoshta nuk e dinin por me veprimin e tyre nga njëra anë ndëronin qytetin e tyre dhe nga ana tjetër shkruanin paragrafët e fundit të diktaturës së Sali Berishës. Plani i Luftës kundër Jugut, në fakt, kundër Vlorës dështonte përfundimisht atje ku bësohej se do të korrite suksesin e tij. Gjirokastra, edhe pse nuk tregoi dinamizëm të nivelëve të Vlorës dhe të Sarandës në kryengritjen popullore, po shkruante pas grevës së urisë së studenteve, një faqe tjetër nderi në kontributin për rrezimin e Berishës. Ishte pikërisht zbrapsja e forcave shtetërore nga populli i Gjirokastrës që e detyroi Sali Berishën të pranojë humbjen dhe të kërkojë të nësermën, serish dialog, si mundësi e vetme që ai të vazhdonte të mbetej në lojën politike për të pritur ndoshta ndonjë ditë më të mirë.

Kur arrita tek ura dallova se midis ushtarakëve, policëve dhe civilëve kishte kontradikta në lidhje më atë se ç'duhej bërë me forcat e Saliut. Një grup kërkonte të sulmoheshin forcat qeveritare, të cilat rrinin në aerodrom, të tjerë thoshnin t'u bëhej thirrje që të largoheshin, të tjerë të ziheshin rrobë. Gazmend Shehu, shefi i policisë, ishte më i revoltuari dhe shokët e vet s'e mbanin dot. Ai kishte qenë në aerodrom kur zbritën forcat dhe u kërkoi pilotëve që t'i mirrinin prap ato forca. Mirëpo njëri i mbështeti automatikun në gjoks dhe pasi e shau e kërcenoi se do ta vriste në vend. Sipas z. Shehu ndër forcat e Salës egzistonin dy kategori. Një grup që donte gjak dhe një grup tjetër që ishin më të butë. Nuk ishin forca të rregullta. Më sa duket ishte pararoja se pritej të vinin atë ditë në Gjirokastër mbi 230 forca. Ndërkohë këto forca që pritnin më sa duket t'i mirrte në dorëzim dikush filluan të tërhiqeshin në drejtim të kalasë së Shen Triadhës.

PLANI I OPERACIONIT NE DUART E KRYENGRITESVE

Në kohën që mbi urë ziheshin se si do të bëhej më ata ndodh një zhvillim i ri. Një grup oficerësh të liruar gjirokastritë bashkë më disa të rinj po nga qyteti, kishin pikasur diku aty midis divizionit dhe spitalit ushtarak nga ana e lumit tre gjeneralët, Koçekun, Vladin dhe Arapin tek po i drejtoheshin aerodromit. Ishte ora 14 30. Kërkuan që ata të ndalonin. Njëri nga gjeneralët nxorri revolverin dhe kërcenoi. Edhe të rinjtë gjirokastritë nxorrën armët. Atëherë gjeneralët e trembur lanë ç'kishin dhe u larguan në drejtim të fshatit Valare. Ali Koçeku, la aty dosjen, kapelën pelerinën, armën, çelësat e shtëpisë dhe ndoqi kolegët. Këto trofe një oficerë i liruar i solli tek grumbulli i nërzëvë. I la në tokë dhe m'u drejtua mua se ç'duhej të bëhëj më to. Ishte pak sa i trembur. E pyeta

në I kishin kapur dhe gjeneralët dhe në fillim më tha se po, bile bashkë me komandantin e divizionit . Por s'qe e vertetë. U ula dhe I mora. Hapa dosjën . Atje ishte kartavizita e Koçekut, shenime të mbajtuara në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, të datës 03.03 dhe disa detaje të planit të luftës, sidomos për veprimet operative për datën 08-09 mars në Gjirokastër, një dokument tjetër, informacion sekret për hapjen e depos ushtarake në Kavajë dhe disa dokumente të tjera. Thira mënjëherë të vetmën kamera të stacionit grek STAR që ishte aty dhe I kërkova t'i filmonte të tëra se bashku me komentet që bënt oficeri I liruar, I cili kërkoi që të mos dilte më fytyrë. Pastaj I thashë oficerit t'i mbledh dhe t'u gjejë një vend të sigurt. Do të na duhen për prova materiale për pas luftës,- I thash. Merri ti ,- më tha. E shikova më ashpërsi. Ai I mori dhe iku më vrap. Kur u kthye me tregoi se ishin në vend të sigurt.

Tek sheshi para Urës së Lumit kishin ardhur dhe tanket. Në një djagaç hyn disa ushtarakë ,policë dhe civilë , për të vajtur tek «forcat e Saliut».Midis tyre edhe prokurori A.Pasho. U vendos që t'u kërkohet atyre të dorëzonin armët dhe të largoheshin nga qyteti. Ndërkohë kërkohet me radio një ndërlidhje që helikopterët të ktheheshin për t'i marrë forcat para se të errej, përndryshe do të qellohej mbi ta . Ndërlidhja ishte e pamundur dhe frika se mos ata prisnin natën për të sulmuar qytetin e shtonin tensionin. Njëerëzit nuk e njihnin përbërjen e këtyre forcave , por fakti që në krye kishin katër gjeneralë të bënte të bësoje se kishin aftësi goditëse shumë të madhe.Pikërisht në ato momente mbi kalanë e Shen Triadhës u shfaq një tank. Atëherë djagaçi u detyrua të niset drejt tyre për t' u transmetuar kërkesat ultimative të qytëtarëve. Kur diagaçi vajti deri ku mund të shkonte, forcat e ardhura ishin larguar.

Ata humben malëve . Të fundit që I panë ishin fshatarët e Nokovës që edhe I ndihmuan dhe u dhanë ushqim . Në drejtim të tyre u nisën njëerëz të Shtabit Qytetar që u krijua të nësërmën, por nuk u gjendën. Më 12.03, kryetari I bashkisë së qytetit të Peshkëpisë, komunikoi më komandantin e Shtabit të Gjirokastrës për t'i gjetur dhe për t'i nisur në Veri. Shtabi I Gjirokastrës u angazhua totalisht për t' I gjetur. Dy xhipa dhe pesë veta arritën nëpërmjet malit deri afër Permetit dhe nuk I gjetën.

SHKATERRIMI I DIVIZIONIT DHE PUSHTIMI I KOMANDES SE TIJ

Tek sheshi para Urës së Lumit, sheshi në fakt është produkt I një kryqëzimi, mblidheshin vazhdimisht njëerëz Shtimi I tyre dhe enigma që filloi të mbështillte forcat qëveritare , bënte edhe më të arsyeshme logjikën e kërkesës për armë. Një grup të rinjsh m'u afrua dhe më pyeti «C'të bejmë?» Ua ktheva shkurt. Unë e kam armën time duke u treguar kasetofonin. Ata ikën duke ndjekur një pjesë të turmës e cila ishte nisur për në divizionin aty pranë.

Edhe paraditën ishte bërë një përpjekje për të hyrë nga ana e qytetit në divizion, por sulmuesit ishin smprapsur nga ushtarët e paktë të mbetur aty. Nevoja për t'u armatosur vinte nga që disa ditë më parë ishin armatosur njëerëz nga PD-ja dhe nevoja për ekulibre ishte e pashmangshme.

Pas atij momenti u nisa dhe unë për në divizion. Eshtë e pamundur të përshkruhet se ç' ndodhte aty . Një bastisje e paimagjinueshme armësh.Njëerëzit mirrin edhe nga 20 apo 30 armë . Ngarkonin pa hesap arka me municione. Mirrin akoma dhe armë të renda, makina, thasë me miell, granata etj. Bastisja vazhdoi mbi 24 orë dhe s' kishte të sosur. Aty pashë se si njëerëz dhe makina shkelnin mbi municion armësh, mbi granata e ku ta di unë. Shpesh qëllohej me bresheri automatiku brenda në depo që njëerëzit të largoheshin , po shqyr zotit nuk ndodhi ndonjë incident.

Zyrat e divizionit I mbronte një njëri I njohur në qytet që kishte humbur një dorë në burg. Aty kishin mbetur disa oficerë që ishin pikë e vrerë. I pashë që u dhimbsej ajo që po ndodhte , por edhe ishin të bindur se s' kishin çfarë të bënin.U thashë në fillim që të largonin një grup ushtarësh të

mbetur në një qëndër vrojtimi aty afër për të shmangur ndonjë tragjedi. Oficerët seç komunikuan me ushtarët dhe ata u zhduken. Pastaj i pyeta se ku ndodhej gjeneral Laci por s' m'u përgjigjën.

Gjeneral Laci, ishte në fakt akoma aty. Më vonë erdhi dhe e mori një benc l bardhë me dy shoqëruesit e tij, dhe shefin e shtabit të divizionit. Shefi l shtabit mbeti në Gjirokastrë tek familja e tij, ndërsa gjeneral Laci u strehua në Lazarat dhe pas tri ditësh u largua nga Gryka e Selckës për në Permet se bashku me shefin e organizimit dhe shefin e SHIU-t.

Pak orë me vonë u hap lajmi se në komandën e divizionit kishte pistoleta. Kjo e bëri komandën objektin më të sulmuar të asaj dite. Një nga godinat e tij u dogj Pas disa orësh nëpër faqet e zyrave qëndrore ishin shkrua më bojë. «E zenë», «e zenë», «e zenë». Kjo donte të thoshte se për sulmuesit këto zyra ishin komode për t'u banuar prej tyre. Kjo ishte dhe pjesa më e turmshme e kryengritjës dhe shenjat e perspektivës së saj pas tradhëtisë së 9-të marsit

Tek Ura e Lumit moria e njërzëve nuk po largohej. Por nga qyteti ishin larguar dhe po largoheshin qindra njërzë në drejtim të Greqisë. Iknin kryesisht njërzit e makinave luksioze, por edhe ata që kishin një lloj frike të vecantë, jo aq nga "lufta" se sa nga e kaluara e aferme e tyre.

FATI TRAGJIK I NJE HELIKOPTERI

Televizioni shtetëror njoftoi atë natë se "Gjirokastra është në dorën e forcave ushtarake". Ishte një lajm l parafabrikuar që u fut në transmetim pa u ballafaquar me realitetin .

, Ishte në të erur dhe në tre pika kyçe të qytetit ishin ngritur postbloqe të mbështetura edhe me tanke . Në ato momente përgjimi kolektiv, në sfondin e Grykës së Selckës u shfaq një helikopter tjetër. Mobilizimi l njërzëve që l fuqishëm. Qëllonin nga të tera anët. Sapo helikopteri arriti në aerodrom dhe tentoi të ulej, u rrethua dhe në drejtim të tij qellohej më armë. Tre plumba e zunë atë mu te dera e pilotit.. U dëgjua një klithmë e fuqishmë dhimbjeje. Helikopteri tentoi të ngrihej serish por nuk mundi. Një nga tre pilotët ishte plagosur. Mëgjithatë nuk ishte ajo arsyeja që helikopteri ngeci. Plumbat l kishin shkaktuar difekt, për të mbetur përjetësisht aty, si dëshmitar l dështimit pa luftë të një operacioni ushtarak të shtetit kundër popullit

Njërzit e helikopterit u dorëzuan dhe kërkuan ndihmë për të plagosurin Mirëpo lartësia e madhe nga toka e bënte shumë të vështirë zbritjen e tij. Ndërkohë shumë njërzë mirreshin me çarmatosjen dhe hetimet e dy kolegëve të tij. Pilotët, është e vertetë, se e kishin harruar vetën dhe kërkonin shpëtimin e shokut të plagosur që lengonte.

Vrapova mes njërzëve që qëllonin dhe vura përpara një makinë Eolksëagen për të marrë të plagosurin, që u çua mënjëherë në spital. Nuk arrita të shikoja plagët e tij. Dikush thoshte se u rrezua dhe theu këmbën aq sa l dukëshin ështrat e kërcirit. Dikush thoshte se u plagos tek donte të zbriste , edhe u rrezua. Në të njëjtën kohë m'u kërkua që të ndërmjetësoja në konsullatën greke për ta dërguar në Janinë. Pas ndihmës së parë të dhenë në spitalin e Gjirokastrës, piloti u nis për në Janinë. Ishte plagosur me armë zjarri

Dy të tjerët mbetën të zbuluar para presionit të madhë të qytetarëve të cilët kërkonin të dinin më të drejtë misionin e tyre. Kërcenimi bëhej madje pa u shqëtësuar se kanalet e huaja televizive ishin aty. Kërcenimeve nuk u dihej fundi po të mos l mirrte pilotët në besë në shtëpinë e tij, njëri nga protagonistët e asaj dite, B.S. Mirëpo, me kalimin e orëve shqëtësimi se ç' punë kishte helikopteri në atë orë në Gjirokastrë ,filloi të ngrinte serish krye. Pilotët kërkoheshin serish për të dhenë shpjegime. Madje kishte nga ata që kërkonin të hakmerreshin. Situata kundër piloteve keqësohej edhe për arsye thjesht subjektive. Njërzit kishin një urrejtje tëpër të madhe dhe s' kishin ku ta shfrynin. Shkrehja e vazhdueshme e armëve nuk l çlironte. Kjo urrejtje herë mirrte kahun e njërzëve të SHIK-ut, e herë ndaj njërzëve që kishin lidhje me Berishën. E mora përsipër për ta zgjidhur këtë punë. Me

një koleg gazetar vajta tek shtëpia ku ishin strehuar. Kur I thashë të zotit të shtëpisë si qëndronte puna, ai më tha se do të qëllonte me armë këdo që do të guxojë t'i prek..-Nuk është ajo zgjidhja , - I thashë dhe hym se bashku në dhomë ku pilotët rrinin shtrirë ne krevate të improvizuara. E kishin dëgjuar bisedën dhe pa u prezantuar mirë e mirë na thanë, “n.q.s doni të na vrisni na vrisni, vetëm mos na torturoni kështu”. “Jo , u thashë,- nuk ju vret njëri,. Vetëm se duhet të tregoni qëllimin e ardhjes këtu.” Të përkrahur dhe nga I zoti I shtëpisë , thanë vetëm se vinin nga Tirana , (helikopterët e tjerë kishin ardhur nga Permeti) se nuk e dinin ç’ kishte ndodhur në Gjirokastrë dhe se u kishin dhenë urdhër se “detyrat e mëtejshme do t’i mirrin sa të zbrisnin në Gjirokastrë””.

Ishte e qartë se helikopteri kishte ardhur nga Tirana për të tërhequr, gjeneralët e fshehur ferrave, por këtë gjë as që mund ta konfirmojë plotësisht. Pilotët , të trembur nga reagimet e ashpra të njërëzve nuk e pranuan kërkësën tonë që të dilnin para tyre dhe t’ë flisnin. Kishin frikë. “Ata do të na vrasin,” thanë që të dy pothuaj më një gojë. “ Atëherë , - u thashë, të sjellim një kamera, që t’ I thoni aty.» Nuk pranuan. Nuk e fshihnin se e urrenin Berishën dhe se po të dinin ç’ kishte ngjarë atë ditë në Gjirokastrë, nuk do të vinin. Mirëpo kishin frikë të dilnin edhe në kamera se po t’i shikonin njërëzit e Berishës në Tiranë, mund të hakmerreshin me familjet e tyre. “ Më mirë të vdesim ne se sa të pësojnë gjë familjet”- na thanë. Pamë se kishin të drejtë. I siguruam se nuk do t’ u ndodhte asgjë dhe ikëm duke u marrë përsipër dhe njoftimin në Tiranë të familjës së kolegut të plagosur.

Dhe vertet kështu ngjau, Atyre nuk u hyri asnjë gjemb. Në ditët që pasuan ata pinin kafe bashkë me njërëzit e tjerë tek Shtëpia e Oficerëve ku kishte selinë edhe Shtabi Qytetar për Gjirokastrën që u krijua të nësërmën më 09.03 1997.

Ajo natë kaloi pothuaj pa gjumë jashtë nëpër postblloqët e ngrituara në hyrje-dalje të qytetit. Krismat e të gjitha llojëve të armëve tregonin se një luftë midis dhjetra kundërshtarësh zhvillohej sokak më sokak e shtëpi më shtëpi në Gjirokastrë. Pa kuptuar kishim filluar të jetojmë mes plumbave pa na bërë shumë përshtypje. Madje ndjeheshim më të sigurt. Na dukej se kishim shpëtuar nga ai vëzhgim dhe kërcënim I vazhdueshëm

Kapitulli 11

GJIROKASTRA KRIJON STRUKTUREN E VET PER TE MBAJTUR GJALLE STRUKTURAT E SHTETIT

Dita e nëserme e gjeti Gjirokastrën pa institucione dhe pa organe të pushtetit lokal. Nëntë marsi filloi rishtaz me grabitjen e depove të divizionit,. Ishin të njëjtat skena më një masivitet më të gjerë. Kameramanët e dhjetra kanalëve të huaj që kishin zbritur gjatë natës në Gjirokastrë hapnin sytë me skenat që shikonin. Ishte një babëzitie për t’u armatosur, pa e ditur askush arsyen pse, por edhe një shprehje e lirisë në trajta natyrale, për të demtuar shtetin , të cilin e konsideronin si pronë të presidentit. Kjo ishte logjika e imponuar njërëzve prej tij për disa vite rrjesht.

U drejtova disa oficerëve që të bënin diçka për të ndaluar atë shkatërrim. Mblodhën supët dhe gjërat që mbanin në dorë, disa minakërkues, mjete kundërkimike dhe disa aparate te tjera ndërlihdjeje, treguan vertetë paaftësinë e tyre për të bërë diçka.

Aty nga ora dhjetë e datës nëntë mars, në shtëpinë e ushtarakëve, ishin mbledhur shumë njërëz. Kishte filluar puna për ngritjen e Shtabit Qytetar. Inisiatorë ishin disa të rinj Gjirokastritë, që kishin pse jo dhe lidhje me PD-në. Ata edhe pse nuk ishin pjesëtarë në rezistencën ndaj “forcave të Salës” kishin bërë një listë me rreth 15 emra nga qyteti. Disa njërëz të armatosur u vunë në mbrojtje të dhomës ku po zhvillohej takimi dhe nuk linin asnjë të futej brenda, pavarësisht nga kontributi I dhenë. Një grup tjetër shkoi me një makinë për të mbledhur njërëz të tjerë të listës. Por s’

ishte e thenë që Shtabi Qytetar të ngrihej me disiplinë ushtarake. Shumë njërëz, që vertet kishin 24 orë në kembë kërkonin të bëheshin anëtarë shtabi, ndërkohë që jo të terë do të futeshin atje. E keqja ishte se në listë ishin njërëz që jo vetëm s' kishin merita, por nuk shquheshin as për aftësi organizative dhe ndikim në opinion. Prania e Kryetarit të Bashkisë Ylli Asllani dhe deklarata e tij se jam këtu si gjirokastrit dhe jo si kryetar bashkie, ishte një shenjë pozitive për të nxjerrë në publik një ekip njërëzish jasht ndikimëve politike, ose më sakt që bashkoheshin për të përballuar një të keqe të vetme. Kryetar u zgjodh Agim Gozhita me gradën gjeneral, por në lirim. Pjesa dermuese ishin intelektualë të qytetit, të njohur për veprimtarinë e tyre si dhe ushtarakë të mirfilltë. Kishte edhe njërëz, siç thashë që jo vetëm nxorrën gjoksin tek barrikada kundër "forcave të Salës" por edhe ishin të domosdoshëm për ndikimin që kishin në qytet ashtu edhe disa të tjerë që nuk dihej se cili ishte qëllimi i tyre. Gjithsej 15 veta. Unë u thirra tre herë për të vajtur atje dhe vetëm në fund kur do të shkruhej deklarata pranova të shkoja duke më lenë detyrën e propagandës së Shatabit.

Në deklaratën e hartuar nga Shtabi Qytetar, theksohej se ai ishte krijuar në fillim për të organizuar mbrojtjen e qytetit nga ndonjë invazion i mundshëm i forcave qeveritare dhe pastaj, në kushtet e mungësës së funksionimit të të gjitha strukturave shtetërore mirrte përsipër të rivendoste rendin, qetësinë dhe rikthimin e jetës normale. Njëkohësisht Shtabi Qytetar adaptoi edhe një qëndrim të qartë politik brenda kuadrit të qëndrimit politik të Komitetit të Shpërtimit Publik të Vlorës. Shtabi Qytetar pra kërkonte përkrahjen e gjithë qytetit për të kontribuar në rifunksionim e të gjitha strukturave shtetërore. Ai, si të gjitha shtabet e tjera kurrë nuk kanë kërkuar të eliminoheshin strukturat shtetërore. Thjesht kërkonte të luante rolin e koordinatorit. Madje që në deklaratën e parë u bënte thirrje të gjithë nëpunësve të administratës shtetërore të riktheheshin në punë. Kërkonte gjithashtu të organizonin dhe vetmbrojtjen e institucionëve të tyre. U përjashtuan vetëm strukturat e SHIK-ut, për të cilat, me ndërhyrjen e z. Asllani, bëri përjashtim funksioni i tyre për çështje kombëtare.

Ideja ishte që shtabet të kishin një shtrirje në të gjithë rrethin dhe të mbroheshin pikësepari institucionet e mbetura të rendësisë së veçantë. Shtabi kërkoi që në funksion të tij të vihej edhe Radio Gjirokastra. Kërkoi gjithashtu që të ndalohej të shtenat pa qëllim, të ndalohej armëmbajtja nga persona nën 18 vjeç dhe dorëzimi i teknikës luftarake që kërkonte përdorim të kualifikuar.

Kjo deklaratë u lexua pasdite në orën katër para më shumë se tre mijë vetave. Përkrahja e qytetarëve gjirokastritë që totale. Aty u vendos që çdo mëngjës e pasdite të organizoheshin mitingje ku do të lëxoheshin komunikata dhe njoftime.

FILLIMI I INSTITUCIONALIZIMIT TE BANDA VE

Shtabi punoi atë ditë intensivisht. Mbrojtja e rrethit dhe e qytetit bëhej tani kundër dy fakotrëve kryesorë. Kundër njërezve të Berishës dhe kundër bandave kriminale dhe hajdutëve. Po atë ditë, me 09.03 një grup i ardhur nga Saranda dhe Delvina shkuan në doganën e Kakavisë dhe e shkatërrojnë atë plotësisht, duke djegur dhe dokumentacionin e mbetur. Sulmi mbi doganën tonë të Kakavijës në pamje të parë u duk se i detyroi dhe punonjësit grek ta mbyllin doganën greke të Kakavijës. Problemi mëgjithatë që më i thellë.

Një situatë e tillë e bëri Shtabin e Gjirokastrës të mendonte seriozisht për të parandaluar invazionin e mundshëm nga Delvina dhe Saranda. Ishte e disajta herë që arrinte në Gjirokastër një lajm i tillë. Gjendja e luftës për disa ditë dhe shpërthimi i burgut kishte prodhuar aty banda të rrezikshme hajdutësh dhe kriminelesh, kështu që kryengritësit e vertetë, në një ambjent tjetër kishin humbur fizionominë e tyre përballë emrit të keq të bandave. Nga ana tjetër trazirat në Gjirokastër në fillim të marsit priteshin të importoheshin nga Delvina, ashtu si në Delvinë pothuaj u importuan nga Saranda. Kjo lojë mund të ishte akoma në fuqi. Në Gjirokastër përveç njerëzve që mirreshin

refugjatët, ishin instaluar në këtë periudhë dhe mbi 130 veta nga rrethe të tjerë jugorë të cilët do të aplikonin profesionin e vjedhjes dhe terrorit. Në ditët e ardhshme do të vihet re qartë se këto bandat ishin dy llojesh. Kategoria e ordinëreve dhe e atyre që nxiteshin për motive politike nga strukturat e SHIK-ut. Përderisa vjedhja ishte një mjet shumë i mirë fitimi këto dy lloj bandash baskëpunonin midis tyre. Faktorët që qëndronin prapa tyre u interesonte përfitimi politik. Bandave ana materiale ose investimi për të ardhmën. Pjesëtarë të tyre arrinin pse jo dhe të ishin fare pranë shtabëve, ose të paktën të kishin informatorë të tyre brenda në shtabe.

Shtabi I Gjirokastrës për të parandaluar këtë situatë mendoi në fillim atë që bëri Saranda dhe Delvina para disa ditësh, 06.03., kur hodhën në erë, urën mbi fshatin Grapsh të Dropullit, me qëllim që "forcat e Salës", të ardhura nga Gjirokastra, të mos kishin mundësi për të rihyrë në Delvinë. Kjo ide u hodh posht dhe u vendos të mirreshin masa për të kontaktuar me shtabin e Sarandës, të Delvinës dhe të Tepelenit dhe të vendosej me to një bashkëpunim në shumë nivele. Lidhja u vendos shumë shpejt me Tepelenën dhe në mëngjesin e ditës tjetër edhe me Delvinën dhe Sarandën.

Shqëtësimi kryesorë mbetej riorganizimi i komisariatit. Ishte tepër e vështirë që të gjendej një njeri i cili pa emerim nga një organ kompetent dhe zyrtar të mirrte përsipër zbatimin e ligjit ushtarak në polici. Këtë detyrë e mori përsipër Drini Toro. Por ai jo vetëm që nuk gjeti personelin e duhur për të ringritur komisariatit por u përballë me përplasjen e grupeve të ndryshme brenda në komisariat. Jeta e komisariatit u fik brenda disa ditëve. Fundi it ij erdhi nga vjedhjet e njëpasnjëshme, kryesisht të bankave të qytetit, ku arriti kulmin me vjedhjen e bankës kryesore të qarkut të Jugut e cila ishte rrethuar me tri tanke

Pjesa e ushtarakëve brenda në Shtab mori detyrë që të rivendoste situatën në divizion dhe në repartët e tjera të rëndësishme në Gjirokastrë. Shtabi gjithashtu u muar atë natë me organizimin e postëbloqëve fikse në aksin e rrugës nacionale që kalon në këmbët e qytetit, dhe patrulla të levzishme në të gjithë aksin nga Jergucati deri në urën e Kardhiqit. Patrulla u organizuan dhe brenda në qytet nga vet banorët e pallatëve më grafik dy orësh.

SHIK-U IRIQI ME GJEMBA BRENDA TRUPIT TE KRYENGRITJES

Qendra kryesore megjithatë mbeti postblloku tek Ura e Lumit. Këtu, më dhjetë mars, aty nga ora 21 30, erdhi lajmi se u shpërthye godina e SHIK-ut. Me dhjetra makina sollën aty mijra flet të mbushura me informacione të punonjësve të SHIK-ut për një rrez të ndryshëm. Dikush më tha që të shkonim edhe ne aty. Nuk pranova. Shumë shpejt makina të shumta sillnin aty dosje nga të SHIK-ut. Dhjetra kryengritës lëxonin ato mijrat e faqëve. Flisnin se si survejoheshin të gjithë. drejtorët e doganave deri dhe ku hanin bukë. Tregëtarët, shitësit, gazetarët, një rrezit e thjeshtë kur martoheshin. Atje erdhën edhe dosjet personale të shumë inspektorëve publik dhe të fshehtë. Megjithatë thelbi i SHIK-ut nuk që aty. Pesë arka me shirita dhe dokument tjetër të rëndësishëm së veçantë, ishte terhequr nga godina e SHIK-ut që kur u hap SHIK-u në Sarandë dhe Delvinë dhe ishte përcjellë në shtabin operativ të Divizionit. Ky material u terhoq nga shtabi operativ me një makinë tip Aro, pa targa, ngjyrë kafe, në mëngjesin e po asaj dite për në drejtim të paditur. Po atë ditë, njerëz të panjohur me një bens i bardhë me targa të mbuluara hynë në zyrat e divizionit, morën simbolët luftarakë të Divizionit dhe ikën (bashkë me to dhe një yll të artë i cili çdo vit peshohej nga një i derguar i ministrisë që të mos falsifikohet). Dukej qartë pra që ndërsa një rrezit e thjeshtë në atë lemsh, përbënin mbulesën për veprime të parashikuara të një dore të padukshme. Madje dhe hapja e godinës së SHIK-ut, ashtu si djegja dhe më pas servirja e gjithë asaj morisë së fletëve informacioni nga inspektorët e SHIK-ut, ishte një lojë për të provokuar tension, dhe konflikte.

Situata tek Ura e Lumit po tensionohej për arsye se shumë njërz gjënin emrat e tyre dhe emrat e atyre që l spiunonin. Në këto kushte l afrohem z. Gozhita dhe l them, që të marrim masa, se mund të na vritën njërz. N.q.s këtu ka spiunë lë t' l zhdukin,- më tha. Nuk fola më. Ai sapo ishte kthyer nga një zenkë e tillë. Njërzit e postbllokut kishin ndaluar një anëtar të PD-së dhe kërkonin sher, por kuptohet sher me armë. Gozhita, siç më tregoi, ndërhyri dhe e largoi atë me takt. Atë natë, nuk zbulova vetëm felliqësitë e makinës supërgjigante survejuese të SHIK-ut , që nuk arrinte ta kapte as fantazia më e çmendur, por edhe urrejtjen e pashembullt të njërzve ndaj tij.

Mëgjithatë, n.q.s Vlora, Tepelena, Saranda apo dhe ndonjë rreth tjetër, kishte arritur të neutralizonte deri diku punën e SHIK-ut pas rrenjës së strukturave shtetërore në këto rrethe, në Gjirokastër SHIK- u vazhdoi l pashqëtësuar shumë punën e tij. Ishin kapur madje biseda telefonike të kreut më të lartë të SHIK-ut në rreth ku thoshte se jemi shumë mirë, hamë pimë dhe punojmë rehat. Në Shtabin Qytetar arrinin njoftime për qëndrat e SHIK-ut nëpër fshatra apo dhe lagje të qytetit por nuk veprohej. Pavarësisht nga këto njoftime dhe të tjera që flisnin për veprime konkrete të SHIK-ut, Shtabi, me përjashtim të disa komunikatave ku denohej veprimtaria e SHIK-ut dhe u kërkohesh shikasve verbalisht që të largoheshin nga qyteti, nuk ndërmori kurrë asnjë veprim. Madje të nësërmën e takimit të Shtabit me partitë politike, përfaqësuesit e tyre kërkuan me këmbëngulje të dinë emrat e anëtarëve të Shtabit . Kur l kërkova njërit nga përfaqësuesit e partive pse gjithë ajo këmbëngulje, ai më tha se në gjirin shtabit keni tre njërz të SHIK-ut. Dhe vertet ,në debat e sipër njëri nga ata që dyshohej foli sikur ta “kishte mizën nën kësulë” që thotë dhe populli.Që atë ditë ai u largua nga përberja e SHIK-ut Farë nga këta brenda Shtabëve, apo më vonë të Komitetëve mbetën deri në fund të funksionimit të tyre.

Kapitulli 12

NGJARJA E PERMETIT.

SITUATA E NJE DITE ME PARE

Pas goditjës që studentët gjirokastritë l kishin dhenë Berishës dhjetë ditë më parë, dështimi l përpjekjës për ta përdorur kryeqëndrën e Jugut si pyk ushtarake kundër rajonit të rebëluar, përbënte për pushtetin e Berishës goditjen fatale për mbajtje me dhunë të pushtetit. Kjo solli edhe çekulibrime të rrezikshme në Permet ku ishin dislokuar më shumë së pesë mijë trupa me mbi 160 oficerë të ranqeve të ndryshme.

Këto forca vepronin në dy vija paralele. Së pari aty ishin dislokuar forca të regullta të ushtrisë, (kryesisht trupat komando), dhe në anën tjetër ishin forcat e SHIK-ut. Këto të fundit përbehëshin kryesisht nga forcat e rekrutuara enkas dhe nga forca të tjera të regullta dhe që ishin në komandën e gjeneral Bujar Ramës. Në forcat e porsarekrutuar, dhe që ishin të moshave të ndryshme, kishte nga ata që ishin gati “të luftonin për Saliun” se donin kështu të justifikonin dhe rrogën prej rreth 500 000 lekëve që u kishin premtuar. Kishte të tjerë që nuk reagonin. Por që të gjithë ishin tepër të bezdishëm për qytetin e vogël të Permetit. Që në Permet ishin të dislokuar dy kategori trupash e verteton si prania e Zhulalit dhe refuzimi l Ramës për t'u takuar më të, ashtu dhe deklarata e ish Shefit të Shtabit të Përgjithshëm A. Copanit : “ Nga sa morëm vesh më vonë, në zonën e Permetit ishin futur fshehurazi edhe forca të SHIK-ut për të cilat Shtabi l Përgjithshëm nuk kishte marrë asnjë njoftim”

Nga ana tjetër populli l Përmetit l provokuar vazhdimisht më gjithfarë mënyrash, sidomos të renda ishin provokimet ndaj grave dhe vajzave përmetare, u kishte dhenë të kuptohej drejtuesve të

këtyre forcave se durimi ishte sosur. Një anëtar i shtabit të gjendjes së jashtakonshme për Permetin i kërkoi kryetarit të këtij Shtabi, më datën 08.03 natën vonë që “ këto forca të largoheshin nga qyteti i Permetit, sepse mund të sillnin provokime dhe acarime të metejshme, pasi ata ishin jashtë kontrollit .”Ky pra ishte një ekulibër i rrezikshëm, një ekulibër shpërthyes.

Ngjarjet e datës 08-09 mars në Përmet kanë një intensitet të jashtëzakonshëm në një situatë që është pothuaj jashtë çdo kontrolli. Pasi forcat qëveritare nuk arritën të hynin në Gjirokastër, në Permet arrin ish Ministri i Mbrojtjes Safet Zhuliali , i cili po sipas Copanit, “...rastësisht marrim vesh se kishte marrë një helikopter dhe pa njoftuar paraprakisht asnjërin , kishte shkuar në Përmet.

Sipas informacionëve gojore të disa oficerëve të pranishëm , shton Copani,-Zhuliali kishte mbledhur oficerët dhe u kishte kërkuar bësën për të luftuar, “sepse më kanë tradhëtuar gjeneralet e Shtabit të Përgjithshëm dhe nuk kam besim tek ata”,-u tha Zhuliali Sipas Bujar Ramës, Misioni i Zhulialit ,(nga ato ç’ka Rama, siç pretendon ka dëgjuar më vonë), ishte që të bindte brigadën komando për të shkuar në Gjirokastër . Mirëpo Zhuliali ishte në Përmet mbasdite të po asaj dite ku forcat qëveritare kishin ardhur në Gjirokastër dhe iku të nësërmën më datë 09. Në të njëjtën kohë zoti Copani njoftohet nga komandanti i repartit komando se sapo Zhuliali u largua forcat e SHIK-ut kishin kryer veprime rrugaçerie në qytet , duke irrituar popullin dhe tensionuar situatën . Në situatën e krijuar komandanti i trupave komando këkron të tërhiqet për në Tiranë.

Leje për tërheqje nga “drejtuesit më të lartë” kërkoi edhe Buajr Rama për trupat e veta. Gjenerali Rama dhe njëkohësisht numri dy i Sherbimeve Sekrete Shqiptare kuptoi se situata e krijuar në qytetin e Përmetit “natën mund të kishte një efekt negativ në popull, mund të dukej gati një luftë civile” . Po ashtu ai kuptoi se pas renjës se Gjirokastrës dhe po atë ditë të Skraparit, mund të binte edhe Erseka . “Forcat veriore që ndodhëshin aty, -thekson po Bujar Rama , mund të ishin të rrethuara. Pra kishte dy rrugë, o të çanim me luftim , ose të dorëzoheshim” . “Drejtuesi më i lartë “ i tha që të vendoste vet dhe Rama vendosi largimin nga Përmeti të nesërmën.

Të shqëtësuar për situatën në qytet ishin dhe vet përmetarët. Kryetari i Bashkisë si kryetar i shtabit të gjendjes së jashtëzakonshme thirri po atë natë një tavolinë të rrumbullakët më partitë politike të rrethit ku u shtrua me shqëtësim çeshtja e forcave qëveritare domosdoshmeria e largimit të tyre nga qyteti, aq më tepër po të që se destinacioni i tyre ishte sulmi mbi qytete të tjera si Tepelena dhe Gjirokastra. Mbledhja u ndërpre në orën dymbëdhjetë të natës, kohë që gjeneral Rama, siç pohon vet “thërras Kryetarin e Bashkisë dhe atë të Rrethit në orën 24. 00 dhe u thashë se ju nësër do të mblidhni forcat politike dhe me policinë që është këtu, më gjithë njëëzitet që janë këtu, merrni masa që bandat të mos djegin Përmetin”.Rama pra i jep atij porosi që të krijohej një komitet i ipit të rebeleve, por nën drejtimin e tyre. Në Përmet nuk egzistonin as forca të rendit

MASAKRA NE DISA VARIANTE

Të nësërmën në orën njëmbëdhjetë, Kryetari i Bashkisë thirri mbledhjen e partive politike të rrethit ku kërkoi “ të krijojmë një Komitet për shpëtimin e qytetit, pasi forcat e qeverisë do të ikin në orën dymbëdhjetë, pas një ore”.Por situata ishte renduar sët ëpërmi. Në shesh ishin mbledhur shumë njëërez dhe ankohëshin për prishje lokalësh nga ana e “çeqenëve”.

Në vijim po sjell tre përshkrime të ndryshme për zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjës.. Kryetari i PS-së për Përmetin Petrit Bregasi.

“ Në orën 11 futemi në sallë . Në këto momente, pa filluar diskutimet mirë, revolta në shesh përjashta u zgjerua. Forcat qeveritare që ishin dislokuar në Dysh, u lëshuan kundër qytetarëve që nga Përtera, duke shtënë në ajër e kundër qytetarëve. Në këtë kohë, në sallë, ne dëgjojmë një zhurmë, një thyerje xhami, ku vritet njëri nga shokët tanë. Atëherë të alarmuar ne largohemi nga

salla, pasi ishim në survejim e në goditje të forcave qeveritare. Kuptohet që ushtria vepron me urdher . Nuk e di kush ka urdhëruar që ata të lëshohen mbi qytetaret, të dalin nga reparti, nga Dyshi ku ishin dhe të lëshohen drejt qytetit. Qytetarët nuk kishin armë fillimisht. Ishin të paarmatosur. Forcat u versulën mbi qytetarët e pambrojtur. Pastaj filluan edhe qytetarët të pajisen me armë. Nuk pati konfrontime në mes tyre sepse ata u larguan menjëherë.»

Në Dysh ishin strehuar forcat që drejtoheshin nga gjëneral Rama I cili tregon: “ Në orën 11. 15 unë jam larguar . Forcat nuk I kisha aty pasi I kisha përtëj Permetit. Në këtë çast buçiti një zhurmë në qëndër të Përmetit . Zhurma u dëgjua rreth 800m larg . Thirrjet Vlora, Vlora. më zë të lartë dhe një grup njërezish që nuk mund t'i shikoja në këtë distancë bërtasin dhe volumi vjen duke u shtuar. Njërezit që kisha përballë u acaruan dhe thonë:

“Kanë ardhur banditët e Vlorës dhe të Tepelenës. Kemi rast që tani të sulmojmë.” Unë e dija që aty ishte një protest brënda për brënda qytetit dhe u thash në mënyrë kategorike se ne nuk duhet të sulmojmë qytetin e Përmetit. Një pjesë e tyre , të irrituar thirrën: kjo është tradhëti që bëhet nga vet ju zoti gjeneral...me qëtësi dhe gjakftohtësi I binda se nuk mund të qëllonim mbi popullin. Ekzistonte rrëziku se turma e qytetit të Permetit mund të dilte në krahë ku isha unë për të marrë armë. Atëherë dhashë urdhër që të hapej zjarr në ajër me qëllim që të parandalohet kjo. Por në këtë çast turma kishte pushtuar policinë . Policia kishte lënë aty të gjitha armët. Pas kësaj populli filloi të qëllonte në drejtimin tonë . U krijua një gjendje tamam lufte . Dhashë urdhër që forcat të hipnin në makina dhe të largoheshim më shpëjtësi nga qyteti I Përmetit”

Gjëneral Rama duke marrë përsipër për të sqaruar dhe pozicionin e trupave komando, thotë. “ Në ato çaste është qëlluar me armë mbi një makinë të komandos dhe komandot kanë qëlluar në drejtim të turmës duke vrarë tre veta në një kohë. Ndërsa tre të tjerë janë vrarë në rethana misterioze, do të thoshja që janë vrarë nga plumbat qorr” (Shënojmë që dëshmitarë okularë tregojnë se trupat komando u tërhoqën me flamur të bardhë).

Adem Copani duke sqaruar se kërkesa e trupave komando për t'u larguar nga Përmeti më datën 09.03, ishte aprovuar tregon dhe arsyeën pse nuk filluan normalisht levizjen . “ Sepse u goditën me zjarr nga forcat e SHIK-ut. Si rezultat I këtij zjarri humbën jetën disa qytetarë të pafajshmë të Përmetit».

Gjithsej u vranë 6 veta. Tre në sheshin e protestës një brenda në sallën e mbledhjeve të këshillit të rrethit dhe dy të tjerë burrë e grua u vranë brenda një makine po nga forcat qeveritare gjatë tërheqjes së tyre.

Masakara e Përmetit, përbën një nga dramat më kulmore të kryengritjes popullore Vritën brenda një dite , në një qytet të vogël 6 veta , që përbënin numrin më të madhë të të vrarëve nga ana e popullit. Vrasja kryhet nga forcat shtetërore në mënyrë demonstrative .Mëgjithatë, edhe pse është ngritur edhe një shoqatë për gjetjen dhe denimin e fajtorëve, edhe pse janë bërë kallzime në organët e drejtësisë, fajtorët s' janë denuar.

PJESA E TRETE

Kapitulli 13

9 MARS - DITA E MBIJETESES SE FAJIT

Pengu I kësaj tradhëtie përspektiva e vendit

Zhvillimet e datës 08-09 mars kishin vulosur në mënyrë të qartë një situatë të dyzuar në vend. Nga njëra anë qëndronte tanimë populli dhe nga ana tjetër politikanët. Kjo tablo shtrihej në Tiranë dhe në Jug të vendit. Në Jug, pas kaq javësh protestash, përlëshjesh, të vrarësh dhe të plagosurish, djegjesh e shkatërrimesh, ishte përcaktuar qartë mënyra e zgjidhjes së krizës së shtetit shqiptar. Duke hequr qafe pjesën e keqe që e shkaktoi. Lëvizja popullore në këtë kohë, në mos në mënyrë plotësisht të kristalizuar, në vija të trasha, kishte përcaktuar edhe strategjinë e së ardhmës. Por për vete kishte marrë përsipër dhe tregonte se dinte ta bënte mirë, pjesën e çmontimit të së keqës. Pjesën tjetër, përspektivën po ua besonte në mënyrë të verber politikanëve opozitarë.

Politikanët e Tiranës e panë vetën jashtë këtij realiteti. Njëra palë, opozita nuk mundi të administronte këtë kryengritje dhe pala tjetër nuk mund ta shtypte. Lëvizja popullore kishte logjikën e vet, ndaj edhe opozita u mbyllë në ambientin e Tiranës që ende nuk ishte çliruar nga realiteti i praktikave të lojës politike të imponuar nga Berisha. Këtu njëra palë, pushteti, kërkonte të mbetej në lojë dhe pala tjetër, opozita të futej në lojën politike. Pengu ishte përspektiva e vendit.

Të gjitha zhvillimet në Tiranë imponoheshin nga zhvillimet në Jug të vendit. Mëgjithë këtë avantazh Jugu kishte disa dizavantazhe serioze. Politika në Tiranë ishte e organizuar dhe zyrtarisht mund të administronte institucionët e shtetit. Kryengritja Popullore ishte e paorganizur në institucione që të vetadministrohej në nivele analoge. Ajo sapo kishte arritur të orientonte urrejtjen popullore në një formulë politike, që kërkonte dorëheqjen e Berishës, krijimin e një qeverie teknike dhe caktimi i datës së zgjedhjeve të parakohshme. Po ashtu Kryengritja Popullore bënte në mënyrë romantike se opozita në Tiranë do të përvetësonte këtë formulë, dhe më mbeshtetjen e popullit kryengritës do të kërkonte zbatimin e vet në praktikë, aq më tepër se kjo formulë ishte artikuluar pikë se pari nga opozita. Nga ana e vet opozita duke e parë rrugën e hapur për në pushtet, dhe duke qenë se prej kohësh kishte filluar të operonte në bazë të recetave perendimore filloi ta shikojë Kryengritjen Popullore me dy opsione. Afrimin më të opozita e shikonte nga njëra anë se mund ta fajësonte si klasë politike që për të ardhur në pushtet përdorë trashëgiminë e së kaluarës, -violencën, dhe nga ana tjetër si një alternativë përjashtuese për të. Kryengritësit, -argumentonte opozita, - do të kërkonin kalimin e pushtetit politik në duart e tyre.

FILOZOFIA E MBRAPSHT E NENSHKRIMIT TE TRADHETISE

Mëgjithatë, edhe me praninë e Vranickit në Tiranë si dhe të shumë diplomatëve të tjerë, çdo orë që kalonte në kryeqytetin shqiptar nuk dinte se ç'do të sillte. Vet Partia Demokratike ishte tepër e hutuar dhe Kryesia e saj nuk kishte asnjë mendim për hapat e metëjshme. Në këto kushte u përhap lajmi se Berisha do të jipte dorëheqjen. Madje njëri prej shumë pranë tij thanë se ai kishte bërë gati edhe tekstin e dorëheqjes. Por dy orë me vonë Berisha doli me "platformën e pajtimit kombëtar",

të servitur në takimin e orës 15 00 me dhjetë partitë politike. Ishte e qartë se rezistenca e opozitës, sado e vogël në kohë do t'i impononte Berishës dorëheqjen. Por partitë politike u futën në rresht. Madje në këtë takim përfaqësuesit e partive politike hynin në Presidencë me frikën e madhe se nuk dihej nëse do të dilnin gjallë që andej. Më këtë ndjenjë frike, ata s'kishin si ta kuptonin se formula e pajtimit kombëtar nuk ishte gjë tjetër veçse një pajtim të opozitës me shkaktarin e krizës, një pajtim që nuk shpëtonte vendin por vet Sali Berishën dhe klanin e tij.

As opozita shkonte aty e përgatitur me ndonjë ide të qartë. Inisiativën e kishte vet Berisha I cili arriti të përpunonte kërkesat e brendshme dhe të jashtme ndaj tij dhe t'i paraqiste si origjinale, si bazë të formulës së pajtimit kombëtar

Në transmetimin e drejtpërdrejt në TV të fjalës së tij Berisha foli për moralin e pajtimit kombëtar që ngrihej mbi moralin e interesave partiake, Në këtë kuadër ai e konsideroi të pranueshëm kombromisin dhe bashkëpunimin me PS-në, gjë që përjashtohej me statutin e vet Partisë Demokratike

Sali Berisha u propozoi përfaqësuesve të dhjetë partive politike

-Amnisti të përgjithshëm për të gjithë ata që u përzier në protestat e shkaktuara nga rrenia e piramidave, duke qenë ata ushtarakë apo civilë.

-E diela, 10 mars, të shpallet ditë zie e lutjeje kombëtare për të vrarët.

-Formimin e një qeverie me përfaqësues nga të gjitha partitë politike.

-Qeveria të quhej "Qeveri e Pajtimit Kombëtar".

-Të shpallen zgjedhje të parakohshme jo më vonë se dy muaj, zgjedhje të cilat do t'i përgatis kjo qeveri e re.

-Zgjedhjet të vezhgohen me reptësi nga organizmat ndërkombëtare.

-Ftohen deputetët e partisë Socialiste të marrin pjesë në Parlament.

-Brenda një jave të dorëzohen armët dhe municionët

-Qeveria e Pajtimit Kombëtar të ndërmjetësojë në organizmat ndërkombëtarë dhe vende mike të ndihmojnë krahinat e demtuara nga revoltat

Dukej qartë se në këto propozime të Berishës ishte I pranishëm mendimi I njërëzve të perëndimit të cilët, në momentët e spostimit tej kufijve të parashikuara të revoltës popullore, shikonin si të vetmën zgjidhje të kontrolluar, kompromisin. Këtë kompromis, ata e shikonin si mundësinë më praktike për ruajtjen e elementëve bazë të një demokracie pluraliste, pjesëmarrjen në jetën politike të partive politike në mënyrë të ekuilibruar. Ky kompromis kishte gjithashtu në thelb edhe kompromisin midis SHBA dhe BE pas qëndrimit në favor të Berishës nga ana e Këshillit të Ministrave të Jashtme të Bashkimit Evropian më 23.02.97,

Por përfaqësuesit e partive politike, nuk e besonin se do ta shikonin Berishën në atë takim me pantallonat në fund të këmbëve. Këto parti nuk arritën të kuptonin se më pak presion akoma nga ana e tyre ai do të kishte marrë valixhët për të ikur. Të gjithë ata ishin viktimë të idesë aq shumë të përhapur ato ditë dhe orë në Tiranë se me ikjen e Berishës shteti shkatërrohej përfundimisht dhe mbajtja e tij më pahir në Tiranë dhe orientimi I të gjitha zhvillimeve të metejshme në vend në bazë të këtij kompromisi, konsiderohen si e vetmja alternativë për rifillimin e funksionimit të shtetit.(!!)

Platforma e paraqitur nga Berisha duket se I befasoi përfaqësuesit e partive politike. Sekretari i përgjithshëm I PS-së në atë takim, Rexhep Meldani, tregohej tëpër I lodhur dhe në vend të diskutonte çeshtje parimore, kërkonte zgjerimin e tavolinës me pjesëmarrjen edhe të partive të tjera siç që Partia Agrare. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Alencës Demokratike tregohëshin shumë të moderuar dhe të hapur me Berishën dhe filluan të mbanin një qëndrim kritik ndaj PS-së që po e prishte disi «qëndrimin pajtues të Berishës».

Dialogu nuk ecte dhe u kërkua pushim. Në këto momente mora në telefon zyrat e PS-së. Më doli Sekretari Organizativ Maqo Lakrori . I foli shumë ashpër duke I thenë, se ç' është ky pajtim kombëtar që bën partia juaj pa kërkuar lirim e udhëhëqësit tuaj të burgosur. Këto bisedime nga ana juaj duhet t'i drejtojë vetëm Fatos Nano. Po ashtu I kërkova që PS-ja të bëhet iniciatore që kryengritësit të ishin palë në ato tavolina dhe t'i hiqeshin Berishës dhe strukturave të tijtribute në lidhje me kontrollin e makinës së shtetit.

M' u përgjigj më një ton zyrtar. "Do t'i kemi parasysh sugjerimet tuaja". Pas takimit Majko e shtroi çeshtjën e Nanos por jo të pjesëmarrjës si palë të përfaqësuesve të popullit kryengritës. Që në këtë kompromis çeshtja e komitetëve do të kthehet në një tabu politikë ku mënyra se si do të përballoheshin në jetën politike të muajve të mëvonshme do të përcaktohej serish nga Berisha. Një qendrim I tillë dhe formula " e pajtimit kombëtar" që gjeti Berisha, e shndëronin konfliktin nga konflikt midis popullit dhe pushtetit, në konflikt në gjirin e popullit, ku Berisha kërkonte rolin e garantit.

ANA E PASME E HENES

Mënjanimi I Komitetëve për të qënë palë zyrtare në zhvillimet aktuale në vend , bashkë më përpjekjet e Berishës për të riaktivizuar pushtetin lokal në zotërim të plotë të tij, si dhe aktivizimi I strukturave të tjera të linjës së shtetit partiak të Berishës, nuk solli vetëm zvogëlimin e autoritetit të komitetëve por edhe përgjakjën makabre të vendit. Deri më 09.03 ishin vrarë jo më shumë se 50 veta . Ndërsa deri në qërshor u vrarë rreth tre mijë .

Partive politike u shkriu gjaku sa panë një Berishë me lekurë qëngji, t'u buzeqeshte dhe t'u ofronte «kompromise historike». Harruan se fabulat e La Fontenit edhe pse ishin me kafshë, kishin vetëm parasysh një rrez. Përfaqësuesit e partive politike të opozitës u duk se e gjetën gjuhën e përbashkët në parimet e kompromisit dhe I lanë më shumë kohë ndarrjës se portofolëve në qeveri. Është një moment që tregohet qartë se si partitë e opozitës, sa panë pak pushtet përpara , e harruan Berishën, Harruan njëkohësisht se kush e detyroi Berishën të ulej në një tavolinë me ta. Por ai e dinte se të vetmuara këto parti do ta kishin të pamundur për të shijuar qoftë edhe pak pushtet.

Partitë politike të opozitës nuk vendosen në atë tavolinë se çç do të bëhej me gjendjën e jashtëzakonshme, cili do të që funksioni I parlamentit ,I SHIK-ut, I prokorporisë, I rendit dhe çfarë do të bëhëj sidomos me Radiotelevizionin. Berisha futi si pjesë të kompromisit vetëm qeverinë dhe mbajti nën kontrollin e vet gjithë strukturën tjetër të shtetit. Por edhe në qeveri ai mbajti për vete pjesën e luanit Pas portofolit të kryeminsitrit, të cilin e donte nga opozita por sipas metrave të vet dhe vetëm kur të ishte I bindur se I kontrollonte çdo kopetencë, I dha opozites Ministrinë e Financave pa finanaca, Ministrinë e Punës , pa asnjë punonjës, Ministrinë e Mbrojtjes, pa ushtri dhe armë.

Ministrinë e Brendshme që kishte në dorë rendin, por mbi të gjithë kontrollin mbi zgjedhjet e mbajti për vete. Po ashtu komandanti I gjendjës së jashtëzakonshme mbeti dora e lëshuar e Berishës Bashkim Gazidede

Që në këtë moment Berisha filloi të impononte lojën e vet partive politike . Hodhi posht nja 5-6 kandidatura të opozitës për kryeministër dhe pranon përfundimisht kandidaturën e ish kryetarit të Bashkisë së Gjirokastrës, Bashkim Finos, për të cilin deklaroi se " e njoh, e njoh është djali I mirë"(!!?)

REAGIMET E PARA

Eshtë e vertetë se marrëveshja u prit pozitivisht nga kryengritësit e Jugut, edhe pse nuk plotësohej një nga kërkesat kryesore të tyre,- dorëheqja e Sali Berishës. Gjirokastra dhe qytetet e

tjera të Jugut e përshendetët marrëveshjen më miliona të shtena të llojëve të ndryshme armësh. Shtabi Qytetar I Gjirokastrë në një deklaratë të tij të përbashkët me forcat politike në rreth, midis tyre edhe PD-ja, shprehëshin se marrëveshjen e 09.03 “ e konsiderojnë si fillim të zgjidhjes së krizës së përgjithshme në vend” . Ato kërkojnë në këtë frymë heqjen e gjendjes së jashtëakonshme dhe garanci të plota për zbatimin e amnistisë së përgjithshme. Ndërkohë që deklarata e përbashkët e partive dhe e Shtabit të Gjirokastrës, nuk thotë asgjë për çarmatosjen dhe dorëheqjen e S. Berishës, komandanti I Shtabit të sarandës z. Xhevat Koçia do të deklarojë se “Ne do t’ I dorëzojmë armët kur do të japë dorëheqjen Sali Berisha dhe kur do të egzistojnë garanci të plota se nuk do t’u ndodh asgjë kryengritësve.»

Qëndrimi I kësaj natyre të përfaqësuesve të kryengritjes ishte I shpjegueshëm. E para u mungonte organizimi dhe më e keqja organizimi I njehsuar I mendimit politik . Se dyti, u quajt sukses se edhe ata e panë Berishën, nën syzat e partive të opozitës, të gjunjëzohet. Se treti, u duk pra qart se kryengritësit I kishin besuar vetës vetëm pjesën e shkatërrimit të diktaturës dhe të shtetit të imponuar nga sjellja e drejtuesve të tij. Por pikërisht këtu, tek kjo datë shenohet fundi dhe fillimi I kryengritjes. Këtu fillon dhe pjesa më e rendë e kalvarit të vuajtjeve të vendit . Berisha duke qënë se I çliroi duart nga përgjegjesia e fajit për shkatërrimin e shtetit, ua lëshoi atë çfarë kishte mbetur nga shteti kriminelëve nën përgjegjësini e partive politike të opozitës që drejtonin qëverinë(!). E deklaroi këtë me mburje në fillim të qërshorit 1998 në një emision televiz : «E Diela debat». Pas 09.03.97, tha ai ndodhi kaspahana në Shqipëri.

Po atë ditë Qemal Sakajeva drejtor I Televizionit Shtetëror jep dorëheqjen duke filluar kështu çthurjen dhe panikun në medjën zyrtare

Dita e nësërme ishte e rendë për Gjirokastrën dhe Permetin. Në Gjirokastrë shpërthën në mënyrë misterioze një nga tunelet pranë ish brigadës së pestë, në vendin e quajtur LEKNIAS. Vetëm perendia e di si nuk shpërthyen të tre tunelt e mbushura me tritol. Dhe vetëm një kodër përballë tuneleve shpëtoi nga shpërthimi , një lagje të terë në zonën industriale të qytetit. Mëgjithatë xhamat nuk shpëtuan as brenda në qytet. Në qiell u ngrit një këpurdhë madheshtore në përmasat e bombës atomike. Makinat që vinin në drejtim të Gjirokastrës kishin ndezur dritat dhe ecnin më sa kishin mundësi. Pas dy orësh në Gjirokastrë u dha serish alarmi. Kishte marrë zjarr në divizion një magazinë e bastisur me veshmbathje, por që ishte shumë pranë një magazine me municione. Në Gjirokastrë gjithashtu , brenda 24 orëshit që po flasim ishin plagosur nga pakujdësia 23 veta nga këta tre shumë rendë.

Në Permet zjarri që morri një nga godinat ushtarake afër qytetit rrezikoi shpërthimin e një tuneli gjigant afër tij. Qyteti u evakua I teri . Shpërthimi që mund ta hidhte qytetin në erë, u evitua nga këmbëngulja e disa të rinjve Përmetar që nuk lëjuan përhapjen e zjarrit

Kapitulli 14

STARTI I UNIFIKIMIT TE KOMITETEVE.

Po më datën 09.03, Shtabi I Gjirokastrës vendos lidhje më shtabin e Tepelenës. Një ditë më vonë, në kohën që shtabi I Gjirokastrës zhvillonte një takim pune me partitë politike në rreth Shtabi I Sarandës dërgoi korierin e vet më anë të të cilit donte ta përgëzonte Gjirokastrën që nuk pranoi të bëhëj rajon përqëndrimi për forcat qeveritare . Kërkonte njëkohësisht të vendoseshin kontaktet e para të bashkëpunimit. Po atë ditë me Gjirokastrën u lidhen dhe shtabet e disa rretheve të tjera si Vlora, Berati, Kuçova, Permeti . Agim Gozhita u kërkoi të vinin në Gjirokastrë të nësërmën paradite.

Në Gjirokastrë koha ishte prishur dhe bënte një e ftohtë brisk.. Pas transmetimeve të pasditës dola për të parë punët e pasditës në Shtab. Madje desha t'i propozoja zotit Gozhita, që të nësermën, në takimin e shtabeve, të dilnim më një platformë më të gjerë politike se sa bashkëpunimi I thjeshtë , për çeshtje rëndi Tek sa bëja këto mendime, rreth 100 metra para se të arrija tek rezidenca e Shtabit më thanë se në qytet ishin edhe zotërinjtë Arben Imami dhe Ridvan Pëshkëpia. Ata që më dhanë lajmin më çuan edhe për t' I takuar. Ishin futur në një kthinë të vogël prapa banakut të kafe Okuariumi tek palati I sportit . Imami pinte duhan. Pëshkëpia vinte verdallë në atë dhomë të ngushtë. Pasi u takuam dhe shkëmbyen disa mendime për situatën në Sarandë, (se ata vinin nga Korfuzi, kishin kaluar një ditë në Sarandë dhe që andej erdhën në Gjirokastrë) biseda vajti tek marrëveshja e nëntë marsit. Si njëri ashtu dhe tjetri e denuan atë marrëveshje si veprim që ringrinte në këmbë Berishën e rrëzuar. Ishim të një mendimi. Po ashtu unë rash dakord me mendimin për të organizuar shtabët në një Komitet të Përgjithshëm dhe të zgjidhnim një udhëheqje të përhershme dhe organet e tjera drejtuese të tij. Domosdoshmëria e këtij organizimi nuk rridhte vetëm si një nevojë e brendshme por edhe si një nevojë për të realizuar deri në fund kërkesat e popullit, dhe për më tepër të mbahej I nënshtruar Beriisha, pasi forcat politike pa Kryengritjen Popullore as që mund ta përballonin atë dhe strukturat e veta shtetërore të paprekura. Kjo strategji mund të realizohej më mirë vetëm po që se pranoheshin si palë komitetet, si përfaqësues të popullit që imponuan tek Berisha pranimin e kapitullimit. Aty për aty caktuam dhe termonologjinë. Kryengritja Popullore të quhej Levizja Qytetare për Demokraci dhe shtabët të përfshiheshin në Komitetin Kombëtar të Shpëtimit Publik. Hartuam një projekt deklarate në të cilën thuhej:

“ Sot më datën, përfaqësuesit e revoltës popullore “ LEVIZJA QYTETARE PER DEMOKRACI”, duke shprehur vullnetin e popullit deklarojmë krijimin e Komitetit Kombëtar të Shpëtimit Publik. K.K.SH.P, në emer të Lëvizjës Qytetare për Demokraci” , kundër diktaturës së Sali Berishës , I cili kërkon :

Dorëheqjen e menjëhershme dhe pa kushte të Sali Berishës.

Krijimin e një Këshilli Presidencial deri në zgjedhjen e parlamentit të ri.

Krijimin e një qeverie koalicioni deri në zgjedhje të reja

Duke vlerësuar kontributin e partive të opozitës për Demokracinë, u kujtojmë atyre se armët në duart e popullit nuk janë për vëllavrasje, e as për ndasi kombëtare, por janë në duart e popullit kundër diktaturës së Sali Berishës dhe se populli do të vendosë t'i dorëzojë ato kur të krijohen garanci për vendosjen e demokracisë në Shqipëri.

Komiteti Kombëtar I Shpëtimit Publik thekson se që nga ky moment del si palë, krahas pushtetit aktual dhe opozitës se mbledhur në Forumin për Demokraci»

Ishte hera e parë që artikulohehin kaq qartë kërkesat politike të kryengritësve të Jugut. Këto kërkesa kishin një superioritet absolut ndaj kërkesave të partive politike. Në këtë deklaratë përpunohej I plotë koncepti I funksionimit të shtetit pa figurën e Sali Berishës, nëpërmjet një Këshilli Presidencial të zgjedhur nga parlamenti Po ashtu ishte mëse legjitime kërkesa e kryengritësve për t'u paraqitur si palë në tavolinën e vendimeve të partive politike.

KONKRETIZIMI I INISIATIVES , - ME DIFEKTE QE S'U RIPARUAN KURRE

Të nesermën me datë 11.03, për çudinë e të gjithëve, ca të lajmëruar , ca nga nevoja e brendshme për të shtrirë bashkëpunimin , në Gjirokastrë erdhën përfaqësuesit nga tetë rrethe, nga, Berati, Saranda, Delvina, Gjorokastra, Tepelena, Memaliaj, dhe Koçova. E fundit dhe kur nuk e prisnim, erdhi përfaqësia e Vlorës. Përfaqësuesit e Sarandës me Koçinë në krye, ishin nga më të veshtirët për të hyrë në bisedime. Koçia hyri në sallë kur u prit me duartrokitje dhe entuziazëm

grupi I Vlorës. Kuptohej se qendresa e Koçisë kishte si qëllim që të ushtronte presion për të qënë ai I pari I vendit. Për këtë Imami në një moment tha se duheshin ndërprerë të luturat.

Gjithsej ishin 25 veta përfaqësues nga 8 rrethe të Jugut. Diskutimi zgjati mbi dy orë dhe , pavarësisht nga puna e bërë që deklarata të mos kishte pika të diskutueshme, aty pati debat . Debatu u përqndrua në momente të tilla që do të përcaktonin në vijim natyrën e vet Komitetëve. Këto debate pra, lidheshin kryesisht me angazhimet partiake të të pranishmëve. Kërkesa për të dalë si palë, u duk qart që në momentin e parë se shqetësonte shumë partitë politike, kuptohet , nga vet avantazhi që do të krijonte pala e tretë, populli I përfaësuar nga komitetet. Ky rol konsiderohej nga partitë e opozitës si ekskluzivitet e tyre. Fakti që të dy udhëheqësit e AD, Imami e Pëshkëpia u gjendën nën breshëritë e politikanëve të Tiranës, madje edhe të kolegëve të partisë së tyre, e sqaron më së miri këtë situatë.

Edhe pse më e fshehtë, e pranishme qe edhe xhelozia për faktin se kush do të qe udhëheqës. Takimi do ta justifikonte plotësisht qëllimin e vet po të arrinte të zgjidhte një ekip udhëheqësish. Por kjo s'u arrit. Deklarata e Imamit dhe e Pëshkëpisë se kishin dhenë dorëheqjen nga pozitat në AD, u dha dorë atyre për t' I bindur të pranishmit se nuk niseshin nga motive partiake në këtë ndërmarrje. «Madje,-thanë,- po të shkonim në Tiranë mund të mirrin dhe portofole ministrash në qeverinë e Pajtimit Kombëtar. Ne nisemi,-shtuan,- nga motive patriotike». Mirëpo ky qëndrim mbipartiak I bëri dhe më xhelozë pretendentët për të qenë udhëheqës. Një situatë e tillë detyroi z. Pëshkëpinë të tërhiqet nga debati duke më detyruar të ndërmarrë rol aktiv në krah të Imamit.

Këto dy arsye që aty për aty u kapërxyen, u rishfaqën me më forcë tre ditë më vonë në takimin e radhës në Vlorë, me pasojë Imami dhe Pëshkëpia të mos lejohen të marrin pjesë në takim, dhe më e keqja të mos marrin pjesë në grupin e përfaqësuesve të Kryengritjes Popullore që u takua po atë ditë mbi anjën italiane ALIZEU me Vranickin. Mungesa e mendimit të kualifikuar politik në emer të kryengritjes, dhe zëvendësimi i argumentit politik me deklarata patetike kundër Berishës , deri edhe në nxjerrje koburresh nga ana e përfaqësuesve të Komitetëve,(Do t'i nxjerrim koburën Vranickit, thoshin gjatë udhëtimit me helikopter përfaqësuesit e komiteteve), për treguar se me atë armë do të vrisnin Berishën, tregoi se njohja e tyre si palë nga faktori ndërkombëtar që vendoste gjithçka mbi fatin e Shqipërisë, shënoi në esencë edhe fillimin edhe fundin e këtij procesi.

Ishte pikërisht kjo atmosferë e krijuar në takimin e Gjirokastrës që nuk lejoi edhe zgjedhjen e një udhëheqjeje përfaqësuese të Komitetit Kombëtar të Shpëtimit Publik. Atje u pranua si gjysma e së mirës nënshkrimi i deklaratës që pranonte unifikimin e Komitetëve. Zgjedhja e një udhëheqjeje të përgjithshme u vendos të lihej për një takim tjetër , atë të Vlorës më 14 mars 1997.

Mirëpo, për të njëjtat arsye , gjërsa këto Komitete e humbën rolin efektiv të tyre, nuk arritën të zgjedhin një udhëheqje, kështu që u krijua një rast unikal në historitë e levizjeve popullore që konsiderohen të sukseshme, që ajo të zhvillohet pa patur një udhëheqje të përcaktuar ushtarake dhe politike. Pak nga pak , arma e tyre e vetme mbetën deklaratat , të cilat kishin në përgjithësi një qëndrueshmëri dhe vijimësi politike.

Po ashtu pas nënshkrimit të deklaratës nga të gjithë të pranishmit u duk mëse e pamundur për ta përcjellë në Tiranë. Disa miq te Imamit dhe të Pëshkëpisë, nuk pranuan t'u përcilleshin në aparatet e faxeve të tyre dokumente të tilla «të rrezikshme». I gatshëm u tregua Skënder Gjinushi, I cili megjithatë nuk pranoi ta përcillte në partitë e tjera të Forumit për Demokraci. Madje , fillimisht nuk pranoi as të diskutohej edhe për rendësinë që kishte ky organizim. Vetëm kur I thashë se n.q.s ju nuk do të angazhoheni seriozisht me Levizjen Popullore për Demokraci, ne do të dalim si forcë e pavarur politike , ndryshoi qëndrim. E njëjta gjë ndodhi kur unë bisedoja me njërin nga udhëheqësit e AD-së, për ta bindur se « Levizja për Demokraci , deri në zgjedhje duhet pranuar si palë aleate dhe

garanci kundër pushtetit të Berishës e në vijim të administrohej nga opozita politike e organizuar.. Për këtë parti të politike duhet të hedhin veshtrimin nga komitetet dhe t'i njohin zyrtarisht ato. Përndryshe, këmbëngulja unë, ne do të dalim si Levizje Politike me vete». Arben Imami që ishte i pranishëm u hodh dhe më tha. «Mos u thuaj kështu se ata në Tiranë trembën nga hija e tyre». Në këtë këndvështrim nuk mund të mos theksojmë se deri më 28 mars, por edhe në vijim parti të politike mbetën në mes të dy zjarrëve. Ato i donin Komitetet por u qëndronin larg nga frika e akuzave të Berishës që i konsideronte komitetet krahun e armatosur të opozitës.

Të nësermën pjesa e partizuar komitetit të Tepelenës nuk njohu unifikimin e Komiteteve në Gjirokastrë. Si rezultat ndodhi shpërndarja përfundimtare e një pjese të njëzëzve partiakë e me pushtet politik në këtë komitet, duke i hapur përfundimisht rrugë drejtimit të këtij komiteti nga njëzëz si Gjolek Maliaj dhe Robert Targaj. I njëjti fenomen ndodhi edhe në Permet. Duhet gjithashtu të sqarohet në këtë moment se asnjëherë këto komitete nuk mbetën të pastër nga njëzëz që kishin lidhje të drejtpërdrejta me parti të politike, madje edhe nga njëzëz të kamufluar të Sali Berishës apo dhe të SHIK-ut. Ky mbeti, siç e theksuam, një faktor tjetër që ndikoi në mos organizimin e Komiteteve.

K.K.SH.P DHE ANTIPODI FANTASME I TIJ NE VERI

Më datë 13.03, ndërsa njëzëzit e Komitetit Kombëtar të Shpëtimit Publik po përgatiteshin për takimin e Vlorës, takim i cili kishte një rëndësi shumë të madhe (se ishte hera e parë që në Vlorë pas pesë Shkurtit mbledheshin përfaqësues të popullit të rebeluar nga shumë qytete të vendit), televizioni shtetëror emtoi lajmin se në Tiranë ishte themeluar një organizatë e rretheve të Veriut me emrin "Komiteti i Shpëtimit Mbarëkombëtar". Lajmi, siç do të tregonte më vonë spikerja, iu servir në momentin që ajo transmetonte, pa i dhenë asaj mundësi të reagojë. Deklarata e këtij Komiteti, thoshte se Komiteti i Shpëtimit Mbarëkombëtar denonconte Komitetin Kombëtar të Shpëtimit Publik si ngjarje pa precedent, "vepër e shërbimëve të huaja sekrete, që çon në copëtimin e vendit dhe në luftë krahinore" "Cdo sulm kundër nesh, thoshte komunikata, do të ndëshkohet në bazë të ligjeve ushtarake" Ky Komitet që kishte dhe degët e veta, siç pretendonte edhe në disa rrethe veriorë, u bëntë thirrje gjithë oficerëve aktivë dhe rezervist, "të rrembejnë armët për shpëtimin kombëtar"

Prania e "Komiteti të Veriut" në aparençë krijonte përshtypjen e shfaqjes së një tensioni të ri të përmasave Jug - Veri. E verteta është se lajmi për egzistencën e Komitetit të Veriut, edhe pse të gjithë ishin të sigurt se ishte një fantazmë dhe asgjë më shumë, ndikoi shumë në nevojën e theksimit të shprehjeve që kishin lidhje me unitetin midis Jugut dhe Veriut, aq sa të krijohej përshtypja se vertet Komiteti i Jugut fshihte një diçka tjetër nga ato që deklaronte, gjë që s' ishte aspak e vertetë.

Lajmi për krijimin e Komitetit të Veriut, i cili u shfaq pak ditë më vonë edhe me një deklaratë të dytë, ishte më sa duket një përpjekje e fundit, qoftë për ta eksportuar krizën jasht vendit, qoftë për ta t'i ndryshuar asaj destinacionin, ta kthente në luftë krahinash. Këtij plani i shërbente organizimi, pak ditë më vonë edhe i shout televiziv në parlament ku gjenerali B Gazidede, edhe pse kishte dhenë dorëheqjen nga detyra e kryetarit të SHIK-ut, raportonte në Parlament për egzistencën e një plani "LLotus" të Greqisë për aneksimin e Shqipërisë së Jugut.

Këtij qëllimi i shërbente dhe dhenja e urdhërave për shkatërrimin e urave të Shqipërisë së Mesme që lidhnin Shqipërinë e Jugut me atë të Veriut. Një urdhër i tillë u dha në kuadrin e operacioneve luftarake kundër Jugut, më 03.03, dhe bëhej kongretisht fjalë për shkatërrimin e urës hekurudhore, në Qafën e Sokolit në Rogozhinë, ura më e madhe në rajon. Qëllimi i Berishës që i qartë. Konfliktin midis pushtetit të tij dhe popullit kërkonte ta shndërronte në konflikt Jug-Veri duke riaktivizuar një nga tezat që prodhon armiqësi në vend, atë se Greqia kërkon të marrë Jugun.

Kështu duke shkatërruar ura në Shqipërinë e Mesme, rreziku për gjoja aneksimin e Shqipërisë së Jugut bëhej më evident për Veriun e pa informuar realisht. Nisja e forcave nga Veriu për të çliruar Jugun e pushtuar ose të shitur, ndizte përplasjen me Jugun, që ishte ngritur në këmbë kundër pushtetit të Berishës dhe «forcave të Salës» të ardhura nga Veriu për të nënshtruar të parat se kishin «shitur» Jugun

MOSNJOHJA NGA KOMUNITETI NDERKOMBETAR NJE FATALITET I RI

Më 14.03, pra në Vlorë mbledhen përfaqësuesit nga 11 krahina të ndryshme të vendit . Në deklaratën e nënshkruar vihet re që egziston e njejtë frymë e deklaratës së Gjirokastrës. Vetëm se këtu shtrohet në parim nëvoja e rritjes së pjesëmarrësve nga e gjithë Shqipëria, dhe se denohej me përbuzje” si përçarëse dhe me rreziqe të pallogaritshme “ krijimi i Komitetit të Shpëtimit Mbarëkombëtar. Komiteti i drejtonte gjithë popullit Shqiptar “ një mesazh paqeje nga Tropoja në Sarandë” . Përfaqësuesit e rinj që e firmosnin atë ishin nga Himara, Mallakstra dhe Përmeti.

Por vëmendja kuptohet, nuk mbeti serish në takimin midis komiteteve në Vlorë. Ajo u përqëndrua në anijen Italiane “Alizeu».

Pa mbaruar mirë e mirë ky takim, ashtu siç ishte përfolur një grup prej njëmbëdhjetë vetash, përfaqësues të komiteteve, hipën në një helikopter ushtarak Italian dhe u nisën në drejtim të anijës “Alizeu”, diku në mes të detit Adriatik.Takimi më të drejtë, konsiderohej prej tyre si fitorja më e madhe. Ishte një njohje e dyfishtë. Si nga komuniteti ndërkombëtar, ashtu edhe nga kryeministri I ri I vendit. Në fakt njohja nga faktori ndërkombëtar i komiteteve kishte filluar kohë më parë, veçanarisht në bashkëpunimin me Italinë dhe Greqinë për evakuimin e të plagosurve.

Në këtë kuadër , një ditë më parë 13.03 një anije ushtarake greke kishte sjellë në Sarandë një sasi të konsiderueshme me ushqime dhe medikamente të dorëzuara për shpërndarje në Komitetin e Shpëtimit Publik të Sarandës dhe të Delvinës, në prani edhe të përfaqësuesve të pushtetit lokal.

Por sukcesi i takimit me Vranickin , për përfaqësuesit e Komitetëve mbaronte aty që u vendos se do të takoheshin. Kjo ndodhi pasi përfaqësuesit e komiteteve nuk nxorrën as kryetar të delegacionit, as përckatuan një platformë politike se si e shikonin ata zgjedhjen e krizës dhe ecjen përpara të vendit.Në takimin më përfaqësuesin e OSBE-së për zgjidhjen e krizës Shqiptare , F. Vranicki, dhe me përfaqësuesin e Bashkimit Evropian, Zëvendës Ministër I Jashtëm I Greqisë Kranidhiotis, ata përcollën vetëm urrejtjen ndaj Sali Berishës, ku njëri tregohej më i zellshëm se tjetri. Ata nuk i treguan dot se si ishin të organizuar, cili që ndikim i tyre në popull,cilat do të qenë veprimet e mëtejshme për të rrezuar Sali Berishën të rifutur në skenën politike shqiptare, si ndikonin ata në ngritjen e strukturave shtetërore, cilat ishin garancitë që jipnin këto komitete për zhvillimin e zgjedhjeve, cila do të qe në të ardhmën fati i armatimit në duart e popullit, etj.Vranicki edhe pse u tremb nga urrejtja e shprehur nga përfaqësuesit e komiteteve, e kuptoi se deri ku arrinte mesazhi i kryengritësve .

Kështu që në atë anije Vranicki kishte realitetin e vertetë të nivelit të politikës shqiptare më të cilën duhej të bashkopunonte deri në zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Ata ishin udhëheqësit e komitetëve të cilët do të përbenin në të ardhmën sfondin kërcenues kundër Sali Berishës , dhe Bashkim Finua , i cili fliste shumë dhe dukej i gatshëm për të pranuar udhëzime.Për komitetet , këtu fillon kalvari i njohjes dhe i mos njohjes nga faktori ndërkombëtar, nga partitë politike shqiptare dhe nga qeveria Fino. Ky qëndrim dhe harresa e plotë ndaj tyre nga ata që përgatiteshin për të marrë dhe e morren pushtetin, nëpërmjet Kryengritjes Popullore, përbën dhe dramën e madhe të Komiteteve të Shpëtimit Publik dhe njëkohësisht dramën e përspektivës së shtetit shqiptar

STARTI I QEVERISE SE PAJTIMIT KOMBETAR

FINUA NUK E HUMBET RASTIN PER T'U BERE KRYEMINISTER

Sali Berisha menjëherë sapo I vuri partitë politike të nënshkruanin marrëveshjen e 09 marsit, pa pranuar nga partitë politike të shtonin as një presje mbi ato që ai kishte propozuar, u kthye në menyre solemne në fronin e tij duke kthyer njëren pas tjetrës kandidaturat e propozuara nga partitë politike për postin e kryeministrit. Udhëheqësit e opozitës, në vend që t'i bënin presion Berishës që të pranonte të paktën tani propozimin e tyre, u vunë në siklet dhe në kërkim të kandidaturës që do të plotësonte kushtet e Berishës. «Të vinte nga provinca, të ishte I ri dhe të mos qe mbleksur me zhvillimet e fundit.» Kjo do të thoshte të ishte plastelinë në duart e Berishës.

Kandidatura e Bashkim Finos që në fakt një surprizë, për gjithëkënd. Kur e njoftuan ai luante tavëll me ish futbollistin e njohur Sefendin Brahon. Deri në atë moment Finua nuk shqëtësohej fare përsa ndodhnin rreth tij dhe as mirrte pjesë në zhvillimet e fundit në qytetin e vet . Po ashtu kishte kohë që priste t'i hapej një vend pune, deri në drejtor në ndonjë ndërmarrje në qytet dhe lufta më sa duket I kishte prishur të gjitha planet. Lajmi , megjithatë , ndezi në qytet një stuhi të paparë shkrehje armesh që zgjati disa orë. Por kishte në qytet shumë njërez që mendonin krejt ndryshe. Gjetja e Finos në fakt tregoi se shteti shqiptar do të vazhdojë të udhëhiqej nga njërez të rastësishëm dhe të rendomtë provincialë. Shumë të tjerë që njhnin natyrën e z. Fino si njëri të kompromiseve në përgjithësi pa parime , menduan se Berisha pranoi Finon -kryeministër, si njëriun e vet, duke u nisur edhe nga allishevrshet me njëriun e Berishës në Gjioprkastër, ish prefektin Fatos Gjyrezi.

Të tjerë mendojnë se Berisha pranoi Finon kryeminsitër që të mund ta përdorte si klient. Të tjerë mendonin se gjithë historia që këtej e tutje do të zhvillohet përmes kompromiseve dhe lëshimëve reciproke, kështu që Berisha pranoi Finon si një alternativë të propozuar nga Fatos Nano, meqë Finua I ishte gjendur Tosit në burg. Por sido që të jetë, fakt është që në Gjirokastër Finua e kishte gunën të djegur. Vet partia e tij në rreth nuk e kishte ripropozuar për kryetar Bashkie , apo për deputet

Komiteti I Shpeëtimit Publik reagoi krejt ndryshe. Në Gjirokastër edhe mbasditën e 11 marsit ndodheshin akoma Arben Imami dhe Ridvan Pëshkëpinë. Bashkë me Gozhitën ata I vajtën në shtëpi Finos dhe I kërkuan të mos e pranonte propozimin. Një qëndrim I tillë I shoqëruar me një deklaratë do të ishte një mjet tjetër presioni mbi Berishën për ta detyruar të jipte dorëheqjen Por Finua nuk pranoi këtë propozim dhe as propozimin që të paktën të pranonte postin me disa kushte që do ta kufizonin pushtetin e Berishës. U pa që ishte e kot. Finua kishte vendosur që të mos e humbiste rastin për t' u berë kryeministër duke e konsideruar këtë akt si detyrë patriotike. Nëna e tij këmbëngulte se djali I saj I vetëm ishte I zgjuar dhe I zoti dhe e meritonte postin, ndërsa e shoqja jipte intervista në gjuhë të huaj duke mos e fshehur entuziazmin për surprizën.

Të nësermën Komiteti I Shpëtimit Iajmeroi qytetin që të mos qëllohej mbi helikopterin që do të vinte nga Tirana për të marrë Kryeministrin e ri. Para se të largohej për t' u treguar njërezve se do të që një kryeministër I vendosur në realizimin e misionit të vet, deklaroi para gazetarëve se ai “ do të jipte doreheqjen në rast se nuk do të dorëzoheshin armët “ Madje ai vuri dhe nja afat , -deri të dielën .Ai nuk e kuptoi se kjo deklaratë binte në kundërshtim me qëllimin e armatosjës së popullit dhe vet

qëndrimin e komiteteve për të cilat Finua deklaroi se “do t'i takoj për të dëgjuar kërkesat e tyre”. Mëgjithatë , pavaresisht se e kishte apo jo seriozisht, deklarimi se mund të jipte dorëheqjen ishte shpresëdhënëse për logjikën e komiteteve.

FINUA ARRIN NE TIRANE KUR KRYEQYTETI U CMEND DHE VENDI U PERFSHI NE KAOS

Finua sa arriti në Tiranë pretendoi rolin e një kryeministri për pajtim të vertet kombëtar. Ai tregohej tëpër i hapur dhe tëpër popullor, madje vuri në dispozicion të publikut edhe tre telefona të kryeministrisë të cilat vertet funksionuan për pak kohë . Ato , mëgjithëse ishin gjithë ditën të zëna, nuk përcillnin mesazhe për të ndihmuar kryeministrin e ri, por vetëm njoftime për shkatërrime dhe dhunë.

Pa arritur Finua në Tiranë, kryeqyteti ishte përfshirë nga kaosi Më 11.03 ishin hapur depot ushtarake në Shkollën e Bashkuar.Fillimisht nga ky institucion ishin hequr drejtuesit kryesorë dhe komanda kështu që njërezit që ndodheshin atje , nuk kishin si të vepronin, dhe njëkohësisht nuk mund të përballonin turmat e mëdha të njërezve. Po atë ditë sulmohen repartët ushtarake të Zall Herit dhe të gjitha repartet përreth Tiranës.Në krye të sulmuesve ishin deputetë të PD-së.

Hapja e depove dhe armatosja e popullatës po ndodhte me të njëjtat skenare si në Jug edhe në Veri të Shqipërisë, në Kukës, në Shkodër, në Tropojë. Në duart e Shqiptarëve janë tani mbi një milion armë të llojëve të ndryshme ndërsa municioni llogaritet me miliarda. Paralelisht do të ngrihet me një shpëjtësi maramendëse trafiku i armëve . Në këtë kohë në Sarandë disa njërez blinin një automatik 80 dollarë amerikanë dhe një pistoletë TT 100 dollarë.

Tanimë vetëm në disa rrethe të vogla nuk dihej se ç' po ndodhte.Në mbi tridhjet rrethe situta ose kontrollohej nga komitetet, ose ishte jasht kontrollit. Kështu që qëverisë së Finos do të kontrollonte “ vetëm disa kilometra katrorë” siç do të deklaronte disa ditë më vonë vet ai. Më datë 12.03 në mesditë arratiset nga Shqipëria ministri i Mbrojtjes Safet Zhulali me gjithë familjën Jasht shtetit ishte tanimë edhe familja e Berishës dhe të plotë zyrtarëve të tjerë të lartë.

E ndërsa Jugu ishte përfshirë në një kaos vjedhjesh dhe bastisjesh, e njëjta situatë përvijohet dhe në Tiranë. Më datë 13.03 vetëm nga dy spitale të Tiranës vinin njoftime se dhjetë veta ishin vrrarë . Po këtë ditë shpërthejnë burgjet në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë .Si pasojë fitojnë lirinë afro 1500 të burgosur me denime nga më të ndryshme. Përfiton nga kjo situatë edhe Fatos Nano. Ai ikën nga qelitë e 313-ës me makinën e drejtorit të burgut. (Nanua nuk doli në publik e as u ndoq nga simpatizantë të tij. Që të dalë në publik Nanua do të pres datën 16 mars kur Berisha do t'i japi falje midis 52 të denuarve të tjerë.)

Shtetet perendimore po u bejnë thirrje njërezve te tyre që të largohen nga Shqipëria. Italia dhe SHBA-ja ndërmarrin operacione tëpër të veshtira evakuimi të njërezve të tyre në Tiranë. Urdhëri që kanë ambasadat është të heqin nga Tirana dhe serviset e argjenta. Bashkë më ta ikin edhe shumë zyrtarë shqiptarë dhe njërez të tjerë, akoma edhe gazetarë veçanarisht ata që janë shumë pranë Sali Berishës.

Njëkohësisht fillon eksodi masiv sidomoë drejt Italisë dhe Greqisë. Në brigjet e Italisë kanë arritur deri në këtë periudhë mbi dhjetë mijë njërez, gjë që detyron Italinë të kërkojë ndihmën ndërkombëtare dhe të shpallë masa të jashtëzakonshme në kufirin detar me Shqipërinë. Numri i atyre që ikën në Greqi është akoma më i madhë. Në Tiranë mbyllet gjithashtu , aerodromi i Rinasit

Radiotelevizioni shtetëror braktiset nga të gjithë punonjësit e vet dhe transmeton si të mundet. Programet janë të mbushura me thirrje për mos braktisjen e gjithëçkaje dhe të ndalimit të rrokullisjes në të cilin ishte përfshirë vendi.Eshtë momenti që Berisha nga pozitat e numrit një të

shtetit kërkon të gjejë zgjidhje me thirrjen e forcave shumëkombëshe si rrugëdalja e vetme për të rikthyer mundësinë e besimit tek shteti. Këtë mendim Berisha e përpunon në kokë më 13.03. Më 15.03 kërkesa drejtuar Bashkimit Evropian e nënshkruar edhe nga Finua, është nisur. Më 18.03 Bashkimi Evropian e aprovon kërkesën dhe në fillim të prillit parlamenti voton në mënyrë unanim ligjin përkatës, (në 01-02-prill). Në fillim u tha për disa qindra forca. Në vijim numri i tyre arriti në gjashtë mijë e pesëqind. Vendosja e forcave do të fillojë më 15 prill me detyrë kryesore ruajtjen e portëve aerodromëve dhe akseve rrugore për kalimin e ndihmave.

FUNKSIONET REALE TE QEVERISE FINO

E verteta është se edhe pse është publikuar formimi i qeverisë askush nuk i jipte rëndësi asaj dhe as që dihej nëse funksiononte. I vetmi vendimi i marrë prej saj ishte shtimi në masën 300 % të rogës së policëve. Eshtë gjithashtu fakt se Qëveria është më e zbuluar se Presidenca përballë kërcenimeve. Sherbimi i rojës tek Kryeministria rrinte barkas pothuaj gjithë ditën nga frika se hanin ndonjë plumb kokës. Në një situatë të tillë qëveria e Finos nuk mundi të mirrte votbesimin në parlament në datën 13.03, siç që parashikuar. U tha se nuk ishte i përgatitur programi. Por në fakt struktura e qeverisë vetëm atë natë kishte arritur të formohej e plotë. Nga ana tjetër ishte e pamundur të mendoje se në atë situatë, mund të mbledhej parlamenti. Finua doli në televizion dhe dha një mesazh të thenë me të folurën e tij të nxitur. “ Emri i qeverisë, tha Finua, e ka brenda mesazhin për të gjithë popullin »

Ajo që nuk dihej qartë në atë kohë lidhej me rolin e vertetë të qeverisë Fino. De jure ajo mirrte përsipër vendosjen e rendit, çarmatosjen e popullsisë dhe zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme.

Në fakt 9 marsi dhe qëveria Fino mirrte një rol krejt tjetër. Perendimi gjeti këtë zgjidhje për të rimarrë situatën nën kontroll pas shpërthimit në një nivel të pakontrolluar të revoltës popullore. Në vijim mediatorët dhe kancelaritë perendimore nuk e kishin akoma të qartë nëse duhej hedhur Berisha dhe kush duhet ta pasonte. Ose më sakt, cili do të që roli i tij në Shqipëri. Në këtë kohë u rishfaqen dy qendrimet të ndryshme. Senatori Bob Doule do t’ i kerkojë Gjermanisë 14.03 të merrte më shumë përgjegjësi për krizën Shqiptare. Po në këtë kohë Ministri i Ekonomisë së Gjermanisë Shprangel bëri një deklaratë në favor të Sali Berishës, por është kinkeli ai që do ta kundërshtojë një deklaratë të tillë. Ambasadori i SHBA-së në OSBE më 15.03 do të qarkullojë një material ku kumtohej se SHBA kërkojnë dorëheqjen e Berishës. Kjo kërkesë nuk u lexua në seancën plenare të OSBE-së dhe Shtëpia e Bardhë do ta quajë këtë gabim interpretimi. Ideja u vazhdua në Tiranë nëpërmjet zedhenësit të Forumit për Demokraci, por që nuk u materializua dot as të formulohej si kërkesë. Mëgjithatë në këto momente vet Berisha do të mendojë edhe një herë për të braktisur vendin. Një helikopter rri serish i ndezur në presidencë. Por Berisha nëpërmjet zedhenësit njofton se nuk do të japi dorëheqjen duke përgenjshtruar lajmet e emetuara të cilat kishin rritur në jug entuziazmin në një shkallë të tillë sa që u zbrazën tonë me municione.

NJE LETER DREJTUAR KRYEMINISTRIT

Letra, mban datën 17.03. Eshtë dërguar menjëherë pas njoftimit të vet kryeministrit se kërkon ndihmë dhe mendime për drejtimin sa më të mirë të vendit. Letra ka të koncentruar të gjitha tezat që do të përfshihen në qëndrimet e Komiteteve të Shpëtimit Publik deri më 28 mars në

takimin e Vlorës. Por Kryeministri mësoi shumë shpejt në Tiranë gjëra që kishin një drejtim tjetër nga ato që kishte parë por që vazhdonin të ndodhnin në Jug dhe e kishin bërë atë kryeministër. Objektivat e kësaj letre janë bërë në vijim thelbi I qëndrimëve të K.K.SH.P.

Zoti Kryeminister

Opinionin ndërkombëtar dhe Komitetin Kombëtar i Shpëtimit Publik, që përfaqëson popullin e armatosur, kosiderojnë shkaktar përkatësisht të pjesës dhe kryesor të krizes në vend dhe vazhdimin e saj, Sali Berishën. Këtë nuk e bëjnë vetem forat politike Shqiptare (!!). N,q,s nga brenda vendit nuk do të këtë një reagim dhe vendosmeri për ta detyruar Atë të japi dorëheqjen, jo vetëm, mendoj, se kriza do të shkallëzohet, por krijon precedent që opinionin ndërkombëtar të ndryshojë mendim në favor të atyre që mendojnë se Ai është i pazëvendësueshëm, gjë që vë në rrezik çdo sakrificë të deritanishëm

Së dyti . Qëveria që ju drejtoni fitoi , me të drejtë dhe përkrahjen e Komitetit Kombëtar te Shpëtimit Publik, i cili nuk i përket më vetëm Jugut. Mirëpo, bashkëjetesa e kryeministrit nën ormbrellën e presidentit për një kohë më të gjatë se deri tani, ka rrezik të vë në pykëpyetje qëndrimin e deritanishëm pozitiv të K.K.SH.P ndaj kësaj qëverie.

Për këtë

Mendoj se , brenda kuadrit ligjor, t'i kufizoni kopetencat e shtuara që ai ka gëzuar padrejtësisht. Cdo kontakt me të të minimozohet ose të bëhet nëpermjet personaneve të tjerë. Të jipet nga ana juaj një deklaratë ku të lihet të kuptohet se edhe ju e kërkonin këtë dorëheqje,

Në këtë kuadër, mendoj se duhet të kalosh inisiativen e dialogut në duart e qëverisë. Për këtë duhet të thërasni, mendoj dhe të drejtoni ju një tavolinë të Partive politike me një rend të përcaktuar në menyrë rigoroze.

Po ashtu duhet të kërkonin nga parlamenti të anullojë gjithë dekretet e Presidentit që lidhen me situatën e kohëve të fundit dhe të kërkonin urgjentisht largimin e të gjithë atyre personave që u lidhen drejtpërsdrejti me ngjarjet e fundit , apo kanë emer të keqe në qëveri.

Të realizoni , një takim me Komitetin Kombëtar të Shpëtimit Publik dhe përvec propozimeve të tyre t'u propozoni që të emerosh prefekte, sipas vullnetit të tyre me qëllim që të fillojë të lëviz makina shtetërore.

Mendoj gjithashtu që të shkurtohet sa më shumë që të jetë e mundur koha për caktimin e datës se zgjedhjeve

Po ashtu duhet te ndiqet me perparesi problemi se kush i kontrollon forcat që veprojnë në Tiranë

FINUA SFIDON KOMITETET QE TA KETE MIRE ME BERISHEN

Përkeqësimi në mënyrë të paimagjinueshëm I situatës jo vetëm në Tiranë por në të gjithë vendin, në Jug edhe në Veri, mënjëherë pas krijimit të Qëverisë së Pajtimit Kombëtar ishte më sa duket një reagim I ri I qarqëve rreth Berishës, pas suksesit të arritur me marrëveshjen e 09.03,për të mbetur pjesë e lojës politike Shqiptare. Nga ana tjetër në popull atëherë ishte përhapur gjërësisht

ideja se ata pak njëz që I qëndronin nga pas Berishës në ato ditë të veshtira marsi, ku kishte ndodhur evakuimi I gjithkaje të huaj dhe I pjesës më të madhe të pushtetarëve , më shumë se ruanin Berishën dhe nuk e linin të largohej, mbronin vetën e tyre . Kuptohet që largimi I Berishës shënonte lenjën e tyre në mëshirë të fatit.Por siç u theksua dhe më lart, Berisha, fuqitë që dispononte akoma I lëshoi në drejtim të shaktërrimit të asaj që kishte mbetur. Kështu ai tregonte «zotësinë» e vet për të mbrojtur më mirë se kushdo tjetër shtetin.

Mdërkohë, funksionimi I Finos nën ombrellën e Berishës filloi të lekundte përkrahjen e komitetëve të Jugut . Këto komitete të mbledhura, në Ballsh, më 17.03 nga 12 rrethe të vendit, edhe pse do të këmbëngulin që partitë e opozitës të shprehin hapur qëndrimin ndaj Berishës, (madje atje u përvijua dhe ultimatumit I njohur për dorëheqjen brenda tri ditëve të Sali Berishës që tronditi vecanërisht SHBA-në) dhe I nxiste ato, partitë, të ndërmyrrnin hapa konkrete për t'u imponuar Berishës për dorëheqje. Një presion I tillë shtrohej nga ana tjetër dhe ndaj qëverisë Fino. Finos I thuhej hapur se “vazhdimi I baskëpunimit të kësaj qeverie me Sali Berishën, I heq të drejtën K.K.SH.P, për të vazhduar mbeshtetjen ndaj saj”. Po ashtu I kërkon asaj të njoh strukturat shtetërore të inicuar nga K.SH. P të rretheve, të cilat do të funksiononin deri në zgjedhje të reja. Por Finua nun bëntë as njëz as tjetz.

Një ditë më vonë, më 18.03, del në publik një deklaratë e dytë I Komitetit Mbarëkombëtar të Shpëtimit Publik që thoshte se është organizatë ushtarake, përkrah si Berishën ashtu dhe Finon dhe u kërkon partive që të respektojnë marrëveshjen e nëntë marsit .Kuptohet që kjo deklaratë ishte një kundërpeshë e deklaratës së K.K.SH.P të Ballshit.

E rëndësishme është këtu të theksohet deklarata e një dite më vonë nga ana e Finos mënjëherë pas takimit të tij me përfaqësuesit e dhjetë partive politike të marrëveshjes së 09.03. Finua do të deklarojë se “ ne do ta qeverisim vendin jo nën diktatin e ultimatumëve ngado që të vijjë ato “ Kjo deklaratë bëhet në fakt për të kundërshtuar vendimin e Komitetit Kombëtar të Shpëtimit Publik në Ballsh. Kështu Finua merr hapur në mbrojtje Berishën . Për të treguar devotshmerinë e tij në këto deklarata ai mënjëherë pas takimit më partitë politike njofton në Gjirokastër me telefon komandantin e K.SH.P A. Gozhitën , se nuk do të vinte të nësermen në Gjirokastër, siç kishte lajmëruar. Finua u kishte premtuar komitetëve se do të shkonte edhe në Ballsh por nuk vajti.

QEVERIA E FINOS PERBALLON «ME SUKSES INCIDENTE DIPLOMATIKE»

Kryeminsitri Fino nuk do të shkojë në Gjirokastër edhe për një arsye tjetër. Për të shmangur takimin me zëvendësministrin grek Janos Kranidhiotis I cili më 19-20 .03 vizitoi Gjirokastrën dhe Sarandën. Refuzimi I një takimi të tillë ishte drejtpërdrejt ndikim I qëndrimeve të PD-së.Preteksi qe u gjet është se vizita nuk kaloi në analet e njohura diplomatike.(!) Kjo vizitë ishte përcaktuar që kur Finua u takua me Kranidhiotin në anijen italiane më 14 mars. Atje Finua u shpreh I gatshëm për një vizitë të përbashkët në Jug. Finua u pëngua nga njëz e Berishës për të ardhur në Gjirokastër pikërisht se kjo vizitë lidhej ndërmjet të tjerash edhe me njohjen e rolit të komitetëve.Po ashtukjo vizitë bëhej pikërisht vetëm disa ditë pasi Athina zyrtare kishte prerë përfundimisht «komunikimet» me Berishën.(shih më posht) Në këtë kuadër jo vetëm Finua nuk duhet të vinte por të pëngohej edhe Kranidhiotis.

Kranidhiotis erdhi në Gjirokastër dhe Sarandë.Askush nga të gjitha strukturat e pushtetit lokal, partitë politike dhe komitetet nuk shprehën ndonjë rezervë për këtë vizitë.Madje vizita u konsiderua shumë e vlefshme se konkretizohej në më shumë plane ndihmën e dhenë Jugut dhe

Shqipërisë nga ana e Greqisë. Nga ana e vet delegacioni grek bëri shumë kujdes që të mos linte asnjë përshtypje të kundërt veç qëllimit që deklaronte.

Zëvendës Ministri I Jashtëm grek u takua si me përfaqësuesit e Komitetëve, të Gjirokastrës , Sarandës, Permetit. Tepelenës dhe Memaliajt, ashtu dhe më përfaqësues të Pushtetit Lokal . Fakt është që si përfaqësuesit e partive politike dhe të pushtetit lokal , ashtu edhe përfaqësuesit e komiteteve I kërkuan zëvendësministrit të Jashtëm Grek ndihmën direkte të Greqisë nëpërmjet kontributëve të veta, por edhe indirekte nëpërmjet rolit të saj në organizmat ndërkombëtare, për kthimin e normalitetit në Shqipëri. Komitetet deklaruan se nuk do t'i lëshonin armët nga dora pa dorëheqjen e Sali Berishës. Madje ata kritikuan ashpër qëndrimin e ambasadorit grek në Tiranë I cili disa ditë më parë kishte berë thirrje për dorëzimin e armëve pa kushte. Në këtë kuadër ata I deklaruan z. Kranidhjtis se në asnjë mënyrë nuk do të lejonin praninë e forcave shumekombeshe në jug të vendit me synim çarmatosjen e kryengritësve. Ata I drejtoheshin Kranidhjtisit edhe si përfaqësues i Bashkimit Evropian I cili vendimin për ardhjen e këtyre forcave në Shqipëri e kishte marrë një ditë më parë.

Duke u nisur nga fakti se Finua e kishte dhenë Ok-in për vizitën e Kranidhjtisit në Jug, se qeveria shqiptare nuk kontrollonte veçse disa kilometra katrore vend rreth kryeqytetit, duke qenë se Jugu shumicën e problemeve jetësore i zgjidhte me Greqinë ose nëpërmjet saj dhe se fundi , duke u nisur nga fakti se qeveria greke ishte, në ato momente, më e interesuara për ruajtjen e integritetit të Shqipërisë, reagimet e Tiranës për shkeljen e rregulave diplomatike, lidhur me këtë vizitë dhe pretendimi se pas saj fshiheshin qëllime aneksioniste, nuk ishin gjë tjetër, veçse një përpjekje e atyre segmenteve që kontrollonte akoma Berisha edhe në qeveri për t'i mëshuar idesë se Jugu kërcenohej nga Greqia. Viktimë e këtyre qëndrimeve ra dhe Finua, I cili edhe pas disa ditësh do të shfaq mendime të njëjta në takimin që pati me përfaqësues të Komitetit të Shpëtimit Publik të Vlorës. Këto segmente pra, nuk thanë kurrë,se kush I mbrojti kufijt e Shqipërisë me Greqinë. (!) Po ashtu duhet theksuar se vetëm dy javë më parë Tirana e përfaqësuar atëherë nga qeveria e PD-së, I kërkonte Athinës nëpërmjet ambasadorit grek në Tiranë mbeshtetje për asgjesuar «rebelet».

Nga ana e vet Ministria e Jashtëm Greke e hodhi posht notën e protestës të palës shqiptare.Nuk e mori atë seriozisht dhe u tregua vazhdimisht e gatshme për të ruajtur marrëdhënie të mira me Shqipërinë dhe të mbante peshën që I takonte nga kriza shqiptare. Vet Ministri I Jashtëm grek Pangallos do të deklaronte disa javë më vonë , duke vizituar Tiranën se « Ndihma për Shqipërinë, është ndihmë për mbrojtjen e integritetit të vet»

FINUA FILLON T'I SHIKOJE ME DYLBË KOMITETET (Vizita e tij në Athinë «vezhgohet» nga Prodi)

Në Gjirokastrë Finua do të zbres më një prill një ditë para se të ikte për vizitë në Athinë.Asnjë seriozitet si kryeministër.Shoqëruesit e Finos dhe personeli I komisariatit të Gjirokastrës humbasin midis dhjetrave kryengritës të armatosur.Supërioriteti I tyre lidhej me atë se u jipej mundësia për të kryer një rol. Sjellja e Finos I vinte rojet në siklet për detyrën që kishin, ta mbronin apo të mos e mbronin. Edhe njëherë e pranishëm e përballonin si njëri të zakonshëm , megjithse kishhte nga ata që nuk harruan zakonet,- servilosjen.

Kryeministri shqiptar as këtë herë I takon përfaqësuesit e Komitetëve. Kërkësës për një takim të tillë Finua I përgjigjet “ Lëri mo ata tani se kush I dëgjon ata në Tiranë” Në një takim që organizon në Bashkinë e Gjirokastrës me njëherë pa asnjë protokoll Finua do të prononcohet për

Komitetet:-” Ato nuk diktojnë por vetëm propozojnë. Ne njohim vetëm pushtetin lokal dhe bëjmë dialog më të gjithë bile edhe me kriminelet”, tha Finua duke provokuar kështu rendë udhëhëqesit e Komitetëve. Gjolek Malaj braktis sallën në mënyrë demonstrative dhe e paralajmëron Finon se nuk do të lejohet të vizitojë Tepelenën .

Në Tepelenë Finos I rezervohet një pritje shumë e ngrohtë . Kishin dalë për ta përshëndetur mbi dhjetë mijë veta. Ishin të terë kundër Sali Berishës, por Finua mendonte se kishin dalë për të, kështu që s’ kish si ta kuptonte mesazhin e tyre.

. Nga ana tjetër Berisha e ka të bllokuar gjithëandëj Kryeministrin Fino.Ndër katër ligje që futi për tre javë në parlament qeveria e Finos parlamenti I PD-së dhe Berisha kthyen tre. Finua tregon se s’ ka fuqi që të bejë asnjë ndryshim në Radiotelevizion, lodhet shumë edhe kot për të hequr njëri të inkriminuar dhe që kontrollojnë akoma rendin në Shqipëri. Përpjekjet e Finos për të shkarkuar Agim Shehun nga kabineti I tij do të mbëtën anektodikë.

Presioni nga ana e komitetëve, të bindur se Qëveria e Pajtitimit Kombëtar nuk mund ta kryejë misionin e vet nën ombrellën e Berishës, vazhdon të rritet për të arritur pikën maksimale pas Tepelenës , më 21.03.97 dhe në takimin e Vlorës më 28 .03. Në Vlorë gjashtë parti politike të pranishme në takim detyrohen jo vetëm të rreshtohen, të paktën në deklaratë, me komitetët, jo vetëm përse u përketqëndrimit ndaj qëverisë, por edhe në dy qëndrime bazë të deklaratës së Vlorës : - Në dorëheqjen e Berishës dhe në shndërrimin e parlamentit vetëm në funksion të Qeverisë së Pajtitimit Kombëtar.

* * *

Tek sa pas kthimit nga Tepelena Finua po bente gati valixhet dhe personat që di ta shoqërojnë të nesermën në Greqi, vjen lajmi se para se të largohet kërkon një takim në Gjirokastër, kryeministri Italian Romano Prodi. Agjensite e lajmëve nuk duan ta pranojnë si të vertetë lajmin aq më tepër se ishte dhe një prilli, dita e gënjeshtreve .Vizita e Prodit konfirmohet me gëzim nga homologu shqiptar.Gëzimi qëndronte tek rendësia që tanimë ai demonstronte tek vendlindja e tij . Por kur udhëtimi I Prodit filloi të shqëtësonte qarqet diplomatike , ai kërkoi ndihmë për t’u sqaruar. Prodi në Gjirokastër disa minuta para se Finua të nisej për Greqi , do të dukej sikur Prodi donte ta instruktonte Finon për vizitën në Athinë. Pas tundimesh të shumta Finua vendosi, aty në të gdhirë pothuaj, për ta pritur Prodin në Gjirokastër.Nuk I dihej, tundimi I tij ndoshta lidhej dhe me qëndrimin e palës greke.

Prodi erdhi. Gjashtë helikopterë të medhenj në orën tetë të mëngjesit u çfaqën kësaj here nga ana e Malit të Gjerë, duke e trembur qytetin me zhurmën e tyre por edhe me marinsat që transportonin.Shumë pak njëri, më shumë kureshtarë dukeshin në rrugë. Qëllimi I deklaruar I vizitës së Prodit në Gjirokastër e shtoi dyshimin për qëllimin e vertetë të takimit me Finon në Gjiroakstër pak para se ai të vizitonte Athinën. Në takimin kokë me kokë për rreth 35 minuta , siç deklaruan më pas , Prodi I kërkoi Kryeministrin Shqiptar të rikonfrmonte edhe një herë vullnetin e palës Shqiptare për pranimin e Forcave Shumëkombeshe në vend, se atë pasdite çeshtja do të votohej në parlamentin Italian. Finua edhe pse atij I tha dakort, tha gjithashtu se vendimin do ta mirrte qëveria e cila do të mblidhej pasi ai të kthehej nga Greqia.Misteri u shtua edhe më kur Prodi, sipas Finos, erdhi për të shprehur ngushëllimet për viktimat e kanali të Otrantos tri ditë më parë.(!!)Kuptohet, midis tyre të dy burrat nuk thanë asgjë në lidhje me vizitën në Greqi por në diplomaci nuk kanë vlerë vetëm veprimet apo dhe deklaratimet, por edhe lëvizjet kongrete.

Vet zhvillimi I ngjarjeve do të provojnë se Italia veçanërisht, do të synojë të krijojë një imazh të tillë patronimi të marrëdhënjeve të Tiranës me Athinën.

POLITIKANET LEXOJNE QELLIMET E BERISHES DHE MENDOJNE TE REAGOJNE

Berisha nga ana e vet kishte vendosur t'i godiste opozitaret në qeveri, natë e ditë në mikroepisode dhe deklarata të vazhdueshme, më qellim që t'i mbante të izoluar në Tiranë , ku ai kishte tanimë të vetmën qendër dhe strukturat e tij ishin në efikasitet të plotë.

Duke l ndjekur me kujdes ngjarjet e asaj periudhe, lexohen mjaft mirë veprimet dhe qëllimet e Berishës. Dalëngadalë ai kaloi nga faza e rifutjes në jetën politike Shqiptare në fazën për të ripretenduar pushtetin. Realizimi i këtij qëllimi as që mund të mendohej në kushtet e egzistencës së Komitetit Kombëtar të Shpëtimit Publik. Midis tij dhe komitetëve ishte shpallur një konflikt për jetë a vdekje. Berisha synonte të dobësonte dita ditës rolin e tyre aktiv politik dhe inisiativën e tyre për të rifutur në funksionim makinën e shtetit në nivelin lokal. Pikë se pari synonte hapur që ato të mbeteshin të paorganizuara. Nga ana tjetër Berisha mxihi në maksimum krimin ordiner dhe të organizuar. Ky kriminalitet kishte në fakt një bazë , atë ekonomike, por pikërisht pas kësaj fshihej përfitimi politik . Rivaliteti i bandave me preteks ekonomik fshihte në fakt konfliktin politik. Gjithashtu për qëllimin e vet Berisha aplikonte taktikën e bllokimit në çdo hap qeverinë e Pajtitimit Kombëtar sidomos kur ajo ndërmyrte hapa që çonin në zhvillimin sa më afër të zgjedhjeve elektorale. Se dyti u mundua të mbante sa më larg Komitetët e Shpëtimit Publik nga partitë politike të opozitës. Kështu që në një fragmetarizim të tillë të jetës në vend ai mund të percaktonte rregullat e lojës.

Por dalëngadalë politikanët do ta kuptojnë se po të mos reagojnë kundër Berishës, do të mbetën në rrjetën etij. Më 23.03, nën drejtimin e Fatos Nanos udhëheqja e lartë e Partisë Socialiste së bashku me ministrat në qeverinë e Finos bënë një mbledhje shumë të gjatë pas se cilës, zedhënësi i saj Kastriot Islami do të deklarojë: “Në rast se Partia Demokratike do të vazhdojë të pengojë veprën e qeverisë duke u përpjekur të mbajë në këmbë ato struktura në të cilat u mbështet regjimi i Berishës, ne do të reagojmë energjikisht”,- tha Islami duke lenë hapur të kuptohet se PS-ja mund të tërhiqet nga qeveria.

Nga ana e vet Bashkim Fino në takimin e Romës të Ministrave të Jashtë të vendeve anëtarë të BE, më 25 .03 do të deklaronte se “Qeveria e tij has në shumë pengesa serioze dhe se ai do t'i thoshte me emrin e vet përgjegjësit e kësaj gjendjeje”

Njëherë shumë afër Finos , tregonin se stafi i tij ishte i detyruar të punonte nën presionin e njëherë të ndryshëm që i dedikoheshin PD-së dhe Sali Berishës, gjë që mund të çonte në dorëheqjen e vet zotit Fino. Mirëpo kjo nuk ndodhi as kur disa javë më vonë Parlamenti i PD-së votoi ligjin elektorale që deshë Sali Berisha dhe jo atë që propozonte qeveria e Pajtitimit Kombëtar. Sjellja standarte në këtë linjë nga ana e PD-së e detyroi në një moment udhëheqësin e socialistëve të largohet shumë i nervozuar nga tavolina e dhjetë partive politike. Një veprim i tillë, linte si shteg të vetëm për politikanin Nano, atë që të çonte në Vlorë. Por Nanua nuk do ta marri atë mundim as atëherë, as më 12 prill, kur u këshillua me miqtë e tij nëse duhej të zbriste në qytetin martir, e as gjatë gjithë majit. Fatos Nanua do të shkojë në Vlorë vetëm njëzet ditë, 09.06, para zgjedhjeve. Po krijohej precedenti . Opozita sa herë vendoste e pavarur nga tutorët e huaj , mirrte vendime të prera dhe të ashpra ndaj Berishës. Por detyrohej t'i «rishqyronte», kur ngrinte telefonin dhe komunikonte në gjuhë të huaj.

Deri atëherë ishin vlarë jo më shumë se 40 veta. Pas nëntë marsit numri i tyre i kaloi të dy mijë vetat. Pas kësaj date fillon seriali i grabitjës së bankave, i shembjës së urave dhe i terrorit mbi njërezit e thjeshtë. Është pikërisht momenti që Berisha firmosi humbjen e tij, por që fiton të drejtën për të mbetur në lojën politike shqiptare. Është momenti që partitë politike firmosin fundin e kryengritjës popullore duke e tradhetuar atë. Pas kësaj mpleksja e krimit politik me atë ordiner nuk dihet se ku fillon e ku mbaron, ashtu si nuk dihej ku mbaronte kriminelin dhe ku fillonte politikani, gjë që bën situatën kaotike, shpërthyes dhe të frikshme.

STRUKTURA E KRIMIT POLITIK,- ROLI I GARDES

Në një nga pika e operacionit ushtarak kundër jugut flitet edhe për "Organizimi i terrorit në popullsinë e qytetit të Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës Permetit, Tepelenës, nëpërmjet djegjeve shkatërrimëve të objekteve të ndryshme, që të paralizojnë jetën publike". Kjo gjë do të realizohej nëpërmjet "Vendosjës së lidhjeve direkte midis forcave qeveritare dhe repartëve të policisë, SHIK-ut dhe forcave të besushmërisë së lartë të cilët do të armatoseshin nga shtabet e gjendjës së jashtëzakonshme me armatim të lehtë dhe që do të shërbënin si baza të besueshme dhe të qëndrueshme për forcat qeveritare" Dy ishin në fakt njësitë ushtarake që do ta realizonin këtë qëllim Garda Presidenciale dhe SHIK-u. Pas vendosjës së gjendjës së jashtëzakonshme, gjithkush që mbante armë për llogari të shtetit u vu nën komandën e ish kryetarit të SHIK-ut, B Gazidede Mëgjithatë, gjatë kësaj periudhe, sipas pohimeve të prokurorëve që hetuan problemin e Gardës Presidenciale, njësi të saj, në kundërshtim të plotë me ligjin, ishin armatosur me armë nga më të sofistikuar, deri edhe raketa. Kanë ndërmarrë ekspedita ndëshkuese në Jug të vendit. Prokuroret pohojnë se ka shumë raste të aktivizimit të Gardës për situata që nuk i përkisnin aspak asaj, e që po të ishin realizuar pasojat do të kishin qenë tragjike. Midis të tjerash flitet edhe për një rast ku është mobilizuar garda edhe me tanke për të venë nën kontroll një zonë rebele, por që më pas ekspedita është ndërprerë.

Më pas ndërhyrjet e gardës në punët e policisë, gjatë periudhës deri në zgjedhje, shtohen. Në Tiranë forcat e policisë dhe të krimëve disa herë janë konfrontuar deri edhe me armë me forcat e gardës. Titullarë të asaj kohe në polici kishin deklaruar në shtyp se kishte skuadra të gardës që nuk dihej se kush i komandonte. Por përplasja midis Kryeministrit Fino dhe Sali Berishës pak para zgjedhjeve, kur Berisha kërkoi të vinte nën kontrollin e gardës Kryeqytetin, pra të organizonte një grusht të vogël shteti, vertetoi plotësisht se kush i komandonte ato dhe cili ishte qëllimi. Po ashtu natën e 29.06 një grup i gardës rrethoi një qendër votimi në Laprakë duke sulmuar anëtarët e komisionit.

Shumëfishimi i gardës ishte bërë nga persona që nuk figuronin në asnjë listë dhe dokument që ka lidhje me Gardën Presidenciale. Nga këto dokumenta mungojnë dhe emrat e disa protagonistëve të ngjarjës tragjike të Cerrikut, ndërsa ndonjë, apo disa nga të vlarët e Cerrikut mbetën për tri javë në morgun e Tiranës pa u identifikuar. Problemi që shtrohet është se kush i paguante dhe nga rridhnin fontet për pagesën e tyre? Kështu që duhet marrë në konsideratë fakti që askush nuk ka përgenjështuar pohimet se një pjesë e parave të grabitura nga bankat, shkonin për financimin e këtyre grupeve.

Po ashtu nuk ka asnjë dyshim se garda ka qenë një nga repartët që ka marrë pjesë aktive në shumicën e aksioneve në Jug. Arëstimi në Tepelenë më 06.03, ditën që u vra me snajpër në kokë një i ri tepelenas, i tre oficerëve të Gardës Presidenciale është një tregues i qartë se

operacionet ushtarake do të gërshetoheshin me veprime terrorizuese. (Këta ishin Skëndër Kalemi, ndërlidhësi Behar Trimi dhe Adem Hasa, anëtarë të një grupi. Asqeri Zeneli ishte drejtues i grupit tjetër më qëllim po Tepelenën . Ata, siç pohuan edhe vet pas 15 ditësh të arrestuar të Komitetit të Shpëtimit Publik të Tepelenës, ishin të derguar të Agim Shehut për të vepruar në zonën e Tepelenës , shih më lart) Kur deshti pjesa ushtarake e planit , mbeti për t' u zbatuar ajo e gërryerjës së strukturave kryengritëse nga brenda.Pas nëntë marsit kjo skemë mbeti në fuqi dhe u shty me zell përpara edhe me qëllimin për t' l lënë,siç e thamë, kundërshtarit politik që po mirrte pushtetin tokë të djegur.

ELEMENTE TE TJERE TE KRIMIT TE ORGANIZUAR

Vjedhja e bankave , shkatërrimet e objekteve te karakterit social e kulturor në Vlorë vetëm një ditë (05.04) pas deklaratës së komitetëve se qenë dakort për viziten e Krymenistrit Italian Prodi në Vlorë, incidenti i Urës Vajgurore dhe ai i Cerikut ku humbën jetën gjashtë njëzëz. Organizimi dhe drejtimi në mënyrë ilegale nga ana i ministrit të rendit Belul Celu dhe Sokol Mulosmanit të grupëve të ndryshme por të armatosur, tregon qartë sa ishte i vertetë predispozicionin e Berishës për pajtim kombëtar. Sokol Mulosmani më këto trupa, në emer të rivendosjës së rendit, hapte në Veri rrugën e Berishës për fushatë elektorale. Po ashtu në shumë rajone të Jugut, Berat , Vlorë Gjirokastrë, acarimi i situatës, bëhej shpesh me qëllim që vet autoritetët lokale të detyroheshin të kërkonin praninë e këtyre forcave. Mëse dy herë, pushteti lokal i Gjirokastrës kërkoi ardhjen e forcave speciale. Ato vajtën në Berat dhe rezultati shumë shpejt qe i kundert.

Përplasja e fuqishme me armë e bandave që në pamje të parë dukej si një përplasje e tyre për larje hesapesh apo dhe përpjekje për të kontrolluar një sektor të caktuar ishte në fakt shprehje e nxitjës dhe e ushqimit të kimit dhe terrorit nëpërmjet strukturave egzistuese apo edhe atyre të ngritura enkas por, siç thamë, kontrolloheshin nga njëzëzit e pushtetit egzistues.Me ditë të tera në Vlorë vazhdonte përplasja më armë nga më të ndryshme i bandave që në fakt shprehnin palë politike.Qyteti për ditë me rradhë veçanarisht gjatë gjysmës së dytë të prillit dhe deri disa disa orë para zhvillimit të zgjedhjeve, ishte ngujuar tërësisht nëpër shtëpi. Goditëshin me antitank shtëpi të kundërshtarëve. Shpesh këto veprime luftarake në rrugë e sheshe, që të kujtonin filma artistikë , zhvilloheshin nën hundën e forcave shumëkombëshe. Gaxhai e Zani, psh, ishin dy emra që kundërshtonin njëri tjetrin në dukje për motive ekonomike.Rrezja e veprimit të bandave të tyre mbliidhte njëzëz deri në Tepelenë.Ato krijonin situatë terrori për të përfituar ekonomikisht. Bandave u interesonte terrori për të përfituar ekonomikisht. Ata që ishin pas tyre u interesonte terrori për të përfituar politikisht. Veprime të njejta kishte po ashtu në Berat, në Tepelenë apo edhe në Fier e Gjirokastrë.Siç edhe më lart e theksuam, zemëreku i l lëvizjës së tyre ishin paratë, ustallarët korrnin përfitim politik

Një mjet tjetër që u përdorë në këtë periudhë me qëllim që Berisha t'i shmangej presionit popullor, ishte dhe provokimi i përplasjeve midis grupeve të krahinave të ndryshme , apo dhe njëzëzve të komitetëve dhe të rendit me banda që vepronin për motive të pastra politike. Një përplasje e tillë filloi dhe u shmang në Gjirokastrë midis Tepelenës dhe Lazaratit. Situata mori përmasa të rrezikshme në Tepelenë dhe Memaliaj kur një bandë me njëzëz shumë afër Blerim Celës hynë në Memaliaj dhe vranë pa kurfarë arsyeje një nënë dhe fëmijën e vet pesëvjecare si dhe dy persona të tjerë. Më pas ata u ngujuan në një pallat dhe qëllonin këdo që levizte nëpër qytet.Njëzëzit e bandës kërkonin që kundër tyre të vendosej Komiteti i Shpëtimit Publik dhe forcat e rendit të riorganizuara atëherë nga Komitetit i Shpëtimit Publik.

Po në këto ditë makina të blinduara I drejtoheshin Tepelenës për të transportuar armë të sofistikuar, por edhe për të terhequr anëtarët e bandës që kërkonte domosdo kundërshtarë. (Të njëjta makina u ripanë dy ditë më vonë në masakrën e Cerrikut) Qëllimi që I qartë. Të futnin në kurth komitetet dhe forcat e rendit për një përplasje brenda në qytet me qëllim që pas kësaj të fillonte një reaksion zinxhirë vrasjesh ku më siguri do të njollosej emri I Komitetit të Shpëtimit Publik. Mirëpo as komitetet dhe as forcat e rendit të Tepelenës nuk ranë viktimë e këtij kurthi.

Ndërkohë janë të njohura tanimë dhe veprimet e hapura më qëllimë ta caktuara politike . Më 04.04, po atë ditë që Komiteti I Shpëtimit publik në Vlorë dha OK-in për vizitën e Krymenistrit Italian Prodi në Vlorë, vetëm një javë pas tregjedisë së Otrandos, (Vizita u realizua më 12.04), në qytetin e Vlorës u demtuan rendë një varg qëndrash social-kulturore, të cilat nuk ishin objekt I bastisjeve të zakonshme për motive përfitimi, pasi asgjë nuk u vodh, vetëm u shkatërrua ,(shpëtoi vetëm TELEKOM-i, në saj të mbrojtjes që I bënë vet qytetarët).

Natën e datës 15.04 nga dy makina, njëra e blinduar, njërez të armatosur me armë jo të zakonshëm, hapin zjarr mbi Hotel Bolonja. Atje qëndronin gazetarë të huaj që hanin darkë me anëtarë të Komitetit të Shpëtimit Publik të Vlorës në pritje të ardhjes të nësermën në Vlorë të Vranickit. Vranicki , më ndërhyrjen ultimative të ambasadorit Italian Paulo Foresti nuk do ta vizitojë Vlorën. Kuptohet që vajtja e Vranickit në Vlorë do të shenonte një njohje të kryngritjes popullore, dhe incidenti i drejtuar ishte një argument që Foresti, kur dihet roli I tij , të bindte Vranickin se në Vlorë nuk ka garanci « ose ai të shkonte atje me antiplumb» Në po këto kategori përfshihen edhe incidenti I 23 majit në Cerrik ku si pasojë I ekspeditës ndëshkimore të njësive të Gardës kundër Cerrikasve që nuk pranuan vizitën e Berishës humbën jetën 7 veta, apo edhe incidenti tepër I rendë I Urës Vajgurore, incidenti më vonë I vilës në Elbasan, etj

KRIMI POLITIK DHE ORDINER FENOMEN I KALBJES SE SHTETIT

Rendësi kishte të shpëtoje kokën. Më këtë logjik një nuse e re pranon t'i presin gishtin për t'i marrë unazën

Situata përbënte gjithashtu një deshmi të dekombozimit maksimal të shtetit dhe veprimi kriminal ishte pa tjetër edhe produkt dialektik I këtij procesi dekombozues.Aksioni politik I kryengritjes ishte frenuar praktikisht plotësisht , nga fakti se tanimë në Tiranë ishte formuar një qeveri e pranuar nga opozita dhe nga vet kryengritësit.Cdo gjë të kujtonte teorinë e ujit të ndenjor që prodhon kalbje. Po të shikohet në këtë periudhë ata që kontrollojnë, mbisundojnë dhe provojnë egjencën e shoqërisë dhe të shtetit janë njërezit e bandave, të cilët nuk është vetëm se janë bërë përsona publik, por imponojnë dhe respektin e shoqërisë ndaj tyre. Pikërisht në një moment të tillë ndodh ajo pleksje e fenomenëve të një procesi anarkik ku krimi I organizuar shpesh fshihet pas krimin ordiner të ditës

Më 11-12 mars në Gjirokaster ishin bastisur dhe zenë më forcë një serë institucionesh shtetërore si bashkia,spitali ,mitropolia e kishës ortodokse,azili I pleqve kopshte, konsulltorja, banka e kursimeve, etj. Digjen në mënyrë të plotë zyrat e doganës pranë qendrës së shtypit dhe një ditë më vonë edhe zyrat e kartotekës pranë gjykatës. Ishte edhe ky një veprim që tentonte të humbiste gjurmët. Jashtë këtij cikloni nuk mbëtën as zyrat e gazetarëve në qendrën e shtypit.

Në Sarandë po atë ditë, ishte bastisur e djegur hotel turizmi Butrinti, shtëpia e pushimit të punëtorëve, Banka tregëtare dhe bujqësore. Banka këtu u grabitën pasi drejtorët morën një sasi parash që e konsideronin kapitale dhe i çuan në Greqi. Kthimi i parave në bankat shqiptare u bë në atë sasi, kuptohet që foli ndërjegja e këtyre drejtuesve.

Gjithëandëj po ndodhte e njehta furtunë katastrofash, me intensitet më të madhë në Tiranë. Korça, Librazhdi dhe Laçi kanë mbetur pa ujë. Në akset e rrugëve maskat do të bënin kërdinë. Në Kakavijë, s'guxonte të shkelte këmbë njëriu. Vjedhja e shtëpive, e makinave, e firmave tregëtare, dhe gjithçkaje tjetër që mund të vidhej ishte bërë normë e kohës.

Rendësi kishte të shpëtoje kokën. Kështu arsyetoi edhe një nuse e re e cila në prani të bashkëshortit, pranoi t'i prisnin gishtin për së gjalli për t'i marrë unazën, se sa t'i bënin të njëjtën gjë por e vdekur. Pësoi një fat të tillë një nuse tjetër e re nga Saranda, e cila rembeu çelsat e makinës kur grabitësit kishin zbritur nga makina bashkëshortin. I morën çelsat pasi ia bënë trupin shosh nga plumbat. Nuk ishte çudi e madhe nëse në rrugë gjeje një apo disa kufoma të hedhura.

Reagimi popullor ndaj pushtetit të Berishës arriti ekstreme të papranueshme, -armatosjen e të medhenjve dhe të vegjelve. Pasoja ishte e tillë që të viheshin në rrezik ekuilibret shoqërore dhe mbi të gjitha të vihej në rrezik e drejta themelore e njëriut, -ajo për të jetuar. Po vuanim gjithashtu pasojat e një lirie në natyrë dhe jo të një lirie në shoqëri civile. Përdoruesit e drogës e shprehnin vetën duke qëlluar me armë drejt e në mish. Vrasja ose kërcenimi bëhej edhe për të gjetur parët për dozën tjetër.

Jugu po paguante haraçin e madhë të kundërshtimit të regjimit të Berishës. Sipas logjikës së këtij regjimi, i cili rimori vetën në sajë të këqadmirimit nga ana e partive të opozitës të sakrificave popullore për ta rëzuar atë, Jugu pra, duhej të pendohej, Qëllimi i tij, siç e theksuam edhe me lart, ishte që pas eliminimit të komitetëve dhe të kryengritjës popullore, të linte opozitë në opozitë.

KOMITETET E SHPËTIMIT JANE FIJE KASHTE PARA KRIMIT

Komitetet e Shpëtimit Publik mëgjithatë, bënin ç' ishte e mundur për të parandaluar një situatë të tillë por ishte e pamundur. Nëpër fshatra ishin ngritur patrullat për t'u mbrojtur nga maskat. Nëpër qytete mundoheshin të organizoheshin me blloqe dhe lagje për të mbyllur të gjitha rrugët apo edhe për të penguar ndonjë sulm të mundshëm. Policia nuk kishte asnjë fuqi. Partitë politike nuk bashkëpunonin pothuajse fare me komitetet. Vetëm kërkonin përgjegjësi nga komitetet për situatën.

Në Gjirokastër mënjëherë pas krijimit të qeverisë, partitë politike u distancuan nga Komiteti i Shpëtimit Publik, mohuan deklaratën e dy ditëve më parë 13.03 dhe u mblodhën nën drejtimin e kryetarit të këshillit të rrethit për të organizuar një strukturë të re drejtimi në rreth. Në deklaratën e hartuar i kërkohet qeverisë që të gjitha kompetencat e prefektit t'i kalonin kryetarit të këshillit të rrethit. Mirëpo të qenit minoritar i kryetarit të këshillit të rrethit i bëri përfaqësuesit të partive të ndryshme skeptikë. (Partitë politike në rreth do të kërkonin serish pas disa ditësh, bashkëpunimin me Komitetin e Shpëtimit Publik, pasi situata është agravuar setepërmë dhe po prap, pasi situata filloi të stabilizohej dhe partitë politike filluan të gjenin vetën në një situatë të qetë, në një takim të tyre me kryetarin e këshillit të rrethit menjëherë në mënyrë provokative përfaqësuesit e Komitetit.).

Partitë kundërshtonin edhe përbërjen e komitetëve. Sipas tyre në to kishte edhe njëherë që s' meritonin të ftoheshin as edhe për muhabet. Por ata nuk mund t'i hiqje andej se të drejtën e kishin fituar me rolin e tyre në ditën e parë të qëndresës ndaj forcave të Salës, por edhe me organizimin e lagjeve për vetmbrojtje, edhe me kryerjen e detyrave të tjera të veshitura. Është e vertetë se në përbërje të Komiteteve kishte edhe njëherë që ditën rrinin me to dhe natën shkonin e vidhnin, apo njëherë që ishin aty vetëm si sy e vesh të tjetërve. Kishte edhe ndonjë që të afermit i kishte në

pararojë të vjedhjeve, por kontributi i tij personal për momentin që i konsiderueshëm. Por ata megjithatë ishin shumë pak, dhe pak nga pak filluan të largohen vet nga Komitetet .

Qeveria nga ana e vet po vononte çdo emërtesë sidomos në organet e rendit ku edhe një policë, sipas ligjeve në fuqi mund ta lironte apo ta mobilizonte urdhëri i ministrit të Rendit, i cili ishte përfaqësues i PD-s . Nuk bëhet fjalë që qeveria të mund të emeronte prefektët apo njërëz të tjerë në nomeklaturë të saj. Nuk mund të bëhej fjalë për drejtësi dhe denime fajtorësh. Drejtësia ishte krejtësisht jashtë loje. Në këtë situatë edhe njërëzit kishin filluar të lodheshin nga përpjekja për të rezistuar . Pasiguria po u mësonte atyre një rrugë më të thjeshtë për të shmangur frikën . Ikin nga vendi .

SINDIKATA E GRABITJES SE BANKAVE

Mëgjithatë si një krijesë e dalë nga situata kundër regjimit , dhe si një strukturë që përpiquej për të bërë diçka i bënte Komitetet të ishin faktorë shprese. Ishte kjo arsyeja që Komitetit të Shpëtimit Publik të Gjirokastrës , p.sh edhe pse mundësitë i kishte gjithëmonë e më të pakta për të reaguar, i vinin vazhdimisht informacione për ato që ndodhnin por edhe për ngjarje që përgatiteshin .

Më datën 15.03 në takimin e radhës së Komitetit, u diskutua lidhur me informacionin e ardhur se në një nga ditët e aferme do të sulmohej Banka Tregtare e Gjirokastrës që mbante dhe paratë e të gjithë Jugut, si dhe një serë objektësh shtetërorë si arkivi, biblioteka radjua etj.

U bënë dy propozime për mbrojtjen e tyre. I pari që mendimi im që bankat dhe institucionet e tjera të minoheshin me mina kundër këmbësorisë dhe i dyti të mbroheshin këto institucione me forca të shumta. U pranua mendimi i dytë, pas një debati tepër të tensionuar lidhur me mundësinë e kalimit të tankeve tek Ura e Nanzës, një urë e vjetër prej guri me një hark të madhë, të vetëm . U vendos që tre tanke të kalonin nga kjo urë dhe të shkonin, tek banka, posht godinës së Kesillit të Rrethit, pasi nga Varroshi ishte e pamundur që të ngjiteshin për shkak të gjerësisë së tankeve, kalldremit dhe pjerësisë. Kështu edhe u bë. Propozimi i parë u hodh posht me preteksin se s' kishte mina kundër këmbësorisë(!!!)..Në radio, megjithatë u transmetua njoftimi se këto institucione ishin të minuara dhe u bëhej thirrje qytetarëve të mos u afroheshin .

Natën 17 marsit grabitja e bankës u krye. Sulmi në fakt filloi që paraditën kur një grup i armatosur me maska (të cilat në fakt nuk u duheshin se njiheshin kush ishin) hyri në bankë në momentin e dhenjës së rrogave, i morrën paratë dhe ikën pa i penguar askush.

Përpjekja e paraditës edhe pse e suksesshme për grabitësit e armatosur, nuk mund të quhej e kënaqshme në krahasim me sasinë e parave që ndodheshin aty, (mbi 20 milion dollarë). Vjedhja e paraditës ishte një paralajmerim për aksionin e natës. Pjesëmarrës në këtë vjedhje duhet të ishin mbi tridhjetë veta, të ardhur nga të gjitha rrethet e jugut. (Këtu zë fill krijimi i sindikatës se bastisjës se bankave të Jugut që do të marrë fund më 27.03 me masakrën e Levanit, fshat jashtë Fierit ku u vranë në menyrë misterioze 17 veta . Ishin nisur për vjedhjen e bankës së këtij qyteti, të cilën një pjesë e "sindikatës" e konsideronte të fundit. Pas kësaj do të largoheshin jashtë shtetit , për të jetuar jetën me paratë e vjedhura. U vranë tek sa shkuan në Levan , sipas pohimeve të ndryshme për të marrë disa qindra pistoleta tek romet e atjeshëm , por u gjendën të rrethuar si tek skena e Zapatës ku u vranë të tërë. Egzistojnë megjithatë, si për çdo çështje misterioze, variante nga më të ndryshme.)

Atë natë pra, tanket që bllokuan tre rrugët kryesore që të çojnë në bankë, nuk lëvizën as gjysëm metri për të mbyllur rrugën e automjetëve që sollën hajdutët, nuk i bllokuan rrugën as dhe të minibasit që u ngarkua me para. Patrulla e rrezikshme kundër banditëve në lagjen "Punëtori", atë natë "nuk funksionoi". Po ashtu "askush nuk pati frikë nga «minat», për të cilat ne kishim folur

në Radio Gjirokastra. “Hapësit e bankës» punuan pa u shqëtësuar mbi tre orë. Banoret e pallatit përsipër bankës e përjetuan gjithë situatën por nuk mund të reagonin megjithëse në atë vend që është banka tre njëzëz me nga një arkë me granata të hipur mbi godinën e ish gjykatës, të këshillit të rrethit dhe të pallatit ku vet banka është vendosur, mund të zbrapsnin dhjetra sulme ose të asgjesonin të gjithë sulmuesit e bankës. Për mënyrën e hapjes së kasafortave ka edhe këtu dy variante. I pari pretendon se hajdutët e armatosur kishin siguruar kodet e kasafortave që më parë. Brenda këtij varianti është edhe pretendimi se kasafortat u lanë të hapura me marrëveshje pasi vet punonjësit kishin marrë një sasi parash . Këtë variant e përforcon edhe deklarimi I një punonjësi policie I cili tha atëherë se tek të gjitha kasafortat celësat ishin në vend. Por kjo hipotezë bie pasi siç thamë , vjedhësve u është dashur të punojnë mbi tre orë për të hapurtë gjitha rrugët deri tek thesari dhe se e njëjta bankë u vodh për katër ditë radhazi.

Ironia e vjedhjes është se paratë u ngarkuan në një mini bas të grabitur policisë dhe ikën “në drejtim të paditur”. Njëzëzit madje panë dhe veshtirësinë që kishta makina nga ngarkesa për të zbritur kalldremet e Varroshit.Të nësërmën shumë njëzëz dhe veçanarisht femijë mbledhnin në rrugën e Varroshit paratë që ishin shpërndarë nga pakujdësia, sidomos monedha metalike. Sipas të thenave ,grabitesit ndaluan diku pranë Viroit dhe I ndanë paratë me thasë. Në ndarjen e tyre lanë një pjesë të majme për “x”, përsone të rëndësishëm. Emrin megjithatë nuk e përmendnin se kush ishte.

Të pasnesermen, më 19.03 ,në bursën e rrugës të Gjirokastrës erdhën thaset e para me kartmonedhat e vjedhura të lidhura në pako pësëqindmijshe dhe njëmilionëshe me fije peri.Kërkonin t'i këmbenin me dhrahmi dhe për këtë rritën kursin deri në 80 %.

Lajmin për vjedhjen e bankës e mora vesh kur dola nga shtëpia. “Më para e ke të mbushur atë cantë?”, më pyeti një bashkëqytetar, në fakt tregëtar. Ishte shumë I pezmatuar dhe gjithë fajin ia veshi Komitetit që s'arriti ta mbronte bankën as me tanke.

Nxitova për tek selia e Komitetit. Aty ishin vetëm komandanti, sic I thoshim zotit Agim Gozhitës dhe nënkryetari I Komitetit, Isuf Cepani. U futa brenda dhe pa e kontrolluar vetën fillova të bërtas. Mbjaj mend që thash se “ n.q.s ju doni të turpëroni emrat tuaja na thoni,që ne të ikim në shtëpi. Si nuk ju vjen rend që lejoni t'ju poshtërojnë disa hajdutë ordinerë ju që keni grada të larta ushtarake. Keni bërë një betim ushtarak dhe si guxonit pas kësaj të quheni ushtarakë”.Të drejtën për të bërtitur ma kishte dhenë këmbëngulja ime disa ditë më parë që banka të minohej. Z. Gozhita , dukej se ruante gjakftohësinë dhe priste të shfryhësha . Cepanit I kushtoi shumë fjalja e fundit

Pas tre ditësh në një takim të radhës në komitet zoti Gozhita , u dha urdhër disa oficerëve që të ndihmonin banorët e një fshati në Lunxheri për të mbrojtur depot e minave kundër këmbësorisë, pasi vinin makina që nga Tirana dhe “ngarkonin minat për në Mal të Zi”.

Nuk prita gjatë dhe ndërhyra. “Si kishte mundësi që kur u kërkuan mina për të minuar institucionët e veçanarisht bankën që mund të sulmoheshin nga kriminel e grabitës u tha se nuk egzistojnë ndërsa tani na del që me to ngarkohen makina?” “Nuk I përdorem se mund të vriteshin banoret e pallatit “që përgjigja. Por pas këmbënguljës për një përgjigje më të saktë të disa anëtarëve të Komitetit një oficer tha se “ ato vrasin vetëm shkelësin e tyre”.

. Banka e Gjirokastrës u vodh për katër ditë radhazi.Bashkë me vjedhjen e Bankës vidheshin shtëpi e dyqane . Natën që në Gjirokastër ishte zëvendësministri I jashtëm grek Janos Kranidhjtis, shumë pranë rezidencës ku ai rrinte shpërtheu një konflikt I ashpër me armë midis një bande dhe pronarëve të disa dyqanëve.

NJE ZGJIDHJE QE E RINDERLIKUI SITUATEN NE GJIROKASTER

Ngjarjet tronditën Gjirokastrën si asnjëherë tjetër. Ishte mëse e domosdoshme një zgjidhje. Si zgjidhje u pranua ardhja e forcave të K.SH.P të Tepelenës të drejtuara nga Gjolek Malaj dhe Robert Targaj. Prania e tepelenasve solli vertet një qetësi në Gjirokastër. Por pas ditës së dytë edhe kjo zgjidhje filloi të rinderlikonte gjërat. Shumë të rinj Gjirokastritë nuk mund të pranonin më që të konsideroheshin të pazot për të mbrojtur qytetin e tyre. Situata u përkeqësua më shumë kur Tepelenasit u konfliktuan me Lazaratasit të cilët edhe ata pretendonin se mund ta ruanin Gjirokastrën dhe se nuk ishte e nevojshme prania e tepelenasve. Përplasjet midis tyre shkonin nga Lazarati dhe deri afer Tepelenës. Armet që përdorshin ishin gjithashtu nga pistoletat deri tek kondratanket. Disa përplasje më armë midis tyre sollën si pasojë plagosjen e disa vetave, djegjen e disa makinave të Lazaratasve apo dhe të Tepelenasve. Frika se mos Gjirokastra po kthehej në shesh lufte midis këtyre dy rivalëve për të kontrolluar qytetin detyroi tepelenasit të largoheshin nga Gjirokastra. Por edhe po të donin ata nuk mund të rezistonin më gjatë. S'kishin ku të flinin e ku të hanin. Të ftohtit bënte po ashtu punën e vet. Aq më keq që shumë nga fytyrat e tepelenasve shiheshin shpesh në aksione vjedhjesh, apo akuzoheshin dhe për vjedhjen e bankës.

Disa ditë më vonë, më 26 mars, rezultat i këtyre përplasjeve ne dukje, një grup prej afro tridhjetë Lazaratas rrethuan Shtëpinë e Oficerëve ku kishte mbledhje Komiteti i Shpëtimit Publik dhe përfaqësues të partive. I pranishëm që edhe Neritan Ceka. Diskutohej për organizimin e mëtejshëm të Komitetëve, sigurimin e ndihmave për ata që s'kishin asnjë mundësi jetese dhe qëndrimin që duhej të mbahej në Vlorë në Kuvendin Kombëtar të Komitetëve të Shpëtimit Publik më 28.03. Lazaratasit pasi u bindën se rojet nuk kishin ndërmend të hapnin zjarr me mitrolozët të vëna në çdo anë të shtëpisë së ushtarakëve, hynë më shpëjtësi brenda. Carmatosen rojet personale të Agim Gozhitës dhe hynë në sallën e mbledhjës. Qëllimi i tyre ishte të mirrnin peng zotin Gozhita. (loja e pengjeve që do të zgjaste gjithë beharin, kishte filluar). Kryesuesi i të rinjve nga Lazarati, disa ditë më parë, kishte një përvojë të hidhur nga një përplasje me armë me një grup tepelenasish, jo anëtarë të Komitetit. Shpëtoi në saj të fatit dhe të shkathësisë së tij. Ai pra hyri i fundit dhe vajti e mori Gozhitën prej krahu duke i thenë "C'bëni këtu brenda Vorio Epir apo komunizëm. Dijeni se po fituat ju komunistët ne nuk do ta ndalojmë luftën gjërsa t'ju përmbysim". Në këto momente një ish student i imi, që dinte greqisht ulet mbi kokën time dhe më thotë, "mbathja se do të hash plumbin kokës, duan të të vrasin". Kuptohet që nuk ika. Lazaratasit pas një dialog tepër të tensionuar ikën duke marrë me vete premtimin se nuk do të pranoheshin më tepelenas për të mbrojtur qytetin. Prania e Cekes i thjeshtësoi pak gjërat. Askush nuk pati punë me të dhe nuk dihet nëse ishte ky incident që do ta bënte më vonë Cekën ministër të Brendshëm, me deklarata të papeshuara mirë, të hidhte kundër vetës Lazaratin Por ato që na tha si kërcenim kryetari i tyre, i dëgjuam në darkë në parlament nga goja e Gazidedës. Dy ditë më parë i kishte përseritur në Parlament deputeti i Gjirokastrës Fatos Beja

Më ikjen e tepelenasve dhe dorëheqjen e Shefit të Komisarariatit Dritni Toro, qyteti i Gjirokastrës mbeti serish në duart e bandave. Jeta mirrte fund aty nga ora 14 00. Në aksin rrugor Gjirokastër-Kakavijë nuk gjeje këmbë njëriu.

Më 22.04 në një autobus që kthehet nga Kakaviaja për në Gjirokastër dy veta vrasin një bashkëudhetar brenda në autobus se nuk pranoi t'u jipte parët që kishte me vete. Pasagjeret e tjerë bashkëjetojnë me viktimën për minuta të tera se kishin frikë të zbrisnin nga autobuzi ndërsa policia nuk e zbriste viktimën se s'dinte çfarë ta bënte. Të bënë përshtypje gjakftohtesia më të cilën bëhen egzekutimet. Një rrez kopotent flasin për marrje droge nga ana e egzekutorëve.

Më 03.05 fillon në Gjirokastër loja e minimin të urave. Mbi 35 kg tritol ishin vendosur në kurrizin e urës së Kardhiqit më e madhja në aksin rrugor Gjirokastër - Tepelenë që do të pasohet me vonë

edhe nga tri shpërthime të tjera gjersa u bë e pakalueshme . Po atë ditë tre veta vriten në Permet nga përplasja midis bandave dhe një autobus plaçkitet

Një çift vritet po në këtë periudhë brenda në Gjirokastrë. Një djalë 1 ri vret babanë ën ndikimin e drogës,ndërsa një gjakamarje e nisur një vit më parë merr edhe katër jetë njëzësh të tjerë.

Në më pak se 20 km rrugë midis hidrocentralit të Bisticës deri në Jergucat u regjistruan 7 vrasje në jo më shumë se tre ditë.

Pësë veta, meshkuj e femra, pasagjerë në të njëjtën taksì, u vranë në menyrë makabre tek Ura e Glinës ditën vizitës së Nanos në Jug të vendit.10.06.I kishin zbritur nga makina dhe I kishin çuar tek këmba e urës së vjeter.Aty I vranë Ishin goditur në kokë, në gojë, në zemër, pranë e pranë dhe kishin mbetur aty, se cili në pellgun e gjakut të vet. Ishin akoma të ngrohtë kur vajtën njëzëzit e parë dhe gishtat e gjymtyrëve të tyre leviznin në trupat pajetë, shenjë e vuajtjeve për të dhenë shpirt.Asgjë nuk u ishte prekur nga sendet përsonele U tha së ishin nga Korça dhe historia u mbyll. Po atë ditë, pak pasi Nano kishte kaluar nga Qafa e Muzinës një njëri ishte vranë dhe dy të tjerë ishin plagosur.Një plagosje ndodhi edhe në Tepelenë, po atë dite para vizitës së Fatos Nanos Të nësermen Berisha deklaroi se ku shkel këmba e Nanoë vendi skuqet me gjak.

Në Janinë arrijnë ditë për ditë të plagosur. Spitalet e këtij qyteti bëjnë fjalë për rreth katër miliard dhrahmi shpënzime për të shpëtuar jetë njëzësh nga Shqipëria. Në këto spitale janë shtruar mbi 500 veta me plagë nga më të ndryshme. Në shumë raste palët kundërshtarë ishin të detyruar të shtroheshin në të njëjtën dhomë.

Pjesa më tragjike e kësaj lufte me shumë viktime pa kundërshtarë , ose me kundërshtarë vetveten , ishin femijët. Në duart e tyre armët e verteta dhe jo lodra.Shumë janë femijë të vdekur dhe të plagosur nga këto lodra të vdekjës . Ka të djegur dhe të gjymtuar. Në kujtesën tone u ngjallën serish skenat e plagosjeve dhe të gjymtimëve nga municionet e mbetura nga lufta. Skenat e sotshme janë më të shumta dhe më trishtuese.

Situata që e tillë që megjithë përpjekjet kolosale shkollat e kishin shumë të veshtirë që të hapëshin. Vendimi që ato të hapëshin më 15.04, u shty për 23.04, për 29.04 e më vonë për më 05.05. Ai viti shkollor megjithatë mbaroi si për të thenë. Të parët që guxuan të funksiononte shkollat ishte Komiteti I Shpëtimit Publik I Tepelenës që para datës 15.04.

Më rrezik shumë të madh ishin invazionet e bandave kriminale në fshatrat e minoretetit. Përplasjet në Vrisera, në Frashtan , në Vrahogoranxi, në Dervician, apo në Livadhja të Sarandës mbetën raste të veçanta. Në qytetin e Sarandës mbi 80 shtepi minoritarësh grek u bastisën apo dhe u zunë me forcë. E njejta skenë u përserit në fshatin Cukë, Një përgjithësim I situatës në këtë pjesë të vendit do të sillte me siguri një reaksion ndryshe reagimesh me një mundësi reale për kalimin e kufirit të konfliktit. Fatmirësisht nuk ndodhi kështu .

Kuptohet sa më shumë përkeqësohej situata në vend aq më shumë ritej fluksi I familjeve dhe I njëzëve të veçantë që braktisnin vendin . Konsullata greke punonte me një intensitet të paparë në dhenjen e vizave. Me mijra njëzëz mblidheshin ditë për ditë para kangjellave të konsullatës, Shpesh personeli diplomatik ishte I detyruar të jpte viza nën presionin e kallashnikollëve ose të ndërpriste punën për shkak të incidentëve të përditshëm të rënda me armë. Vetëm nga Gjirokastra Ilogariten të jenë larguar për në Greqi mbi tre mijë njëzëz. Në Itali kishin arritur deri në dhjetëditëshin e dyte të marsit mbi 12 mijë veta. Italia I kërkon në këtë kohë ndihmë Komunitetit Evropian që të mos e lenë vetëm në përballimin e gjendjës në Shqipëri, ndërkohë që shpall gjendjen e jashtëzakonshme në kufi për të parandaluar fluksin e refugjatëve nga Shqipëria. Logjika e kësaj politike çoi në mbytyjen më 28.03. 97, të anijës “I Katerti I Radës” me afro 105 veta në bord në një kohë që kapaciteti maksimal I saj nuk I kalonte të 60 vetat . 83 veta mbetën në fund të detit.

Në qytetin e Gjirokastrës dhe në aksin rrugor deri në Jergucat do të rivendoset një qetësi relative kur nga mesi I prillit deri në fillim të majit me inisiativën e disa biznesmenëve dropoullitë ngrihet në Jergucat një postbllok, ndersa në hyrje të Gjirokastrës, disa jave para zgjedhjeve, disa të rrinj gjirokastritë ngritën një postbllok tjetër . Postblloku I Gjirokastrës ishte pasojë e drejtpërdrejt e një përplasjeje më armë I gjirokastritëve me bandën e Hormovës e cila ishte bërë tmeri I krahinës

KOHA E SHPËRTHIMIT TE DEPOVE ME MUNICIONE

Dhjetëditëshi I fundit I prillit dhe fillimi I majit shenon periudhën më intensive të shpërthimeve të depove me municion . Më 24 prill në Qafën e Manit , fshat afer Lezhës nga këmbimi I zjarrit midis dy banorëve, shpërthen një depo me mina kundër tanke ku si pasojë plagosen 20 veta ndërsa 8 shtëpi shkatërrohen plotësisht. Nga një shpërthim tritoli po në një fshat të Lezhës një femijë vritet dhe një tjetër gjymtohet Më 30.04 në Qafë Shtanë të Burelit nga shpërthimi I një depoje me municion të armëve të renda humbasin jetën 27 veta. Në depo ndodheshin mbi 40 veta të cilët pasi zbraznin nga predhat lendën plasëse, I mirrnin ato dhe I shisnin për hekur të rallë në Mal të Zi. Një ditë më parë në Berat shpërthejnë dy depo mbitokësorë më lendë shpërthyesë dhe municion që venë në rrezik vet qytetin e lashtë.Më 09.05 shpërthejnë në Picar të Gjirokastrës depo municionësh armësh të renda ku si pasoj vdesin më vonë katër oficerë. Të afermit e viktimave do të këmbëngulin për veprim të qellimshëm

Kapitulli 17

KOMITETET.-BRENDA RRITJES ISHTE DHE FUNDI I TYRE

Komitetet kanë një origjinë të përbashkët, pavarësisht se ato diku u ngritën pas provokimeve ushtarake dhe diku gjetkë si pasojë e boshllekut të krijuar nga braktisja e institucionëve nga drejtuesit e tyre. Edhe qëllimet e tyre qënë po të njëjta . Nga njëra anë ishte organizimi I rezistencës kundër pushtetit të Sali Berishës, nga ana tjetër riorganizimi I strukturave të shtetit në nivel të dytë dhe të tretë, si dhe organizimi I rendit dhe I mbrojtjes së qytetarëve nga veprimi I krimi.Këto komitete përbënin në fakt edhe thelbin e Kryengritjes Popullore që pas unifikimit u quajt Levizja Popullore për Demokraci me një platformë të qartë politike. Deri më 09.03 kjo lëvizje plotësonte gjithë boshllëkun politikë të partive opozitare , ndërsa pas kësaj date partitë politike të opozitës dalin si palë e vetme ndaj pushtetit të Berishës. Lëvizja e tyre ishte e detyruar nga nevoja për të fituar rol politik për vete. Mirëpo kjo lëvizje determinonte dhe rifutjën në lojën politike edhe të Sali Berishës. Lëvizja Popullore për Demokraci, në fillim ishte e shkëputur .Ajo shpërthente qytet pas qyteti në shumë segmente vertikale për të përmbysur regjimin e Berishes dhe për ta larguar atë nga politika. Mirëpo kjo lëvizje do të kishte si rezultat vetëm dorëheqjen e tij. Hapi I mëtëjshëm, sidomos pas 09 marsit, u mbeti në dorë partive politike

Midis paaftësisë së politikanëve për të inicuar lëvizje dhe realizuar ndryshime politike (dhe këmbënguljes popullore për arritjen e këtij qëllimi. (Dorëheqja e Berishës dhe drejtimi i vendit nga një Këshill Presidencial, deri në zhvillimin e zgjedhjeve të reja), ndërmjetësoi shumë kohë . Kjo bëri që në një lëvizje politike të përseritej fenomeni i ujit të ndenjtur. Lëvizja Popullore kur nuk arriti objektivin e vet të drejtpërdrejt, filloi të reagojë ndaj institucionëve shtetërorë të para këto si produkt dhe derivat i pushtetit të Berishës. Kundër po këtyre institucioneve u sulen dhe vet ata pushtetarë që

ishin të interesuar të humbisnin gjurmët. Por pushteti i Berishës, kishte edhe një arsye tjetër për t'u sjellur kështu me shtetin. Kur e kuptoi se humbi çdo shans për të vazhduar qëverisjen , atëherë ,sipas logjikës së mbajtjes me dhunë të pushtetit, politika e tokës së tokës së djegur , përbën premisën më të mirë për të ricikluar krizën dhe për të ardhur rishtaz në pushtet.

Pas unifikimit të tyre më 11.03, komitetet në fakt morrën një drejtim të përcaktuar në kërkesat e tyre politike që përmblihdeshin, siç e thamë edhe më lartë, në një triptik. Pranimi I Komiteteve si palë,dorëheqja e Berishës dhe drejtimi I vendit nga një Këshillë Presidencial,(me këtë kërkesë ishte lidhur fortë dhe problemi i çarmatosjës), zhvillimi I zgjedhjeve të reja. Këtë bosht kërkesash, (te cilat ndryshonin në dy aspekte me marrëveshjen e 09.03 , në praninë si palë në tavolinën e partive edhe të komiteteve dhe në dorëheqjen e Berishës),Komitetet u munduan t'i ruajnë nga njëri takim tek tjetri me kombinime taktike, pse jo edhe duke aplikuar edhe radiolojën. Po ashtu nga takimi në takim vihet re edhe një shtim i përfaqësuesve të komiteteve të shpëtimit publik nga një numer qytetësh dhe rrethesh që arrijnë numrin 21 në takimin e Vlorës, më 28.03 Kjo pjesëmarrje nuk I perket vetëm Jugut por edhe Veriut.

Karakteristikë mbetet pamundësia për organizimin e plotë të këtyre komiteteve. Ata s'kishin një udhëheqje permanente e as një kryetarë të vetëm dhe as struktura që të mund të raportnin apo të mirrnin vendime. Kjo dobësi ishte pikasur që më 11.03 prandaj dhe u bë taktikë që pas çdo takimi të dilte një deklaratë e përbashkët.

Nga ana tjetër duke parë se veprimet kongrete drejt qëllimit të deklaruar po bëheshin të pamundura, atëherë u pa e udhës që këto deklarata të kishin një dinamikë , në kuadrin , kuptohet, të paralajmërimeve, me qëllim që të fitohej kohë në luftën e nervave me Sali Berishën.

Fundi I komiteteve që I tillë. Sa më shumë afrohej fundi I fushatës elektorale aq më shumë ato shkriheshin përballë veprimit të partive politike të opozitës. Në çdo vizitë shefi partie të opozitës ata bëheshin pjesë e rreshtave të gjata me makina pas tyre.Ose shtonin në mënyrë të frikshme rradhët e bodygardëve vullnetarë duke mos I lenë udhëheqësit e tyre të dashur të shikonin me tutje tyre. Ishte ky një kopjim I skajshëm I taktikave të përdorura nga Sali Berisha në fushata të tilla për të treguar fuqinë e vet elektorale. Ndryshimi që se ata ishin të armatosur. Pas këtyre sherbimeve devotshmerie shumë anëtarë të komiteteve vraponin individualisht, bashkë me militantë,të tjerë të fshehur deri atëherë, për ndonjë kockë .Dhe I morën, pavarësisht se ndonjëherë shpërblimi ishte I një mënyre të njëjtë apo dhe më të keqe akoma se ato për të cilat ata u ngritën për të rezuar «DIKTATORIN SALI BERISHA» Ky fenomen solli zhgënimin e madhë dhe po ndikon dukshëm në humbjen e rastit të fundit për shtetin shqiptar.

TAKIMI I KOMITETEVE NE BALLSH.

Pas takimit në Vlorë,më 14.03.97, të komiteteve të shpëtimit publik, ku kërkesat ishin standarte me ato të deklaratës se Gjirokastrës(nuk përmendej vetëm kërkesa që komitetet të ishin palë në bisedime si dhe ceshtja e armëve), më 17 mars në Ballsh zhvillohet takimi I tretë I radhës. Në takim marrin pjesë 12 përfaqësi, një më shumë se në takimin e Vlorës. Pjesëmarrësi I ri ishte Fieri. Atje pritej të vinte në mos Finua vet, një përfaqësues I tij , si dhe përfaqësues të partive politike. Por askush nuk erdhi

Ishte hera e dyte që mirrja pjesë në një takim të tillë. Ishin me dhjetra gazetarët e pranishëm por edhe popull kishte shumë. Respekti ishte I jashtakonshëm. Ndërhyra që në fillim që gazetarët të marrin planet e duhura për reportazhet e tyre dhe të danin jashtë. Pak më vonë mendova se propozimi im ishte shumë I vlefshëm. Kjo për arsye se pas disa fjalimeve mirësearchjeje filluan raportet mbi gjendjen. Ato ishin pothuaj të njejta, vetëm sa ndryshonin vendet. Grabitje, vrasje

plagosje, shkatërrim objektësh, zenjen me forcë të institucionëve arsimore e shoqërore,-ky ishte thelbi i raportimeve. Pas kësaj filloi një diskutim ku secili tregonte vlerat e veta në kryengritje dhe ku secili kishte mendimin e tij për daljen nga kriza. Siç e thamë edhe më lartë, nuk egzistonte një ekip drejtues. Cdo qytet organizator i takimit të radhës mirrte përsipër çdo gjë , madje edhe projektdeklaratën..

Në takimin e Ballshit vura re se në përbërjen e komitetëve kishte njëri që rastësisht kishin ardhur aty. Kishte oficerë të lartë të cilët nuk ishin në gjendje të lidhnin situatën politike me veprimet ushtarake , apo të kishin mundësi për të organizuar dhe drejtuar gjithë atë mori njëri që ishte armaturë. Por ata s'kishin edhe guxim. Aty u hodhën dy tre ide për t'i imponuar Berishës dorëheqjen . Njëra nga ato ishte që të bombardohej Presidenca me topa të kalibrit të madhë, ose edhe me aeroplanë nga Kuçova. Goditja e parë të qe me bomba të çarmatosura për paralajmerim.

Mendimi i dytë ishte që të dilnin tanket në rrugë nga Saranda deri në Ballsh që konsiderohej zonë e lirë. Tanket do të mbaheshin në rrugë për disa ditë dhe në rast Berisha do të rezistonte, tanket të niseshin drejt Tiranës. Ata që e kundërshtuan këtë logjikë ishin oficerët madhorë me preteksin se do të derdhej shumë gjak. Edhe logjika e tyre u kundërshtua me argumentin se po të rri Berisha në krye të shtetit, do të derdhet më shumë gjak se sa nga një sulm drejt Tiranës me piksynim vetëm presidencën.Më të dytët që e verteta, por në atë tavolinë prej me shumë se 40 veta, të pakët ishin ata që ishin të gatshëm për veprime konkrete brenda logjikës së ngjarjeve të kohës.

KOMITETEVE KISHTE FILLUAR T'U PRITESHIN GJUNJET

Lodhja e komiteteve kishte filluar. Ishte një lodhje që vinte si rezultat i kohës së gjatë të protestës popullore pa rezultatin e pritshëm. Ishte rezultat i ndikimit të partive me njëri të kontrolluar prej tyre, pse jo edhe nga Partia Demokratike, ishte rezultat i frikës se midis nesh kishte njëri të SHIK-ut,veprimtaria e te cilit konsiderohej evidente, por edhe i frikës se mos vinte serish në pushtet Sali Berisha.Fakti që armatosjen e popullit komitetet e lidhen me egzistencën në pushtet të Sali Berishës e verteton më se miri këtë fenomen. Krijimi i Qeverisë së Pajtimit Kombëtar më 13 mars dukej se kishte liruar në një masë të madhe barrën e komitetëve për të rrezuar Sali Berishën.Mëgjithatë frika e Komiteteve dhe e popullit që shumë herë më e vogël se frika që ndjente Berisha nga egzistenca dhe veprimtaria e komiteteve dhe orgjia e popullit. Midis të dy palëve pati një dualitet konfrontues shumë të ashpër. E verteta ishte se nuk kishte përplasje. Gjithëkush qendronte në llogoren e vet. Vetëm se Berisha përpiquej që t'i gerryente me gjithëfarë menyrash komitetet. Atë që arriti në mënyrë të dukshme ishte se duke i akuzuar komitetet si grupe terrositesh të kuq dhe si krahu i armatosur i forcave të opozitës, veçanarisht i PS-së,i mbajti aleatët natyralë larg njëri tjetrit. Po ashtu duhet thenë se Komitetet, duke deklaruar që në këtë kohë, se misioni i tyre mirrte fund me zhvillimin e zgjedhjeve, ato kishin dalë për vete në një pozicion mbrojtës, me rol pasiv për fatet e pushtetit politik. Që të shprehemi më qart nuk pretendonin pushtet ,por pretendonin rolin e garantit vullnetar për të marrë pushtetin opozita.

Në një klimë të tillë filloi edhe diskutimi për aktin kryesor të takimit,-deklaratën. Diskutimet nuk kishin asnjë bosht dhe idet për deklaratën nuk rezononin me aktualitetin politik në Shqipëri.Diskutantët shprehnin dufin dhe nuk arrinin as t'i koncentronin problemet e as të kuptoni cila ishte e rëndësishme dhe cila jo e rëndësishme. Nuk mund të mohohet kurrësesi edhe shqëtësimi i shprehur për mënyrën se si do të rifunksiononte shteti dhe strukturat e tij në Jug, qëndrimi ndaj ardhjes së forcave të huaja dhe rolit të tyre, etj Por diskutimet në përgjithësi rrihnin tek deklarata e Berishës para dy ditëve se do të jap dorëheqjen po të humbas në zgjedhje Partia Demokratike. Deklarata e Berishës , kuptohet ishte një sfidë për komitetet, ndërsa çeshtja e SHIK-ut, me gjithë

rendësinë e saj lidhej edhe me frikën për fatin e secilit në atë sallë, në krahë të djthtë të hyrjes për në hotelin kryesor të qytetit.

THELBI I DOKUMENTIT KRYESOR TE TAKIMIT DHE SI LINDI ULTIMATUMI

Unë kisha vajtur atje me një projekt deklaratë, e cila ishte një vazhdim i deklaratë së 11.03 dhe i takimit të Vlorës së 14.04. Deklarata i atakonte të gjitha instancat që përbënin në atë moment shtetit, me të vetmin dallim që tehu i kërkesave binte mbi partitë politike dhe mbi qeverinë Fino. Bëra në vend edhe disa ndryshime ku përmbledheshin edhe mendimet e shprehura aty dhe kur lodhja po e shkatërronte mbledhjen kërkoja fjalën për të bërë propozimin tim që ishte.

1.K.K.SH.P e konsideron deklaratën e Presidencës për mos dhenjen e dorëheqjes së Sali Berishës si një provokacion të rendë ndaj dinjitetit të popullit dhe papërgjegjësi totale ndaj gjakut të derdhur dhe shkatërrimit të vendit dhe strukturave shtetërore, me synim të qartë për përçarje politike e kombëtare.(Dy ditë më parë S. Berisha kishte deklaruar se do të jipte dorëheqjen po të humbiste Partia e tij në Zgjedhje)

2. K.K.SH.P, kërkon prerazi dorëheqjen e menjëhershme dhe pa kushte të Sali Berishës

3. Në rast të kundërt, kërkojmë zgjedhjen e menjëhershme të një Këshilli Presidencial nga tavolina e partive politike në vend, me pjesëmarrjen si palë edhe të K.K.SH.P.

4. K.K.SH.P shpreh edhe një herë mbështetjen ndaj qeverisë Fino, por ky Komitet deklaroi gjithashtu se vazhdimi i bashkëpunimit të kësaj qeverie me Sali Berishën e kompromenton me regjimin e Berishës. Nje veprim i tillë nga ana e qeverisë i heq të drejtën këtij Komitetit për të vazhduar mbështetjen ndaj saj

5. K.K.SH.P kërkon të njihen nga qeveria Fino, strukturat shtetërore të aprovuara nga K.SH.P të rretheve, të cilat do të funksionojnë deri në zgjedhje

6. K.K.SH.P kërkon një takim me forcat politike brenda vendit.

7. K.K.SH.P thekson edhe një herë se armët nuk janë në duart e rebelëve por në duart e popullit që i mban ato si garanci për rrezimin e diktaturës Berishiane.

Në këtë kuadër e konsiderojmë të pavlefshme praninë e forcave të huaja për çarmatosjen e popullit.

Këto pika,që përbënin edhe deklaratën përfundimtare, u pranuan pa veshtirësi nga të pranishmit. Një debat të zjarrtë ndezi kërkesa e z. Xhevat Kocia që deklarata të kishte karakterin ultimatativ,d.mth për dorëheqjen e Berishës të kishte vetëm tre ditë kohë. Argumentova të kundërtën unë edhe shumë të tjerë, madje kur u daktilografua nuk u shkrua në fund të pikës dy togfjalëshi “brenda datës 20 mars 97” Por Koçia tha se kjo përbën tradhëti dhe se ai nuk do të nënshkruante. Duke u mbështetur në parimin se në politikë vazhdimisht duhet të egzistojë hapi i mëtejshëm, argumentova se karakteri ultimatativ për një kohë kaq të shkurtër i fut në grackë kërkesat politike të K.K.SH.P, pasi nuk shoh gadishmeri për veprime të llojit praktik që presupozon ultimatumi. Por Koçia nguli këmbë dhe me votim fitoi.

Por nuk kaluan as katër ditë dhe deklarata e takimit të Tepelenës që shumë e veshtirë për t’u shkruar. Ishte hera e parë që unë do të shkoja i papërgatitur ose pa asnjë ide në kokë për një takim. Në fakt kishin nënshkruar humbjën e dinamikës në kërkesat tona politike.

Po në këtë ditë kërkesave për përfeksionimin organizativ të K.K.SH.P iu dha një përgjigje. Pasi u pa që ishte tepër e veshtirë të zgjidhej një këshill i përhershëm drejtues me një kryetar ose komandant. (kjo për shkak se të gjithë mendonin se kishin arsye për t’u zgjedhur dhe nga ana tjetër të gjithë e kuptonin se po të ishin në krye, nuk dinin çfarë do të bënin) u zgjodh një këshill prej tetë vetash me kryetar zotin Koçia. Ky këshill, midis të cilëve edhe unë, por edhe Petro Koçi, kryetari i

PS-së së Fierit I qethur zero nga Sali Berisha, kishte për detyrë të përgatiste takimin tjetër në Tepelenë dhe asgjë më shumë. Por ajo mbeti si kryesi edhe në takimin e Vlorës më 28 mars. Që në takimin e parë z. Koçi nuk dëshoi dhe nuk e nënshkroi deklaratën. Ai tha se nuk trembej por komiteti që egzistonte në Fier nuk ishte si komitetet e tjera . Ai kontrollohej nga njëri që nuk mund të bashkëpunonin më këto komitete dhe se ai nuk donte ta vinte vetën në pozitë . P.Koçi erdhi për herë të parë dhe të fundit në takimet e komitetëve,

Kështu mbaroi takimi I Ballshit. Jasht na prisnin shumë njëri por edhe gazetarë Atje u lëxua edhe një herë deklarata e cila për herë të parë u drejtohej si partive politike dhe qeverisë shqiptare, ashtu deh organizmave nderkombëtare , Trupit Diplomatik në Tirane dhe qeverive të B.E dhe të SHBA-së. Po ashtu ishte hera e parë që deklarata shkante në Tiranë

RADIOLOJA

E verteta është gjithashtu se një grup I vogël njëri u interesua që Berisha të mësonte se po të mos jpte dorëheqjen «pallati presidencial do të goditej me top nga Berati» me bomba të ç'aktivizuara dhe po të këmbëngulte akoma do të niseshin tanket drejt Tiranës. Ishte pikërisht ky shkak që Berisha pajisi gardën me raketa dhe rrethoi presidencën me tre rrathë rojesh Rojet ishinq shumë të trembur sa që një lëvizje po të ndodhte qëllonin me bresheri për minuta të tera. Në Tiranë shumë afër presidencës një njëri humbi jetën pasi ecte me shpejtësi me makinën e vet, duke dashur ndoshta të provokonte rojet. Skena u pa nga dhjetra gazetarë të huaj që rinin tek Hotel Rogneri.Po ashtu njëri të Berishës në një moment tjetër iu kumtua se vendet e mundshme që mund të strehohej Berisha do të goditeshin me aeroplanë të cilët do të përfundonin pastaj në Itali.Siç u muar vesh shumë më vonë, në po të njëjtën periudhë me lajmin, në Rinas një Mig qëndroi në gadishmeri dhe I armatosur për 15 ditë. Në kuadër të kësaj loje doli dhe varianti që drejt Tirnaës do të niseshin 50 veta të stërvitur enkas për të sulmuar presidencën. Vetëm se ky variant u mbajt më shumë sekret, ose u përhap duke kërkuar që të ruhej sekreti, më qellim që të ishte më shumë bindës.

Nga radio Dojce Ëelle u njoftuam se në Gjirokastrë në mes të ditës u grabit Banka e Gjirokastrës në momentin që jipeshin pagat. Kishte filluar kështu loja e bankave për të cilat komiteti I Gjirokastrë kishte informacion dy ditë më parë.

ULTIMATUMI SKADON.... CFARE DO TE BEHET ME TEJ? !

Kërkesat e deklaratës së Ballshit të 17 marsit, kishte shqetësuar në shumë drejtime brenda dhe jasht vendit . Në kampin e partive politike të opozitës kishte një ndjeshmeri të diferencuar për sa u përket qëndrimeve të Komitetëve. Shumë më afër tyre qëndronin PSD-ja dhe AD-ja, parti që këtë qendrim e vinin në funksion të qëllimit për të rritur elektoratin e tyre Por edhe ato nuk vinin se bashku. PS-ja tregonte një siguri ndaj pushtetit dhe rriste distancën ndaj komiteteve.Forumi për Demokraci edhe pse egzistonte nuk funksiononte si një organizëm I vetëm. Më 20 mars, një ditë para takimit të Tepelenës së Komiteteve, në Gjirokastrë kishin ardhur nga Vlora Skendër Gjinushi dhe Paskal Milo. Në një takim me udheheqësit e Komitetëve të Gjirokastrës, Tepelenës dhe Sarandës Skendër Gjinushi dhe Paskal Milua, kërkonin t'u mbushinin medjën kryengritësve të zëvendosonin dogmën e dorëheqjes së Sali Berishës me taktikën e çmontimit pjesë-pjesë të diktaturës së Sali Berishës.Kjo ishte në fakt teoria që do të adaptonte me vonë përfundimisht FatosNanua.

Kryengrittësit nuk bindeshin dhe kundërshtimi ngrihej më shumë kur problemi lidhej me armët. Gjinushi duke e njohur situatën shumë mirë, u tregonte udheheqësve të Komitetëve të pranishëm se nuk kishin më kontroll absolut në popull dhe se përveç organizimit duhet të përshtatëshin me situatën e krijuar.

Në kulmin e këtij debati arriti një grup gazetaresh amerikanë, të cilët me një autoritet absolut pretenduan se nga kamerat e tyre do të informohej drejtpërsdrejti vet Presidenti Klinton . Ishin gazetarë të CNN. Thelbi i kërkesave të tyre ishte të njihnin përmbajtjen e deklaratës së takimit të Ballshit dhe cili do të që hapi i mëtejshëm në rast se “ultimatumi nuk respektohej” (Sipas deklaratës, afati i fundit mbarronte në mesnatën e asaj dite.

Gjinushi dhe Milua si përfaqësues të Partive Politike u distancuan. Milua pranoi rolin e përkthyesit dhe biseda filloi. Folësit e komitetëve nuk arrinin t'i jepnin një përgjigje të saktë gazetarëve se kundër kujt po drejtohej ultimatumi. Me ndihmën edhe të z. Gjinushi dhe të z Milo , arritëm t'i sqaronim se ultimatumi në fakt u drejtohej partive politike . Ata deri me 20.03 duhej të mblidheshin në një tavolinë, ku të përfshiheshin si palë edhe Komitetet dhe të vendosnin se ç' duhej të bëhëj me Berishën . Nga kjo tavolinë t'i kërkohej dorëheqja e Berishës dhe Parlamenti të zgjidhte një Këshillë Presidencial.. Në një moment Gjinushi bëhet protagonist i bisedës dhe flet pikërisht në frymën e deklaratës. Ai foli për domosdoshmerinë e dorëheqjes së Berishës si një veprim që lidhej me çarmotosjen e popullit dhe rikthimin e normalitetit. Gjinushi sqaroi gjithashtu se nuk bëhej fjalë për mundësi provokimi dhe shpërthimi të një lufte civile, si dhe nuk bëhej fjalë për ndarje VERI - JUG.Jugu dhe Veriu nuk kishin asgjë midis tyre,- sqaroi Gjinushi . Në esencë si Jugu ashtu dhe Veriu ishin kundër Berishës, vazhdoi kryetari i PSD-së. Por gazetaret amerikanë këmbëngulnin të mësonin se çdo të bëhet të nësermen e përfundimit të ultimatimit. Këtë s'kishte si ta dinte Gjinushi dhe as kishte të drejtë të mirrte përsipër një rol të tillë. Përfaqësuesit e komitetëve të pranishëm as që i kishin bërë vëtës një pyetje të tillë.Në këto momente ngecjeje ndërhyri Gjoleka . Ai nxorri nga xhepi një nga variantet e diskutuara në qarqe shumë të ngushta për një mundësi imponimi të dorëheqjes së Berishës. “Në rast se Berisha nuk do të japi dorëheqjen dhe partitë politike do të bejnë sehir, tha Gjoleka,- drejt Tiranës janë bërë gati për marshim 50 burra të përgatitur enkas për dëbimin nga Presidenca të Sai Berishës” Lajmi kaloi si një rrufe në syte e gazetarëve të huaj. Kamerat u kthyen me nxitim nga Gjoleka dhe gazetarët kërkuan sqarime. I bëra me shenjë Gjolekës që të mos fliste më. “ Sqarime të tjera se kush i dergon, ku janë përgatitur dhe kur do të arrijnë në Tiranë, nuk mund t'ju jap”, tha Gjoleka .U ngrit në këmbë dhe doli. Takimi mbaroi. Por deklarata e Gjolekës bëri xhiron e botës. Arriti edhe në veshët e Berishës i cili shtoi rojet rreth presidencës të cilët nga ana e tyre pas çdo zhurme që degjohej, qëllonin nga frika më breshëri të pafundme

TAKIMI I TEPELENES E VERTETA NDRYSHE

Kërkesat ultimative të Ballshit, bllokojnë dokumentin bazë të takimit

Një ditë më pas do të zhvillohej takimi i Tepelenës për Komitetin Kombëtar të Shpëtimit Publik. Ky takim ishte shumë i veshtirë. Komitetët në linjën e vet ishin të bllokuar nga pyetja: Ultimatumi mbaroi, partitë politike heshtën. Po tani, cili do të jetë hapi i mëtejshëm?Shumë provokues që në fakt edhe qëndrimi i përfaqësuesve lokal të partive opozitare, veçanarisht të përfaqësuesit të PS-së që takimin e konsideronte një diçka që s' kishte asnjë lidhje më të dhe me partinë e tij. Megjithatë Partia e bëri atë deputet

Në Tepelenë numri i komitetëve lokalë u shtua edhe me dy përfaqësues të rinj,-më ata të Elbasanit dhe të Cerrikut. Kjo nuk ndryshoi situatën . Të pranishëm ishin përfaqësues të studentëve

grevist të Vlorës, të Sarandës, Drelvinës, Gjirokastrës, Vlorës, Permetit, Memaliajt, Kelcyrës, Beratit, Koçovës, Mallakastrës, Elbasanit Cerrikut.

Kryesia për përgatitjen e dokumentit bazë të takimit, nuk gjente rrugëdaljen nga momenti kritik. Kjo i bënte që të ktheheshin tek momenti që pranuan propozimin ultimativ të Xhevat Koçisë. Albert Shyti si përfaqësues i Vlorës, kishte si qëllim bazë që të denohej verbalisht Berisha dhe të flitej diçka për kthimin e parave. Arsyetimi i tij lidhej më atë që donin të dëgjonin në Vlorë mijrat e protestuesve të përditshëm. Edhe deklarata paraprake të njejtën gjë bënte. Si anëtar i kryesisë për përgatitjen e deklaratës megjithë hezitimin që kisha për të marrë pjesë, propozova një rrugë tjetër. Në pjesën e parë mund të përmendeshin të gjitha ç'ka kishte bërë Berisha në kurriz të popullit dhe që i përmbante edhe deklarata paraprake. Në pjesën e dytë, sipas propozimit tim, Berisha President të konsiderohej inegzistent dhe t' u kërkohet partive politike të zgjidhnin, me pjesëmarrjen si palë edhe të Komitetëve, një Këshill Presidencial deri në zgjedhjen e parlamentit të ri. Propozova gjithashtu që të shtoheshin në deklaratë rezervat për qeverinë -Fino e cila vazhdonte të punonte nën ombrellën e Sali Berishës. Qeverisë t'i kërkohet gjithashtu të paralizonte të gjitha strukturat që lidheshin me qeverisjen dhe rolin e Sali Berishës dhe të vinte nën kontroll RTSH-në. Po ashtu kërkova të s'qarohet pozicioni i Komitetve në lidhje me pushtetin dhe kërkesen për të qenë palë në zgjedhjen e krizës në vend.

DEBAT DHE DESHIRA TE MEDHA - MUNDESI TE KUFIZUARA

Në tavolinën e gjatë drejtëkendeshe të takimit serioziteti i fillimit me pije freskuese dhe fruta u fashit shumë shpejt. Nuk e prishën atë as qeflinjtë e konjakut e as ata të pijeve të tjera. Pas raportimit lidhur me gjendjen në Elbasan dhe Cerrik debati u çvendos me force se çdo të bëhej tani me çeshtjen Berisha dhe ultimatumin. Albert Shyti riskicoi idenë e çmontimit pjesë-pjesë të Sali Berishës, si dhe idenë, që komitetet t'u linin më shumë fushë veprimi partive politike, ide që një ditë më parë na i kishte servirur në Gjirokastër Skender Gjinushi. Në këtë frymë ai tentoi t'i imponohej çdo folësi në takim. U detyrova të ndërhyj duke i thenë se «ne flasim dhe këmbëngulim për parime demokratike dhe ti nuk lë asnjë që të thotë mendimin e vet. Je aty në krye për të drejtuar dhe jo për t'u imponuar të tjerëve. Këtu secili do të shpreh mendimin e vet dhe pastaj çdo propozim do të hidhet në votë». Albert Shyti u ul dhe nuk tentoi të ndërpriste më njëri.

Por takimi u ritensionua nga fakti se dëshira për të detyruar Berishën për dorëheqje, ishte shumë e madhe se mundësitë që pakësoheshin. Aty dolën dy propozime tepër të guximshme. E para që të sulmohej Tirana, ose sipas variantit të Gjolekës, thenë gazetarëve një ditë më parë ose me trupa të rregullta. Mendimi i dytë lidhej me ngritjen e një çifti aeroplanësh nga aerodromi i Kuçovës drejt Presidencës në Tiranë dhe që andej ose të iknin drejt Italisë ose të ktheheshin në bazë.

Mendimi i parë u hodh menjëherë posht me të njëjtin pretext si në Ballsh, se mund të derdhej shumë gjak. Ndërsa mendimi i dytë, i bërë drejtpërsdrejti nga dy djem të rinj pilotë në Kuçovë, i vuri të pranishmit në siklet. Ata kishin përpara dy heronj dhe nuk dinin ç'të bënin votën e tyre.

Në pushimin e bërë, pyeta pilotët nga Kuçova se sa të sigurt ishin që nuk do të pësonin asgjë. Siguria e tyre ishte absolute. Madje thanë se s' kishte pse të iknin dhe ata në Itali, kur shumë mirë mund të ktheheshin në Kuçovë. Ata kundërshtuan edhe mendimin që në Presidencë të hidhnin në vend të predhave një ngarkesë të çfarëdoshme me një letër paralajmëruese për Berishën.

Në vijim i sqarova se vendime të tilla as që mund të shtrohen për diskutim, as që mund të mirren në prani të një amalgamin njërezish që s' u dihet origjina.

Nuk arrita të mbaroj mendimet dhe arriti aty një nga zotërinjtë e kryesisë . Thirri Gjolekën mënjanë dhe I tha :” mos I lejoni vetës që t’ju manipulojë një grek”. Unë e dëgjova por nuk reagoja. E dija pozicionim tim dhe kjo ishte arsyeja e kufizimit të kembënguljës time për t’i çuar gjërat deri në fund.

DEKLARATA NDRYSHE

Mëgjithatë në deklaratën e hartuar nuk kishte asgjë nga mendimet dëshirë, të shfaqura në pjesën e parë të takimit. Cdo gjë, sidomos domosdoshmerinë e përsosjës së organizimit të K.K.SH.P dhe të pjesëmarrjës së përfaqësuesve të partive politike dhe nga qeveria, u la për në takimin e Vlorës. N.q.s edhe aty nuk do të realizohej një unifikim I Lëvizjes Popullore për Demokraci me përpjekjet e partive politike , atëherë u vendos, pa u futur në deklaratë, që partitë politike të abandonoheshin nga K.K.SH.P. Po ashtu u përcaktua platforma organizative për sigurimin në takimin e Vlorës të një pjesëmarrjeje nga e gjithë Shqipëria si një akt që do të krijonte edhe mundësi për një organizim përfekt. Në esencë deklarata thoshte:

- KKSHP, në bashkëpunim me partitë politike e Forumit për Demokraci si shprehje e vullnetit mbarëpopullor, t’i kërkojë tryezës së rrumbulakët të partive politike të zgjedhin një Këshill Presidencial me mandat të kufizuar deri në zgjedhjen e parlamentit të ri.

- Shprehim mbështetjen tonë për Qeverinë Fino dhe theksojmë se misioni I saj nuk mund të realizohet nën ombrellën berishiane.

- I Kërkojmë kësaj qeverie paralizimin e veprimtarisë së strukturave që mbajnë në këmbë diktaturën e Berishës . (venjën nën kontroll të RTSH-së dhe medjës tjetër shtetërore, venjën nën kontroll dhe ristrukturimin urgjent nga qendra në bazë të SHIK-ut dhe të Ministrisë së Rendit)

- Kërkesa jonë për të qenë palë në bisedime në përpjekjet që bëhen për zgjidhjen e krizës së përgjithshme deri në zgjedhjet e reja nuk ka asnjë lidhje me qëllimin e partive për marrjen e pushtetit.

Kërkesa për të qenë palë në marrjen e vendimeve, nuk kishte asnjë lidhje me kërkesën e partive për të marrë pushtetin. Në fakt kjo përbente një manover për t’ I afruar partitë me komitetet. Arsyeja qëndronte tek fakti se partitë politike përveç presionit të Berishës për t’u distancuar nga komitetet, kishin filluar të frikësoheshin se mos do të ishin të detyruar ta ndanin pushtetin me këto komitete.

NE TEPELENE ASKUSH NUK MENDOI PER «QEVERI TE JUGUT»

Deklarata u aprovua dhe pas nënshkrimit u lexua para një numri shumë të madh njërëzish dhe gazetarësh të huaj, ku mbizotëronin ata grek. Vura re që të gjitha dritat dhe mikrofnat ranë mbi Gjolekën me pyetje që lidheshin me qëndrimin e komitetëve ndaj qeverisë Fino. Gjoleka dha një përgjigje shumë diplomatike. “ne e përkrahim qeverinë Fino,- tha ai, - por do ta përkrahim edhe më shumë kur ai nuk do të punojë nën ombrellën e Berishës”. Thelbi I pyetjeve të kësaj natyre, lidheshin në fakt me një lajm të përhapur se komitetët mund të shpallnin mosnjohjen e qeverisë Fino dhe të krijonin një qeveri të tyre, lajm që në të vertetë nuk kishte asnjë bazë ashtu si nuk kishte asnjë bazë akuza se Komitetët synonin ndarjen Jug - Veri. Viktimë e një lajmi të tillë ra në fakt një gazetare fare e re madje e kanalit shtetëror televiziv grek .Ajo tha pak a shumë se komitetët pritet këto ditë të shpallin qeverinë e Jugut (!!!). Unë protestova për këtë lajm tek Konsulli grek në Gjirokastrë Pas kësaj gazetarja greke iku nga Shqipëria. Madje as u pa më në kanal televiziv shtetëror grek.

TAKIMI I VLORES KULMI DHE FUNDI BASHKE?!

Në fakt takimi I Vlorës, pavarësisht se nuk arriti të bëjë asnjë hap për një organizim serioz të KKSHP, për shumë arsye të tjera mbetet historik . Ky takim shenoi njëkohësisht kulmin dhe fundin e veprimtarisë së organizuar të këtyre komiteteve, pavarësisht se veprimtaria e tyre do të shtyhet deri në zhvillimin e zgjedhjeve më 29 qershor dhe nga disa do të kembëngulet për të vazhduar më forma të tjera edhe pas formimit të qeverisë së socialistëve.

NGJARJET E RENDA QE I PARAPRIJNE

Takimi I Vlorës u parapri dhe u përcollë nga tri akte tëpër të renda më shumë viktima. Në dy prej tyre duket si protagonist Zani I Vlorës. Pasditën e 27 marsit sindikata e bankave mbledhet në Vlorë për të "vizituar" natën , sipas dëshmitëve të njëjzve shumë afer «sindikatës» , bankën e Fierit. Në Vlorë Zani me disa makina që kishin lidhje me policinë I ndiqte "sindikalistët" nëpër Vlorë. Kjo shkaktoi përplasjen midis tyre. Sindikata mbetet pa armatim dhe vendos që para se të shkojë ne Fier, do të kalonte në Levan për t'u riarmatosur dhe për të marrë nja sasi shumë të madhe pistoletash, të cilat I posedonin romet e etjeshëm (tregëtia e të cilëve ishte për kohën fitimprurëse). Mirëpo në Levan u futën në pritë. Njëri nga dy dëshmitarët e mbetur gjallë, tregon se prita ishte e organizuar dhe se 17 anëtarë të bandës u vranë pasi ishin dorëzuar.

Natën e asaj dite , në Kanalin e Otrandos do të mbytet anija me mbi njëqind veta që iknin nga Shqipëria për t'i shpëtuar kaosit dhe vdekjes së ngadaltë në Shqipëri. Anija «Ikaterti I Rades» që kishte atë fat të mënxyrshëm, ishte manaxhuar nga Zani. Anija nuk mirrte më shumë se 60 veta në bordin e saj dhe kishin hipur mbi 100. Mëgjithatë ajo nuk u mbyt nga mbi ngarekesa . Anija e vogël që u bë e njohur pasi u mbyt, u godit dy herë me dergjegje nga një anije ushtarake italiane . Ishte koha që në Itali stuhia kundra emigranteve klandestinë shqiptarë po vinte në rrezik qeverinë italiane dhe incidenti ndoshta duhej shkaktuar për të parandaluar fluksin në rritje të klandestinëve nga Shqipëria. Kriza qeveritare u kapërxye. Njëkohësisht u kapërxye edhe kriza në marrëdhënjet ndërshtetërore.

83 veta mbetën në fund të detit duke shenuar një tragjedi të paprecedent në historinë moderne Kjo jo vetëm për numrin e viktimave por edhe për faktin se anija shqiptare u godit nga anija italiane edhe pse e dinte që atje kishte gra dhe femijë. Gjithashtu askush nuk kërkoi falje për këtë tragjedi. Pala shqiptare nuk kërkoi përgjegjësi palës Itliane për këtë akt të rendë për civilizimin modern, por I thotë Italisë me përulje faleminderit që nxorri një pjesë të tyre nga fundi I detit. Eshtë fakt tepër domothenës që Tiranës dhe Romës u duhet niveli I mirë I marrëdhënjeve politike dhe aspak fati I njëjzve. Eshtë ky një tregues renqethës I indeferencës së shtetit për shtetasit e vet. për hir të politikës...

Po atë natë në qafën e Pocemit ishin hapur magazinat e mëdha të rezervave të shtetit. Një mizëri e pafundme njëreish nga Tepelena, Mallakastra, Fieri e Vlora rrembenin ç' të mundnin që nga gururi , dhe karbuarantët që s'kishin të sosur deri tek çadrat dhe barelat ushtarake. Grabisnin me mjete me kafshë , por edhe vet ngarkoheshin, ose bënëin togje të mëdha me mall, kryesish me grurë dhe I transportonin pak nga pak. Gjashtë veta ishin vranë dhe varrosur në depot me grurë . Tek shikoje gjithë atë babëzitie, ishte e kot të mendoje një rol efektiv të veprimtarisë së komitetëve.

Në ditët e para vjedhja ishte masive dhe e lirë. Në ditët që pasuan , dhe ishin disa, depot u futën nën kontrollin e grupëve të forta dhe duhej të paguajë atje për të ngarkuar sidomos karbuarant.

GAZIDEDE NE PARLAMENT ME COPA LETRA «KUNDER COPETIMIT» TE SHQIPERISE

Gjithashtu dy ditë më parë,26.03, Bashkim Gazidede kryetari I SHIK-ut që kishte kërkuar dorëheqjen, therritët në parlament për të dhenë variantin e vet të shembjës së shtetit. Rëfimi I Gazidedës I lexuar në copra letrash risolli në skenë me pak retushim aktakuzën kundër drejtuesve të OMONIAS më 1994. Ai foli për egzistencën e një plani “Lotos” të hartuar nga qarqe greke që më 1991-2 për shpërbërjen e Shqipërisë. Qarqet greke të mbeshtetura nga lobi grek në SHBA me ndikim në qeveritë amerikane kishin hartuar, sipas Gazidedës, një plan afatgjatë për copëtimin e Shqipërisë. Ai pretendoi se protestat e Jugut manipuloheshin nga qendra të huaja . “Një diplomat I huaj disa gangsterë grek dhe një Bashkim Driza “ sollën kaosin në Shqipëri, tha Gazidede . Ai nuk nguron edhe duke venë në pikëpyetje punën e vet katërvjeçare në krye të SHIK-ut , të krijojë lidhje të paqena midis qarqëve të ndryshme dhe drejtuesve të komitetëve në Jug, kuptohet në shërbim të idesë së tij se përfundimisht I gjeti copëtuesit e Shqipërisë. Kuptohet qëllimi I tij dhe I ustait të vet.Të shfrytëzohej parlamenti për eksportimin e krizës në kurriz të kryengritësve drejt shtetit fqinj Greqisë

Një konkluzion I tilë nga ana e B. Gazidedes dhe qëndrime të përaferta me të nga parlamentarë të tjerë të PD-së ashpërsoi edhe më revoltën popullore sidomos në Vlorë që kursesi nuk mund të pranonte akuza të tilla.

KUVENDI I VLORES REFLEKTON PAQARTESI TAKIM KOMITETESH APO TRIBUNE PARTISH OPOZITARE

Po ashtu Kuvendi I Vlorës, siç e pagëzuan organizatorët e tij, zhvillohej pas takimit që një përfaqësi e Komitetit të Shpëtimit Publik të Vlorës kishte në Tiranë me Kryeministrin Fino dhe përfaqësues të disa partive politike , si të PS-së, të PSD-së ,të së Djathtë Demokratike,të PR-së dhe të partisë Demokristiane si dhe me ambasadorin Italianë Forestin.

Mëgjithatë në këto takime Vlorë shkoi si Vlorë dhe jo si përfaqësues I të gjithë K.K.SH.P-së. Kështu që edhe këto takime nuk mund të shërbënin si një njohje e komitetëve në përgjithësi nga ana e qeverisë Fino dhe e partive politike pjesëmarrëse ose jo në qeveri. Në pikëpamjet e delegacionit të Vlorës, qeveria Fino konsiderohej si” mundësia e vetme për të shpëtuar vendin nga katastrofa, ku e futi vendin pushteti I Berishës”. Po ashtu në kuminikatën e leshuar me këtë rast nga Komiteti I Vlorës theksohej se i“Takoni popullit të bejë pajtimin”. Të dyja këto qëndrime binin ndesh me misionin e komiteteve si për zgjidhjen e krizës , ashtu dhe për faktin se populli nuk ishte në asnjë lloj konflikt përçarës me vetën e vet. Konflikti ishte produkt I politikës se ndjekur nga Sali Berisha dhe ishte ai që ishte venë përballë popullit.

Kuvendi I Vlorës karakterizohet edhe nga një aspekt tjetër I rendësishëm . Eshtë hera e parë që në një takim të komitetëve të marrin pjesë përfaqësues nga disa parti politike, PS-ja, PSD-ja, PDD-ja ,PKD-ja PR-ja, PAD-ja dhe përfaqësuesi I Forumit për Demokraci. Në kuvend mirrnin gjithashtu pjesë përfaqësues nga rrethet veriore të vendit si nga Malesia e Madhe, Kukësi, Bulqiza, Dibra,Gramshi,etj.

Kuvendi I organizuar në një nga sallat e shkollës së mesme “Ali Demi” ku kishte edhe selinë Komiteti I Shpëtimit Publik I Vlorës . Në pikëpamjen formale dukej një përgatitje përfekte , me masa sigurie të përpunuara, me programe punimesh dhe me materiale të tjera të botuara në mënyrë luksoze dhe të futura nëpër dosje . Por sa filluan punimet gjithëçka mori një drejtim tjetër. Partitë

politike që kishin radhën për të përshendetur shfrytëzuan tribunen e Kuvendit për të bërë propagantë për vete. Oreksi u hap aq shumë sa që përshendetjet filluan të ezauronin të gjithë rendin e ditës. Këtë rrjedhë tenton ta prish Frok Cupi I cili I kritikoi partitë për mefshtësi dhe theksoi se ky takim duhet të sherbejë konceptit dhe aspiratës së kryengritjes popullore për një shtet të vertet demokratik. Për këtë duhej t'i hapej rruga me ndihmën e Komiteteve si shprehës të drejtpërdrejtë të Kryengritjes Popullore të ristrukturimit të pushtetit lokal dhe të institucionëve të tjera shtetërore të shkatërruara apo të braktisuara nga funksionarët partiakë Në këtë kuadër, më qëllim që të përshpejtohej zgjidhja e krizës, Cupi kërkoi që parlamenti të vihej terësisht në funksion të qeverisë Ai u kërkoi partive politike që të shprehnin hapur qëndrimin e tyre ndaj Berishë dhe ndaj komiteteve.

Kjo nuk I pengoi përfaqësuesit e partive politike që të vazhdonin të bënin Propagantë . Arta Dade e PS-së arriti madje të thotë se “kur ne dilnin rrugëve që të kundërshtonim Berishën, populli nuk na ndoqi pas”. Daut Gumeni duke folur si përfaqësues I Forumit për Demokraci ,me retorikën e tij për rolin e Forumit u bë edhe më I bezdishëm. U detyrova të ndërhyja nga salla pothuaj pa takt duke I kërkuar atij që të deklarohet hapur , në emer të Forumit, për qëndrimin ndaj komitetëve dhe ndaj Sali Berishës. Gumeni u përtyp dhe nuk dha asnjë përgjigje. Kjo ishte shenjë e keqe jo vetëm për punimet e mëtejshme të Kuvendit por edhe për bashkëpunimit midis Komitetëve dhe Partive Politike. Diskutimet përshendetese zgjatën aq shumë sa u vu në rrezik sukcesi I takimit, I cili më kot kishte marrë përsipër përveç rishikimit të qëndrimeve, edhe riorganizimin e strukturës së Komiteteve

PARTITE POLITIKE ZGJATIN DOREN PER FIRMOSJEN E DEKLARATES

Partinë Demokratike e pickon gjarperi

Këto dy çështje përbën në vijim dhe problemin kryesor në hartimin e deklaratës , për hartimin e secilës u caktua kryesia e Komitetëve, përfaqësuesit e partive politike dhe përfaqësues të intelektualëve. Debat pati gjithashtu edhe për egzistencën e një deklaratë të përbashkët apo për dy,- një e komitetëve dhe një e partive politike . U vendos për një deklaratë ku përfaqësuesit e partive politike do të firmosnin jo drejtpërdrejt tekstin, por pas një pike të fundit ku të thuhej se edhe përfaqësuesit e partive politike ishin dakort me deklaratën. Kërkesat e deklaratës së Vlorës mbeten pothuaj të njejta . E reja qëndron në faktin se kërkohet që parlamenti të vihej në funksion të Qeverisë së Pajtimit Kombëtar. Ai, Parlamenti, vetëm formalisht dhe për efekte juridike duhet të funksionojë.

Kjo u arrit pas një përpjekjeje vertet të veshtirë me përfaqësuesit e Partive Politike. Ata e kishin të veshtirë të adaptonin qëndrimet e Komitetëve për zgjidhjen e krizës në Shqipëri që fillonin me heqjen e Sali Berishës, zgjedhjen e një Këshilli Presidencial, mënjanimin e funksionarëve të lartë në shërbim të Berishës nga institucionet shtetërore praninimin si palë të Komitetëve. Objeksioni I partive politike mbetej zhvillimi I zgjedhjeve dhe lenjën e frenave të gjithçkaje partive politike, të cilat do të mirrnin përsipër edhe çmontimin pjesë pjesë të «diktaturës së Sali Berishës».

Pëërfundimisht përfaqësuesit e partive e firmosen dokumentin pas kërcenimit të hapur që iu bë nga përfaqësuesit e Komiteteve në Kuvend se nëse partitë politike edhe kësaj here nuk do të prononcoheshin zyrtarisht në lidhje me komitetet dhe strategjinë e tyre për zgjidhjen e krizës në vend, komitetet “do të distancohemi edhe nga partitë politike të opozitës edhe nga Qëveria e Pajtimit Kombëtar”. Në fakt partitë edhe pse e firmosen deklaratën as e zunë në gojë ndonjëherë e as bënë ndonjë veprim për ta kongretizuar atë në praktik. Thjeshtë treguan një akt deheroizmi ndaj komiteteve. Por as komitetet reagues ndaj falsitetit të partive politike opozitare. Gjithë historia ishte një shërbim I mirë ndaj Berishës I cili në fillim u tremb dhe pastaj , kur pa se gjithë historia e deklaratës së përbashkët ishte diçka si gjethet në vjeshtë , ai e shfryteszoi momentin për të folur

deri në fund të zgjedhjeve se rreziku kryesor për zgjedhjet janë komitetet. Berisha e shfrytëzoi këtë situatë për të provuar edhe një herë peshën e pushtetit të tij mbi partitë opozitare.

Rrethi i Berishës reagoi ashpër ndaj deklaratës në fjalë. Pjetër Arbnori e konsideroi “puç konstitucional kundër Parlamentit” deklaratën që “shkel marrëveshjen e nentë marsit” Kjo deklaratë sipas Arbnorit, “synon të përkrah qeverinë në dem të parlamentit” dhe kërcënon se qeverinë “Do ta mbeshtesim deri në pikën që ajo do të respektojë ligjet kushtetuese”. Të njejtat kërcënime benë edhe ministrat e PD-së në qeverinë Fino. Ishte pra e qartë se PD-ja dridhej nga një vendim i tillë i shndërrimit të parlamentit në një formalitet juridik për vendimet e qeverisë. Kjo u duk qartë kur në mesin e majit po ky parlament i kontrolluar nga PD-, nuk mori në shqyrtim fare projekt-ligjin elektoral të qeverisë por një ligj të propozuar nga deputet të PD-së. Pas kësaj Berisha shpërndau Parlamentin duke e futur në rrezik gjithë procesin e deriatëhesrshëm për zgjedhjen e krizës në Shqipëri.

ASGJE E RE NGA FRONTI I ORGANIZIMIT TE KOMITETEVE

Edhe takim i Vlorës, i pesti brenda një harku kohor prej njëzet ditësh, nuk bëri asgjë për organizimin e tij përfekt si një institucion popullor me të gjitha atributet si për të ndihmuar në ringritjen e strukturave shtetërore, ashtu edhe për të drejtuar revoltën popullore. Por edhe për të qenë palë serioze në zhvillimet politike në vend. Të vetmet vendime që u morën në këtë takim ishte ndërrimi i emrit nga Komiteti Kombëtar i Shpëtimit Publik në Kuvend Kombëtar i Shpëtimit Publik dhe qëndra e përhershme e takimeve do të qe Vlora .

Ky ishte në fakt një nga takimet e fundit. Më 24 prill komitetet u mbledhën serish në Vlorë (Komitetet e Sarandë Gjirokastrës, Tepelenës dhe Permetit shmangën një pritë në qafën e Poçemit. Kishin informacion për një pritë, ndaj dhe ishin armatosur deri në dhemb, por në momentin e fundit vendosën të shkojnë nga Fieri duke e lënë pritën të ngrehur në qafën e Poçemit. I kësaj periudhe është edhe deklarata e Belul Celos në delegacionin e partive të EDU-s në Tiranë , se po të kishte një urdher nga organet kompetente , do t'i shtypte komitetet)

Edhe në këtë takim ishin përfaqësues nga partitë politike. Nga takimi nuk rezultoi as edhe një deklaratë. Ndërrhyrja e përfaqësuesve të partive politike ishte e tillë sa që komitetet pothuaj e kishin humbur fare individualitetin e tyre. Kjo gjendje ishte dhe rezultat i humbjes së kredibilitetit në popull të komiteteve. Populli vazhonte të tregojë gatshëm vetëm për thirrje që drejtoheshin kundër Berishës, pavarësisht se kush e bënte këtë thirrje.

. Më 16.05 u zhvillua edhe një takim tjetër i cili u imponua nga fakti se parlamenti me deputetë vetëm të PD-së votoi atë ligj elektoral që propozoi PD-ja dhe jo qeveria . Ky veprim i PD-s u muar pavarësisht nga reagimet e shumta të brendshme dhe të jashtme . Komitetet , tashmë nga vetëm 15 rrethe dhe me përfaqësues partish vetëm nga PS-ja , me një eksponent lokal, dhe PAD-ja, shtruan si alternativa , ose një ultimatum të ri ndaj Berishës, ose fillimin e veprimeve luftarake, ose reagim për bojkotim të zgjedhjeve. PS-ja propozon që për marrjen e një vendimi të pjekur , të thërritën gjithë komitetet, partitë politike opozitare dhe personalitete nga i gjithë vendi. Propozimi pranohet dhe njëkohësisht mirret edhe vendimi që komitetet të rrinë të mbledhura për të ndjekur kështu zhvillimet politike në vend , që me të vertetë në ato momente ishin të stuhishme.

Problemi është se as komitetet qëndruan të mbledhura e as propozimi i PS-së u realizua. Afroheshin zgjedhjet dhe qëndrimi i kuvendit në lidhje me këto zgjedhje shkaktonte pështjellim në radhët e komitetve . Interesat për karrierë politike personale ishte arsyeja e këtij pështjellimi. Shumë elementë në radhët e komiteteve e shikonin se partitë politike kishin më shumë mundësi për t'i kënaqur ambicjet e tyre . Lidhjet e vjetra me to duhej të rinovoheshin në bazë të një kontrate te re “shpërblimi” me poste politike për sakrificat e treguara..

STATUTI UNIFIKUES I KOMITETEVE MBETI SYRTAREVE

Deshton edhe përpjekja për krijimin e një Levizjeve të re me aspiratë ndërtimin e shtetit

Mëgjithatë gjatë kësaj periudhe Komiteti I Vlorës I cili në fakt kishte një organizim pothuaj me efekt në jetën e Vlorës, punoi për një statut dhe një program unifikues të Komitetëve në bazë të përvojës së Vlorës. Statuti përbëhet nga 33 nene që përbejnë edhe pesë kapitujt e statudit. Statuti kërkon të institucionalizojë Kuvendin Kombëtar të Shpëtimit Publik, “që krijohet si shprehje e vullnetit të popullit protestues nga të gjitha krahinat, rrethet qytetet pjesëmarrëse”. Ky Kuvend është organ vendimor, vendimet e të cilit “Mirren kryesisht në bazë dhe për zbatim të dispozitave kryesore kushtetuese e legjisllacionit në fuqi”.

“Komiteti Kombëtar I Shpëtimit Publik krijohet për bashkërendimin e mbrojtjes së interesave të popullit dhe ato mbarëkombëtare....” “Lufton për stabilizimin e gjendjes në shkallë kombëtare, forcimin e rendit e të qëtësisë, funksionimin e jetës normale politike edhe ekonomike, sociale e kulturore në bazë të legjisllacionit në fuqi”. Ai mbeshtet veprimtarinë e të gjitha forcave politike “pa dallim e privilegje, për të shkuar në zgjedhjet në kushte normale”.

Në statut theksohen mjetët paqësore dhe demokratike të veprimtarisë së K.K.SH.P. Po ashtu përcaktohen rregullat e zgjedhjes së organëve të tij, por nuk flitet për detyrat e çdo strukture, e as për egzistencën e një kryetari, por vetëm të një kryesie dhe të seksionëve të veta.

Kuptohet që ky statut as u diskutua e as u aprovua ndonjëherë. Mëgjithatë ishte një tregues I shqëtësisë të shumë anëtarëve të këtyre komitetëve për të krijuar një institucion të Kryengritjes Popullore. Kjo kërkesë lidhej jo vetëm me faktorin e realitetit të krijuar, si aspekt historik, por edhe me faktin se partitë politike tregonin se ishin të interesuara vetën për marrjen e pushtetit dhe aspak për ngritjen e shtetit.

Ishte pikërisht faktori I dytë, dyshimi se partitë politike jo vetëm se nuk do të arrinin të mboshtnin përfundimisht Berishën, por as nuk tregonin një predispozicion serioz për restaurimin e shtetit, që impononte mendimin për organizimin e një levizjeje të re intelektualësh me pikënisje konceptin e Kryengritjes Popullore. Në rastin më të keq kjo lëvizje të synonte në grumbullimin dhe interpretimin e materialëve qoftë edhe për efekte njohjeje apo edhe historike të Kryengirtjes Popullore. Realisht kjo Levizje e re parashikohej të shndërrohej në një subjekt elektoral dhe të përbënte frymën e Kryengritjes Popullore në sistemin e ardhshëm të shtetit. Ajo edhe pse kërkonte të kishte në përmbajtjen e saj aspiratat e Kryengritjes Popullore nuk donte të kishte si element bazë njëriëzor atë të Komitetëve. Arsyet qënë: E para. Në teresinë e vet, komitetet kishin treguar se ishin larg pretendimit popullor për t'u shndëruar në bosht udheheqës të tij. E dyta në shumë raste Komitetët ishin kompromentuar qoftë edhe me shpifje me stituatën kriminale dhe të degraduar në vend. E treta. Shprehnin vetëm Jugun, ndërsa forcat e verteta intelektuale gjendeshin në Tiranë.

Në shtepine time dy herë radhazi, nga data 10 - 14 prill, unë juristi I njohur për kontributin në Kryengritjen Popullore, Arben Pasho dhe publicisti Frok Cupi diskutuam për platformën e kësaj Levizjeje. Hartuam, krahasplatformës së Lëvizjes së re edhe listën e emrave që mund të bashkoheshin në të. U ndanë edhe detyrat Për organizimin e figurave të njohura në Tiranë dhe hartimin e dokumentave u caktua Froku, meqë unë dhe Pashua e kishim tëpër të veshtirë për të udhetuar në Tiranë. Disa nga emrat e listës ishin Fatos Lubonja, Edi Rama, Ylli Popa, Agim Isaku, Gazmend Kapllani, etj.Cupi na foli edhe për emra të tjerë të njohur të tij në Shkodër madje edhe në Tropojë

Mirëpo pas disa ditësh Froku na telefonon për veshitësitë në komunikimin më këta intelektualë. Njëkohësisht në këtë kohë na njoftoi se, ai u kërcënuar disa herë dhe u detyrua të largohet jashtë vendit. Atje ai mbeti pa asnjë lloj komunikimi me ne për një kohë relativisht të gjatë dhe u kthye kur filloi procesi i venjës së kandidaturave për deputet. Ai vuri kandidaturë me AD-në në Vlorë përball Skendër Gjinushit.

Kështu mori fund edhe një përpjekje tjetër për të organizuar një levizje intelektualësh në Shqipëri, që të kishte frymën e Kryengritjes Popullore dhe njëkohësisht të ishte larg standartave të partive politike shqiptare.

Nëvojën për të fituar terren elektoral në Jug e ndjenin edhe partitë politike sidomos ato të vogla. Në këtë kohë, një mik i imi anëtarë i Komitetëve dhe njëkohësisht anëtarë i një partie të vogël politike, vjen me një platformë të ardhur, sipas tij, nga Tirana më anë të secilës kërkohet që të shpallëshin njësoj të rrezikshme si PD-ja ashtu edhe PS-ja, kështu që t'i hapet rruga një force politike të qendrës, thoshte platforma dhe miku im, i cili më vonë zuri një vend të nderuar. Kuptohet që kjo platformë u kundërshtua me forcë si vertet metafizike për situatën dhe gjendjen politike në vend.

Kështu Kryengritja Popullore mbeti njëdimensionale, vetëm si mohim i regjimit të Berishës. Partitë politike të opozitës e shfrytëzuan në mënyrë të paskrupull këtë sakrificë popullore, dhe kur e panë vetën shumë afër pushtetit tradhetuan si aspiratat e kësaj Levizjeje ashtu edhe premtimet e dhena. Komitetet të cilët mezi mbaheshin në këmbë, mezi prisnin një moment të tillë. Dhe ato u shkrinë në zjarrin e opozitës për pushtet me dëshirën e zjarrtë për të përfituar pak nga ky zjarr

PJESA E KATERT.

Kapitulli 19

PO KUSH TJETER E SHKATERROI KETE SHTET.

(Komisioni Ngjela nuk disponon asnjë dokument për veprimtari të agjentuarave të huaja)

Një miku im jurist duke iu referuar shkaktarëve të gjendjes së paralizuar të shtetit edhe pothuaj një vit pas zgjedhjeve dhe fitorës së thellë të ish opozitës , thotë se është faktori shoqëri që ndërton apo shkatërron shtetin. Faktori I udheheqjes politike është promotori përcaktues I reagimit të shoqërisë. Në këtë kontekst sipas tij , faktori politik përcaktues për shkatërrimin e shtetit është Berisha dhe PD-ja, ashtu si tani faktor kryesor për mos ristrukturimin e shtetit është PS-ja. Rezultati I të dy qëndrimeve është I njëjtë dhe lidhet me degjenerimin e shoqërise civile deri në degradimin maksimal të shtetit.

POLITIKANËT SHQIPTARE KERKOJNE FUQI PER TE QEVERISUR VENDIN TEK TE HUAJT

Do ta pranoni këtë aksiomë si përkufizimin më të mirë të faktorit të brendshëm që çoi në shembjen e shtetit si një keshjtjellë rëre Por a egzistonin faktorë të jashtëm ?. Sigurisht që po . Vet Fatos Nano nga posti I kryeministrit të vendit duke vizituar Londrën tha për BBC-në . “Komuniteti ndërkombëtar ka harxhuar qindra e mijra dollarë për të ardhur në këtë situatë , ku Berisha është në opozitë” Deklarata bombë, e peshuar apo e papeshuar e Nanos zbulon dy elementë thelbësor. :- që Perendimi harxhoi shumë para për ta rezuar Berishën , por jo për ta menjanuar fare nga politika, por për të qëndruar në opozitë.Po ashtu Nanua nuk nguron të pohojë në mënyrë të terthortë se e ka kuptuar se për të gëzuar gjatë karrigen duhet t’u bindesh atyre që të ulin apo dhe të heqin në karrigën e pushtetit. Historikisht po vertetohet se shumë njëhëz në Shqipëri që pretenduan fronin, e morën atë duke bërë kombromise vasaliteti ndaj të fuqishmëve të Perendimit. Por sa mirrinin skeptrin kujtoheshin se ishin shumë të fuqishëm dhe kërkonin të ndreqnin gabimin e berë, ose harronin lidhjen e parë dhe I qëpeshin ndonjë oferte të re. Nuk bën përjashtim nga ky rregull as Enver Hoxha.

Po ashtu , ngjarjet e vjetshme, ose pas 26 majit 1996, vertetuan edhe një herë se kurdoherë që burrat e shtetit shqiptar «zihen» midis tyre, gjejnë strehë ku të zbrazin pakënaqësitë e tyre tek të huaj, veçanarisht tek ambasadat e huaja. Këtu nuk bën përjashtim as burri I fortë Mehmet Shehu.

HARAC NGA GJEOSTRATEGJIA E VENDIT

Por cilët ishin dhe si vepruan këta faktorë të jashtëm? I pari lidhet me përplasjen e interesave të fuqive të rëndësishëm që përbejnë Perendimin për të vendosur influencën e tyre në pjesën e mbetur të boshtit gjeostrategjik të ekulibreve Lindje Perendim,-Ballkanit .Pjesa e mbetur e këtij boshti është Jugu I Ballkanit, në një kohë që faktori që ndikoi në zgjidhjen e konfliktit në Bosnjë konsiderohet dhe si faktor determinant I influencave politike në pjesën veriore të Ballkanit që tradicionalisht I përkisnin në mos Austrisë ,Gjermanisë . Përvoja e shpërberjës së Jugosllavisë në

pjesën Veriperendimore të saj tregoi se vendosja e influencës në një rajon me një qendrushmeri pesëdhjetëvjeçare, mbi bazën e një harte politike të ndryshuar, arrihej mes konfliktit. Kjo çon në përfundim që përplasja e po këtyre faktorëve në një rajon më po atë rendësi gjeostrategjike të bëhet më intensive pikërisht pas marrëveshjes së Dejtonit .Duke qenë se Shqipëria përbënte hallkën me të rendësishëm të konfliktit të pashpërthyer në Kosovë, kjo përplasje shfaqej në vullnetin politik për të hequr apo lenë Sali Berishën në pushtet.Ndodhte kështu se Berisha kishte arritur të ndryshonte simpatitë dhe partneritetin me Perendimin në funksion të këtij roli që I besohej për Kosovën.

Faktori I dytë kishte një natyrë krejt ekonomike por që ishte në funksion të faktorit politik. Duheshin fshehur gjurmët e makinës gjigante të shpëlarjës së parave të pista që ishin firmat piramidale dhe që ridhnin nga trafiku I paligjsjëm I armëve, drogës,karburantëve, etj. Jugu dhe kryesisht Vlora ishin qendra kryesore të këtij aktiviteti. Berisha duhej të paguante tani tolerancën e treguar, si orientim politik të drejtimit të shtetit nga ana e tij, në krijimin e një mirëqenjeje dhe bolleku ekonomik fiktiv me bazë këto para të pista.Po ashtu, kur konstatoi fundin e tij Berisha ishte I interesuar të zhdukte gjurmët e drejtimit të keq të shtetit dhe keqpërdorimit të pushtetit dhe të pasurisë kombëtare ne favor të krijimit të një baze elektorale për PD-në .I gjithë kjo problematikë e kishte detyruar Berishën të shtrembëronte natyrën demokratike të shtetit.Ai kishte filluar të besonte edhe vet se kishte ardhur për të qendruar gjatë në krye të shtetit, ndaj dhe kurrsesi nuk ishte predispozuar për ta dorëzuar atë me mjete demokratike.

Në këtë kuadër e interesuar për humbje gjurmesh deri në shkallën e zotërimit të pushtetit ishte edhe opozita e cila kontrollonte deri në fund të vitit 1996 pushtetin lokal.

ROLI I PARAVE TE PISTA DHE DY OPSIONE TE TJERA PER KRIZEN

Nga ana e tyre paratë e pista vetëm sa krijuan tek qytetarët shqiptarë ndjesinë e pasurimit të shpejt. Realisht ato duke patur një origjinë kryesisht nga bota islame dhe rrethet mafioze perendimore , synonin në krijimin e supremacisë së islamizmit në këtë vend Evropian, (gjë që Berisha e favorizonte në mënyrë provokuese në sytë e Perendimit)dhe nga ana tjetër shndërruan vendin në arenë e veprimit të grupeve mafioze me interesa shume të fuqishme ekonomike.Prania e këtyre grupeve në Shqipëri krijoi premisa që në të ardhmen çojnë në sundimin e shtetit , të dobësuar nga korupsionin I funksionarëve të tij pa dallim ngjyrimi politik,nga interesat e këtyre grupeve .Pra krijuan kushtet e një republike e tipit kolumbian, më të vetmin dallim se në Shqipëri interesat e grupeve mafioze bashkoheshin më ato të popullit të “pasuruar” dhe të varferuar si në enderr, bashkoheshin pra tek piramidat. Perendimi , I cili gjykon të tjerët me mentalitetin dhe skemat e veta, nuk mundi të parashikonte rrjedhen e ngjarjeve në Shqipëri.Kështu përpjekja për të hequr Berishën në kushtet kur ky nuk u bindej parimit demokratik të dorëzimit në mënyrë paqësore të pushtetit dhe në kushtet e egzistencës së një opozite anemike ne vend, nxirrte në arenën politike popullin e tradhetuar dhe të ngrenë në besë .Faktori popull I braktisur nga pozita të ndryshme nga forcat politike në vend, iu përgjigj ngerdheshjës shtetërore me nje kryengritje spontane.

Nuk duhet të hidhen posht as mendimet e shfaqura se në qendrat e marrjës së vendimeve u arrit deri edhe tek varianti i ndryshimit të mëtejshëm të hartës gjeografike në Ballkan Kjo solli zgjatjën e krizës deri atje sa situata të mos rifutej serish në një rrjedhë të pakontrolluar Praktika e ditëve të krizës provoi gjithashtu se për të ardhmën e shtetit shqiptar ridolën nga syrtarët e arkivave Perendimore dosjet e pakta që nga dhetëvjecarët e parë të shekullit tonë. Këtu nuk përjashtohej as varianti I një protektoriatit që në fakt , me vendosjen e Forcave Shumë Kombëshe rolin e Vraniskit apo dhe të Forestit , ky protektoariat aplikohet.

Në lidhje me situatën e krijuar në vend në gjysmën e parë të vitit 1997, egzistojnë dy opsione. I pari, I shprehur më së shumti nga klani I Berishës, lidhet me të ashtuquajtura synime për copëtimin e Shqipërisë, I përkrahur bile edhe nga kryeministri I qeverisë së Pajtimit Kombëtar.

Opsioni I dytë e lidh krizën me synimin për shkatërrimin e shtetit shqiptar me qëllim që si shtet am të mos këtë mundësi reagimi në rol faktori determinant, sidomos për çështjen e Kosovës si akti I fundit I krizës se re në Ballkan. Kuptohet ky opsion është i vlefshëm se me një formulë e tillë lokalizohet se tepërmi kriza e Kosovës .Mbështetësit e këtij opsioni lidhin dhe hapjen e depove ushtarake shqiptare me synim kryesor armatosjën në menyrë të natyrshme të shqiptarëve në Kosovë

Po ashtu reagimet e Perendimit pro dhe kundra Berishës edhe pse favorizonin në një shkallë të lartë përqindjeje qëndrimin kundër,(se shprehnin në fakt vullnetin e popullit),ky qëndrim deri në momentin e fundit nuk ishte shndërruar në vendim të formës së prerë. Nga ana tjetër, me fillimin e krizës apo edhe para saj, nuk ishte vendosur asgjë , jo thjesht për zgjidhjen e krizës, por edhe për formën e qeverisjes, forcën, apo forcat politike, përsonat konkretë që do të viheshin në krye shtetit Shqiptar,etj

LOJA E MADHE E BERISHES,- LAK NE FYTIN E VET

Në politikën e vet në krye të shtetit shqiptar, Berisha manifestoi lojën politike dyplaneshë në përgjithësi diametralisht të kundërta.Në thelb ai tentoi të shfrytezonte interesat e shfaqura nga shumë drejtime për gjeostrategjinë e vendit dhe ardhmërinë politiko-shoqërore dhe fetare në vend , për ta kthyer atë sipas konceptit të tij në vend kyç midis kristjanizmit dhe myslimanizmit dhe vetën, në një burrë shteti që mund të vendoste për fatet e rajonit. Konflikti disa vjeçar në ish Jugosllavi I krijoji atij mundësi, siç thamë edhe më sipër, për të bërë një lojë në dukje të pavarur dhe me protagonist vetvetën . Por kjo «liri» që I falej, ishte në fakt edhe një lak I padukshëm në fyt . Në një moment të caktuar, ndërhyrja amerikane për zgjidhjen e krizës në Ish Jugosllavi, pas “pamundësisë së Evropës” për ta zgjidhur atë, u krijoji SHBA mundësi praktike për të vendosur influencën dhe kontrollin e vet në pjesën qëndrore dhe veriore të boshtit gjeostratigjik të ekulibreve Perendim-Lindje.Njëkohësisht Millosheviçi përbente tani pjesë të lojës amerikane në Ballkan. Politika amerikane u provua qart se kontrollonte edhe qëndrimet e Rugovës.Po ashtu shumë kohë më parë ushtarë amerikanë ishin vendosur në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë .Nga ana tjetër qeveria e re majtë e K. Simitisit në Greqi , e përgojuar se do të ndiqte një politikë të jashtme pro gjermane, pas krizës që Turqia provokon në Ishujt e detit Egje në mesin e vitit 1996 , I thotë në mënyrë përlulëse “faleminderit “ administratës së Klintonit për kontributin e dhënë për menjanimin e mundësisë së një konflikti të nxehtë më Turqinë.

Qëndrimi politik prej bajraktari I Berishës ndaj politikës amerikane në rajon, (Berisha kërkonte vazhdimisht lidhje të dyfishta të aplikuara me një mentalitet provincial) dhe pozita e tij e brendshme e lekundur pas referendimit të 1994 sjell fillimin e divorcit me amerikanët, për të arritur kulmin me zgjedhjet e majit 1996. Shkëlja e të drejtave të njeriut, karakteri autarkik I drejtimit të shtetit , devijimi në përgjithësi nga rruga e pritshme demokratike e vendit dhe kurthet ekonomike nëpërmjet piramidave, përbënin në fakt arsye te mjaftueshme për të kërkuar heqjen e Berishës nga pushtetit. Bajraktarizmi I Berishës dhe përplasjet deri jasht etikës diplomatike me personalitete të diplomacisë dhe politikës amerikane, ambasadorin Shifter , me nënsekretarin për çështje globale Timothy Eorth, deputetin Llandosh, e bënë më të prekshme përplasjen dhe ftohjen me amerikanët. Ambasadori I vetëm I Berishës në SHBA mbetet ministri I tij I Mbrojtjes, Safet Zhuliali.Berisha tregoi hej bukëshkalë me ata që e sollën në pushtet duke vertetur edhe një herë parimin se në çdo

rast të tillë kur nuk u duhesh padronëve, ata të hedhin dhe çdo kundërshtim e paguan shumë rendë. Por kjo sjellje ndaj partnereve të tij kryesorë, amerikanëve, Berisha donte njëkohesisht ta përdorte edhe si tregues devotshmerie për relatat e reja me partnere Evropianë, veçanarisht me gjermanet. Mjaltoja e marrëdhënjëve me gjermanet zhvillohet sidomos pas disa marrëveshjeve ekonomike të dyshimta në Veri të vendit.

Berisha do të sjell më vonë edhe një argument tjetër se pse u prish me amerikanët. Sipas gazetës Albania shkaku duhet kërkuar tek fakti se Berisha u mohoi amerikanëve dhenjën e Sazanit. Reagon mënjëherë ambasada amerikane në Tiranë e cila deklaroi se « Ishte qeveria shqiptare që u kërkoi SHBA-s në dhjetor të 1995 një gjë të tillë»

Gazeta «Koha Jonë» sjell, po në atë kohë, fillim të majit 1997 një deklaratë të S. Berishës te para një viti ku «u propozon gjermanëve që të zgjedhin një bazë të tyre në Shqipëri siç bënë edhe amerikanët». Komentet pra, janë të tepërta.

Më gjithatë, roli i Berishës nuk është aq i rëndësishëm për politikën e mbrendshme shqiptare, sa për politikën që mund të luaj në Kosovë. Pikërisht angazhimi i Berishës për radikalizimin e situatës në Kosovë, (pas Dejtonit dhe veçanarisht pas shpërthimit të krizës së përgjithshme në vend), në kundërshtim me politikën e paqës që kërkonte Perendimi në këtë rajon, e kthyen Berishën në objekt të përplasjës për vendosje të influencës në Shqipëri, midis politikës Evropiane, nënkupto gjermane, dhe interesave amerikane në rajon. Në fakt, po përgatitej një faturë e rëndë edhe për pjesën tjetër të Ballkanit me strumbullar Serbinë, me synim shkëputjen nga influenza e amerikanëve të pjesës jugore të Ballkanit. Kosova po përdorej si çelës për të prishur ekulibret e vendosura pas Dejtonit. (I të mos harrojmë se pas humbjes në referendumin e 1994 për kushtetut janë politikanët gjermane me në krye Hercog që e ngrajnë nga balta Berishën duke i krijuar bindjen se mund të mundte amerikanet duke u mbështetur mbi supet e tyre. Po ashtu në një takim pune me Ministrat e Jashtë të NATO-s, në fillim të 1997, Berishës i kujton Kosovën Kinkeli duke i krijuar dhe mundësi për një qëndrim sa më radikal.)

FATURA E BERISHES PER KRIZEN KA EMRIN LOBI GREK

Kanalet zyrtare të shtetit të drejtuar nga Berisha dhe të qarqëve rreth tij mundohen që katastrofën e shtetit shqiptar në gjashtëmujorin e parë të vitit 1997, t'ia faturojnë veprimet të qeverisë amerikane të ndikuar nga Lobi Grek atje. Sipas kësaj logjike prishja me amerikanët erdhi pasi Berisha u prish me disa diplomatë dhe politikanë amerikanë. Pretendohet p.sh se me Shifterin, Berisha u prish pasi ky i fundit nuk pranoi "në emer të sovranitetit" të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, të ndikonte në lirin e pesë "qytetarëve shqiptarë me origjinë greke". Me deputetin Llandosh u prish pasi Tirana nuk e lejoi atë që të shoqërohej nga Nikolla Gage në një vizitë në Shqipëri. Me Eorthin pasi Berisha nuk pranoi ta takonte nënsekretarin amerikan, gjatë një vizite zyrtare që ky i fundit kërkoi të bënte në Shqipëri pas një turneu në Ballkan.

Po sipas këtij varianti, prapa gjithë këtij skenari qëndron ish kryetari i POAKA-s, (Federata Panepirote të Amerikës, Kanadas dhe Australisë), ose eksponenti i Lobit Grek në SHBA, Nikolla Gage. Z. Gage dhe qarqet e tjera greke, sipas këtij varianti, të shpalosur edhe në parlamentin shqiptar 26,03 1997, kishin gati një plan me kodin "Lotos" të pazbatuar që më 1992. Ky përsos pra sipas versionit zyrtar të Berishës, bashk me disa qarqe greke, arritën të bindnin qeverinë e Klintonit të rrëzonte më një mënyrë të tillë Berishën për të marrë gjysmën e Shqipërisë, ose "të shtrinte kufijntë e Greqisë deri në Lezhë"

Berisha shfaqet në këtë literaturë si hero legjendar që lufton me Gage si me bajlozin në strofkën e tij, në SHBA dhe del fitimtar. Kulmi i përplasjes ndodh gjatë periudhës së gjyqit të pesë qytetareve shqiptarë me origjinë greke. Zedhenësit e Berishës e shfaqin lirin e tyre si një vendim aksidental ose personal të Zef Brozit, kryetar atëherë i Kasacionit, pra, vendim i çliruar nga të gjitha ndikimet e të huajve. Ndoshta për këtë fakt Brozi u ndoq egërsisht nga Berisha dhe ky përfundoi në Amerikë. (!!)

Mirëpo Nikolla Gage ato ditë që çuan në lirin e të pestëve, ishte në Tiranë. Fakt është se ai dhe një makinë e ambasadës amerikane u morën me lirin e tyre në mesnatën vonë të 08.02. 1995. Pas kësaj "i rrezikshmi" Gage do të vij disa herë në Shqipëri. Madje nga rrethi i tij doli se ndihmësi i Berishës, Pollo i ka dhënë Gagës një drekë në shtëpinë e tij. Në sfondin e këtyre zhvillimeve deri dhe pak pas zhvillimit të zgjedhjeve të 26 Majit 1996 bëhet edhe vizita në VLORE e ish presidentit Bush me ish shefin e Pentagonit Kolin Pauell. Ndoshta në këto vizita të shpeshta të Gages në Shqipëri fshihet, por jo sipas Berishës edhe çelësi i sekretëve të përplasjes së mevonshme midis tij dhe Berishës.

FLIRTET E ATHINES ME BERISHEN DHE PERPJEKJET E TIJ PER TE EKSPORTUAR KRIZEN GREQISE

Sidoqoftë, në momentet kur Berisha nuk mund të kontrollonte pothuaj asgjë në Shqipëri ai e hodhi në treg, mes parlamentit kartën e stërprovuar të rrezikut të jashtëm për shtetin Shqiptar dhe sidomos rrezikut grek. Termi grek dhe qarqe greke u përdorë në fakt si një bombë tymuese. Në atë raport edhe pse i pa sistemuar mirë nuk flitej asgjë për veprimtari aneksoniste ndaj Shqipërisë të qëverisë apo të shtetit grek. Po ashtu operohej shumë me kujdes për qëndrimin e minoritetit grek në Shqipëri ndaj revoltës popullore. Kjo zbulon në fakt nga njëra anë karakterin propagandistik të kartës nacionaliste të klanit të Berishës dhe nga ana tjetër zbulon lidhjen deri vonë të tij me qeverinë greke. Fakt është që distancimin e minoritetit ndaj kryengritjes popullore kundër Berishës e kërkonte me ngulm edhe qeveria greke. Megjithatë shumë -shumë me këto teza Bashkim Gazidede bindi kryeministrin Fino, i cili dy ditë para shfaqjes në sallën e parlamentit të Gazidedës i kishte thënë delegacionit të kryengritësve të Vlorës «Qarqe të veçanta janë të interesuara për shpërberjen e Shqipërisë» Përgjigjen, megjithatë e dha politikani Sabri Godo kur iu përgjigj Gazidedës po në sallën e parlamentit se "Kufijtë më të sigurtë për Shqipërinë, janë kufijtë me Greqinë, se janë kufijtë e Evropës"

E verteta është se Athina zyrtare tepër vonë u ndërgjegjesua për situatën që po mahisej në Shqipëri dhe rolin e pavlerë të Berishës. Në një takim që patëm më njëherë të kabinetit të ministrit të jashtëm grek Pangallos, vetëm disa ditë pas ftesës që ambasadori i Greqisë në Tiranë, Prevedhurakis i dorëzonte Berishës në emer të homologut të tij grek Stefanopulos për të vizituar Athinën (22.02), vumë re se ata ishin të bindur se Berisha jo vetëm po e kontrollonte situatën në Shqipëri, por edhe do ta kapëerxente shumë shpejt.

Ky qëndrim i Athinës ndaj Berishës duket se nuk u zhblllokua edhe në ditët e fillimit të marsit, kur ajo i propozonte masa urgjente perendimit për parandalimin e një krize me të rendë dhe më të gjerë. Madje duhet thënë se qëndrimi i qeverisë greke në një pozicion të tillë që nuk mirrte parasysh zhvillimet e kryengritjes popullore por shkonte pro Berishës, kishte risjellë në dritë divergjencat midis dy grupeve kryesore të ministrave të qeverisë së Simitit. Ministrat rreth Aqis Tsohatzopulosit, që konsideroheshin të rrethit të Papandreut, duket se kishin një informacion me të plotë për zhvillimet në Shqipëri dhe kërkonin një ndryshim të kursit të qeverisë ndaj Berishës. Vertëtimi në praktikë i

tezave të tyre solli një supremaci të këtij grupi ministrash ndaj kryeministrit Simitis. Kryeministri se bashku me Ministrin e Jashtëm mbanin qëndrimin që rridhte nga informacioni zyrtar I ambasadës greke në Tiranë. Pikërisht ky qëndrim e bëri Greqinë që edhe pse doli e para me propozime kongrete në Perendim për të parandaluar krizën në Shqipëri, të mbetet thuajse në bisht të veprimëve kongrete duke ia lenë kështu iniciativës Italisë

Gazeta greke "Eleftheros Typos tis Qiriaqis" më 9 mars shkruan se sillte në dritë një plan midis Berishës e Athinës dhe që sipas gazetës plani tolerohej nga SHBA. Plani sipas gazetës, është një letër e ambasadorit të Greqisë në Tirane I natyrës «top sekret». Në bazë të letrës, "Tirana kërkonte nga Athina që në marrëveshje me SHBA-në, Berisha të tolerohej në heshtje edhe disa ditë akoma, gjersa të binte morali I kryengritësve të Jugut të cilët përballonin një situatë të veshtirë në karburante edhe ushqime" Qellimi ishte që Berisha në këtë periudhë të arrinte të zbatonte planin e sulmit kundër Jugut, të asgjësonte qëndrat kryesore te rezistencës dhe t'i detyronin kryengritësit të strehoheshin tej kufirit grek. Informacioni që SHIK-u I transmetonte Perendimit, sipas kësaj letre top sekret, ishte që vetëm 1000-2000 veta në Jug mund të krijonin një rezistencë të armatosur. Gazeta në fjalë, thekson se qëndrimi I SHBA, nuk ishte akoma kategorikë për atë që duhej të bënte me Berishën. Por nga ana tjetër një spastrim I Jugut nga elementi kryengritës dhe bashkë më të, logjike është, dhe atij me origjine greke krijonte premisa për egzistencën e territorëve demografikisht të lira në Jug të Shqipërisë. Kjo sigurisht krijonte premisa për ndonjë akt tjetër dramatik për rajonin. Pikërisht një tezë e tillë mund të bënte, në këto momente, SHBA toleruese ndaj Berishës (fakti që pas zgjedhjeve u aplikua një politikë e Jugut - tokë të djegur e mban akoma të ndezur këtë hipotezë.)

Fakt është që deri më 11.03 dogana greke e Kakavijës e mbyll plotësisht veprimtarinë e saj duke veshtirësuar vertet se tëpërmi situatën në Jug. Ishte kjo arsyeja që Komiteti I Shpëtimit Publik I Gjirokastrës duke shprehur edhe vullnetin e Komitetit Kombëtar të Shpëtimit Publik të Tepelenës, Sarandës Permetit, Vlores, etj, në një deklaratë shumë të ashpër të po asaj dite " e konsideron një vendim të tillë, si një akt të njëanshëm me synim të qartë për t'i ardhur në ndihmë rregimit të Berishës". Reagimi I palës greke që I mënjëhershëm Kufiri u hap, të nësërmen për të gjitha llojet e mallrave ushqimore e farmaceutike. U ndaluan vetëm ato që konsideroheshin mallra të mundshme për kontrabandë. Këtu fillon edhe kthesa përfundimtare e Greqisë ndaj situatës në Shqipëri, kthesë që më së shumti lidhet me fundin e turpshëm të operacionit ushtarak të Sali Berishës kundër Jugut.

RREZIQET E NJE QENDRIMI (SIPAS AKUZAVE) TE ATHINES

Kostoja e brendshme e qëverisë greke nga qëndrimi ndaj zhvillimëve në Shqipëri

Mëgjithatë gjatë kësaj periudhe, Athina deklaroi nëpërmjet gojës së Pangallos dy herë radhazi se pavarësisht nga zhvillimet, në Shqipëri, Greqia ndjek politikën e pandryshueshmërisë së kufijve. Në vizitën e tij në Tiranë më 03.06 Pangallos do të deklarojë shprehimisht: «Interesimi për mbeshtetjen e Shqipërisë në këto momente të veshtira që kalon vendi, nuk përbejnë deklarata diplomatike, por një çeshtje vitale që ka si qëllim mbrojtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, egzistencën e një sistemi demokratik dhe një zhvillim me perspektivë të vendit». Nga ana tjetër, Athina, siç e thamë, përpiqet më shumë takt që të mbajë minoritetin grek larg trazirave dhe rebelimit në Shqipëri. Kuptohet që një pjesëmarrje aktive e minoritetit grek në Shqipëri do t'u jipte dorë të lirë qarqeve të caktuara për ta akuzuar Athinën zyrtare si nxitëse të revoltës. Qeveria greke në kohën e marrjës së vendimeve për vendosjen e FMP në Shqipëri u qëndroi më stoicizëm presionit të gjithanshëm për të vendosur forcat e saj në zonat afer minoritetit. Arsyeja, madje edhe e shprehur terthorazi ishte se u druhej provokimëve dhe dihet se si mund të ishin provokime në ushtri. Po ashtu

qeveria greke tregoi një vetpërmbajtje dhe gjakftohtësi shëmbullore në të gjitha rastet kur iu prekën interesat e veta strategjike në Shqipëri. Dy vrasjet në konsullatë apo dhe sulmet e përseritura me armë po në konsullatë apo dhe në rezidencën konsullore, si dhe vrasjet e disa anëtarëve të minoritetit grek apo dhe grabitjeve të shumta, të disa dhjetra shtëpive minoritarësh në Sarandë, ushtrimi i presionit mbi shumë familje minoritarësh në Cukë, Livadhia, Vrisera e gjetkë, do të përbënin gjithfarë pretextesh për ta ndërlikuar në një drejtim tjetër situatën. Qëveria greke pranoi të akuzohej se e braktisi minoritetin grek në Shqipëri, në fakt këtë bëri, se sa të akuzohej për gjëra të tjera

Mbaj mend shumë mirë datën 19 maj ku në konsullatën greke, në dhomën e shërbimit vritet komandanti i Trupit të Sigurimit të Konsullatës. Oficerët grek koleg të vktimës, duke u nisur nga fakti se u vra në dritare dhe se plumbi mbeti në kokë na komunikojnë në Kakavi se vrasja është bërë nga jashtë me armë të sofistikuara. Para se të transmetonim veshtrimet tona u kryqëzuan me ato të policeve dhe oficerëve shqiptarë të kufirit dhe të Kakavijës. As ata e as ne nuk donim të kishte ndodhur kështu se e dinim ç'do të thoshte një gjë e tillë. Ne transmetuam me nxitim duke përdorur fjalët «sipas kolegëve të tij...» dhe prisnin reagimet e Athinës. Në një kohë rekord ministria e Jashtme dhe e Rendit pothuajse e përgenjeshtruan variantin e vrasjës nga jashtë pavarësisht se argumentet e përdorura në moment nuk qëndronin. (Pala greke dërgoi në vend dhe pas disa orësh një grup ekspertesh të supërkualifikuar, për të hetuar ngjarjen dhe të vertetat rreth saj. Vrasja ishte bërë nga një vartës i tij për motive që deri në shkruarjen e këtij libri nuk dihen),

Pra Greqia ishte mëse e ndërgjegjshme se një qëndrim aneksonist ndaj Shqipërisë jo vetëm që qe i pamundur për shkak të pjesëmarrjes së Greqisë në strukturat Evropiane, por edhe për faktin se menjëherë hapej loja e vjetër e fillimit të shekullit për kufijtë kur Greqia kishte bërë një zgjedhje.. Kështu që ashtu si tha dhe Godua në Parlament «Greqia përbente faktorin garant për ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe mos lejimin e destabilizimit të situatës në një rajon më të gjerë.»

Qëndrimi i ri i Athinës, është e vertetë se e vuri përballë reagimeve të shumta të qarqeve të ndryshme nacionaliste. Ata u munduan ta modulonin kryengritjen popullore për rrëzimin e Sali Berishës si një levizje për synimet e tyre. Të realizonin ndoshta shpëputjen e jugut nga pikëpamja e drejtimit administrativ nga pjesa tjetër e vendit. Ndërsa përse i përket qëndrimit ndaj minoritetit grek. ato, kërkonin ta vinin qeverinë greke përballë faktit të kryer. Në këtë këndvështrim nuk mund të fshihet se përfaqësuesit e këtyre qarqeve e kishin shmangur pothuaj fare veprimtarinë e tyre në minoritet, ashtu si nuk mund të fshihet se kishin arritur të kondaktonin edhe më ndonjë përfaqësues të komiteteve më synim atë që thamë më lart. Mirëpo fakt është që ndikimi i tyre në qëndrimet kolegjale të Komitetit Kombëtar të Shpëtimit Publik ishin inegzistente. Duhet pohuar se këta persona të veçantë, anëtarë të komiteteve i shfrytëzuan këto kontakte, pse jo për përfitime personale, ndërsa partneret e tyre për të treguar “meritat e tyre” në dosjet e përgatitura më këtë rast.

Me kthesën e vet qeveria greke (Kthesa fillon realisht me vizitën e Kranidhjtis-it në Tiranë i cili i kërkon Berishës dhe lirim të Fatos Nanos nga burgu (12-13 mars) Disa ditë me vonë ai lirohet por jo nga Berisha) kërkon një bashkëpunim real me Komitetet dhe pushtetin lokal të mbeshtetur prej tyre. Dëshmi e kësaj kthese është ndihma me ushqime dhe medikamente të ardhura në portin e Sarandës, në mesin e marsit, me një anije të vjetër ushtarake për popullsinë e Sarandës dhe të Delvinës. Në këtë kuadër u hartua edhe një plan tjetër për dhenjen ndihmës në një rajon më të gjerë. Më këto lëvizje Greqia donte të zbuste dhe të ndryshonte përshtypjet negative për përkrahjen e Berishës, gjë që realisht kishin armiqësuar së tepërmi popullsinë e Jugut me Athinën zyrtare. Në këtë kontekst realizohet, disa ditë pas takimit të 14 marsit të Komiteteve me Vranickin, edhe vizita e zëvendësministrit të jashtëm grek Janos Kranidhjtis në Jug të Shqipërisë. (18-19 mars) Kondaktet edhe kësaj here ishin me përfaqësuesit e komiteteve dhe ata të pushtetit lokal, në

Gjirokastrë edhe në Sarandë. Në Gjirokastrë pati me kërkesën e tyre edhe takim me grupimin politik të Forumit për Demokraci.

Në vijim të këtij qëndrimi Athina zyrtare fillon të institucionalizojë lidhjet me opozitën nga nivel personal në nivel partiak duke mbetur rigorozisht jashtë skemave të qarqeve të caktuara. Shërbimet e veta sekrete ishin venë në shërbim të plotë të shmangjës së kurtheve nacionaliste ngado që vinin ato dhe arsyet qenë të dukshme dhe bindese. Pikërisht ky ndryshim kursi i qëndrimit të Athinës ndezi dhe armiqësinë e Berishës ndaj Greqisë.

GREQIA DHE ITALIA - PARALELE.

Sigurisht, janë që të dyja vende fqinje të Shqipërisë, anëtarë të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s, me një ndikim të rëndësishëm, sidomos në zhvillimin ekonomik të saj. Pikërisht ky faktor e bën interesimin e të dy këtyre vendeve për Shqipërinë dhe të Shqipërisë ndaj tyre shumë të madhë. Lidhjet njëzëre sidomos midis Greqisë dhe Shqipërisë janë shumë të shumëllojshme e favorizuar kjo nga lidhjet tradicionale por edhe nga kufiri i madhë tokësor midis tyre.

Të dy këto vende morën barë shumë të madhe nga kriza shqiptare dhe po ashtu rol shumë të madhë. Qëndrimet e tyre shkojnë paralele për sa i përket krizës. Të dy, si Roma ashtu dhe Athina janë të parët që shikojnë rrezikun e krizës. Zëvendës ministri i Jashtëm Italiani Fassino dhe ambasadori grek në Tiranë, shfaqin të parët shqetësimet për përmasat e ngjarjeve në Shqipëri që më dhjetëditorin e dytë të Janarit. Mirëpo të dy manifestojnë edhe një karakteristikë tjetër. Ambasadorët e tyre në Tiranë janë besnikë të Berishës. Dallimi qëndron në faktin se Foresti duket se kërkon të luaj një politikë personale në Tiranë në favor të Berishës, në kundërshtim me qëndrimin e deklaruar të Romës, (kujtojmë bisedat telefonike midis tij dhe Shehut të publikuara në shtypin shqiptar gjatë majit), ndërsa Prevedhuraqis duket se sillet ashtu siç do t' i pëlqente Athinës.

Dallimi tjetër qëndron në faktin se ndërsa amerikanët gjetën si partner kryesor për zbatimin e politikës së tyre në Shqipëri, (e deklaruar nga dhjetopri 1996) qeverinë italiane, Greqia duhet të gjejë një rol të vetin në krizën shqiptare. Është pikërisht ky fakt që Italia, sidomos përsa i përket Forcave Shumëkombëshe do të marrë një rol primar.

Të dy vendet kanë po ashtu të përbashkët faktorë të brendshëm që pengojnë në mënyra të ndryshme rolin e tyre në krizën shqiptare. Në Greqi qeveria do të gjendet përballë presionit herë të opozitës e më shumë të qarqeve të ndryshme nacionaliste për qëndrime në kundërshtim me parimet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu ajo duhet të mënjanojë mosbesimin e shumë qarqeve në Shqipëri për predispozitat e Greqisë. Është pikërisht ky shqetësim që e detyron dy herë radhazi, siç e kemi theksuar, Ministrin e Jashtëm Grek Pangallos që të deklarohet për ruajtjen e integritetit të shqipërisë dhe forcimin e shtetit të saj demokratik.

Italia nga ana e vet do të gjendet përballë kundërshtimeve të vazhdueshme të partive në koalicionin e brishtë qeveritar. Mëse një herë (kur ishte fjala për dërgimin e forcave shumëkombëshe në Shqipëri, problemi i refugjatëve, etj) e futën në krizë këtë koalicion. Po ashtu incidentet e rënda midis dy vendeve, si ai i 28 marsit i futën këto marrëdhënie shpesh në rrugën e ftohjes. Kapërximi i këtyre situatave të rënda treguan nga ana tjetër se sa e cilit ishte Italia nga ndikimi i paragjykitimeve shqiptare në marrëdhënjet ndërshtetërore me Shqipërinë.

Por në asnjë rast nuk duhet harruar dhe kujdesi që tregonin këta dy fqinj të Shqipërisë për të kontrolluar, ose më sakt për të bërë veprime analoge në lidhje me Shqipërinë, ashtu siç nuk mund të mos e vemë re se Klasa politike shqiptare nuk arriti ta vë në efikasitet për hesap të vet këtë analogji lëvizjesh dhe interesash.

CILI ESHTË FAJI I GAZETAREVE

Të akuzuar shpesh si fajtorë për shkatërrimin e shtetit shqiptar qenë gazetarët. E verteta është se kontributi i tyre përbën universin jo vetëm në pasqyrimin e këtij realiteti, por edhe të morisë së faktorëve që ndikuan në fenomenin Shqipëria 1997.. Nuk duhet venë në diskutim se politizimi i medjave vendase ishte produkt logjik i vet zhvillimeve në vend. Kështu që edhe midis gazetarëve kishte grupime pro dhe kundra Berishës. Është fakt i pamohueshëm që pjesa dermuese e gazetarëve vendas në vija të përgjithshme luajtën me ndergjegje rolin e vertetë opozitar ndaj regjimit të Berishës. Grupimi pro Berishës herë pakësohej e herë shtoej. Ky grupim në një moment të caktuar, u distancuan hapur nga Komitetet, kur roli i tyre filloi të binte dhe iu drejtuan serish pushtetit lokal, që kontrollohej edhe në Jug nga PD-ja, për ta rifitur atë në lojë. Ky grupin gazetarësh duke shfrytëzuar rolin dhe funksionin e tyre morën përsipër edhe justifikimin në publik të njëzve që abuzuan me pushtetin që kishin dhe bënë krime.

Gjatë periudhës së trazirave në Jug Shtypi botëror, sidomoë para fillimit të krizës, vetëm sa e nervozoi dhe e bëri pushtetin e Berishës të humbasi ekulibrin. Gjatë periudhës së krizës, vecanërisht në Jug kontributi i tyre që i pazevendësueshëm për të informuar, qoft edhe me dozën euforike opinionin e brendshëm dhe të jashtëm për cka po ndodhte në Jug në kushtet e mungesës së informacionit nga burime të tjera si të pushtetit lokal por edhe të shërbimeve sekrete, rrjeti i të cilëve kishte pesuar një goditje të rëndë. Publikimi, psh i planit operativ ushtarak kundër Jugut nga këto medje, pasqyrimi i masivitetit të kryengritjës popullore, dhe vecanërisht i qëndrimit të Komitetëve për cdo ceshtje, ishin disa nga meritat e gazetarëve në Jug.

Kursesi nuk mund të mohohet se Jugu ishte kryesisht monopol i gazetarëve grek, prej të cilëve për një kohë të gjatë furnezoheshin dhe kanalet e tjera të huaja. Për javë të tera kanalet televizive greke i kushtonin vendin kryesor me minutazh tepër të gjatë në lajme, gjendjës në Shqipëri. Këto kanale harxhonin me mijra dollarë për transmetime direkte apo për të shtitur sesacione. Madje agjensi ndërkombëtare e shitjeve të pjesëve filmike vendosën qendrën e tyre të transmetimit në Gjirokastër. Por përse i përket rolit në vecanti të gazetarëve do të mund t'i ndanim ata në disa kategori. Grupi i parë i gazetarëve ishte ai i gazetarëve objektiv dhe seriozë që kur bënë kronikat e tyre nuk lejonin shqiptarët të qëllonin me armë për të treguar tensionin konfliktual në Shqipëri.

Grupi tjetër, ishte ai i gazetarëve që synonin rolin e protagonistit në kryngritjen shqiptare. Ky grup kërkonte të kumtonte se kryengritja shqiptare ishte e varur nga kamera apo mikrofoni i tyre. Ata arrinin deri atje sa të pretendonin se kryengritjen në shqipërinë e Jugut nuk e bënë shqiptarët por ata me reportazhet kronikat dhe pamjet që arrinin të transmetonin. Ata kërkonin rolin e CNN-it në Irak, apo të gazetarëve perendimorë në ngjarjet e Timishuarës në Rumani më 1990. Në fakt kjo kategori gazetarësh nuk arriti kur të konstatonte thelbin e situatës në Shqipëri, ose nuk donin.

Kishte një grup tjetër gazetarësh të cilët kërkonin ta shfrytëzonin situatën në Shqipëri për të bërë karrierë apo edhe për t'u bërë të njohur. Ashtu sic kishte gazetarë që i sherbenin qëllimeve të grupeve të caktuara me qëllime nga më të ndryshme.

Askush nuk duhet të mendojë se zgjatja e krizës në Shqipëri, (po të mendohet se zhvillimi i zgjedhjeve më 29 Qershor përbën fillimin e mbylljes së periudhës së kaosit), ishte thjesht një pamundësi e faktorit të brendshëm apo dhe të jashtëm për ta kontrolluar atë. Situatën e krizës nuk e mbante të ndezur as vetëm faktori Berisha. Problemi ishte më esencial. Perendimi që kishte marrë përsipër të manaxhonte ardhmerinë e shtetit shqiptar kishte përpara shumë probleme për të zgjidhur, që nga forma e qeverisjes deri dhe tek aktorët e politikës së ardhme në Shqipëri, pavarësisht nga ngjyra politike. Figura të tilla nuk ishin të evidentuar, ose nuk i përshtatëshin plotësisht interesave të «manaxherëve perendimorë», të cilët, edhe ata kishin interesa të ndryshme për të njëjta çështje. Hartat, dosjet e vjetra, interesa të ngushta dhe rajonale, pykëpyetjet e vjetra për aftësitë vetëqeverisëse të shqiptarëve, kërkonin kohë. Një kohë që nuk lidhej aq me gjetjen e një zgjidhjeje të drejtë dhe përfundimtare, por të pranueshme me konsensus. Ishte pikërisht arritja e këtij konsensusi që zgjedhjet nuk u shtynë për në vjeshtë, ashtu siç u shty paraprakisht mandati i Forcave Shumëkombëshe edhe me tre muaj të tjerë. Institucionet egzistuese të shtetit vetëm formalisht vepronin. Cdo gjë drejtohej nga faktorët ndërkombëtar. Franc Vranicki, si përfaqësues zyrtarë i OSBE-s, ndërsa realisht krahu dhe mendja e SHBA-s, jo vetëm që sillte recetat e gatshme për zbatim, por therrte, në Tiranë, sa herë që politikanët shqiptarë ziheshin ose nuk donin t'i zbatonin ato që ai thoshte, në kohën e duhur. Vendosja e Forcave Shumëkombëshe përbente garancinë finale që situata në vend të mos shkiste me asnjë mjet nga rruga e përcaktuar nga kancelaritë që përfaqësonte Vranicki.

Në një këndvështrim më real ky faktor çvlerësoi dhe poshtëroi rolin e politikanëve shqiptarë dhe përbën një fyerje për dinjitetin e qytetarit më të thjeshtë të shtetit. Nga ana e tyre këta politikanë kishin kohë që kishin harruar zyrat e partive të tyre dhe sillleshin si të hutuar nëpër sallonet e hotelëve të Tiranës të frekuentura nga diplomatët perendimorë, si mbartësit ekskluziv jo vetëm të lajmëve nga Shqipëria, por edhe për të ardhmën e këtyre politikanëve. Në Shqipëri egzistonin në fakt aktorë kuklla që përfaqësonin institucionet shtetërore për momentin para zgjedhor, si dhe brumi i paarrirë mirë, në bazë të parametrave Perendimorë, politikanësh Shqiptarë, nga do të përzgjidheshin aktorët e politikës së ardhme.

I vetmi që vazhdonte t'i jipte mëvetësi dhe pavarësi rolit të vet ishte Sali Berisha. Me logjikën s' kam ç'të humbas më shumë, ai kërkonte të justifikonte përkrahjen e qarqëve Evropiane dhe të impononte pazëvendesshmërinë e tij politike.

FORMULA E ARDHJES SE F.M.P OSE E F.SH.K

OSBE-ja e cila mori përsipër zgjidhjen e krizës Shqiptare, hapin e dytë që bëri pas caktimit të mediatorit të saj, Vranickit, merr seriozisht parasysh propozimin italian për vendosjen e një Force Ushtarake në Shqipëri. Ky përbën edhe hapin e mënjëhershëm të Vranickit pas krijimit të qeverisë Fino. Përbën gjithashtu veprimin e parë me përmasa historike, pavarësisht se negative, të Qeverisë se Pajtitimit Kombëtar, si dhe veprimin e parë të përbashkët të Finos dhe të Berishës.

Ky vendim pavarësisht nga koha e shkurtër që u muar dhe u zbatua nga të gjitha instancat, (u deshën gjithsej një muaj. Më 15-16 mars Kryeministri dhe Presidenti i drejtojnë kërkesën K.S të OKB-s, me 29 mars merr vendimin Këshilli i Sigurimit në ditët e para të prillit, 01-02.04 vendos parlamenti shqiptar dhe 15 Prill vendosen trupat e para në Durrës,), përbën në fakt një kopjim të zbehtë dhe të pamotivuar të partnerëve Evropianë, të inisiativës dhe zgjidhjes amerikane të krizës

në Bosnjë. Njëkohësisht edhe një përpjekje të Evropës për të sfiduar në rastin e Shqipërisë, amerikanët.

Fakt është që amerikanët nuk pranuan të dërgonin forca në Shqipëri . Arsyetimi ishte se situata në Shqipëri ishte e tillë që nuk mund të përcaktoje rolin e një force ushtarake. Në të njëjtën kohë ata , pavarësisht se inisiativa ishte e partnerit të vet kryesor në “zbatimin e politikës amerikane në Shqipëri”, -Italisë, mënjanuan strukturën e NATO-s nga një ndërmarrje të tillë . Me vendim të Këshillit të Sigurimit të OKB-s 6000 forca shumëkombëshe nën drejtimin e Italisë do të vendoseshin në Shqipëri. Vendosja e e F.SH.K bëhet në harkun kohor të tre javëve dhe përfundon më 05.05 me vendosjen e 395 forcave rumune në Gjirokastrë. Qytetet e tjera ku u vendosen janë Tirana , Vlora, Elbasani, Lezha, Korca .Forcat ishin nga Italia, Franca, Greqia, Turqia, Rumania, etj, gjithsej tetë vende. Komandanti i tyre ishte gjenerali italian Forlani. Më 08.06, Kryeministri Fino bën kërkesë që të shtohet afati i qëndrimit të F.SH.K në Shqipëri. Numrin i këtyre forcave shtohet, më 17.06 , kur mbrijnë dhe 536 forca të tjera Italiane

Për hir të së vërtetës dhuet thenë se asnjëherë këto forca nuk e përcaktuan qartë dhe për një kohë të gjatë misionin e tyre në Shqipëri. Një fakt i tillë e bën dhe më të rëndë instalimin e tyre në fundin e shekullit njëzet ,për një periudhë prej gjashtë muajsh, në një vend që konsiderohej sovran.

Me ardhjen e tyre u deklarua se do të ruanin hyrjet portuale dhe akset rrugore për depërtimin e ndihmave humanitare në Shqipëri. Se nuk do të kishin asnjë lidhje me konfliktin politik në vend. Se nuk do të tejkalonin kompetencat që shkelnin sovranitetin e vendit.

Në Shqipëri në këtë periudhë nuk arritën as pesë milion dollarë ndihma humanitare në një kohë që rrogat mujore vetëm e kontigjentit të forcave Italiane i tejkalonin të 10 milion dollarët.

Po ashtu deklarojnë se nuk marrin përsipër rivendosjen e rendit që ishte dhe problemi kryesor në vend Më përjashtim të ruajtjes së portit të Durrësit e të Vlorës, si dhe të aerodromit të Tiranës, F.SH.K nuk morrën përsipër asnjëherë mbrojtjen e rrugëve që ishin kthyer në një sketërrë të vertetë. Madje ato u ndodhën shpesh pranë incidenteve të rënda me armë apo pa armë dhe nuk ndërhyjnë Kostoja e qëndrimit të tyre në Shqipëri që shumë e lartë. Po të kemi parasysh dhe shpënzimet për shumëfishat e forcave në vendet fqinje që ruanin kufijt e tyre për ndalimin e ikjeve masive të shqiptarëve për në këto vende , kuptohet që këto shpënzime ishin më të mëdha se humbjet e shqiptarëve nëpër piramida .

Më 23.05, pas takimit me Finon, Forlani deklaroi se F.SH.K, në kuadrin e zgjedhjeve, do të marrin përsipër vetëm vëzhguesit e huaj . Një javë më vonë , kur u kërkohej këtyre forcave që në mënyrë indirekte të ruajnë qëndrat e votimit, Forlani deklaroi se nuk do të mbulojmë gjithë vendin , “ por do të krijojmë një kordon sigurie për zgjedhjet se bashku me vëzhguesit e huaj . Këto forca nuk marrin përsipër as shpërndarjen e materialëve të votimit dhe as mbylljen e tyre dhe transportimin e dokumentave . Në përgjithësi ato manifestojnë një frikë shumë të madhe se mos behën personazh në kaosin Shqiptar..Po ashtu shumë vëzhgues politik kishin venë re se Shqipëria mund të behëj arenë e incidenteve midis njësive ushtarake të vendeve me kondradikta midis tyre, gjëra që më sa duket aq shumë i dëshironte Berisha.

Sido që të jetë ato ikën nga Shqipëria pas gjashtë muajsh më një ceremoni më tëpër se solemne e festive “për suksesin e misionit të tyre”

KRONIKE E FUNDIT POLITIKE

01.04. Kryeministri B.Fino vjen në Gjirokastrë pasi do të nisej për një vizitë pune në Athinë. Eshtë e para vizitë jashtë Tirane e Finos. Kryeministri Prodi I bën parapritë udhëtimin të Finos për në Greqi me pretekstin se kërkonte edhe një herë konfirmimin e qëverisë Shqiptare për vendosjen e Forcave Shumëkombeshe në Shqipëri para se të vendoste parlamenti Italian. Njëkohësisht Prodi erdhi për t'i shprehur gushëllimet e veta familjeve të viktimave të kanalit të Otrantos.

Vizita e Prodit nga pikëpamja diplomatike mund të keqinterpretohet nga pala greke. Finos I është dashur të mirrte vendimin përfundimtar në orën tre pas mesanate. Këmbënguljës së Prodit për ta vizituar në Gjirokastrë, Finos I nxorri si pengesë pasigurinë e situatës. Por pas Ok-it të Finos Prodi erdhi duke demonstruar një shembull tipik të një vizite të rangut të lartë në kushte të tilla. Gjashtë helikopterë dhe marinsat e shumta Italiane shoqëronin kryeministrin Italian. Sfida ishte e dyfishtë.

02.04. Komiteti I Përgjithshëm Drejtues I PS-së vendos pjesëmarrjen në parlament të dhjetë deputetëve të vet.

04.04. 20 deputet të PD-së kërkuan largimin nga grupi parlamentar I PD-së. Ata dhe shumë anëtarë të tjerë të Këshillit Kombëtar të PD-së kërkuan një analizë të thellë të shkaqëve të krizës.

12.04. Kryeministri Italian Prodi dhe Ministri Italian I Mbrojtjes Andreatta vizitojnë Shqipërinë. Berisha, në takim me ta, akuzon Komitetet si ekstremist të majtë, mafiozë, kondrbandist, faktor I vetëm që pengon zhvillimin e zgjedhjeve.

13.04. Prodi në Vlorë, I rezervohet një pritje madheshtore, pavarësisht se dy javë më parë një anije me mbi njëqind refugjatë shqiptar për në Itali u mbyt në det

13.04. Këshilli Kombëtar I PD-së mbledhet në një mbledhje shpërthyesë. Kundërshtarët e mbrendshëm të Berishës, të cilët kishin vendosur ta luftonin PD-në nga brenda, nuk ia dalin dot. Berisha del fitimtar. Frika, motra e vdekjes, siç thotë ai vet, e ndihmuan edhe në këtë ballafaqim.

15.04. Fillon startin vendosja e FMP, Vijnë 100 trupat e para dhe vendosen në Durrës.

15.04. Fillojnë mësimet në dy shkolla në Tepelenë

19.04. Zhvillohet takimi I FMP-s me komitetin e Shpëtimit Publik të Vlorës. Përfaqësuesit Italianë të FMP, kërkojnë bashkëpunimin e K.Sh.P

21.04. vazhdon polemika për shkarkimin e zëvendës ministrit të rendit A.Shehu

21.04. 9 parti të tavolinës së dhjetë partive shprehën në favor të një ligji proporcional. PD-ja kërkon një ligj mazhoritar

21.04. Forca të dyshimta me makina të blinduara dhe armë speciale kërkohen të hapin rrugën drejt jugut nga dy drejtime, nga Tepelena dhe Permeti. Gjirokastra qallon për 15 minuta rresht në shenjë proteste për lajmet e përhapura për një vizitë të mundshëm të Berishës në qytet

23.04. Masakra e Cerikut. Vriten 5 anëtarë të gardës. Komiteti I Tepelenës identifikon makinat që dy ditë më parë ishin parë jashtë Memaliajt.

24.04. Gardistët sulmojnë spitalin ushtarak. Vdes gardisti I gjashtë I masakrës së Cerikut.

24.04. Shpallet krijimi I Partisë «Levizja për Demokraci», partia e 35 -t e shqiptarëve dhe e treta që shkapulet nga PD-ja.

28.04. Ringjallja në Pashkët e Ortodoksëve nuk zhvillohet në mesnatë por në orët e para të ditë. Arsyeja,- gjendja e jashtzakonshme.

28.04. Viziton Shqipërinë. Tiranë-Elbasan-Vlorë, Ministri grek I Mbrojtjes Agis Tsohaxopoulos

29.04. Partitë politike të frontit kundër Berishës vazhdojnë debatin për ligjin elektoral. Qeveria deklaroi se do të pres edhe dy ditë që ato të gjejnë gjuhë të përbashkët.

30.04 Socialistët kërkojnë përsosur të tretë garant për ligjin elektorale . Kongregjisht Lambertino DININ.

30.04. Fatos Nanua takohet me homologun e PD-s Tritan Shehun.

01.05. Bashkim Fino flet për krizë qeveritare. Ai I kumunikon Vranickit se pas një takimi të fundit më Partitë Politike do ta përcjell draftin e qeverisë , të ligjit elektorale në Parlament. Po atë ditë pranoi ftesën për një vizitë në SHBA.

02.05. Në pyllin afër Shen Gjinit mbi 3 000 veta presin për t'u larguar në Itali.

05.05. B. Fino flet për votbesim të qeverisë së tij .

05.05. PD-ja u deklaroi përfaqësuesve të Këshillit të Evropës se ligji elektorale në standartet e saj dhe Komitete janë pengesa për zgjedhjet.

05.04 Takimi I dytë Nano-Shehu. Fatos Nano I shmangjet një kurthi të PD-së për komitetet. Shehu I kërkon Nanos të shpërndarjen e Komitetëve. Nano - nuk I krijuam ne që t'i shpërndajmë po ne.

12.05. Berisha guxon pas kaq kohesh të dali në konferencë shtypi.

13.05 Finua në SHBA. PD-ja çon draftin e vet në parlament , një kopje e ligjit elektorale të 1996. dhe të nësermën me preteksin se ishte afati I fundit që të mund të zhvillohen zgjedhjet brenda Qërshorit. voton ligjin. Berisha firmos ligjin elektorale dhe shpërndan parlamendin Nuk mirret parasysht as formula e Vranickit. Nanua largohet nga një takim I dhjetë partive. 8 parti deklarojnë se me ligjin e PD-s do t'i bojkotojnë zgjedhjet dhe do të terheqin ministrat nga qeveria. Pas një dite Fatos Nano e terheq deklaratën. Kategorik për mos shpërndarjen e qeverisë edhe Fino.

16.05 Mbledhet Komiteti Kombëtar I Shpëtimit Publik në Vlorë. Marrin pjesë 15 rrethe dhe përfaqësuesit e PS-s dhe të PAD-s. Mbledhja që reagim imediat I ligjit elektorale të votuar nga PD-ja

17.05 Berisha fillon fushatën elektorale

19.05. Nanua nuk firmos formulën e Shehut për një fushatë elektorale të qetë. Arsyeja egzistenca e gjendjes së jashtëzakonshme

24.05 Leka Zogu viziton Vlorën ku pritjet shumë keq.

26.05 Finua kërkon nga Roma rithirrjen e Parlamentit për heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme . Partitë politike kërcenojnë se do t'i bojkotojnë zgjedhjet.

27.05 Hapet në Tiranë fushata elektorale e socialistëve

28.05 Arbnori është negativ në çeshtjen e rithirrjes së Parlamentit dhe deklaroi se çdo gjë që lidhet me zgjedhjet është në dorë të qeverisë.

29.05 Të gjitha partitë e formulës së 9 marsit , me përjashtim të PD-së , mohojnë pjesëmarrjen në zgjedhje. Kushtet janë:- Heqja e gjendjes së jashtëzakonshme, kontrolli I SHIK-ut dhe I medjës zyrtare nga ana e qeverisë.. AD-ja shkon më larg kërcenon se do të dali nga marrëveshja e nëntë marsit

01.06. Prodi andreta serish në Tiranë

02.06. Bombë në dyqanin e Lush Përpalit në Tiranë.

03.06. Vizita e Ministrit të jashtëm Grek Pangalloës në Tiranë. Ndihma e Greqisë konsiston midis të tjerave në mbrojtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. deklaroi Pangallos.

04.06. Atentat kundër Berishës në Shkallnur të Durrësit

04.06. Vendoset aleanca paraelektorale PS-PSD.

08.06. Vranicki serish në Tiranë . Diskuton për anën teknike të zgjedhjeve por edhe për formën e qeverisë pas tyre. Kutitë e votimit do të sillleshin nga Bosnia. Fletët e votimit do të shtypeshin në Itali.

Finua deklarohet pro një bashkëpunimi paszgjedhor në qeveri me PD-në

08.06. Gjykata kushtetuese e heq nenin në ligjin elktoral sipas të cilit partitë që nuk fitojnë vendin e parë dhe të dytë në zgjedhje dhe plotësojnë masën e dy përqindëshit do të ndajnë midis tyre 75 përqind të votave të proporcionalit prej 45 vendësh

09.06 Nanua shkon në Vlorë. Premton kthimin e parave nga piramidat.

17.06 Ndërpritet rruga e Mejdanit për në Veri. Një ditë me parë u qëllua për paralajmerim A. Hajdari në Ballsh

18.06 Nanua pengohet të shkojë në Mirëditë. Mirëditorët shkojnë e marrin në Tiranë, e degjojnë dhe e çojnë serish në Tiranë.

19.06 Vendoset përfundimisht që zgjedhjet të mos shtyhen asnjë ditë tutje 29 qërshorit.

19.06 Pas shumë orë debati dhjetë partitë politike bien dakort që kutitë e votimit të mbyllën në orën 18 dhe jo në orën 21 që thoshte ligji I aprovuar nga PD-ja

20.06 Fillon në itali shtypja e fletëve të votimit. Marrin pjesë 22 parti me 1100 kandidatë për deputet 93 përqind e të cilëve janë burra.

23.06 Takimi I San Edigio nën drejtimin e Don Vcenzo Pajlia . I pranishëm dhe Andreata.

24.06 Berisha deklaron në periferi të Tiranës. «Do t'u ngrijmë buzeqeshjën në buzë»

25.06. Nanua nuk shkon dot në Shkodër.

Kapitulli 22

IKEN BERISHA VJEN NANUA.

Që në hapat e para të tatëpjetës së Berishës, në shumë nivele individesh, shtresash e kategorish shoqërore, me apo dhe pa potencë në politikë ishte krijuar pikërisht kjo përshtypje pak a shumë fikse. Nanua shumë shpejt do të zëvendësojë Berishën Këto ishin në këtë kohë edhe titujt më të medhenj në shtypin e huaj. Në aparençë represioni I Berishës mbi opozitën socialiste I kishte dhenë mundësi asaj që të shfaqte një unitet solid. Vet ky unitet I socialistëve kondicionohej gjithashtu edhe nga faktori I kryetarit. Ai egzistonte si kryetar , por në burg. Kjo bëntë që ai të mbetë jashtë meskinitetit politik në vend. Burgu jo vetëm që e mbrojti Fatos Nanon nga sulmet meskine të klanëve politike shqiptare përfshi patjetër dhe partinë e tij, por , dhe gjithmonë në aparençë, e kishte heroizuar dhe idealizuar atë dhe vizionin politik të tij. Kjo bëri që çdo përpjekje e Berishës për t'u zmadhuar , më të njëjta përmasa rritej edhe Nanua . Veçse Nanua, ndryshe nga Berisha, kishte avantazhin e madhë që pozicioni I tij, si I burgosur politik, e mbronte atë nga çdo rrezik përmbysjeje.

Por në esencë nuk ishte plotësisht kështu. Vet logjika e rrjedhës së ngarjeve verteturuan tezën se idenë e arestit të Nanos në veshët e Berishës e kishte vërshëlyer miku I tij I ngushtë Rayerson . Arrëestimi u bë që të materializohej pragmatizmi ideologjik që e solli Berishën në pushtet dhe që ishte lufta kundër komunizmit. Në këtë plan Nanua zëvendësoi simbolin komunist të përenduar tanimë, -Ramiz Alinë. Kjo ,kuptohet që e bënte të përsëritshëm pozicionin e tij për të dalë nga burgu për aq kohë sa antikomunizmi do të vazhdonte të ishte politikë sunduese e qeverisjes së PD-së. Njëkohësisht një situatë e tillë I bëntë të pavlefshme protestat e të gjitha nivelëve në favor të Nanos si I burgosur politik. Vet Berisha do të deklarojë në një emision televiziv në majin e 1998-s se nuk kishte marrë asnjë kërkesë, letër apo sugjerim për lirin e Nanos nga burgu.

Nga ana tjetër edhe me kundërshtarët e brendshëm të Nanos po vertetohej semundja e vjetër e politikanëve shqiptarë, që çdo konflikt të brendshëm nuk gjenin forcën dhe guximin ta përballonin me mjete publike, por kërkonin shpagim me goditje ndën brez , duke u rrefyer tek

ambasadat e huaja. Keshtu ndodhi edhe me Nanon . Kundërshtarë të tij në kryesi të Partisë Socialiste , sidomos pas vitit 1994 akuzonin rregullisht Nanon tek njerezit e ambasadës amerikane si antiamerikan, si anti NATO, konservator, komunist , etj. Më një fjalë I trembeshin lirit të tij

Këtë fakt një diplomat I ambasadës amerikane nuk ma fshehu as mua (dhe më shumë si mentalitet dhe jo si veprim), në një takim në Gjirokastër në fillim të viti 1996, kur fjala erdhi për Fatos Nano si alternativë politike në Shqipëri. Amerikanët ia thanë në menyrë indirekte këtë, vet F. Nanos kur vizitoi SHBA-n. «Kur të gjithë të kishin harruar, i thanë, një njëri këmbëngulte për lirinë tende». Dhe këtë njëri Fatos Nanua e di se kush është . E di madje që s'ka asnjë lidhje me jetën politike e aq me pak të partisë tij.

FATOS NANUA NUK U LIRUA NGA BURGU SI ALTERNATIVE POLITIKE

Më gjithatë për faktorin ndërkombëtar, lirimi I Nanos nuk erdhi si alternativë e vetme në jetën politike shqiptare pas trazirave të gjysmës së parë të vitit 1997. Nuk e ndihmuan për këtë as levizjet mocioniste për rinovimet e partisë në gjysmen e dytë të 1996, e as testet personale mbi politikanin Nano, të mbyllur në burg për çështje që akuzohej nga njerezit e tij në krye të partisë. As burgjet nuk u shpërthyen më 12 - 13 mars ,për të liruuar atë. Siç tregon edhe vet ai në një intervistë për revistën franceze «politique internationale», kur shpërtheu burgu I Tiranës dhe të gjithë u larguan ai mbëti aty I vetëm. As ai vet u largua as kolegët e Partisë së vet u interesuan për të e as simpatizantë të tij apo të PS-së shkuan për ta marrë. « Mendova , -thotë Nanua për revistën franceze, -se në qoftë se largohësha , do të konsiderohësha si I arratisur. Prandaj vendosa të qendroja në vend , në shoqërinë e të burgosurve të rallë që nuk ikën».(Pra një I denuar politik, një I burgosur I pafajshëm , siç konsiderohej, më gjithë ai edhe pas një viti nuk guxoi të kërkojë pafajësi, një njëri që vendi e priste për ta drejtuar, nuk guxon të shkel ligjin që gabimisht e denoi, ligjin e një shteti që nuk egzistonte më) Edhe vet drejtori I burgut 313 në Tiranë , ku Nanua që transferuar nga Bença, u çudit kur e pa dhe e mori në zyrën e tij. Kryeministri I ardhshëm I Shqipërisë , edhe pas kësaj nuk guxoi të dilte në publik. Priti sa Berisha nxorri, më 16 mars, dekretin për amnistinë apo faljen e të 52 të burgosurve për faje të renda. Berisha e rreshtoi Nanon midis krimineleve të rrezikshëm të vendit.(!) Edhe kur doli në publik, faktikisht nëpërmjet medjës, kryesisht të huaj (!) nuk kishte nga pas as udheheqjen e Partisë së vet, as simpatizantë, në një kohë që Leka Zogu hyri në Tiranë pak ditë me vonë I ndjekur nga dhjetra e dhjetra makina. Deklaratat e para shprehnin një njëri që duhej përkedhelur se doli nga burgu dhe jo një politikan të cilin kaq shumë nevojë e ka vendi. Qëndrimi i Fatos Nanua ishte shprehje e qëndrimit të deriatëhershëm të opozitës shqiptare , e cila vepronte në kufijt që lëjontë tutela e Sali Berishës.

FATOSI ADAPTON TAKTIKEN E ÇMONTIMIT PJESE-PJESE TE SALIUT

Fatos Nanua I kishte të gjitha mundësitë legjitime e aq më tepër morale që në ato momente kritike për Levijen Popullore për Demokraci që sapo ishte organizuar, të plotësonte boshllëkun e udheheqësit politik që asaj I mungonte. Por ai adaptoi mënjëherë taktikën e çmontimit pjesë-pjesë të Sali Berishës, duke u bërë madje frymëzuesi I kësaj ideje. E verteta është se pas 9 shkurtit 1997 kur kërkoi dialog nga të gjitha palët dhe nga Berisha të çtensiononte situatën në vend , Nanua nuk foli më për zhvillimet në vend. Dhe pas daljes nga burgu më shumë tregohej I kënaqur që më në fund ishte I lirë se sa tregonte I gatshëm për të marrë mbi supë situatën. Në publik ai do të dalë faktikisht pas një muaji e gjysëm më 27 maj 1997 kur PS hap në një aneks të shesheve të Tiranës,

fushatën elektorale Në Vlorë dhe në Jug do të arrijë pothuaj dy muaj pas daljës nga burgu më 09 qërshor 1997.

Udhëheqësi I socialistëve pra nuk u shfaq si një figurë politike që diti të administronte kryengritjen popullore për ta shndërruar në një lëvizje të qartë politike për rrotacionin e pushtetit me mjete paqësore, por priste momentin që të montohej si aktor kryesor I jetës politike në vend edhe pse I vihej kusht trashëgimi dhe riciklimi në jetën politike shqiptare të përgjegjësit kryesor të katastrofës. (atëherë në publik u fol nën zë se dekreti I Berishës për amnisti, kishte në thelb një kompromis midis Berishës për të mbetur në politikë dhe Nanos që do të pretendonte pak me vonë se do ta luftonte për ta shkatërruar pjesë-pjesë. Lë të mos harrojmë se Pandeli Majkua në turin e dytë të takimit të nëntë marsit I kërkoi Berishës lirin e Nanos. Ishte një kërkesë në një kohë që Berisha pranonte çdo kusht mjaft që të shpëtonte rolin e vet në politikën shqiptare)

NANUA ESHTË I KONTROLLUAR NE QENDRIMET E VETA POLITIKE

Kryetari I socialistëve gjatë gjithë kësaj periudhe deri në zgjedhje, shfaqet me qëndrime të dyzuara politike. Për të njejtat probleme realiteti politik shqiptar I dikton një qëndrim të caktuar dhe vullneti politik I partnereve Perendimorë një qëndrim tjetër të kundert më të parin . Kështu kur grupi parlamentar I PD - së injoron qëverinë për sa I përket ligjit elektorale duke aprovuar një ligj sipar parametrave të vet, 13.05, Fatos Nanua do të deklarojë «vertetohet se diktatorët nuk mund të rezohen me mjete demokratike». Kjo deklaratë kapërxën edhe logjikën e Komitetëve të Shpëtimit Publik, duke e sjellë atë shumë afër me to. Disa ditë më vonë, në takimin e parë elektorale, 27.05. e ndryshon qëndrimin duke thenë se « Berisha si diktator duhet të iki me zgjedhje demokratike». Një ditë më përpara duke u nisur nga fakti që PD-ja nuk abrogonte ligjin e gjendjës së jashtëzakonshme para zgjedhjeve, F. Nano deklaroi se vihen në dyshim zgjedhjet demokratike në Shqipëri. Të nësermën në Tiranë ai bënte thirrje për fitore në zgjedhje, por kryetari I socialistëve të Tiranës kërcenon se PS-ja do t'i bojkotojë zgjedhjet në rast se PD-ja nuk heq ligjin e gjendjës së jashtëzakonshme. Po ashtu kur PD-ja votoi ligjin e vet elektorale ai deklaroi se do t'i heq ministrit socialist nga kabineti Fino. Të nësermën e ndryshon qëndrimin, duke thenë se nuk do të bëhet kjo . Qëveria na duhet për të patur kontakte shumëplaneshë .Po ashtu është Fatos Nanua, I cili harron se mandati që kërkon nga populli , lidhet me një dëshirë e shpresë e elektoratit për dënimin e shkatërrimit të vendit dhe të kursimeve të tyre . Nga ana tjetër pranon bashkëqeverisjen me PD-në dhe Berishën , te cilin e quan diktator.

Që në këto momente PS-ja dhe kryetari I saj fiton më veshtirësi terren ndaj PD-së, në luftën politike partiake (dhe bëhet fjalë për gjëra brenda kuadrit logjik).Madje ajo terhiqet vazhdimisht para këmbënguljës së PD-së, edhe pse ndonjëherë si gaforja. Kjo karakteristikë bëhet më e evidente kur PS-ja erdhi në pushtet . Duket pra qartë se Fatos Nano në qëndrimet e veta politike është I varur nga një dorë e padukshme por fort e ndjeshme në zhvillimet e atëherëshme në vend. Ishte pikërisht kjo dorë që ktheu Fatos Nanon në tavolinën e bisedimeve , kur ky në një takim me dhjetë partitë politike për ndryshimn e ligjit elektorale ,09.05,nuk e duroi më kokëfortësinë e PD-së, dhe u largua nga bisedimet duke lenë të hapur të vetmën derë, atë të Komitetëve.

Kjo u vertetua akoma më shumë në qëndrimin e tij ndaj Leka Zogut. Edhe Nano , pas Berishës që e aprovoi ligjerisht ardhjen e L.Zogut në Shqipëri, dhe disa partive të tjera politike,pranon jo vetëm ardhjen e tij si trashëgimtar mbretëror, por edhe kryerjen e referendumit për formën e qëverisjës në vend, po ditën e zgjedhjeve . Ai merr pjesë në pritjen që Leka Zogu jep si mbret I Shqiptarëve.një pritje që ka në fakt si qëllim, kthimin e tij në simbol të unitetit të politikanëve dhe mandej të popullit shqiptar.

ARDHJA E L ZOGUT,- PERENDIMI NUK E KA ZGJIDHUR PROBLEMIN E ZEVENDESUESIT TE BERISHES

Ardhja e Leka Zogut në Shqipëri , kësaj here jo si vizitor por për të luajtur rol politik, ishte dhe një tregues tjetër se Perendimi akoma nuk ishte i bindur nëse aktori kryesor i politikës Shqiptare duhet të ishte Nanua. Leka Zogu erdhi këtu nga të njëjta qendra që kontrollonin situatën në Shqipëri, si një alternativë politike, ose më sakt si një figurë që duke shfrytëzuar autoritetin e mbretit të mund të disiplinonte regullat e lojës politike me «paanësinë» e vet. Ajo që u konstatua lehtësisht ishte se Leka Zogu si alternativë do të ballafaqohej me Sali Berishën meqëse ai ishte kartë e djegur dhe mund të mundej lehtësisht.. Berisha e pranoi këtë sfidë se jo vetëm që rifutej përsembari në lojën politike por edhe sepse i njihte shumë mirë ndjenjat antimbretërore të popullit shqiptar. Kështu çdo ballafaqim vetëm me Leka Zogun do nxirrte Berishën fitimtar. Një veprim i tillë i jpte mundësinë Berishë që të tregonte luajalitetin e vet dhe frymën e bashkëpunimit më fatvëndosësit e perspektivës Shqiptare. Kështu, Sali Berisha pasi ia arriti qëllimit që të ishte palë në bisedime, vetëm me partitë dhe jo me popullin, rasti i djalit të ish mbretit i jpte mundësinë për rolin, sipas tij, të figurës qëndrore në lojën politike Shqiptare. Për këtë e pranoi në fillim si partner të vetëm, djalin e ish mbretit të vetëshpallur, por pa asnjë shans për të fituar. Megjithatë takimet e para të djalit të ish mbretit në popull, televizioni i Berishës i ilustroi deri në atë shkallë sa i krijoi përshtypjen dhe vet Lekës se mund të konkuronte. Mirëpo sapo Berisha tentoi dhe doli në fushatë elektorale, televizionin i tij vuri re si formë reaksioni ndaj «mbretit» edhe gurin më të vogël që rra mbi makinën e Lekës. (Tropojë) (!!). Ndërsa takimet e Berishës edhe në fshatra te zakonshme paraqiteshin në TV-në e kontrolluar prej tij, më shumë se madheshtore. Po ashtu Leka dhe Saliu filluan të parët fushatën elektorale, ndërkohë që partitë të tjera , me pavendosmerinë për të marrë pjesë na zgjedhje, kishin renë në kurthin e Berishës «për të nxjerrë gurët nga lumi» që vet ai kishte hedhur. Partitë politike kërkonin t'i bënin Berishës presion për të bërë ndryshime në ligjin elektorale apo dhe ndryshime që lidheshin me heqjen e gjendjes së jashtzakonshme.

Nga ana tjetër Berishës i duhej Leka Zogu jo vetëm si «kundërshtar» i mundur por edhe si aleat i natyrshëm «në luftën kundër komunizmit». Vetëm kështu mund të kuptohen edhe dy ngjarjet e rënda mënjëherë pas ditës së zgjedhjeve. Njëra me autor Berishën , i cili disa orë pas 29 qershorit tentoi të nxirrte në Tiranë Gardën e Republikës, më preteksin se kishte informacion për invadim bandash në Kryeqytet,(veprim që u cilësua si përpjekje për grusht shteti) dhe tjetra «marshimi ushtarak» i Leka Zogut në Tiranë , më tre korrik në drejtim të Pallatit të Kongresëve , ku ishte vendosur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Një rëzit e armatosur rreth uniformës ushtarake të djalit të ish mbretit, ishin një rëzit të Berishës, se mbreti ishte në atë kohë lakuriq për sa u përket pasuesve që mund të mbanin armë brenda në kryeqytet. Parat ata i kishin marrë dhe nuk kishte përse të sakrifikonin për ato që i kishin marrë .

. Fakt është gjithashtu se të vetshpallurin mbret të shqiptarëve e ndiqnin në «fushatën e vet» pro referendumit, në një kohë që asnjë nga forcat e tjera politike nuk u kujtuan për referendumin , disa një rëzit të huaj, jo shumë të çuditshëm, që testonin pranushmërinë e mbretit në popull. Ky testim doli negativ dhe një rëzit e testit ikën duke lenë megjithatë Lekën të vazhdonte një fushatë me shpënzime shumë të mëdha . Deri në këto momente Fatos Nanua nuk evidentohej aspak si eksponent politik i dorës së parë , veçse si kryetar partie. Kështu shpjegohet fakti që Nanos i jipej deri atëherë roli i bisedimeve me kryetarin e PD-së Tritan Shehu. Në tre takimet e tyre ata nuk arritën asgjë, gjë që do të thotë në një farë mënyre se Nanua ishte nuk kishte më shumë fuqi se Shehu, pavarësisht se ky i fundit ishte tanimë një kopje e zbehtë e kreut të PD-së

Kjo skemë , ashtu edhe mundësia e një protektoriati, do të ndryshojë përfundimisht me takimin e San Edigios, 23.06. Këtu Fatos Nanua, tregoi edhe një herë se kish filluar të luante në rolin kryesor në bazë të formulave të Perendimit. Në San Edigio, Nanua pranoi, për këtë rol, bashkëpunimin me opozitën. Partia Socialiste I fitoi zgjedhjet se populli I dha votat në kushtet e mungesës së një alternative tjetër dhe të urejtjes ndaj Sali Berishës. Njëkohësisht Berisha , I çmontuar pjesë - pjesë do të mbëtët në opozitë, fatkeqësisht për të lenë të çmontuar shtetin dhe për të penguar çdo zhvillim të shpejt politik në vend.

BERISHA HIDALGO QE VRET ENTUSIAZMIN E FITORES SE OPOZITES

Ndjenja se pushteti pas 1992 I përkiste vetëm Sali Ram Berishës, frika e pasojave dhe e përgjegjësive për shkatërrimin e vendit dhe të shtetit, boshleku politik që linin nga entuziazmi I tëpëruar udhëhëqësit e opozitës, , si dhe dëshira e tij pa kufi për të treguar vitalitetin e vet politik, bashkë me interesat e qarqëve perendimore që ridhnin nga investimet që kishin bërë në figurën e presidentit shqiptar, e kthyen Sali Berishën në një makinë pune që funksiononte me parametra maksimalë për 24 orë.

Politikanët shqiptarë të opozitës tregoheshin euforikë dhe të dehur para fitorës të dhuruar nga populli , dhe të mbyllur në valixhët e diplomatëve Perendimorë. Mëgjithatë ata ende nuk ishin çliruar nga nga hija e Berishës. Një situatë e tillë I bëntë ata faktikisht lojtarë të pafuqishëm para Kryetarit de jure të shtetit, I cili duke aplikuar taktikën e lojës së faktit të kryer, jo vetëm që u vriste entuziazmin, por duke u hedhur një gurë në lumin e zhvillimëve politike në vend I nërvozonte ata dhe u harxhonte shumë kohë në përpjekjet që bënin për ta nxierrë gurrin nga uji

Gjatë gjithë kësaj kohe, në qëndrimin e vet në favor te mbajtjes me çdo kusht të pushtetit, Berisha midis të tjerave, përfitoi shumë edhe nga koncepti i konsesnsusit që mediatorët evropianë serviren për arritjen e marrëveshjeve politike midis partive. Baza e këtij koncepti ishte zbatimi i formulave të perspektivës se vendit dhe të shtetit nga politika dhe politikane të çliruar nga ngarkesat dhe praktikat e së kaluarës. Në këtë kuadër duhet kuptuar dhe përpjekja e partnerëve të huaj për krizën Shqiptare, për t'u drejtuar partive politike ,pa i ndarë ato në fajtorë dhe jo fajtorë në procesin e shkatërrimit të shtetit shqiptar. Kjo bazë bashkëpunimi I jipte mundësi pozitës së ardhshme për të fshehur pjesën e fajit të vet . Tolerancën e treguar në këtë drejtim nga partitë e frontit kundër Berishës, ai e shfrytëzoi për të ruajtur pozitat e veta në emer të Partisë Demokratike. Pushteti i mbetur në dorën e tij, sidomos ai legjislativ , shërbimet sekrete , ministria e rendit, si përgjefjese për të rivendosur rendin dhe organizuar zgjedhjet, ishte arma tjetër e tij drejt këtij qëllimi.

BERISHA, KJO MAKINE QE PUNON PA U LODHUR, POR NE KURSIN E VET

Koha dhe veprimet për Berishën qenë rigorozisht të përcaktuara. Në pësëmbëdhjetëditëshin e parë të prillit synimi I tij kryesor ishte të zgjidhte kondradiktat e brendshme në parti. Ai vendos në fillim të prillit përjashtimin nga PD-ja të kundërshtarëve të brendshëm politikë dhe arrin të eliminojë në mesin e prillit gjithë forcën goditesë të opozitës së brendshme që dukej tepër e fuqishme dhe e vendosur për të luftuar nga brenda partisë. Berishën. Në aktivin e PD-së më 13.04, e kundërshtuan shumë pak njëri nga sa pritej dhe I detyron ata të largohen nga PD-ja. Më 24 të po atij muaji ata formojnë partinë e tyre «Levizja për Demokraci», partia e tretë që shkëputët nga grupimi më I madhë politik në vitin 1992 Stimulimi dhe përkrahja që iu bë njëriëve të këtij grupimi brenda në PD që nga fillimi I vitit kishte si synim nga njëra anë të frenonte dhe të dobësonte absolutitetin e figurës së

Berishës dhe rolin e tij në zhvillimet politike në vend dhe nga ana tjetër të shërbënte si një bazë e fuqishme ku të mbështetej përspektiva e PD-së, të paktën pa Berishën. Fitorja e Berishës në këtë plan, solli si pasojë edhe një «shtrengim» të rradhëve të PD-së. Bërthama e vogël e besnikëve që rrethonte Berishën edhe në kohrat më të veshtira, (të cilët duke mbrojtur Berishën, e përdornin njëkohësisht si mburojë për vete), tani u zgjerua nga kategoria e njërezve të inkriminuar ose të pasuruar në kohën e PD-së dhe që ishin trembur nga rrebeshi popullor. Gjallërimi i strukturave të kontrolluara nga Berisha erdhi dhe si rezultat i pamjaftueshmërisë së opozitës për ta penguar atë sidomos në çështje të tilla siç ishte miratimi i Ligjit Elektorale.

Kjo shenon edhe drejtimin tjetër të përpjekjeve të Sali Berishës për mbijetesë politike. PD-ja duke përdorur me kokëfortësi minorancën bllokuese në tavolinën e partive politike ashtu dhe shumicën në parlament, i futi partitë e tjera në një debat pa fund (prej më shumë se 15 ditë, duke thirrur madje dhe Vranickin në Tiranë) ,Kjo nisi, fillimisht me natyrën e ligjit, (PD-ja kërkonte çudetërisht një ligj mazhoritar kur ajo kishte pak mundësi të fitonte qoftë edhe në dhjetë zona , nëntë parti të tjera një ligj proporcional. Partitë opozitare tregonin kokëfortësi për t'u kaluar ideja e tyre dhe njëkohësisht tregonin se nuk ishin të gatshëm për të ruajtur bashkëpunimin para dhe pas zgjedhor.Ligji proporcional kuptohet që u vliente vetëm partive të vogla.Nga ana tjetër, duke e aprovuar në parlament,13-14.05, draftin e vet (me preteksin se Finua nuk çoi në parlament, në kohën e duhur draftin e qëverisë dhe meqëse zgjedhjet do të zhvilloheshin në fund të Qërshorit, përfundonte koha 45 ditore paraelektorale e parashikuar në ligjin kushtetues. Ligji u aprovua kur Finua ishte në SHBA i ftuar nga Ollbrajt.),i futi partitë politike kundër tij në një përpjekje të pafundme për t' i bërë këtij ligji arnimet e mundshme .

Kjo situatë u përserit edhe për ndërrimin e orarit të mbylljes së votimit nga ora 21 në ligjin e Berishës, në orën 18.U përserit më kërkësën e opozitës për heqjen e gjendjës së jashtëzakonshme, apo dhe me heqjen nga ligji të së drejtës partive të vogla që plotësonin 2 % për të përfituar 75 % të vendeve në parlament të pjesës proporcionale të ligjit.

Taktika e Berishës që kjo. Edhe pse kërkesat e tij binin shpesh ndesh më interesat e Partisë së tij , ai këmbëngulte në to i bindur se do të jenë partitë e tjera ato që do të luftonin për t'i hequr. Ai vetëm donte të fitonte kohë. Fakt është se ndërsa partitë e tjera mirren pikërisht me këto probleme, Berisha fillon i pari, pas Leka Zogut, fushatën elektorale Qëllimi i tij në fillimin i pari të fushatës elektorale , ishte:

E para. Bën për llogari të vet një testim në popull se sa i pranueshëm është. Nga ana tjetër kërkon t'i tregojë botës nëpërmjet TV-së se si vetëm ai, Sali Berisha, është i pranueshem nga populli.(,mëgjithëse e di shumë mirë që edhe shumë nga ata që nuk e duan shkojnë në «mitingjet e tij» për të parë ndoshta ku fshihet gjithë ajo prapësia e tij). Së dyti, duke i mbajtur gjithë partitë e frontit kundër tij të bllokuara në bisedime të pafund, kërkon t'i nërvोजоjë ato dhe t'i çorientojë, sidomos në qëndrimet ndaj perendimit. Madje, duke i detyruar të ndryshojnë disa hërë dhe qëndrimet e veta lidhur me zgjedhjet, tenton t'i kompromentojë me jo seriozitetin e vet., synon t'i tregojë popullit paaftësinë e opozitës për ta “mposhtur” atë, pra dhe paaftësinë qeverisese të saj.

Së treti .Por ajo që është më kryesore është se me këto pengesa ai krijon distancë kohore në komunikimin e partive të opozitës me popullin.. Keshtu Berisha duke shfrytëzuar këtë boshllëk komunikimi synon që vektorin e urrejtjes popullore ndaj tij ta kthejë dhe në vektoreë pakënaqësie ndaj partive kundërshtarë te tij. Kërkon pra te fragmetarizojë gjithnjë e me shumë frontin e deritanishëm unik kundër tij, si brenda popullit, ashtu dhe midis partive.

Së katerti Taktika e lojës së tij mbetet gjithashtu aplikimi i metodave perjashtuese të partive politike nga proceset politike, qoftë dhe ato zgjedhore.Kjo kuptohet do të çonte në dështimin e zgjedhjeve me

shkaktar kryesor këto parti dhe ai do të dilte dyfish I fituar. Më se një herë partitë politike të bashkuara apo dhe veç e veç kërkojnë, në këtë periudhë, të bojkotojnë zgjedhjet

Mëgjithatë ajo që i intereson më shumë Berishës, është përdorimi i taktikave përjashtuese të popullit nga votimi. Kjo do të thotë se kur numri i votuesve të PD-së sado i pakët, mbetet i pandryshueshëm, atëherë,sa me pak votues në zgjedhje aq më e lartë përqindja e PD-se.Kjo është arsyeja që Berisha ,votuesit e opozites kërkon t'i largojë nga vendi nga frika e pasigurisë, përpiqët t'i terrorizojë, e t'i tremb që të mos shkojnë në votime.

Këtij qëllimi, që përbën dhe drejtimin e tretë të veprimëve të Berishës për të fituar terren në zgjedhje, ai përpiket ta arrijë. Së pari me presionin ndaj partive për t'u distancuar nga Komitetet. Cdo tërheqje nga ana e tij përta I përket heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme apo dhe vet zhvillimin normal të zgjedhjeveBerisha dhe PD-ja e lidhnin me egzistencën e Komitetëve të Shpëtimit Publik. Qëllimi që I dyfisht. Nga njëra anë duke u detyruar partive distancimin nga këto Komitete, u hiqte atyre mbeshtetjën kryesore dhe të vetmën që I trembej realisht Berisha. Fundi I pushtetit të tij që I lidhur ndër faktorët e brendshëm , me këto Komitete. Nga ana tjetër , më menjanimin e këtyre komitetëve Berisha u hapte rrugën strukturave të veta për të mbjellë kaos, anarki, pasiguri. I hapte po ashtu rrugë edhe «marshimit» e tij elektoral, ashtu siç e mendonte, - «triumfal». Për këtë në një gazetë Irlandeze ,«Irish Times», më 25.05. Berisha deklaroi se «do t'i shtyp Komitetet e Jugut para zgjedhjeve»

Faktet dhe ngjarjet vërtetojnë katërcipërisht këtë. Rasti I sulmit mbi hotel Bolonja në Vlorë, apo I përplasjes midis bandave në Kripën e Vlorës, ku u përdorën armë të sofistikuara dhe mjete të blinduara. Provokimi I komitetëve në Tepelenë dhe Memaliaj. Tentativa e mjetëve të blinduara për të çarë rrugën në Tepelenë e Permet për të dalë në Gjirokastrë më 21 .05 dhe pjesëmarrja e po këtyre mjetëve në masakrën e Cerikut dy ditë më vonë. Kthimi I qytetit të Vlorës deri më 28 Qërshor në fushë beteje midis bandave rivale, në fakt për motive politike, janë fakte kuptimplotë që e vërtetojnë këtë tezë.Kjo përbën në fakt edhe një përpjekje të Sali Berishës I cili duke provokuar popullin, donte ta detyronte atë që edhe një herë të rimbente armët Kjo më siguri do të fuste në vallën e konfliktit të ri FMP-t për të vertetuar kështu tezen e vet se me armë në duar nuk bëhen zgjedhje. Ishte njëkohësisht edhe një mënyrë efikase për të trembur, e larguar sa më shumë zgjedhës nga Jugu, që s'ishin të tij , ashtu siç edhe u larguan.

Po ashtu përpjekja për të ruajtur socialistët larg nga Veriu I vendit (rasti kur Mejdani nuk lejohet të shkojë në Verilindje të vendit ,e Nanua në Shkodër dhe në Mirëditë) dhe disa episode në Jug me PD-në, (me Azem Hajdarin në Ballsh ku u qëllua mbi të në ajër dhe rasti me Leonard Demin në Sarandë), tregojnë se Berisha ishte I interesuar për të ruajtur, ose për ta mbajtur gjallë pretendimin e vet të përplasjes Veri - Jug dhe si pasojë ai të shpallej shpëtimtar.

Mëgjithatë, opozita duke patur me vete popullin edhe faktorin ndërkombëtar, po tregonte durim duke pritur vetëm momentin e zgjedhjeve e bindur në fitore.Mirëpo tërheqjet e njëpasnjëshme I krijuan mundësi praktike Berishës për ta penguar opozitën edhe pas fitorës në zgjedhje. Pamundësia e saj për ta çmontuar , jo Partinë Demokratike por faktorët që çuan në shkatërrimin e shtetit, për të dënuar kriminelet dhe për të instaluar në praktikë shtetit , treguan se kësaj opozite I interesonte thjesht pushteti dhe jo shteti.

RASTI I FUNDIT

(Në vend të pasthnjës)

Me shprehjen «rasti I fundit» në përpjekjen për të nënvizuar domosdoshmërinë e mobiliimit të të gjitha forcave për të parë përpara, u abuzua shumë. Thelbi I këtij koncepti ishte që të gjithë duhet të përpqëshin për të bërë shtetin si I vetmi institucion më të cilin lidhen prosperiteti I një vendi apo dhe kombi. Situata në vend imponon nëvojën e një ndryshimi epokal që lidhet fillimisht me përpunimin e një ideali të lartë brenda kuadrit të pranueshëm të aspiratave të popullit, me angazhimin total të intelektualëve, institucioneve të kulturës, të arsimit ,të letrave dhe të shkencave, të gërshetuar me kontributin e forcave politike progresiste.

Revolucioni Freng u bë me frymëzimin e një ideali trikomponentësh, Liri ,Barazi Vëllazerim. Kombi gjerman i rezistoi pushtimit Bonapartian duke i kundërvënë klasicizmit të kulturës ushtarake të N Bonapartit, romantizmin popullor të vitatilitetit të racës ariane. Vetë lufta jonë Nacional-Clirimtare u zhvillua nën frymëzimin e aspiratave për liri dhe një sistem shoqëror të emancipuar.

Ky përpunimi ideali fillon me mbrojtjen morale të njerëzve , që presupuzon çlirimin e tyre nga terrori psikologjik i përjashtimit nga pjesëmarrja aktive në zhvillimet në vend, nga psikoza se servilosja ndaj pushtetit dhe korrupsioni janë mënyrat më të mira për të jetuar dhe krijimi i bindjes se demokracia e aspiruar fillon tek indivindi kur ai nuk e lyp lirinë dhe të drejtat e veta, kur, si qytetari i thjeshtë dhe njeriu i mekanizmit shtetëror e ndjen se është i mbrojtur dhe njëkohësisht i rrezikuar nga ligji dhe jo nga njëriu që e ka në dorë këtë ligj.

Faktoret qe spikatin në lëvizje të tilla janë dy. Popujt si mishërim i idealit dhe frymëzuesit e idealeve, që janë intelektualët dhe politikanët

Mirëpo në gjashtëmujorin e zhvillimeve të vrullshme në vendin tonë u vu re një shtresim dhe një shpërndarje e faktorëve të tillë që përbëjnë bazën e ndryshimeve epokale. Në kohën e Lëvizjes Popullore për Demokraci, u vu re se faktori popull veproi në pararojë. Lëvizja e tij karakterizohej nga pragmatizmi, (parat e humbura) dhe nga ideali i cili drejtohej kundër diktatorit Berisha. Faktori intelektual ose u vetëpërrjashtua ose ishte i dyzuar,pra pak e frymëzoi apo e udhëhoqi këtë Lëvizje për të afirmuar aspiratën e popullit e shprehur nga ai vetëm si mohim. Ndërsa njëherë e politikës prisnin gështenja të pjekura dhe te qëruara, duke bërë që më kalimin e kohës të krijohet terreni për lulëzimin e banditizmit , kriminalitetit dhe kaosit të përgjithshëm.

Kjo situatë u trashëguar edhe pas zgjedhjeve . Ideali u këmbye nga pragmatizmi fatal I shfrytëzimit të pushtetit për të zhvatur vlerat e krijuara nga populli që ia beson për ruajtje shtetit. Rasti I fundit u konceptua nga pushtetarët e rinj si një rast I fundit individual për t'u pasuruar. Rrethi I politikanëve u ngushtua shumë nga numri I madhë I bodygardëve dhe I njerëzve të tjerë që treguan devotshmeri dhe servilizëm pa I lenë ata të shikonin mbi kokat e tyre as popullin e as aspiratën e tij për të pasur një shtet. Ideologjia e re e meritokracisë dhe e gjithëpërfhsirjës u zëvendësua shumë shpëjt nga militantizmi dhe nepotizmi.

Lufta për çmontimin e atyre strukturave që prodhonin korrupsion, kontrabandë dhe vdekjen e shtetit, u shndërua në një hakmarrje e strukturave të njejta për me ngjyrë tjetër politike duke krijuar kështu precedentin e rrëzikshëm të rotacionit të pushtetit mbi baza të tilla.Partitë pretendente për pushtet në kuadrin e gjithëpërfhirjës, zëvendësuan opozitën konstruktive me mbajtjen njëra tjetrës të asove nëpër mëngë.

Intelektualët dhe njerëzit e ndërshëm u pakësuan edhe më ose u shpallën njerëz të tepërt. Shqipëria, tani në fund të shekullit njëzet arriti të kishte një popull të zhgënjyer dhe njëkohësisht një brez fatkeq të humbur intelektualësh. Këto shtresa rrugën e shpëtimit e gjetën tek ikja nga vendi. Ndërsa brezi I humbur quhet fatkeq se jo vetëm pa t'i treteshin idealët, por njëkohësisht ata nuk kanë asnjë mjet jetese. Kështu ata ose detyrohen të tradhetojnë këto ideale duke u përfshirë në klanët zhgënjyese, ose pranojnë të largohen nga vendi duke krijuar një vakum idealesh dhe idealistësh për të cilët vendi ka nevojë më shumë së çdo gjë tjetër.

F U N D